

**Dr. Nuhi Veselaj**

**RRETH IDENTITETIT TË  
GJINISË ASNJANËSE NË  
SHQIPEN E SOTME**

**Prishtinë, 2013**



***Përshëndetje!***

***Lexues i nderuar,***

***Kjo vepër si punim-sprovë me titull “Rreth identitetit të gjinisë asnjanëse në shqipen e sotme” në version pak më të shkurtër është publikuar së pari në veb-faqe [zemrashiptare.net](http://zemrashiptare.net), në 10 vazhdime (03.11.2009 – 25.04.2010) dhe së andejmi e plotë në Google (Akllapi net A.G/ Kuvendi L.) Vlerësuesit dhe publikuesit i falenderoj nga zemra.***

***Tashti, pas rishikimit e përpunimit të lëndës, u bë edhe ndonjë përplotësim, pos tjerash, përveç 3 tipave të asnjanësit të trajtuar në atë version: asnjanësi i mirëfilltë i paparanyjzuar, asnjanësi prembiemëror i paranyjzuar dhe asnjanësi prepjesor i paranyjzuar, këtu u përfshi edhe tipi i katërt: asnjanësi në shprehjet ablativale (prejrrjedhore).***

***Kemi bindjen se nga trajtimi i bërë kryesisht në aspektin sinkronik, identiteti i emrit të gjinisë asnjanëse në shqipen e sotme del më i plotë se në çdo punim të mëparshëm kushtuar kësaj teme, prandaj gramatikanët e standardologët e sidomos studiuesit e gjuhës sonë do të bënin mirë që rezultatet dhe sidomos risitë e këtij punimi t’i keni parasysh e t’i vlerësojnë dhe studimet kërkimore shkencore t’i çojnë më tej.***

***Autori***

***Prishtinë, janar 2013***

**Redaktor:**

**Recensues**

- 1. Prof. dr. Abdullah Zymberi**
- 2. Prof. Dr. Begzad Baliu**

## **Pasqyra e lëndës:**

Parathënie

Sqarim

Konstatime paraprake

1. Rreth kundërthënieve (nën)tekstore të sipërshprehura
2. Konstatime nga normativi “Gjuha letrare shqipe për të gjithë”
3. Konstatime nga prof. Kolec Topalli
4. Konstatime tona vetjake

### **I. PRANIA E ASNJANËSVE NË SHQIPEN LETRARE (FSHS 2002) DHE GRUPIMI I TYRE SIPAS NYJË-MBARESËS SË NJËJËSIT TË SHQUAR**

- 1) Grupimi i asnjansve sipas nyjë-mbaresave të njëjësimit të shquar
- 2) Konstatime rreth grupimeve të mësipërme
  - a) Grupimi sipas tipit të nyjë-mbaresave të shquarsisë
  - b) Grupimi përkatës dhe numri i shembujve

Tabela e numrit të asnjansve të regjistruar në FShS 2002.

### **II. NËNFUSHAT SEMANTIKE SIPAS TIPAVE TË ASNJANËSVE NË SHQIPEN LETRARE**

#### **A. ASNJANËSIT E TRASHËGUAR SI EMRA TË MIRËFILLTË (TË PAPANJËZUAR)**

#### **B. ASNJANËZIMI I MBIEMRAVE TË PAPANJËZUAR**

- a) Prejmbiemërorët me kuptimësi cilësie
- b) Prejmbiemërorët me kuptimësi gjendjeje a të qeni
  1. Rreth kuptimit strumbullar të asnjansit prejmbiemëror
    - a) Rreth sinonimisë së asnjansve prejmbiemërorë të cilësisë
    - b) Rreth sinonimisë së asnjansve prejmbiemërorë jociësorë
  2. Sqarime të tjera rreth kuptimësisë së prejmbiemërorëve  
Skema ndërsinonimike e prejmbiemërorëve
  3. Shembuj ilustrues fjalisor në përputhje me skemën e mësipërme
    - a) Nga grupimi i prejmbiemërorëve me kuptimësi cilësie
    - b) Nga grupimi i prejmbiemërorëve me kuptimësi jociësore (gjendjeje a të qeni)
  4. Vazhdimi i sqarimeve në raportin asnjansi prejmbiemëror/ barsvlerësit sinonimikë
    - 1) Specifikimi i nënfushave semantike kusht i bashkëjetesës sinonimike
    - 2) Gjinia mashkullore si trajtë përfaqësuese e emërtimit të njerëzve sipas gjendjes a veprimtarisë së tyre
    - 3) Rreth zhvillimit të strukturës sinonimike të prejmbiemërorëve

#### **C. ASNJANËZIMI MBI BAZË PJESOREJE**

1. Grupimi i asnjansve prejpjesorë sipas profilit të nënfushës semantike

2. Disa nga karakteristikat e veçanta të asnjansve prejpsorë

### III. FAKTOGRAFI RRETH SHTRIRJES SË PËRDORIMIT TË ASNJANËSVE PREJPJESORË NË GJUHËN SHQIPE

1. Rreth qëndrimit jo të qartë teorik e praktik ndaj asnjansve prejpsorë në shqipen e sotme letrare

2. Rreth përfshirjes së asnjansve në burime të caktuara leksikografike të gjuhës sonë.

### IV. VENDI I ASNJANËSVE PREJPJESORË NË KUADËR TË PREJPJESORËVE TË TJERË

1). Treshi sinonimik dhe emërtimi i proceseve tekniko-teknologjike në gjuhën shqipe

2) Shembuj tipikë të treshit sinonimik të shqipes në krahasim me dy gjuhë të huaja në kontakt

3) Nënfishat semantike në raportin asnjansi prejpsor / barasvlerësi sinonimik

4) Skema e shembujve të treshit sinonimik sipas nënfushave semantike të tyre

Konstatime nga skema e mësipërme

Sipërfundim

### V. KONSTATIME TË TJERA PLOTËSUESE RRETH IDENTITETIT TË ASNJANËSVE TË PARANYJËZUAR

1. Rreth identitetit formal gramatikor

a) Raporti ndërgjinisior: asnjans/mashkullor/femëror

Shënim

b) Raporti një-përcaktuese e përparme joshquese ndaj emrit të gjinisë përkatëse

c) Raporti asnjans/mashkullor, sipas një-mbaresës shquese

2. Rreth identitetit semantik plotësues të asnjansve në raport me sinonimikë të tjerë.

Skema e dallimeve ndërgjinisore sipas një së përparme dhe të një-mbaresave të shquarsisë

### VI. ANASHKALIMI I VLERA VE REALE TË ASNJANËSIT NË SHQIPEN E SOTME LETRARE PASOJË E KONSTATIMEVE TË NXITUARA APO JO?

1) Çka mësojmë nga reagimi i prof. A. Xhuvanit

2) Pasojat nga zëvendësimi i asnjansit prejpsor me trajta foljore në FGJSSH 1980

3) Rreth një konstatimi të nxituar kundërthënës të prof. A. Kostallarit

Sipërfundim

### VII. ÇËSHTJE TË HAPURA SPECIFIKE RRETH ASNJANËSIT NË SHQIPEN E SOTME

1) Rreth përkufizimit terminologjik të emërtimeve të tre tipave të identifikuar të asnjansve

2) Rreth identifikimit të asnjansit prejrrjedhor (ablatival)

1. Nga gramatika e Akademisë

- a) Nga morfologjia e gjuhës shqipe
  - b) Nga sintaksa e gjuhës shqipe
  - 2. Nga punimi i prof. Shaban Demirajt
  - 3. Nga konstatimi i prof. Kolec Topallit
  - 4. Nga Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (2011)
  - 3) Çështje rreth përkufizimit të nënfushës semantike të asnjësve
  - 4). Disa vërejtje për çështje të veçanta
- Sipërfundim

#### VIII. MENDIMI PËRMBYLLËS PËRGJITHËSUES RRETH IDENTITETIT TË ASNJANËSVE NË SHQIPEN E SOTME

1. Konstatime përgjithësuese
2. Përkufizimi përmbyllës i profilimit të nënfushave semantike që mbulojnë katër tipat e asnjësve
  - a) Asnjësit si emra primitivë të paparanyjësuar
  - b) Asnjësit mbi bazë të mbiemrave të paranyjësuar
  - c) Asnjësit prejpjesorë të paranyjësuar
  - ç) Asnjësit në shprehje prejrrjedhore (ablativale)

Përfundime rreth profilimit të nënfushave semantike të asnjësve
3. Edhe disa konstatime përgjithësuese rreth asnjësve
  - Konstatime përmbyllëse
  - Rezyme
  - Literatura kryesore





## Parathënie

Gjinia asnjane e emrave në gjuhën shqipe nuk është temë e patrajtuar në gjuhësinë tonë, si në aspektin historik ashtu edhe në atë aktual. Mirëpo, në studimet e deritashme, jo aq në rrafshin diakronik sa në atë sinkronik, vërehen mjaft paqartësi, madje edhe konstatime jo plotësisht të sakta, të cilat sadopak do të vihen në pah ose do të trajtohen në këtë punim.

Në të vërtetë, në burimet e deritashme, përveç identifikimit të tipave përkatës brendagjuhësorë, janë vënë në dukje, mjaft mirë, edhe disa nga veçoritë e veçanta të kësaj kategorie në shqipe në krahasim me asnjanesit e gjuhëve të familjes indoevropiane që e kishin ose që ende e kanë të gjallë një gjini të tillë. Madje, me sa jemi në dijeni, si karakteristika të veçanta brendagjuhësore të asnjanesit të shqipes që nga faza e dokumentimit të saj, si gjuhë e folur dhe si gjuhë shkrimi, në burime të caktuara, kryesisht përmenden më poshtë:

E para, ndonëse thuhet se shqipja gjininë asnjane e ka të trashëguar nga gjuha i.e., gjuhësia jonë dhe përgjithësisht është konstatuar, me të drejtë, se trajtat e vjetra të protoshqipes do të jenë zhdukur në periudha të hershme, ndërsa që të tre tipat e sotëm të asnjanesve të shqipes, të trajtuar në burimet tona normative: *asnjanësit e mirëfilltë të paparanyjzuar (primitivë)*, *asnjanësit e paranyjzuar prejmbiemërorë dhe asnjanesit e paranyjzuar prejpjesorë*, janë krijime relativisht të vona. Që të tre tipat janë zhvillime të brendshme të shqipes, por të përfutur e të përdorur mjaft gjatë, shekuj me radhë, prandaj edhe gjurmë të tyre të hershëm nuk mungojnë. Zhvillim i brendshëm është *edhe asnjanesi i paranyjzuar prejrrjedhor (ablatival)*, i cili përdoret i ndajfoljezuar në shprehjet përkatëse, *qoftë në kuadër të ndajfoljes, ose të togfjalëshit të kallzuesit të përbërë foljor*, që ne, për të veçantat që ka në krahasim me tre tipat e sipërpërmendur, në këtë punim, e trajtuam si tip më vete.

**Sqarim:** *Me qenë se tipi i katërt i asnjanesit del si fjalë analitike e përbërë prej një fjale shërbyese pjesëza së dhe + një fjalë shënuese, (pjesore, mbiemër ose njësi tjetër gramatiko-leksikore), si p.sh: së + pjesore, së kënduari, së + mbiemër së gjati, së + ndajfolje së bashku etj. dhe, hë për hë, nuk ka një emërtim të vetëm, të veçantë që përfshin të dyja grupet e nëngrupet, edhe pse edhe asnjanesi i tipit së kënduari mund të quhet: asnjanes i paranyjzuar prejpjesor i rasës rrrjedhore i togfjalëzuar në kallzuesin e përbërë, ndërsa grupi tjetër tipi së gjati: asnjanes i paranyjzuar prejmbiemëror i rasës rjedhore i ndajfoljezuar, ne parapëlqyem termin asnjanesi i paranyjzuar në shprehje prejrrjedhore ose asnjanesi ablatival (prejrrjedhor), duke pasur parasysh faktin se me fjalë-termin shprehje (lokucion) quhet një grup fjalësh me veçori të dallueshme nga kuptimi e funksioni, siç në të vërtetë janë pothuaj të gjitha shprehjet asnjane prejrrjedhore edhe kështu përfshimë të dyja grupet në një emërtim, por kjo nuk do të thotë se gjatë analizës, kur trajtohen veçoritë e të dyja grupeve, nuk do të përdoren terma ose*

*shprehje të tjera adekuate. Sigurisht për ne do të jenë më të pranueshëm termat, kur të vendosen institucionalisht.*

E dyta, si veçori e parë formale dhe funksionale e dallimit të një emri si asnjans ndaj dy gjinive të tjera përmendet një-mbaresa **-t(ë)**, p.sh.: *mish-të, të mirë-t, të menduar-i/t* e numrit njëjës në rasën emërore në trajtën e shquar, për ndryshim, pra, nga gjinia mashkullore gramatikore që po në njëjës in e shquar merr një-mbaresat e shquarsisë **-i** ose **-u**: *punëtor-i, njeri-u* si dhe nga gjinia femërore, e cila po në këtë trajtë shquarsie merr një-mbaresën **-a** ose **-ja**, p.sh.: *nën/ë-a, lul/e-ja*, ndërsa për tipin e katërt kjo çështje mbetet e veçantë, sepse ata nuk dalin në trajtën e shquar dhe si një të parme nuk e kanë **të** po **së**, trajtë kjo arkaike e rrjedhore.

E treta, gjithashtu asnjansit dallohet formalisht e semantiksht edhe nga mbiemri a emri i paranyjësuar në trajtën e pashquar të numrit njëjës në rasën emërore etj. dhe kjo shihet më së miri, kur emri përkatës parashoqërohet me një-treguesin numëror **një**, si një joshquese, sepse po në këtë rasë asnjansi parashoqërohet me një e përparme **të** (+ fjala përkatëse), ndërsa emrat, zakonisht të emëzuar nga njësi të tjera leksiko-gramatikore (prejmbiemërorë a prejpjesorë e të tjerë) të dy gjinive aktive (mashkullore e femërore) marrin nyjat përkatëse të përparme, në mashkullore **i** (+ fjala përkatëse) e në femërore **e** (+ fjala përkatëse). P.sh. asnjansi **një të bardhë** ndaj *një i bardhë* (frymor m.) ose *një e bardhë* (frymor a abstrakt f.) ose **një të menduar as**. ndaj m. *një* (person a veprim.) *i menduar* ose f. *një* (personë a punë) *e menduar*. Në të vërtetë, siç del nga shembujt e mësipërm emri në mashkullore ose femërore është i emëruar nga njësi të tjera joemra edhe me kuptim konkret frymori ose me kuptim abstrakt, varësisht nga konteksti..

E katërta, si veçori tjetër e asnjansit të shqipes në krahasim me gjuhë të tjera, po përmendim faktin se në gjuhën tonë asnjansi del i identifikueshëm edhe si fjalë e thjeshtë sintetike, siç është tipi i parë i asnjansve dhe si fjalë *analitike*, siç janë tre tipat e paranyjësuar. Në të vërtetë, tre tipat e asnjansit të paranyjësuar konsiderohen si trajta të përfutuara më vonë në krahasim me tipin e parë dhe quhen emra *asnjans analitikë* vetëm pse janë të pajisur edhe me një e përparme. Krahaso: nyja e përparme **të** + mbiemri i emëruar (*të mirët*) – *tipi prejmbiemëror* ose nyja e përparme **të** + pjesorja e emëruar (*të dalët*) – *tipi prejpjesor* ose nyja e përparme **së** + pjesorja ose mbiemri i emëruar (*së menduari, së mbari*) – *tipi i shprehjeve prejrrjedhore*.

E pesta, edhe sa i përket ndërtimit dhe fushës semantike që mbulojnë asnjansit e katër tipave dallojnë nga njëri tjetri. Ndërsa *tipi i parë*, asnjansi i paparanyjësuar zakonisht del i përfutur si emër i mirëfilltë për të mbuluar kryesisht koncepte nga fusha e konkretizimit, duke emërtuar jo emra të një nënfushë semantike të specifikuar, por të ndryshme, zakonisht nocione të emrave të lëndëve të panumërueshme ose nocione të pjesëve të trupit të njeriut etj. (*ujtë, kryet*), *tipi i dytë*, asnjansit e paranyjësuar prejmbiemërorë të përfutur kryesisht sipas motivimit që u jep tema prodhuese mbiemërore, dalin të specifikuar në atë nënfushë semantike, ku shprehen zakonisht nocione abstrakte *të një cilësie, gjendjeje a të qeni*. Po ashtu edhe *tipi i tretë*, *asnjansit prejpjesorë* dalin të specifikuar për një nënfushë të veçantë semantike, ku shprehen zakonisht koncepte veprimi ose ide të konceptuara veprimtarish. *Tipi i katërt*, *asnjansit prejrrjedhorë*, për të cilët thuhet se duke kaluar në shtresën arkaike e kanë të humbur motivin e ndonjë specifikimi të veçantë të mëvetësishëm, siç e kishin dy tipat e tjerë parashësorë, por edhe këta me tiparin e emrit abstrakt (prejpjesor a prejmbiemëror),

qoftë si pjesë përbërëse të kallëzuesit, qoftë në funksion të shprehjeve ndajfoljore e ruajnë tiparin e emrit abstrakt, dhe kështu mbulojnë fusha semantike lidhur me veprimet përkatëse.

E gjashta, që nga faza dokumentuese e shkrimit të gjuhës sonë e gjithnjë në vijimi konstatohet se asnjësi i të tre tipave të parë, nuk i ka të zhvilluara të gjitha kategoritë morfologjike (numrin e rasën) qysh i kanë emrat e dy gjinive të tjera, dhe si pasojë gjinia e tillë paraqitet me paradigma të mangëta (për nga numri e rasa). Tipi i katërt si prejpjesor ose si prejmbiemëror i emëruar, duke kaluar në funksion ndajfoljeje, nuk e ruan aspak kategorinë e lakimit në rasa, ngase përdoret si fjalë e ngurëzuar. Mirëpo jo vetëm për këtë, por edhe për disa elemente të tjera gjinia asnjësi e emrave në gjuhën shqipe nuk mund të krahasohet si gjini e barabartë me dy gjinitë e tjera, por edhe emrat e tillë të katër tipave kanë specifika të veta të veçanta që nuk i kanë emrat e dy gjinive aktive dhe kështu e përplotësojnë strukturat përkatëse në sistemin emëror të shqipes.

E shtata, është konstatim me vend, ndonëse në finesa shfaqen përjashtime, se asnjësi e mirëfilltë (primitivë) që shprehin zakonisht nocione të gjë-sendeve konkrete jogjinisore, ndërkohë, duke i përzier ose duke i përvetësuar treguesit e emrave të gjinisë tjetër përkatëse, por pa u larguar nga rrënjëzori fjalëformues, shkallë-shkallë janë integruar ose janë në shkrirje e sipër në gjininë përkatëse aktive, më shumë në gjininë mashkullore e më pak në atë femërore.

E teta, edhe për asnjësi të paranyjëzuar si emra analitikë, që shprehin zakonisht nocione abstrakte, por edhe të tjera, janë dhënë mendime jo të padiskutueshme se edhe këta kanë pësuar *rrudhje* sa u përket nënfushave semantike e së këtejmi kanë edhe pakësim numri(!), jo nga shkrirja në gjini tjetër, siç ngjau me asnjësi të tipit të parë, po kanë humbje (zhdukje!) nga konkurrenca d.m.th. nga zëvendësimi i tyre me emra të prejardhur abstraktë sinonimikë të tipit sintetik. Kështu, thuhet, se prejmbiemërorë e rasës emërore janë zëvendësuar kryesisht me emrat e prejardhur me prapashtesën *-si*, ndërsa prejpjesorët e rasës emërore me emrat e veprimet me prapashtesat *-im* ose *-je* a ndonjë tjetër. Për këtë shkak, siç thuhet, edhe numri i asnjësve të këtyre dy-tre tipave është zvogëluar shumë dhe priret të zvogëlohet edhe më(!). Si pasojë e një bindjeje të tillë, për ne, *jo të pleqnueme* drejt, edhe këta dy tipa bashkë me tipin e parë janë karakterizuar nga ndonjë ose nga disa teoricienë të standardologjisë së gjuhës sonë si *mbeturina(!)*, pa të ardhme në standard dhe si të tillë supozohet se do të mbesin në raste vetëm si relikte a si trajta arkaike(!?).

Pikërisht konstatimet e fundit, nga pika 8, lidhur me pasivizimin deri në zhdukje të asnjësve *en bloc* (për të tre a katër tipat) që ne i mbyllëm me pikëçuditje e pikëpyetje në kllapa, i quajmë konstatime të *nxituara, jo të qëndrueshme ose jo të pleqnueme drejt dhe gjithsesi shumë të diskutueshme*. Po shtojmë edhe këtë se *jolumnisht*, konstatime të tilla, pra *shumë të diskutueshme ose jo të pleqnueme drejt* i ndeshim, pothuajse, në të gjitha punimet shkencore e si rrjedhojë edhe tekstet relevante shkollore e universitare përkatëse të gjuhës sonë. Ne i quajmë *konstatimet e tilla të guximshme*, sepse siç do të shohim në këtë punim ato bien ndesh me realien, me realitetin tonë gjuhësor.

Kur themi kështu kemi parasysh dy fakte që nuk janë vërejtur ose nuk ishin të njohura sa duhet më përpara nga studiuesit e caktuar

e para, në studimet e deritashme nuk është vërejtur mjaftueshëm fakti se asnjansit e paranyjëzuar, të dy tipat joprejrrjedhorë, nuk u zëvendësuan dhe as sot nuk po zëvendësohen plotësisht nga sinonimikët përkatës në fushën e abstraksionit që, sipas motivimit, e kishin si destinacion të parë, por janë të zëvendësueshëm ose prirën të zëvendësohen vetëm për një pjesë të fushës përkatëse të abstraksionit, i cili sadokudo ka edhe koncepte me elemente konkretësie dhe

e dyta, nuk është vërejtur gjithashtu fakti se prodhueshmëria dhe aktiviteti i asnjansëve të paranyjëzuar prejmbiemërorë dhe sidomos i atyre prejpjesorë, në shqipen e sotme, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar, faktikisht nuk del i zvogëluar. Gjithsesi dhe kurrsesi në atë masë sa të konsiderohen, emrat e tillë *si mbeturinë(!)*. Përkundrazi numri i tyre, varësisht nga konteksti, po shënon rritje ose, siç do të shohim, ka mundësi të pakufizuar shumimi.

Për një kundërvënie të tillë ne bazohemi jo vetëm në realitetin tonë të përgjithshëm gjuhësor dialektor, por edhe në gjuhën e sotme standarde. Po si ndodhi, pra, një lajthitje e tillë me elemente patologjike ose a pati fare lajthitje? - mund të pyesë dikush. Edhe ne i bëmë vetvetes një pyetje të tillë, prandaj jemi përpjekur me e zgjidhë enigmën në 8 kërret e këtij punimi (monografi), të titulluar: ***Rreth vetëvetësisë (identitetit) të asnjansit në shqipen e sotme***, ku mjaft në hollësi dhe thellësi jemi përpjekur me trajtue këtë temë..

Pa u zgatur shumë, këtu po themi se një lajthitje e tillë, nëse mund të quhet kështu nga dikush-dikushi, konstatojmë me plotgojë se ajo nuk ekziston. Nuk ekziston në kuptimin se ç'është e vërteta studiuesit tanë me dritën e shkencës në mendje ndërkohë, në ecje e sipër, duke u ngjitur malit të dijes, patën hyrë mjaft thellë në pyllin e panjohur të sistemit emëror e foljor të gjuhës sonë dhe atë që e panë në atë pyllnajë, teorikisht e përmbajtësish edhe e patën trajtuar (shënuar) mirë në burimet përkatëse të publikuara, por ata për shkaqe të ndryshme, sigurisht edhe të arsyeshme, objektive e subjektive, nuk patën mundësi me depërtue edhe më në thellësi të asaj pyllnaje, andaj për pjesën e pashkelur dikush prej tyre pati dhënë ndonjë supozim, e supozimet ose parashikimet herë-herë mund të dalin të qëlluara e herë-herë jo. Prandaj për këtë askush nuk duhet fajsuar si i lajthitur.

Ne, ç'është e vërteta, rastisëm të hyjmë pak më thellë në atë pyll, duke ecur rrugës që trasuan ata, për çka i falënderojmë shumë. Mbase pak rrugë hapëm edhe vetë, siç do të shihet nga kjo sprovë jona, apo jo, le të vlerësohet. Kështu themi kur e kemi fjalën vetëm për temën në shqyrtim. Në këtë kontekst, është e vetëkuptueshme, mendojmë ne, se për temën në shqyrtim, pse nuk është studiuar më thellë askush nuk duhet të fajësohet. Pra, asnjëri për atë që s'ka pasur mundësi ta shohë e ta njohë nuk mund të kritikohet. Më parë mund të fajësohemi ne, nëse nuk jemi të zotët me e paraqitë atë risi që e kemi parë e konstatuar dhe njëherazi, mbas tashti, mund të fajësohen edhe më shumë ata përgjegjës nga vendi i punës a pozita që mbajnë, ose nga punët e detyrat që kryejnë në shoqëri, që pasi të vërtetohen risitë shkencore e praktike, të cilat, tashmë, po dalin sheshazi, në dritën me diell sprovash diturie, nuk i interpretojnë si e sa duhet ose edhe nuk i përfillin e zbatojnë apo edhe nuk i bëjnë korrigjimet ose përplotësimet e nevojshme në burimet përkatëse destinuar kësaj teme.

Pra, konfuzioni ka ndodhur pa të keq, sepse studiuesit që i njohim ne, të cilët do të cekën ose edhe jo të gjithë, në këtë punim, me veprat e tyre nuk kanë mundur ta shohin çështjen në fjalë më thellë sinkronikisht, sepse disa prej tyre tërë energjinë e kishin shpenzuar në shndritjen e gjërave nga pikëpamja historike, ku diakronikisht kanë korrur, vërtet, suksese të pamohueshme, kurse nga aspekti aktual sinkronik janë mjaftuar, si me thënë, me të dëgjuar nga të tjerët ose me ndonjë vështrim sipërfaqësor dhe vetëm të një nënfushe semantike, si të themi gjysmabstrakte-gjysmëkonkrete, d.m.th. e patëm nën vëzhgim procesin e veprimit, vetëm nga një pikë, qoftë vetëm veprimin si proces ose vetëm rezultatin e veprimit, në njërën anë e jo edhe idenë e konceptimit në majat më të larta të abstraksionit, në anën tjetër.

Me fjalë të tjera, kur është çështja te nënfusha semantika e vetë procesit të veprimit dhe të rezultatit e kanë hetuar mjaft mirë, sepse këtu me të vërtetë asnjësi përkatës në konkurrencë me sinonimikë të tjerë, ka pësuar *rrudhje*, pasivizim e në raste edhe zhdukje *në dukje*.

E themi, *në dukje*, sepse asnjësi e tillë nuk kishin pësuar zhdukje të vërtetë, siç do të shpjegohet në këtë punim, ngase kishin bërë tërheqje taktike të natyrës praktike, duke marrë përqendrim të ri pozicionimi në një nënfushë të përafërt semantike, jo për të shprehur nocionin e vetë procesit të veprimit, dhe as të rezultatit të veprimit, por për konceptin e shkallës më të lartë të atij nocioni në fushën e abstraksionit, prandaj ne gjykimet e tilla rreth rrudhjes a shuarjes së përgjithshme të asnjësve të paranyjzuar i quajtmë *konstatime të nxituara*.

Sidoqoftë, edhe në këtë punim-sprovën tonë, sigurisht mund të kenë mbetur gjëra të diskutueshme ose të pazbardhura mirë, përveç atyre që pamë ne, pasi nuk kemi mundur ta konsultonim tërë materialin që ndoshta ekziston rreth kësaj teme. Fundja, as që pretendojmë se kemi dhënë përgjigje shteruese për të gjitha çështjet e diskutueshme lidhur me këtë, megjithatë kemi bindjen se temën në fjalë e kemi trajtuar më në hollësi, thellësi dhe gjerësi seç është bërë, me sa dimë, më përpara në aspektin sinkronik nga studiuesit tanë. Së këtejmi, kërkojmë dhe shpresojmë që përpjekja jonë për zbardhjen e problemit në fjalë, do të mirëkuptohet nga dashamirësit e shkencës së gjuhës sonë dhe sidomos nga kuadrot përgjegjës të standardologjisë shqipe, në mënyrë që shembujt e kësaj gjinie gramatikore: asnjësi e paranyjzuar të vlerësohen më drejt, dhe së këtejmi që tashti, menjëherë dhe në të ardhmen edhe në interpretim më mirë të zënë vendin e merituar në kuadër të mozaikut të sistemit emëror të shqipes.

Në fund, kërkojmë nga lexuesi i nderuar që gjatë leximit dhe pasi ta lexojë e rilexojë punimin në tërësi të mbajë qëndrim kritik. Për çdo vërejtje a vlerësim do të jemi mirënjohës. Shfrytëzojmë rastin të falënderomë recensuesit, në mënyrë të veçantë **prof. dr. Abdullah Zymberin**, të cilët jo vetëm pse dhanë vlerësimin pozitiv që i bënë këtij punimi, (me gojë e me shkrim), por edhe për guximin që patën për të mbështetur qëndrimin tonë në dukje të guximshëm, ngase nuk është lehtë me dalë në kundërvënien ndaj konstatimeve të mëparshme të disa studiuesve tanë të njohur, konstatime këto, të cilat edhe janë konsideruar si të vërteta të pakontestueshme e që ne i quajtmë *të nxituara*.

Prishtinë, janar 2014

Autori



### *Konstatime paraprake*

Historianët e gjuhës shqipe kanë konstatuar se në periudhën paradokumentuese, përveç emrit të gjinisë mashkullore dhe asaj femërore ishte shfaqur në gjuhën tonë edhe emri i gjinisë asnjane, i cili ka lindur sigurisht nga nevoja për t'i dalluar emrat përkatës nga dy gjinitë e tjera natyrore, mashkullore e femërore ose ndërkohë për të plotësuar ndonjë *vacuum* në strukturën përkatëse gramatikore, ashtu siç ka ndodhur edhe në gjuhët simotra të familjes i.e. e të tjera.

Në të vërtetë, që në atë periudhë të dokumentimit në gjuhën shqipe dallohen këta tipa asnjane:

së pari, si më të hershëm konsiderohen, pa dyshim, *emrat asnjane të mirëfilltë (primitivë) të paranyjzuar*, me të cilët emërtoheshin koncepte të fushës konkrete e abstrakte të spektrit të gjerë, megjithatë, mund të thuhet se, ndërkohë shihet njëfarë përqendrimi i tyre rreth emërimit të lëndëve (ushqimore) më të përdorura të kohës, zakonisht jo të numërueshme, si dhe në disa emra të veçantë të pjesëve të trupit e të tjerë, zakonisht të pandashëm në ekzemplarë, shembuj këta, që disa prej tyre dalin të identifikueshëm sipas formës së formimit edhe në gjuhën e sotme, siç janë emrat: *mish-të, ujë-t, krye-t, anët(ë)*, e ndonjë tjetër;

së dyti, *emrat asnjane prejmbiemërorë të paranyjzuar*, të cilët u përfatuan më vonë, sipas gjase jo ekskluzivisht për emërtimin e gjërave konkrete, por për koncepte të fushës abstrakte, siç janë konceptet e tipareve të veçanta që i ka mbiemri: të *cilësisë, të gjendjes a të qenit* (tipi: të *mirë-t, të keq-të, të gjallë-t*);

së treti, *emrat asnjane prejpjesorë të paranyjzuar*, që edhe këta, duke ndjekur pas vijën së formës së formimit të prejmbiemërorëve, u krijuan fillimisht për të mbuluar nocione abstrakte, siç janë në radhë të parë, emërtimet e proceseve të caktuara të veprimit e pastaj u shtrinë edhe në ndonjë nënfushë tjetër (tipi: të *menduar-it, të dalë-t, të shkruar-it, të rrezatuar-it*) dhe

së katërti, *emri asnjane ablatival*, pothuajse mbeturinor, që u quajt prej nesh **prejrrjedhor**, sepse del i përftuar në shprehje mbi bazë të rasës arkaike rrjedhore, të cilat në ditet tona, si të thuash, duken si të ringjallura, reflektohen në funksion të një kallëzuesi të përbërë në marrëdhënie kundrinore a rrethanore si p.sh: **pushoi së kënduari (këngën), (u kënaq) së pushuari (nga të pushuarit)**, por edhe si ndajfolje e shprehjes ndajfoljore, ku shprehin nuanca të veçanta kuptimore rreth veprimit të caktuar semantiko- gramatikor, tipi: *së bashku* apo **të ecim së bashku**, *së mbari* apo **u kthye së mbari**, *së dyti* ose **për së dyti në radhë** etj. po duke bartur me vete kuptimësinë e rrjedhojes së veprimit abstrakt, por të gërshetuar me elemente konkretë kryesisht me prejardhje mbiemërore.

Meqë tipi i katërt, edhe pse ka të bëjë kryesisht me shprehje ndajfoljore ose rreth tipareve të veprimit që shpreh kallëzuesi me foljet përkatëse dhe njëherazi shpreh përmbajtjen leksiko-gramatikore të emrit por të gërshetuar me foljen paraprirëse të tipit të veçantë (të nënkuptuar ose të shprehur), në njërën anë dhe njëherazi nuk ka të bëjë me strukturë normale të asnjane të mirëfilltë prepjesor që identifikohet formalisht edhe sot, ne, gjatë tërë analizës edhe pse mund ta përmendim paksa kalimthi, deri në dy kërret e

fundit nuk do ta kemi objekt të veçantë trajtimi, por do të marrim në analizë pothuajse vetëm tre tipat e parë, sepse tek ta, për mendimin tonë, paraqiten edhe probleme të hapura edhe fakte të veçanta më të vërejtshme identifikimi.

Si duket, gjasat tregojnë se në gjuhën tonë të dokumentuar asnjësi primitiv i mirëfilltë asnjëherë nuk kishte përfshirë, jo vetëm të gjithë jofrymorët, por as të gjithë frymorët, madje edhe ata që nuk dallohen sipas seksit, përkatësisht të gjithë ata emra që nuk tregojnë gjini natyrore, prandaj termi *gjini asnjëse*, sidomos sot, me treguesit përkatës që ka, ka kuptim të karakterit thjesht gramatikor, ashtu si edhe shumica e dy gjinive të tjera.

Siç dihet, në shqipe, gjinia e emrit përcaktohet zakonisht nga një-mbaresa e njëjësit të shquar: **-t(ë)** për gjininë asnjëse, **-i,-u** për gjininë mashkullore dhe **-a, -ja** për gjininë femërore; si dhe një-treguesi i pashquar **një** paraprijës të emrit të caktuar: as. *(një)këta*, m. *(një)ky këta* dhe f. *(një)kjo (një)këto*.

Thuhet në burime të caktuara se asnjësi i të tre tipave të parë në periudhat e mëhershme të para dokumentimit të shqipes, ka pasur shtrirje më të gjerë dhe njëherazi edhe përdorim më të dendur se në periudhën e më pasme, kur u bë i mundshëm praktikisht dokumentimi i tyre. Ne, pa kundërshtuar tërësisht, supozimin e tillë teorik, e marrim me rezervë, pikërisht atë pjesë të konstatimit që ka të bëjë me faktin se ndërkohë gjoja fushëveprimi semantik i tyre i të tre tipave të parë, pra edhe i paranyjëzorëve, në vazhdimësi në rrjedhë të kohës, shkallë-shkallë jo pse paska pësuar *turrje*, që nënkupton edhe *zvogëlim numri* për konceptin përkatës, por për faktin se gjoja aktualisht paska marrë përgjithësisht edhe *shenja shuarjeje ose karakteristika reliktove a mbeturinore* ?!

Sidoqoftë, ne para se të shprehim rezervën tonë lidhur me këtë, në vazhdim po japim mendimet, pra, jo të padiskutueshme të disa gjuhëtarëve tanë me emër lidhur me këtë çështje dhe po fillojmë, së pari, me atë të prof. Sh. Demirajt.

Prof. Sh. Demirajt, si duket i përqendruar, kryesisht, në analiza historike, pa u thelluar në aspektin e përimitësuar sinkronik, për të tre tipat e parë të asnjësesve shfaq mendimin, pra sot joplotësisht të pranueshëm, sidomos, kur është fjala, për dy tipat e asnjësit të paranyjëzuar:

*“Gjatë kësaj periudhe (periudha III, shek. XIV, XV – XVI, deri në fillim të Rilindjes Kombëtare n.v.) dobësohet gjithnjë e më shumë gjinia asnjëse, e cila shndërrohet më në fund në një gjini mbeturinore, jo vepruese” ose “Gjinia asnjëse ruhet ende sot te disa emra prejpjesorë si të folurit, të menduarit etj., te disa emra prejmbiemërorë: të kuq-të, të verdhë-t etj. e sidomos tek disa togfjalësha arkaikë (f. 198), sepse, emrat asnjëse, të tipit ballë-të, ujë-t në njëjës janë integruar në gjininë mashkullore, ndërsa në shumës në gjininë femërore, kurse emrat prejmbiemërorë dhe ata prejpjesorë asnjëse, të tipit: të mirët, të qeshurit, si dhe dëftorët asnjëse: ata këta si në njëjës sot në shumës janë integruar në gjininë femërore”.* (Shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1998, f. 57, 200.)

Me fjalë të tjera ky me plot bindje shprehet se te tre tipat e asnjësesve mund të konsiderohen, sot për sot, të pasivizuar, joveprues dhe se një çintëgim i tillë, sipas tij, është rezultat:



*“i prirjes së përgjithshme të shqipes për të parapëlqyer emrat me prejardhje sintetike, përkundër tipit analitik, andaj prejmbiemërorët janë zëvendësuar gjithnjë e më shumë me emra të prejardhur me prapashtesat -i, -ë/ni -ëri, -si, ndërsa prejpjesorët me emra të prejardhur me -im dhe -je. (Aty, f. 204.)*

Një qëndrim të tillë kategorik, pa koment a interpretim plotësues, e ndeshim, pothuaj edhe në *Gramatikën e Akademisë* (1976, 1995, 2002), ku shprehimisht thuhet:

*“Gjinia asnjane në gjuhën e sotme shqipe përbën një kategori që vjen vazhdimisht duke u rrudhur. Ajo është reduktuar në një numër të kufizuar fjalësh dhe, me humbjen plotësisht të gjinisë asnjane të fjalëve përcaktuese (të mbiemrave, të përemrave dëftorë e pronorë), shfaqet vetëm morfologjikisht në tipin e lakimit të shquar (vetëm në rasat emërore e kallëzore njëjës), në disa emra edhe me praninë e nyjës -të, për rasën emërore njëjës dhe, të ndryshme nga ajo e gjinisë mashkullore -i dhe ajo e gjinisë femërore -a: krye-t, të ecur-it, të ri-të. Pra, gjinia asnjane në shqipen e sotme ka karakter mbeturinor”. (Aty f. 93.)*

Jolumnisht, një konstatim të tillë, përgjithësues rreth *tkurrjes, shkrirjes a pasivizimit*, madje edhe *zëvendësimit a shndërrimit*, pa bërë dallimin a shpjegimin e duhur se për cilin tip asnjanesish dhe për cilën nënfushë semantike është fjala, e ndeshim të theksuar, mjerisht, *en bloc*, pothuaj në të gjitha veprat tona gjuhësore të derisotme që konsiderohen normëzuese dhe shkencërisht të drejta, siç janë *Studime gjuhësore në fushë të shqipes* (nga prof. I. Ajeti, Prishtinë, 1985), ku thuhet se “në gjuhën shqipe kemi edhe gjininë asnjane, megjithëse të sjellë në një numër të vogël emrash”. (Shih aty f. 96.), në *Gramatikën praktike të gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë 1998), konstatohet gjithashtu, se *emrat asnjane janë të paktë, përdoren kryesisht në frazeologji, në ndërtime të ngurosura, vetëm në njëjës, më shpesh në një trajtë... ata zakonisht të shquar përdoren edhe si terma.* (Aty f. 15.) Edhe në *Gramatikën e gjuhës shqipe për të gjithë* (të B. Becit), Tiranë, 2004, thuhet shkurt se “janë në gjininë asnjane disa emra të prejardhur nga mbiemrat: të ftohtë-t, të zi-të, të kuq-të; disa emra të nyjshëm të prejardhur nga foljet (prejfoljorët): të folur-it, të shtypurit, të dalë-t, të qeshur-it”. (Aty f. 57.) Po ashtu, por edhe më shkurt del përcaktimi të *Shqipja standarde* (vepër e Rami Memushajt, Tiranë, 2005.), ku thuhet vetëm kaq se “Gjinia asnjane përfshin një klasë shumë të kufizuar emrash, kryesisht ata me nyjë të përparme”. (Aty f. 53.) Prof. Egerem Çabej, në të vërtetë, pa e përmendur tipin përkatës, se cilit tip i referohet, shprehet se “në gjuhën e shkrimit (ashtu si te disa gjuhë të tjera i.e.) është një tendencë që asnjansi të zhduket”. (Shih *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë 1986, f. 94.) Po këtij konstatimi, pa e përcjell me koment, sipas prof. R. Ismajlit, i bashkohet edhe Harvej Mayer me fjalët: “*neutri anon të zhduket në shqip e në rumanisht*”. (Shih: *Seminari... 25/1*, Prishtinë 2007, f. 52.) Edhe studiuesi ri N. Pajaziti, në një paraqitje të vepra *Frang Bardhi - 400 vjetori i lindjes* (përmbledhje kumtesash, botim i IAP-së, Prishtinë 2007.), pa e përcaktuar tipin përkatës, shpreh njëkësi mendimi: “*Emrat asnjane që i hasim te këta shkrimtarë (Buzuku e Bardhi) në ditët tona janë integruar në njërin nga dy gjinitë, pjesa më e madhe në gjininë mashkullore, ndërsa një pjesë më e vogël në gjini femërore*”. (Aty f. 155.)

Nuk po vazhdojmë me përmendje të tjera, sepse lista del e gjatë, por e shohim të arsyeshme që kalimthi të cekim konstatimin e prof. L. Mulakut, i cili pajtohet me atë të

prof. Sh. Demirajt se "asnjanësit participorë dhe ata me prejardhje mbiemërore janë zëvendësuar thuajse plotësisht me emra prapashtesorë" (Shih Seminari...25/1, f. 447.)

Tash së voni temën rreth asnjansit në shqipe e ka trajtuar mjaft gjerësisht prof. Kolec Topalli në veprën *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* (Tiranë 2011). Natyrisht edhe ky duke e trajtuar këtë lëndë kryesisht nga pikëpamja diakronike mbështet konstatimin se ashtu si edhe në gjuhë të huaja edhe në gjuhën tonë sa i përket prodhueshmërisë dhe aktivitetit të tyre kjo gjini gjoja në shqipe ka pësuar pakësim ose çintegrim. Pra, edhe ky autori në një vend tjetër, pa u deklaruar se për cilin tip e ka fjalën, shprehet kështu:

*Nga shekulli në shekull vërehet shtimi i emrave me prapashtesast –im dhe –je, që kanë zëvendësuar emrat e gjinisë asnjansë duke shënuar kështu mënjanimin gradual të asnjansit në gjuhën shqipe. (Vepra e cit. f. 223.)*

Prandaj sipas tij:

*Si rezultat i çintegrimi të emrave asnjans në gjinitë e tjera, asnjansi në ditët tona paraqet një kategori gramatikore reliktoze ...*

megjithatë autori nuk e sheh të zhdukur plotësisht këtë kategori, në gjuhën tonë, ngase asnjansi, fjala e tij:

*Ka mbijetuar me rastet që vijon:*

*1) tek emrat e formuar nga emërzimi i mbiemrave prejppjesorë, si: të lodhurit, të punuarit, të mësuarit; të ftohtit, të ngrohtit etj.;*

*2) tek emrat e mësipërm në rasën rrjedhore, si: mbarova së foluri, plasa së qari, u lodhe së punuari etj.;*

*3) tek emrat e formuar nga emërzimi i një mbiemri të mirëfilltë, si: të zi - të zitë e ullirit, të verdhë - të verdhët e vesë, të kuq- të kuqtë e buzëve; me të mirë, me të keq;*

*4) tek ndajfoljet e shprehjet ndajfoljore, të formuara nga emërzimi i kategorive të tjera leksiko-gramatikore në rasën rrjedhore, si: së largu, së shpejti, së afërmi, së bashku, së pari, për së mbari, për së gjati, për së gjalli; kot së koti etj.;*

*5) në format foljore të pashjtelluara analitike, të krijuara me togje parafjalore me një emër prejppjesor të gjinisë asnjansë, si: me të marrë, një të dalë, për të hyrë.*

Për mendimin tonë, edhe në konstatimet e tij dalin çështje të paqarta ose të diskutueshme. Sido që të jetë, siç mund të shihet nga paraqitja e autorit imponohen për trajtim, jo vetëm asnjansit prejmbiemërorë, të cilët kanë të veçantë ose funksionale rasën emërore dhe kallëzore, por edhe asnjansit e rasën rrjedhore ose asnjansit me shprehje prejrrjedhore, pika 2) dhe 4), që ne i kategorizuam si tip më vete.

Në të vërtetë, në këtë punim janë dhënë edhe mjaft konstatime të tjera plotësisht ose pjesërisht të pranueshme, të cilat domosdo do të përmenden gjatë analizës në punimin tonë, por për ne del i diskutueshëm ose jo i qartë konstatimi tjetër i autorit që ka të bëjë me prejppjesorët e paranyjzuar të rasës emërore, sepse sipas tij,

*këta emra (preppjesorët) sa vijjnë e po zëvendësohen me emra të tjerë joasnjanës ose piren të zëvendësohen (në mjaft raste) me emra prejfoljorë të formuar nga prapashtesast –im dhe –je, si lodhje - të lodhurit, mësim – të mësuarit, larje të larit, kërkim – të kërkuarit, qenie – të qenët, qëndrim – të qëndruarit, ndejë – të ndenjurit etj.,*

konstatim ky që sipas nesh del gjithsesi i diskutueshëm.

Pra, shikuar sipërfaqësisht e njëanshëm edhe ky autor sipas konstatimeve të tij përqafton mendimet e konstatuesve të më sipërm se gjoja kjo gjini aktualisht mund të cilësohet si një formë joaktive ose si një relik, i cili, siç e thonë disa, së shpejti si mbeturinë mund t'i takojë së kaluarës (!), andaj, edhe gjithnjë e më pak është shënuar subjektivisht te disa fjalorë të viteteve '70-'80 të shekullit të kaluar, burime këto, të cilat ende dalin të rekomanduara si plotësisht të normëzuara.

Sidoqoftë, ne gjatë analizës do të vjelim shembuj e konstatime nga këto burime, por edhe do t'i shfrytëzojmë të gjitha ato që shkojnë në interes të punimit tonë *Rreth identifikimit të asnjansit në gjuhën e sotme shqipe*, qoftë në mbështetje ose jo të mendimeve tona.

Ne, vërtet, pas analizës që i bëmë çështjes në fjalë, rreth verifikimit të pohimeve të mësipërme erdhëm në përfundimin se shikuar realisht disa nga konstatimet e mësipërme të të gjithë autorëve që kanë të bëjnë rreth pasivizimit, zëvendësimit a shuarjen apo rreth kufizimit të numrit të asnjansve në përdorim e sipër, sidomos për dy – tre tipat e paranyjësuar, i marrim me shumë rezervë, madje si të tilla pa ndonjë sqarim plotësues, mund të cilësohen edhe si konstatime të guximshme, të nxituara, madje edhe si teprime a një sipunë me gjykime të pamatura mirë.

Ne, për rezervën a mospajtimin tonë gjejmë mbështetje në këta katër faktorë:

e para, nga nënteksti i konstatimeve të tilla kundërthënëse që u cekën më sipër, e dyta, nga vërejtje-vlerësimet e dhëna në "*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*" rreth kësaj teme.

e treta, nga ndonjëri nga konstatimet e prof. Kolec Topallit dhe e katërta, nga realiteti që na ofrohet dhe imponohet përditshmërisht, ashtu siç mund të shihet qartë dhe siç ka filluar në të vërtetë të shihet në kohë të fundit edhe nga studiues e qarqe të tjera, sidomos nga Tirana.

Po i zbërthejmë paksa më poshtë këto fakte rradhazi, në katër nëntituj:

### ***1. Rreth kundërthënive (nën)tekstore të sipërcekura***

Në kuadër të konstatimeve, ndonëse fragmentare, të sipërshënuara prej nesh edhe lexuesi i rëndomtë mund të vërejë kundërthënie kuptimore tekstore dhe nëntekstore të tyre, ngase:

e para, *zëvendësimi* (në proces e sipër) e *integrimi* janë dy procese të ndryshme me dallime të theksuara sipas tipave përkatës;

e dyta, çdo *prirje spontane* nuk do të thotë edhe tkurrje e materialit të goditur dhe që kjo dukuri vlen për të katër tipat e asnjansve;

e treta, kur pas shembujve jepet treguesi **etj.** (do me thënë *e të tjerë*) dhe jo pikë ose e *ndonjë tregues tjetër*, lë për të kuptuar se ka ose mund të ketë edhe raste të tjera, madje mund të ketë edhe shembuj potencialë;

e katërta, edhe nga kuptimi i pjesëz-ndajfoljes *pothuaj* mund të nënkuptohet se shembujt mund të mos jenë plotësisht të rrëguar, por mund të jenë në numër të

konsiderueshëm, në përdorim e sipër, qoftë në cilësinë e termit, qoftë si fjalë aktive në ligjërimin e përgjithshëm;

e pesta, kur pranohet se një trajtë e tillë e ngurosur në shprehje frazeologjike që askush s'mund ta mohojë ashtu si dhe prania e tyre edhe në fusha të caktuara terminologjike e stilistike, thuhet se është normative, atëherë nënkuptohet vetvetiu se ajo fjalë assesi nuk del *jovepruese*, e shuar ose e gjykuar për mospërdorim, por del me gjallëri relative përdorimi, me mundësi që në mënyrë analoge të mundet me joshë ose me krijue edhe shembuj të tjerë dhe .

e gjashta, edhe nga konstatimet e K. Topallit kur përmend vetëm *prirjen* ose *disa raste* të zëvendësimit nënkuptohet jo zhdukja ose pasivizimi i plotë i tyre dhe së këtejmi na jepet e drejta të shprehim rezervë rreth paqëndrueshmërisë së tyre *en bloc*, siç del nga shumica e konstatimeve të shprehura nga studiuesit që u cekën më sipër.

Sidoqoftë, ne mendojmë se këto pesë-gjashtë fakte na japin mbështetje që çështja në shqyrtim të konsiderohet e diskutueshme dhe njëherazi shtrohet nevoja e verifikimit dhe të grumbullimit edhe të fakteve të tjera plotësuese, por, në këtë kuadër edhe për rivërtetësinë e gjykimeve të tilla të diskutueshme.

## **2. Konstatime nga normativi “Gjuha letrare shqipe për të gjithë”**

Kërkesën tonë rreth nevojës së verifikimit të qëndrueshmërisë së konstatimeve të lartpërmendura e mbështesim si të drejtë, madje me fakte bindëse, bazuar edhe në konstatimet e hartuesve të veprës normative: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (Tiranë, 1976), vepër kjo, e cila pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972), si me thënë, u paraprinte burimeve të tjera normative në frymën e *Drejtshkrimit të gjuhës shqipe* të vitit 1973. Pikërisht konstatimet nga doracaku *Gjuha letrare për të gjithë*, ne i shohim mjaft të arrira, të qëndrueshme dhe patjetër normativisht të mbështetura për kohën, vërejtje këto që kanë të bëjnë pikërisht me tre tipat e parë të asnjansve në shqyrtim. Andaj kërkojmë nga lexuesi, jo vetëm nga dashamirësit e rëndomtë të gjuhës shqipe, por edhe nga ekspertët përkatës që së bashku t'i ndjekim vëmendshëm konstatimet përkatëse nga ky burim që po i japim radhazi, sipas tre tipave të asnjansve në shqyrtim:

a) Aty thuhet me të drejtë se “*kjo formë e asnjansit* (është fjala për tipin e parë n.v.) *dëgjohet ende sot nëpër dialekte e në të folurit e brezit të vjetër*” dhe menjëherë më poshtë theksohet e drejta e pamohueshme universale se “*trajtat e asnjansve të këtyre emrave mund të përdoren në vepra letrare për të karakterizuar gjuhën e një epoke të kaluar*”. (Aty f. 12.)

Pra, materializimi i trajtave të tilla në vepra letrare e shkencore (e drejtë kjo e padiskutueshme), gjithsesi jo vetëm nuk nënkupton pra zhdukjen e tyre, por në njëfarë mënyre parakupton këndelljen a jetëgjatësinë e tyre në vepra letrare, në kuptim të shfrytëzimit të vlerave trashëgimore, por, në rast nevoje, edhe mundësinë e krijimeve të vlerave të reja artistike nga mjeshtrit e gjuhës edhe për destinime të tjera po mbi këtë bazë. Po sipas kësaj logjike e quajmë shumë pa vend konstatimin e Seit Lilës, të shprehur ne Kongresin e Drejtshkrimit (1972), ku format ose trajtat *gjalpët, mjaltët, ujët*, sipas tij,

konsiderohen *tashmë të huaja për gjuhën letrare*. (Shih: Kongresi i Drejtshkkrimit, Prishtinë, 1974, f. 267.)

b) Edhe lidhur me asnjësit e tipit të dytë (prejmbiemërorët), ndonëse çështja nuk del plotësisht e qartë, aty jepen mendime të qëndrueshme. Në të vërtetë, nga hartuesit e burimit në fjalë konstatohet mirë, kur thuhet se *ka raste, që “emri asnjans ose femëror pa prapashtesë dhe emri femëror me prapashtesë përdoren me kuptime pak a shumë të ndryshme, si p.sh. të bardhët me bardhësi, të ftohtët e ftohta me ftohtësi etj.”* dhe njëkohësisht theksojnë në mënyrë të veçantë, gjë që nuk e mohojnë as të tjerët, se *“emrat asnjans të formuar prej mbiemrash përdoren dendur në një numër shprehjesh frazeologjike”*, duke theksuar edhe një të vërtetë tjetër të padiskutueshme se *“në këto shprehje përdorimi i tyre është normativ.”* (Aty f. 238.)

Pra, siç po shihet nga formulimet e mësipërme dalin në shesh tri fakte të qarta që i bëjnë të rrëzueshme konstatimet rreth pasivizimit total të asnjansve të tipit në fjalë:

e para, aty pohohet qartë se *në raste bashkëjetojnë trajtat e asnjansve prejmbiemërorë, krahas atyre sintetikë me prapashtesim,*

e dyta, kur thuhet se emrat e tillë *përdoren dendur* dhe

e treta, kur thuhet se trajtat e tilla e kanë bekimin e normës, sidomos *në shprehje frazeologjike*.

c) Edhe më qartë e më mirë se për dy tipat e parapërmendur autorët e tekstit në fjalë, janë shprehur lidhur me tipin e tretë, ndonëse, sipas nesh edhe kjo paraqitje e tyre nuk është tërësisht e plotë. Aty, ndërkaq, pasi ceken 34 shembuj nga ky tip, d.m.th. trajta asnjansish nga emërimi i pjesoreve *“që shënojnë veprime abstrakte”* tërhiqet vërejtja se *“një pjesë e emrave prejfoljorë asnjans përdoren me kuptime deri diku të ndryshme nga ato të emrave përkatës me prapashtesat –im ose –je, p.sh. të çmuarit – çmim, të kënduarit – këndim, të menduarit – mendim, të mësuarit – mësim, të punuarit – punim, të shkruarit – shkrim; të luturit- lutje, të ngjarët – ngjarje, të pyeturit – pyetje, të sharët-sharje etj.”*, duke sqaruar më tej se *“pjesorja e emëruar në këto raste e jep më të theksuar kuptimin e procesit të veprimit, ndërsa formimet me prapashtesa emërtojnë veprimin si nocion abstrakt dhe në mjaft raste emërtojnë rezultatin e veprimit. Pikërisht për këtë arsye në gjuhën e sotme letrare këta emra mund të përdoren me vlerat e tyre të veçanta, p.sh. arti i të kënduarit, por shkrim e këndim, të mësuarit – mësim, të menduarit – mendim, të shprehurit, mënyra e të shprehurit, por shprehje, shprehja e bukur etj.* (Aty f. 239).

Kështu, ndonëse fjalëzat sqaruese *një pjesë* dhe *deri diku* dalin pothuajse të panevojshme, nga teksti i mësipërm, sidomos për faktin kur aty nga fundi i formulimit shënohet treguesi **etj.** (nxirë /bollduar/ prej nesh) si dhe për faktin tjetër që del nga theksimi se *“emrat prejfoljorë asnjans kanë përdorim të gjerë e të qëndrueshëm në gjuhën e sotme letrare në një varg shprehjesh e mënyrash të thëni me karakter frazeologjik”* si dhe fakti i tretë, kur në përfundim thuhet se *“përdorimi i emrave të tipit të tillë të mësipërm në shprehje të tilla është plotësisht normativ”* (Aty f. 239), së këndejmi, pra, kuptohet katërçipërisht se shembujt e tillë, varësisht nga konteksti mund të përdoren edhe sot e gjithë ditën, si të thuash, në numër të pakufizuar, duke i dalluar, pak a shumë, tri nocione 1) nënfushën abstrakte semantike si koncept, 2) veprimin si proces abstrakt dhe 3) rezultatin e veprimit.

Pra, siç po shihet, konstatimet nga kjo vepër, d.m.th. nga *“Gjuha letrare shqipe për të gjithë”* janë të mjaftueshme sa për të sjellë në rishikim konstatimet *en bloc*, nga

thëniet e paracituara në veprat e studiuesve të caktuar, me të cilat, si të thuash, pa të drejtë ose subjektivisht arsyetohej pasivizimi a zhdukja e asnjansit në gjuhën shqipe dhe në këtë kontekst shprehim habi e keqardhje pse kjo lajthitje ndaj së vërtetës së pamohueshme nuk është vënë re më përpara nga studiuesit tanë(?!).

Prandaj është për t'u çuditur, pse një korigjim a modifikim i tillë, ndërkohë e me kohë, deri në ditët tona, nuk është hetuar dhe nëse është hetuar pse nuk është bërë, edhe pse dihet se lënda e doracakut normativ "*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*" nuk ishte e panjohur gjithandej e këndeje dhe më gjerë, madje ai tekst mësohej në hollësi, edhe si tekst shkollor a udhëzues për mësuesit e shqipes, nga të gjitha rrethet tona shkencore dhe arsimore përkatëse.

Sidoqoftë, vërtet, disa gjëra për ne mbesin të paqarta.

### **3. Konstatime nga prof. Kolec Topalli**

Nga prof. Kolec Topalli, diçka shënuam të diskutueshme më përpara, por këtu po i theksojmë këto dy konstatime të veçanta të qëndrueshme të këtij autori:

e para, konstaton me vend kur thotë se *zëvendësimi i formës së asnjansit me emra të gjinive të tjera të formave foljore analitike të pashtjelluara (për të punuar, një të punuar dhe me të punuar) është i pamundur, pasi ato janë kristalizuuar si një njësi gramatikore, dhe*

e dyta, është i padiskutueshëm dhe me interes paraqitja e tij, siç e pamë më sipër, lidhur me tipin e "*ri*": **asnjanësit prejrrjedhorë**, të patrajtuar ose të papërfshirë më parë në burimet tona normative leksikografike i cili pasqyrohet në *shprehjet prejrrjedhore (ablativale), të cilat nga forma përmbajtja dhe shtrirja që kanë imponojnë që të trajtohen si tip më vete, ngase pa trajtimin e tyre identiteti i asnjansit në gjuhën shqipe del i mangët.*

Ka edhe finesa të tjera në konstatimet që ndeshim në punimin e prof. K. Topallit, që ne i kemi cekur ose do t'i shfrytëzojmë në analizën tonë gjatë trajtimit të temës, por këtu, një herë për një herë po mjaftohemi vetëm me dy konstatimet e mësipërme të qëndrueshme, ngase edhe nga kjo anë shohim rrënjëzimin kësaj gjinie në historikun dhe aktualitetin e gjuhës sonë, fakte këto të nevojshme që duhen pasur parasysh dhe nga stadardologët e sotëm të gjuhës sonë.

### **4. Konstatimet tona vetjake**

Si te çdo dashamirës i gjuhës, edhe te ne. pas një përvojë pune prej disa vitesh në arsim dhe në lëmin e krijimtarinë letrare, madje paksa edhe në atë hulumtuese shkencore-gjuhësore, sidomos gjatë dhe pas studimeve pasuniversitare (postdiplomike) dhe konkretisht gjatë hartimit të temës rreth emërtimit të proceseve tekniko-teknologjike në gjuhën shqipe, u rrit interesimi ynë, për ta njohur sa më mirë dhe më në thellësi tërë sistemin ligjërimor të shqipes, si në fushën e konkretizimit, ashtu edhe në atë të abstraksionit. Në këtë kontekst hetuam tema që në gramatikat tona të normëzimit letrar (standard), mbase të bazuara më tepër në fushën praktike të konkretizimit, ishin anashkaluar ose ishin lënë nën hije disa nga komponentet më të rëndësishme të gjuhës sonë që i përkisnin më tepër fushës së gjerë të abstraksionit, dhe shikuar në tërësinë e saj si sistem gjuha jonë në trashëgimi ato komponente i kishte normalisht aktive (që i ka, në

rë vërtetë, edhe sot si gjuhë e natyrshme), siç janë **infinitivi i mirëfilltë edhe neutri i paranyjësuar**. Andaj këtu e ka fillin edhe interesimi dhe angazhimi ynë për shtjellimin e temave të tilla më në hollësi.

Pra, së këtejmi, për të harmonizuar sadopak të dhënat kundërthënëse teorike, në njërin anë dhe realiteti që na imponohet, në anën tjetër, si dhe vetë nevoja që paraqet gjuha për segmente të tilla, sidomos në fushën e abstraksionit, doli e nevojshme që mendimet dhe përvojën tonë mbi këto çështje komplekse, jo vetëm ta mësojmë e përplotësojmë, por edhe ta shprehim me shkrim. Disa vëzhgime a përpjekje tona në këtë drejtim tashmë janë publikuar e disa ende kanë mbetur pa u botuar, madje janë disa raste që janë ende në fazën e përpunimit.

Sidoqoftë, është e vërtetë se për hartimin e këtij punimi gjetëm mbështetje pragmatike dhe logjike, madje edhe në premisen intelektualisht të njohur se çdo bashkësi shoqërore e civilizuar, përkatësisht çdo gjuhë moderne, siç është kjo jona, në zhvillim e sipër, ka nevojë që t'i rrisë kapacitetet e veta të mjeteve gjuhësore. Pra, t'i rrisë, nga gjerësia dhe cilësia e fushave kuptimore që i ka dhe t'i shfrytëzojë të gjitha ato mundësi nga kapacitetet ekzistuese në të mirë të të shprehurit si në fushën e konkretizimit, ashtu e aq më tepër në atë të abstraksionit e jo t'i zhdukë a t'i shuajë subjektivisht ato që i ka, ose t'i anashkalojë nga mosnjohja e lëndës dhe së këtejmi arritëm në përfundimin se gjuha jonë, norma e saj do të jetë shumë më funksionale dhe më e kompletuar, njëherazi edhe shumë më e fortë dhe e qëndrueshme, nëse në gjirin e vet në bazë të normës globale të natyrshme e kthen dhe e mëkon si infinitivin e mirëfilltë të përjashtuar, ashtu edhe neutrin e vet, të nënvlerësuar. Andaj këto dy tema që me kohë edhe i vumë në qendër të vëmendjes të hulumtimeve tona dhe më në fund doli edhe ndihmesa jonë që infinitivi i shqipes të rikthehet në tryezën e (ri)shqyrtimit me propozim rishikimi (Konferenca shkencore e Durrësit 2010), andaj po të njëjtin synim e kemi edhe lidhur me asnjansin e gjuhë shqipe, sepse kur diçka rikthehet, rishikohet dhe rivendoset në tryezën e shqyrtimeve ajo edhe do të gjejë zgjidhje fatlume.

Dhe, në të vërtetë, gjatë verifikimit të fakteve arritëm në përfundimin se konstatimet e dhëna në *“Gjuha letrare shqipe për të gjithë”*, për asnjansit ish-in të drejta, por lypsej vërtetësuar (verifikuar) e sforcuar më tej më mirë dhe më në hollësi. Dhe së këndejmi, gjatë këtij vërtetësimi, sigurisht duke e lidhur punën tonë edhe me realitetin tonë ligjërimor, zbuluam mrekullinë ekzistuese se trajtat e tilla (të asnjansëve të paranyjësuar) jo vetëm nuk dilnin me prirje rrëgjuese nga pikëpamja e përdorimit të përditshëm, por dilnin të sforcuara atavikisht, madje të pozicionuara fort në përdorim normal *po në fushën e abstraksionit, por jo kryekëput për konceptin e vetë veprimt, po në një nënfushë të përafërt me të, d.m.th. në nënfushën që ka të bëjë me konceptin e kuptimit të procesit të veprimt në shkallën më të lartë të abstraksionit, me një shtrirje të lehtë në tërë nocionin lidhur me atë proces.*

Për t'u kuptuar më mirë ky formulim që ka të bëjë vërtet paksa me rrudhje ndaj fushës së gjerë që sipas gjasash mbulonin asnjansit e paranyjësuar në një fazë më të hershme, por njëherazi edhe me një përqendrim të ravijësuar në një nënfushe semantike brenda saj, u desh që kjo çështje të vështrohet më në hollësi dhe thellësi, prandaj po i themi më poshtë edhe disa fjalë si sforcim lidhur me këtë *“mrekulli”* që na u zbulua dhe si një zbulim fatlum na u imponua që ta zbërthenim e sqaronim aq sa mundëm, sipas mundësive tona...

Sidoqoftë, gjatë analizës, siç u tha, doli në shesh e vërteta se asnjësisht e paranyjësuar (prejmbiemërorët dhe prejppjesorët) tani dilnin si një organizën gjallues gjuhësor me prirje të qartë specifikimi për të mbuluar një nënfushë semantike, e cila ka të bëjë me mbulimin e konceptit të procesit të *cilësisë, të gjendjes a të qenit*, përkatësisht të *veprimit*, por jo tani, për tërë nocionin përkatës të fushës së gjerë të abstraksionit, çka na jepet për të kuptuar, siç u tha, gjerësinë përfshirëse që mund ta kenë pasur më përpara, asnjësisht në fjalë për emërtimin e vetë *procesit të cilësisë, të gjendjes a të të qenit, ose të veprimit a të rezultatit të veprimit përkatës*, që tani, me ndonjë përjashtim jo aq me peshë, këto nocione mbulohen kryesisht nga emrat e tjerë sinonimikë, qoftë me prejmbiemërorët me prapashtesat **-si** a **-i**, qoftë me prejppjesorët me prapashtesat **-im** ose **-je**, ose me emrat e nyjshëm femërorë, tipi **e mira** ose me prejppjesorët pandajshësorë, tipi: *shkojë-a, rritë-a* ose nga ndonjë tjetër tip emëror. Për një shtrirje të tillë të gjerë që kishte kjo gjini dëshmon edhe asnjëzimi i shprehjeve ndajfoljore prejrrjedhore, që ne e merendiam si tip të katërt.

Pra, duke u mbështetur në premisën e sipërpërmendur se çdo gjuhë e zhvilluar i ka të ravyjësuar fjalët përkatëse për konceptet e fushës abstrakte, përkatësisht termat e specifikuar përkatës që shprehin ato koncepte dhe të ndihmuar nga konstatimet kritike kundërthënëse që dilnin nga dy-tri pikat e sipërcekura dhe më fort, duke u bazuar në realitetin tonë gjuhësor dhe në faktografi leksikografike, ne arritëm në konstatime të tjera më të modifikuara dhe më të drejt-sofistikuara nga ato që u cituan fillimisht nga disa nga studiuesit e gjuhës sonë, të cilat (konstatimet tona) u përpoqëm t'i sqarojmë dhe argumentojmë sa më bindshëm në këta tetë krerët vijues të këtij punimi:

- I. Prania e asnjësisht në shqipen letrare (FSHS 2002) dhe grupimi i tyre sipas *nyjë-mbaresave të njëjësit të shquar*.
- II. Nënfushat semantike, veçori dalluese sipas tipave të asnjësisht në shqipen letrare.
- III. Faktografi rreth shtrirjes së asnjësisht të nyjshëm prejmbiemërorë e prejppjesorë në shqipen e sotme.
- IV. Vendi i asnjësisht të paranyjësuar në kuadër të prejppjesorëve të tjerë.
- V. Konstatime të tjera plotësuese rreth identitetit të asnjësisht të nyjshëm në shqipen standarde
- VI. Anashkalimi i vlerave të asnjësisht në shqipen e sotme pasojë e konstatimeve të nxituara.
- VII. Çështje të hapura rreth asnjësisht në shqipen e sotme
- VIII. Mendimi përgjithësues dhe përcaktimi i nënfushave semantike të asnjësisht në shqipen e sotme.

Sidoqoftë, ne kemi bindjen se në këtë punim janë paraqitur argumente të mjaftueshme nga jeta jonë gjuhësore, të cilat na japin të drejtë të konstatojmë që asnjësisht e të katër tipave, jo vetëm mund a duhen përdorur pjesërisht e me rezervë, po me lëndën e trajtuar në hollësi e thellësi në tetë krerët e sipërshënuar, u përpoqëm me dhënë ndihmesën në të mirë të ndriçimit të problemeve të trajtuara jo mjaftueshëm në të kaluarën nga pikëpamja teorike e praktike. Në këtë kontekst, ngase kemi të bëjmë me mjaft risime, kërkojmë nga lexuesi i nderuar jo vetëm të lexohen e rilexohen me



vëmendje të veçantë konstatimet tona, por edhe të vlerësohen objektivisht, natyrisht me të drejtën për të mbajtur edhe qëndrim kritik.

Gjithsesi nga trajtimi i kësaj teme, shpresojmë se së paku, më mirë e më në thellësi se asnjëherë më parë, me sa dimë ne, do të qartësohen, jo vetëm nënfushat semantike që mbulojnë asnjësit përkatës, sipas prejardhjes së tyre (emërore, mbiemërore dhe prejpjesore), por do të ndriçohen më mirë edhe çështje të tjera me interes për konsolidimin e shqipes standarde të sotme dhe të nesërme, të qëndrueshme për mot e vjet.



## **I. PRANIA E ASNJANËSVE NË SHQIPEN LETRARE (FSHS 2002) DHE GRUPIMI I TYRE SIPAS NYJË-MBARESËS SË NJËJËSIT TË SHQUAR**

Para se të japim konstatimet tona rreth pranisë së asnjanesit në shqipen e sotme letrare më në hollësi, po përmendim mendimet e tre gjuhëtarëve tanë, të cilët, të ballafaquar me emrat e tillë relativisht të shumtë të përdorur në veprat e traditës si dhe vende-vende në disa tërthore edhe në gjuhën e gjallë popullore dhe intelektuale, jo vetëm për asnjanesit e tipit të parë, por edhe për dy tipat e tjerë sidomos, kanë vërejtur mangësi pranie në burimet përkatëse lidhur me përfaqësimin e tyre përgjithësisht në burime tona të caktuara normëzuese leksikografike, andaj edhe kanë kërkuar që prania a përfaqësimi tyre të jetë më i denjë, përkatësisht që kësaj gjinie t’i kushtohet më shumë vend e vëmendje, sidomos në burimet tona normative. Më i zëshëm në kërkesën për rishikimin e qëndrimit joadekuat të deritashëm ndaj asnjanesve përgjithësisht në shqipen e sotme letrare, që është shprehur disa herë botërisht, me sa dimë, është studiuesi ynë i mirënjohur, **prof. dr. Abdullah Zymberi** (Shih edhe te gazeta “Zëri”, 25.05.2007, f. 22 si dhe te *Gjuha shqipe*, 2/2007, f. 57.), i cili, sidomos për dy tipat e paranyjzuar konstaton me të drejtë se, jo vetëm nuk janë pasivizuar masivisht, por siç thotë ai, “*rrojnë kokrrosh*”, në të folme, por edhe më gjerë në vepra letrare. (Aty f. 59.) Po ashtu edhe **dr. Ragip Mulaku**, në një shkrim të tij, jo fort moti, ngulmonte që “*Në fjalorët tanë shpjegues duhet të ketë më shumë vend për emrat asnjanes: të madh-të, të trash-të, të holl-të (!), të kalbët-it e të tjerëve, sepse e pasurojnë gjuhën*”, (Shih: *Gjuha shqipe* 1-2, 2000 f. 52.) mirëpo edhe ky nuk ndalet në përcaktimin e nënfushës përkatëse semantike në hollësi sipas tipave të asnjanesve, ndonëse faktikisht si shembuj ilustrues shënon vetëm tipin e asnjanesve prejmbiemërorë, duke e anashkaluar tipin më prodhimtar: asnjanesit prejppjesorë.

Zgjon interes edhe mendimi i **prof. Remzi Parnaskës**, i cili tash së voni, në punimin *Si ta përmirësojmë dhe ta pasurojmë standardin e shqipes* (Internet, dt. 17.10.2012) veç tjerash thekson:

*Duhet parë p.sh. mundësia e ngjallërimit të asnjanesit të tipit të menduarit, aq i gjallë në gegërisht dhe që për të ka aq shumë nevojë regjistri abstrakt, logjika e filozofia, si edhe fusha të tjera të ligjërimit...*

Siç po shihet autori përmend vetëm tipin e asnjanesit prejppjesor, të cilit i vë vlerën që e meriton.

Mirëpo, Prof. A. Zymberi, në një punim tjetër (kumtesë) sërish i kthehet kësaj teme. Ai tek vepra *Frang Bardhi – 400 vjetori i lindjes*, botim i IAP-së i kushton më shumë vend këtij problemi, ku veç tjerash thekson:

*Është e vërtetë se asnjanesit që emërtojnë lëndë janë zhdukur pothuajse tërësisht, mirëpo edhe këtë tipi toskërishtja, arvanitasit, arbëreshët e Italisë, shqiptarët e Ukrainës e kanë të ruajtur bukur mirë. Mirëpo tipat e tjerë: prejmbiemërorët e emëruar, prejppjesorët e emëruar dhe ata që shprehen në togfjalësha dhe në*

*shprehje të ndryshme rrojnë edhe sot e kësaj dite në të folmet popullore. Për mendimin tonë këta tipa asnjansish i duhen domosdoshëm shqipes së sotme, sepse e përbëjnë një shtresë të rëndësishme fjalësore për fjalorin e shqipes, sepse u duhen shumë shkencave, sidomos psikologjisë dhe fushës së mjekësisë...*

dhe përfundon me kërkesë-këshillën:

*“Ne do të shtonim se këta tipa asnjansish duhet t’i kthehen shqipes letrare, duhet t’u kthehen gramatikave dhe fjalorëve tanë, sepse i patën shkrimtarët e vjetër dhe të mëvonshëm, sepse i kanë madje mirë i kanë disa të folme popullore, i kanë edhe disa fjalorë dialektorë. Kjo pasuri leksikore do ruajtur dhe përdorur nga shkencëtarët e shkrimtarët tanë, nga gazetarët e nga mjetet e tjera të informacionit, sepse është pjellë e hershme e shqipes sonë”.* (Aty f. 105.)

Që në të folmet popullore ndeshen *plot e përplot asnjans* dhe që aty ruhen mirë, prof. A. Zymberi e dokumenton me fakte edhe në një punim tjetër të botuar në *Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike*, Prishtinë, 36/2006, nën titullin: *Prania e emëzimit në disa të folme popullore*, ku ndër të tjera në të folmet e Pejës dhe të Burimit, si dhe në vise të tjera, thekson ai, asnjansit gjallojnë “për mrekulli”. Po për ne zgjojnë interes shembujt që i jep autori me *rrënjorë të njëjtë*: edhe si mbiemra të emëruar edhe si pjesore të emëruara, si p.sh.,:

t’kalbtit – të kalbunit, t’krym(b)tit, - t’ krym(b)unit, t’ndydhtit – t’ndrydhunit, t’m(p)rehtit - t’m(p)rehunit, t’ngushtit- ngushtu(e)mit, t’prishtit – t’prishunit, t’djegtit – t’djegunit (Aty f. 148),

duke konstatuar se “*përderisa mbiemrat e emëruar në gjininë asnjansë emërtojnë një cilësi ose një pjesë të hequr nga një e tërë, pjesoret e emëruara emërtojnë një veprim*”.

Sido që të jetë, ndonëse të gjitha konstatimet e këtij studiuesi të merituar në ndonjë finesë nuk përputhen plotësisht me tonat rreth nënfushës semantike që mbulojnë ose duhet të mbulojnë sot e nesër asnjansit në fjalë, me shembujt e tillë autori hap çështje që nuk njiheshin mirë në të kaluarën, prandaj edhe ne një kërkesë-këshillë të tillë që asnjansit prejmbiemërorë dhe ata prejpjesorë duhet të konsiderohen jo pa vlerë, por *si një pasuri që e ushqejnë shqipen letrare*, e quajmë shumë me vend, ngase, vërtet, del e nevojshme që asnjansëve përgjithësisht t’u kushtohet më shumë vëmendje e në veçanti asnjansëve të paranyjëzuar, por, së andejmi, sipas nevojës, edhe duhet stimuluar integrimin e tyre pa ngurrim në standard.

Ne, për të pasur edhe më të përkapshme mënyrën trajtëformuese e fjalëformuese të emrave të gjinisë asnjansë, siç u tha, si pikënisje për me u ngjitur kodrave e shpateve drejt majave të objektivit, me qëllim për me mujtë me soditë, me gjurmue dhe me e intensifikue edhe më mirë pikërisht majat e thelbit të çështjes, gjetëm e kapëm fillin e lëndës në *Fjalorin e shqipes së sotme* (1984 ribot.2002), si stacion i parë ky përfaqësues e rekomandues i letrarishtes së sotme, ku gjetëm, volëm e mbarështruar me nge të gjithë emrat asnjansë të regjistruar aty, të cilët po i paraqitim të merenduar, sipas tipave të sipërcekur në tri grupime: së pari, **asnjansit si emra të mirëfilltë lashtënorë**, së dyti, **asnjansit prejmbiemërorë të nyjshëm** dhe së treti, **asnjansit e paranyjëzuar prejpjesorë**.

Tipi i katërt në FSHS 2002, nuk ceket si asnjansë, por së **-ja** shpjegohet në dy zera:

Nën zerin I - si trajtë e nyjës së përparme që përdoret në tri rasa: gjinore, dhanore dhe rrjedhore dhe si ilustrim jepen këta 5 shembuj:

*Ndjenja e së bukurës, Drejtoreshës së kopshtit, Mjelëses së dalluar. I klasës së dytë dhe I foli së bijës (vajzës së vet).*

Nën zërin II – cilësohet si pjesëz trajtëformuese në disa shprehje ndajfoljore dhe për këtë jepen këta shembuj ilustrues:

*së pari, së paku, së tepërmi, së afërmi, së gjalli, së bashku; për së largu, për së mbari.*

Në FGJSH 2006 shënohet vetëm përmbajtja nën II., teksti është i njëjtë. (Aty f. 956.)

Siç po shihet në të dyja burimet nuk ceket gjinia asnjëse dhe mungojnë shembuj prepjesorë si asnjëse të rasës rrjedhore. Madje asnjëri nga 5 shembujt nën I nuk duhet qartë se del në rasën rrjedhore, ndërsa nën II të gjithë shembujt e emëruar në funksion ndajfoljeje dalin në rasën rrjedhore, por ky fakt nuk ceket.

Sidoqoftë, ndonëse gjinia asnjëse e emrave të tipit të katërt trashëgimisht del e implikuar në sistemin ligjërimitor të shqipes ashtu si edhe gjurmët e asnjësit të tillë shihen tek mbiemrat e përemrat e në njësi të tjera leksiko-gramatikore, ne, në vështrimin tonë, pothuajse deri në kreun VII, do të përqëndrohemi sinkronikisht, kryesisht ose në tepër në klasën e emrave të mirëfilltë të paparanyjësuar asnjëse të rasës emërore, jo në veçanti edhe të mbiemrave e të përemrave (asnjëse), madje as të trajtave të asnjësit në shprehjet e ngurosura të rasës rrjedhore me nyjën **së**, po natyrisht këto të fundit nuk përjashtohen të preken në analiza, kur rasti na imponon.

### ***1) Grupimi i asnjësve sipas nyjë-mbaresave në emëroren e njëjësit të shquar***

Duke pasur si kriter nyjë-mbaresën e njëjësit bëmë grupimin si vijon të shembujve që i ndeshëm në FSHS 2002:

A. Së pari, **asnjëse emra të mirëfilltë**, d.m.th, pa nyjën e përparme karakteristike për dy tipat e tjerë, në Fjalorin në fjalë (2002) gjetëm të shënuar vetëm këta 6 shembuj, të cilët i ndamë në dy nëngrupe:

a) katër raste marrin nyjë-mbaresën shquese **-t**: *dhjamë-t, ujë-t, krye-t, paskrye-t*, dhe

b) dy shembuj marrin nyjë-mbaresën **-të**: *mish-të, lesh-të*.

B. Së dyti, sipas tipit të asnjësve **prejmbiemërorë të paranyjësuar** ndeshëm këta shembuj, të cilët i merenduam në tri grupe:

a) prejmbiemërorë të nyjshëm dyrrrokësh me temë në **-ë** që në shumësin e shquar marrin nyjë-mbaresën **-t**: *të bardhë-t, të butë-t, të gjallë-t, të hollë-t, të ftohtë-t, të fortët, të lartë-t, të lehtë-t, të majmë-t, të mbarë-t, të mirë-t, të ndotë-t, të ndytë-t, të ngrohtë-t, të nxehtë-t, të pështirë-t, të pështjellë-t, të rëndë-t, të thatë-t, të verdhë-t, të vështirë-t, të zbehtë-t* - gjithsej 22 shembuj;

b) prejmbiemërorë njërrrokësh që marrin nyjë-mbaresën **-të** në njësin e shquar: *të keq-të, të kuq-të, të lig-të, të madh-të, të ri-të, të zi-të* – gjithsej 6 shembuj;

c) prejmbiemërorë paroksitonë, me temë në bashkëtingëllore që në njëjës in e shquar marrin një-mbaresën **-i/t**: *të egër-it, të ëmbël-it, të fikët-it, të lagët-it, të mugët-it, të pakët-it, të tepërt-it* - gjithsej 7 shembuj.

Gjithsej në këtë burim i ndeshim të regjistruar 35 shembuj të këtij tipi.

C. Së treti, si **asnjanës të paranyjzuar të tipit prejpjesor**, aty gjetëm dhe volëm këta shembuj, të cilët, sipas tipit të foljeve, i radhitëm në katër grupe:

a) Mbi temë të foljeve me fundoren **-ë** dhe që njëjës in e shquar e bëjnë me **-t**: *të bërë-t, të dhënë-t, të gdhirë-t, të dalë-t, të hyrë-t, të larë-t I, të larë-t II, të marrë-t, të ngrënë-t, të ngjarë-t, të pangrënë-t, të parë-t I, të parë-t II, të pëgërë-t, të pështjellët, të prerë-t, të qarë-t, të qenë-t, të sharë-t, të vjelë-t, të vjellë-t* - gjithsej **21 shembuj**. Po këtij grupimi i takojnë edhe këta dy shembuj *të prirët* dhe *të thënë-t*, me të cilët manipulohet në sqarime brenda burimit përkatës, që gjithsej bëjnë **23 shembuj**.

b) Mbi temë të pjesores së foljeve me bashkëtingëllore që në shumës in e shquar marrin mbasesën **-it**: *të ecur-it, të errur-it, të folur-it, të ftohur-it, të lehur-it, të ngrysur-it, të ngjeshur-it, të nuhatur-it, të njohur-it, të prekur-it, të qeshur-it, të sosur-it, të shprehur-it, të tekur-it* - gjithsej **14 shembuj**. Po këtij grupimi i takojnë edhe këta 6 shembuj që i ndeshim të përdorur për nevoja sqaruese po në atë burim: *të hequrit, të mbajturit, të skuqurit, të pasurit, të ndenjurit, të vepruarit* - kështu numri i tyre në këtë grup arrin në **20 shembuj**.

c) Gjithashtu me **-it** e bëjnë njëjës in e shquar asnjansit e përfutur nga tema e foljeve më **-oj** dhe **-ua/j**: *të dëgjuar-it, të menduar-it, të mësuarit, të qëlluar-it; të paguar-it, të rruar-it, të shkruar-it* - gjithsej **7 shembuj**, mirëpo këtij grupimi i shtohen edhe **5 shembuj**, **tre** mbi temë me **-ua/r**: *të bashkëjetuar-it, të jetuar-it e të vepruar-it* dhe **dy** mbi temë në **-ye/r**: *të kërcyer-it të pëlqyer-it*, që i ndeshim të përdorur *po në* atë burim e që gjithsej kapin **numrin 12** (7+3+2).

ç) Te tipi i foljeve me togun **-ie/j**, të regjistruar e gjetëm vetëm një shembull që në shumës merr një-mbaresën **-ë/t** : *të përzier-ët*.

Gjithsej asnjansit të këtij tipi në këtë burim i ndeshim **43 shembuj**.

Si përfundim, numri i tërësishëm i asnjansëve të regjistruar, sipas tre tipave, kap **shifrën 84** (A - 6, B -35 dhe C - 43).

## 2) Konstatime rreth grupimeve të mësipërme

Nga shembujt e mësipërm vëmë re dy çështje që zgjojnë interes: a) versionet rreth një-mbaresave dhe b) numrin e shembujve që ndryshon sipas grupimeve brenda tyre, fakte këto që i konsiderojmë, pra, me interes në të mirë të konsolidimit të drejtshkrimit, si dhe për specifikimin e modeleve fjalëformuese, kriter ky që ne do ta zbatojmë në konstatimet e mëposhtme:

### a) Grupimi sipas tipit të një-mbaresave të shquarsisë

1. Te tipi i parë, d.m.th. te asnjansit primitivë që i quajtmë edhe si emra të mirëfilltë, sipas lëndës së regjistruar, ndër 6 shembuj dalin vetëm këto dy nje-mbaresat të njëjësit të shquar: **-t** dhe **-të**.

2. Te *asnjanësit prejmbiemërorë*, tipi i dytë, që përbëhej prej tri grupesh vihet re se secili grup në njëjësin e shquar merr një-mbaresë të veçantë, përkatësisht: **-t**, **-të** dhe **-it**

3. Te *asnjanësit e nyjshëm prejpjesorë një-mbaresë* e njëjësitet të shquar, sipas 4 grupeve, përkatëse del tri varianteshe: **-t**, **-ët**, **-it**.

Pra, grupi i emrave prejpjesorë të paranyjzuar, sipas shembujve të regjistruar, ka 2 mbaresa më shumë se te tipi i emrave të mirëfilltë të paparanyjzuar *-it* dhe *-ët* dhe ka po aq sa ka tipi i *asnjanësve prejmbiemërorë*, por këtij i mungon formanti *-të* që kishin dy tipat e tjerë, ndërsa tipit të prejmbiemërorëve i mungon formanti *-ët*.

Këto një-mbaresë duhen mbajtur mend, jo vetëm sa me marrë a me pasë në dijëni përgjithësisht, por edhe pse hyjnë në punë për arsye të konsolidimit të rregullave drejtshkrimore dhe të atyre drejt-trajtëformuese brenda strukturës përkatëse emërore.

Në këtë kontekst del i diskutueshëm shembulli i vetëm më *-ë/t*: *të përzierët*. Shtrohet pyetja a do të shërbejë ky rast si një formë përfaqësuese për tërë grupin e foljeve me *-r* në pjesore me tog zanor *-ie/r* apo jo? Më konkretisht a do të shtrihet formanti **-ët** për të gjitha foljet me *-ier* (ndier të ndierët), të atyre me *-yer*: *lyer* (të *lyer-ët*), *ngjyer* (të *ngjyer-ët*) etj. mbase edhe të atyre me *-ua/r* apo do të shkrihet në grupin e rasteve më *-i/t*, dm.th. me një *-i* -anapetike, siç dolën edhe dy shembujt *të kërcyer-it* dhe *të pëlqyerit*, me të cilët manipulohet në atë burim. Sigurisht, kjo çështje mbetet çështje e hapur. Gjithsesi, edhe kjo dukuri imponon sqarim nga normëvënësit tanë kompetentë. Lidhur me këtë, siç jemi shprehur në një vend tjetër, sugjerojmë që forma me **-ët** të jetë e parapëlqyer për *asnjanësit*, ndërsa ajo me **-it** për shumësin e emrave përkatës të gjinisë mashkullore dhe (kuptohet) formanti **-at**, pa diskutim i takon shumësit të emrave të gjinisë femërore.

Sidoqoftë, edhe kjo ide që ne do ta përsërisim herë pas herë, varësisht nga konteksti që na ofrohet, duhet të (ri)vlerësohet nga standardologët tanë

## **b) Grupimi përkatës dhe numri i shembujve**

1) Siç po shihet nga pasqyra e mësipërme sipas numrit të shembujve: *asnjanës emra të mirëfilltë*, d.m.th. pa një të përparshme, janë shënuar në këtë burim vetëm 6 ose më drejt vetëm 5 shembuj të pammë, d.m.th. pa pranëvënësen *paskrye-t*.

2) Shembuj *asnjanësisht të nyjshëm mbi bazë prejmbiemërore* dalin në numër të konsiderueshëm gjithsej 35 (22+6+7), me të cilët, varësisht nga nëntipi, shprehen koncepte cilësie, gjendjeje ose të qeni.

3) Numri i *asnjanësve të nyjshëm mbi bazë pjesoreje* është pak më i madh 43 (21+14+7+1, por që lë mundësi të hapur për përthithje edhe të shembujve të tjerë të përfutur rishtazi ose që i ndeshim në përdorim e sipër në ligjërimet tona.

Siç e pamë më lartë në Fjalorin në fjalë (2002) brenda sqarimeve a formulimeve përkatëse sipas grupeve ndeshëm edhe 13 *asnjanës të tjerë: të pirët, të ngrënë; të mbajturit, të skuqurit, të hequrit, të pasurit, të ndenjurit, të ftohurit, të bashkëjetuarit, të jetuarit, të vepruarit, të kërcyerit, të pëlqyerit* e mbase edhe ndonjë tjetër, fakt ky që shpreh prirjen për shumim të *asnjanësve të këtij tipi*.

Në të vërtetë ka mundësi që nga çdo folje të formohet asnjani përkatës prejjesor.

Sidoqoftë, pra, siç u pa, në Fjalorin në fjalë manipulohet me **6 asnjans** primitivë, të paparanyjzuar, **35 asnjans** prejmbiemërorë dhe **56** (43+13) asnjans prejjesorë që bëjnë gjithsej. **97** (84+13) shembuj. Mirëpo kur është fjala te numri i asnjansve, qoftë të regjistruar, qoftë të legalizuar në përdorim e sipër në shqipen letrare faktikisht numri i tyre gjithsesi del gjithnjë e më i madh. Kjo dëshmohet edhe nga numri i regjistruar në burimin më të ri normativ: *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006, ku siç do të shohim numri i asnjansve të regjistruar shënon rritje të dukshme. Po në kontekst të kësaj që po thuhet duhet pasur parasysh edhe një fakt tjetër me shumë interes se shumica e emrave të prejardhur cilësorë shpjegohen me ndihmën e asnjansit **të qenët + një mbiemër, një emër** ose një fjalë tjetër shpjeguese, si p.sh.: me **-si:** butësi – të qenët i butë, pabesi – të qenët i pa besë, afërsi – të qenët afër; me **-shti:** madhështi – të qenët madhështor; me **-i** bukuri – të qenët i bukur; me **-zi:** marrëzi – të qenët i marrë; me **-ri:** trimëri – të qenët trim, me **-shmëri:** pajtueshmëri - të qenët në pajtim, e kështu me radhë. Pastaj ka jo pak raste emrash me prapashtesat përkatëse të huazuara, që për nga numri i shembujve i sillen dhjetëshit. Sa për ilustrim, po japim vetëm nga një shembull: tipi me **-izëm:** liberalizëm – të qenët liberal; me **-itet:** naivitët – të qenët naiv; me **-llëk:** kalamallëk – të qenët kalama, e kështu me radhë, numri i shembujve të tillë, me: *të qenët + ...*, në FShS 2002 kalon **300-shin**.

Pra, marrë në përgjithësi **numri 84**, përkatësisht **97** i asnjansve të regjistruar ose të përdorur në FSHS (2002) nuk është edhe aq numër i vogël dhe kur të llogaritet edhe numri i shembujve të shpjeguar me togun: *të qenët a të bërët+ fjala përkatëse*, të gjithë shembujt kalojnë dukshëm **400-shin**, atëherë ky fakt vetvetiu bie ndesh me të dhënat se gjoja numri i asnjansve në përdorim e sipër në letrarishten e sotme është i vogël.

Sido që të jetë, kur është fjala se a është bërë përzgjedhje e mirë përfaqësuese me shembujt e regjistruar dhe a është dhënë interpretimi i duhur, apo jo, për të gjithë shembujt sipas tipave, çështja del pa përgjigje. Ky, në të vërtetë, shfaqet si problem më vete, por sidoqoftë edhe çështja rreth numrit të tyre tregon se konstatimet rreth pasivizimit të asnjansit në gjuhën standarde duhen pranuar me rezervë të ligjshme.

Në të vërtetë, nga sa u tha më lartë, si rekapitullim, më poshtë, në tabelën përkatëse po e rijapim vetëm numrin e tërësishëm të asnjansve të regjistruar në FShS 2002, sipas një-mbaresave përkatëse, sipas këtyre rubrikave:

1. tipi i asnjansit: A, B, C;
2. një-mbaresat e njëjësit të shquar dhe numri i shembujve;
3. numri i tërësishëm i shembujve.

**Tabela e numrit të asnjansve të regjistruar në FShS 2002**

1	2		3		
Tipi	-t	-të	-ët	-it	Gjithsej
A	4	2	-	-	6
B	22	6	-	7	35
C	21	-	1	21	43
Gjithsej	47	8	1	28	84



Siç po shihet numri më i madh i shembujve del mbi bazë të temës së pjesores me –ë fundore që marrin nyjë-mbaresën shquese –t, prandaj ky fakt si rregull drejtshkrimor duhet respektuar. Këtë po e theksojmë në mënyrë të veçantë, sepse në burime të caktuara edhe shembujt e tillë po shënohen ndonjëherë, kundër kësaj rregulle, me nyjë-mbaresën kryesisht mashkullore –it, d.m.th. me shtimin e –i-së anapetike.

Të vihet re se asnjansit e tipit të tretë (prejpjesorët) nuk marrin nyjë-mbaresën –të dhe është një rast i vetëm, i vetmuar, me mbaresën –ët (\*ëtë), çështje e hapur kjo që do të rriceket herë pas herë gjatë analizës.

Sidoqoftë, konstatimet që dalin nga ky krye i punimit duhen kuptuar edhe një sihyrje për të përkapur më mirë e më me lehtësi edhe çështjet e tjera në shkallë më të ndërlikuara me të cilat do të ballafaqohemi gjatë analizës a shtjellimit të lëndës në krerët vijues.



## II. NËNFUSHAT SEMANTIKE SIPAS TIPAVE TË ASNJANËSVE NË SHQIPEN LETRARE

Nënfushat semantike të asnjansve sipas tipave u cekën paksa edhe më përpara, por këtu do të trajtohen më në hollësi, duke i vënë në dukje veçoritë *dalluese* dhe *afruese* të tyre sipas asnjansve të tipave përkatës: atyre të trashëguar si emra të mirëfilltë, asnjansve prejmbiemërorë të paranyjzuar dhe asnjansve prejpjesorë të paranyjzuar. Pra në këtë krye kemi të bëjmë pikërisht me ndarjen e asnjansve sipas nënfushave semantike që mbulojnë, ose që priren të mbulojnë. Është e vërtetë se kur është fjala te tiparet afruese, kemi parasysh nënfushën që mbulojnë dy tipat e asnjansve të paranyjzuar (*prejmbiemërorët dhe prejpjesorët*).

### A. ASNJANËSIT E TRASHËGUAR SI EMRA TË MIRËFILLTË (TË PAPANJYJZUAR)

S'do mend se sipas logjikës, siç është cekur edhe më përpara, që në zanafillë emrat asnjans në gjuhën shqipe lindën për të emërtuar koncepte të gjë-sendeve konkrete, por jo për nocione *frymorësh* me gjini të përcaktuara, madje si duket atyre nuk u shkoi fort mbarë as për emërtime të nocioneve abstrakte, ngase nuk na kanë lënë trashëgim shumë emra të tillë abstraktë, po kryesisht konkretë, por megjithatë nuk jemi krejtësisht pa ta, ngase ndonjë rast i vetmuar ka arritur si gjurmë, deri në ditët tona, por, me sa pamë, shumica e rasteve të tilla nga kjo nënfushë semantike më tepër janë huazimet latine, siç p.sh.: *faj-të, mend-të, gjyq* e ndonjë tjetër. Kjo që thamë mund të vërtetohet edhe nga shembujt, edhe pse të paktë që i ndeshëm të regjistruar në Fjalorin e shqipes së sotme (2002), prej kah mund të nxirret përfundimi se me emrat e asnjansve të mirëfilltë të trashëguar të paparanjzuar, mbuloheshin koncepte që emërtonin dhe vazhdojnë të emërtojnë gjë-sende konkrete, por jo të specifikuara sipas ndonjë modeli sipas ndonjë nënfushe të qartë semantike, ndonëse zakonisht emërtoheshin lëndë ose objekte konkrete të panumërueshme ose edhe koncepte që nuk janë aq të thjeshta. Konkretisht, edhe pse në Fjalorin në fjalë (2002) janë shënuar vetëm 6 shembuj asnjansish primitivë, në bazë të nënfushës semantike që mbulojnë, mund t'i ndajmë në këto dy nëngrupe:

a) emra me të cilët emërtohej një sasi lëndë kryesisht e papërcaktuar ose "lëndë e pandashme në ekzemplarë", siç e thotë prof Sh. Demiraj (Shih: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988, f. 184.), por që ishte lëndë e lidhur ngushtë me jetën e atëhershme të shqipfolësve, si p.sh. *dhjamë-t (dhjamë-i dhjamëra-t) ujë-t (ujë-i ujëra-t), lesh-të (lesh-i leshra-t)* si dhe

b) emërtime të tjera, gjithsesi jo aq të thjeshta, që emërtonin dhe emërtojnë edhe sot pjesë të trupit, si është *krye-t*, nocion ky që ka të bëjë me kokën) dhe *ballë-t* që e shënojnë për ilustrim studiuesit tanë si dhe *veshë-t, sy-të, krah-të* që përmenden në burime të caktuara, gjithashtu, si asnjans.

U tha pak më sipër se asnjansit e parmë (emrat e mirëfilltë asnjans të paparanjzuar), të cilët kohësisht janë krijuar më përpara atyre të paranyjzuarve që

kemi sot ishin në përdorim në numër relativisht të madh, por në shqipen e sotme letrare, siç u pa nga pasqyra e paraqitur më parë, numri i tyre del shumë i reduktuar ose gjithnjë e më i reduktuar. Gjithsej 5 shembuj të parmë e ndeshëm në FSHS (2002), mirëpo sipas studiuesve të gramatikës historike të shqipes (Sh. Demiraj, E. Çabej, I. Ajeti, B. Bokshi, K. Topalli etj.) numri i asnjansve të mirëfilltë në përdorim si emra të parmë, d.m.th. pa nyjën e përparme, ishte shumë më i madh, Kështu në shqipen e dokumentuar sillen aty afër a mbi 70 shembuj, ndër të cilët janë edhe këta që ne, duke e pasur si kriter fundoren e temës përkatëse të njëjësit të pashquar, po i ndajmë në tri nëngrupe:

- me –ë fundore: *anë-t, ballë-t, brumë-t, djathë-t, drithë-t, dyllë-t, dhjamë-t, gjalmë-t, mjaltë-t, ujë-t etj,*

- me temë në bashkëtingëllore: *ar-të, bar-të, faj-të, gjak-të, kos-të, krah-të, qull-të, lesh-të, mal-të, miell-të, mish-të, petk-ët, rrush-të, tul-të, vesh-të, shtrat-ët etj.*

- me temë në zanore zakonisht të theksuar ose në diftong: *krye-t, bri-të, gji-të, sy-të, dru-të, pastaj: zë, gjë, hi, fre* e ndonjë tjetër.

Prof. Kolec Topalli, duke u bazuar në shembujt e dëshmuar që dalin në shkrimet e autorëve tanë të vjetër, ku, siç thotë ai, *kjo gjini shfaqej shumë me e fuqishme se në ditët tona*, arrin në përfundimin se në këtë gjini ishin përfshirë nënfushat semantike, si:

- 1) *emra lëndësh*, si: ujë, gjalpë, gjak, drithë, elb, grurë, vaj, mish, djathë, dyllë, kos, kripë, lesh, rush, qumësht, plehë, li, hi, dru, ar, frujt, hekur, bar, dru, dhallë, qull - gjithsej **26 shembuj**,
- 2) *emra të pjesëve të trupit*, si: ballë, sy, tru, krye, gji, bark, prehënë, tul, vesh – gjithsej **9 shembuj**;
- 3) *emra sendesh*, si: rrjetë, fre, gjalmë, petëk, shenj, shtrat – gjithsej 6 shembuj;
- 4) *emra vendesh*, si: va, vorr, krua, kopësht – gjithsej 4 shembuj;
- 5) *emra abstraktë*, si emër, dëm, faj, vjetë, muaj, gjyq, kumët, peng, anë, mend, tëtym, vaj – gjithsej **12 shembuj**;
- 6) *emra të formuar nga mbiemra*, si të madhtë, të bardhëtë, të keqtë, të gjanëtë – gjithsej **4 shembuj** dhe
- 7) *emra të formuar nga mbiemra prejpjesorë*, si: të dalëtë, të ngrënë, të shpërblenëtë **etj.** – gjithsej **3 shembuj**

Pra, siç po shihet autori në këto 7 grupe ka përfshirë **64 emra**, prej tyre 57 shembuj asnjansish të mirëfilltë të paparanyjzuar dhe 7 shembuj asnjansish të paranyjzuar (4 prejmbiemërorë dhe 3 prejpjesorë). Të vihet re, gjë na tërheq vëmendjen, se vetëm për grupin e fundit të asnjansve prejpjesorë e shënon treguesin **etj.**, i cili sot për sot është grupi më aktiv dhe prodhimtar i asnjansve në gjuhën shqipe.

Siç mund të shihet identifikimi i të gjithë emrave asnjans bëhet me nyjën e mbrapme– **t(ë)**, në emëroren e njëjës të shquar, mjet ky sintaksor identifikues kundrejt nyjës, **-i, -u** të gjinisë mashkullore dhe **-a, -ja** të gjinisë femërore, ndërsa për dy pikat e tipat e fundit identifikimi i asnjansit del edhe me nyjën e përparme **të**, mirëpo për këta dy tipa do të bëjmë fjalë në nëntitujt vijues.

Lexuesi i vëmendshëm mund të ketë vërejtur se autori në grupin përkatës nuk e shënon, me të drejtë shembullin *paskryet*, por mbase rastësisht nuk e shënon as emrin dhjamë-t që ne e volëm nga burimi normativ përkatës. Sidoqoftë, edhe kjo tabelë-paraqitje e autorit vërteton se sigurisht numri i tyre, mund të ketë qenë edhe më i madh se 63-shi ose 70-shi i përmendur, ndoshta e kalonte 100-shin e më shumë, ku ta dimë, kur kemi parasysh sugjerimin e bazuar se edhe mjaft emra, gjithsesi, jofrymorë, metaforikë e

metonimikë si dhe ambigjenët, që në zanafillë, thuhet se ishin asnjans. S' do mend se asnjansit e mirëfilltë, emra të paparanyjzuar, jo vetëm atëherë, por edhe tashti, ende janë mjaft aktivë vetëm në disa të folme dhe vetëm te brezi i vjetër i folësve të atyre trevave. Është e vërtetë, se nga folësit e brezit të ri, sigurisht të ndikuar nga gjuha e shkollës dhe e administratës, më drejt, nën ndikimin e gjuhës së sotme letrare, asnjansit e këtij tipi po përdoren gjithnjë e më rrallë e numerikisht më pak, por njëherazi, mund të thuhet se dukuria e shkrirjes po ndihmohet, përveç institucionalisht me gjuhën letrare, në njëfarë mënyre edhe nga vetë struktura e kuptimësisë, ngase për hir të konkretizimit, koncepti përkatës në ndjenjën e folësve, po del më i qartë me emrat mashkullorë a femërorë (njëjës e shumë) se me asnjansit që mbulonin, si me thënë, jo krejt tërësinë e nocionit të gjë-sëdit përkatës, por vetëm një pjesë të tij ose një pjesë të sasisë së lëndës përkatëse. Krahaso: njata a këta djathë ose këta (njëkëta) ujë me njëjës ky djathë, ky ujë, në njërën anë, ose shumësin me këta a këto djathna me këta a këto ujna ose ujëra, në anën tjetër. Pra, konkretizimi bëhet me tregues që përcaktojnë profilime lakime ose kategori të tjera të përbashkëta që nuk i ka, po thuaj, të gjalla, sot për sot, asnjansi përkatës.

Së këtejmi del çështja se koncepti i papërcaktueshmërisë në ndjenjën e folësve po shkrihet në dobi të konkretizimit të shprehur, me tregues gramatikorë, njëherë sipas mënyrës polisemantike e pastaj po natyralizohet në trajtën e njëjësit të gjinisë mashkullore ose të shumësit të gjinisë formale përkatëse aktive femërore në disa raste, me prapashtesën *-ra/-na*.

Me thënë të drejtën, po të shikohet më në hollësi koncepti i tillë i asnjansit edhe pse nuk mbulohet tërësisht në ndonjë rast, pjesa e pambuluar sipas nënvetëdijes a ndjenjës së ligjëruesit nuk kërkon patjetër mbulesë të diferencuar nga ekzistuesja e gjinisë mashkullore. Me fjalë të tjera, në stilin neutral, arsyeja për ta ruajtur trajtën e veçantë asnjansë për shumicën folëse po del gjithnjë e më tepër si diçka jo aq e domosdoshme.

Prof. Kolec Topalli si ndryshim a si shkak ndikimi që ka prekur paradigmat e emrave të gjinisë asnjansë përmend këto dy dukuri:

e para, kur atëbotë ekzistonin si emra të gjinisë asnjansë dhe emra të gjinisë tjetër mashkullore e femërore që shprehnin të njëjtin nocion, d.m.th. *objekte të panumërueshme*, si p.sh. në njërën anë: *ujë-t, gjak-të, grurë-t, mjaltë-t* etj, e në anën tjetër: *mel-i, tërshanë-a (tërshërë-a), avull-i, gjellë-a* etj. - andaj, sipas tij “*nuk kishte kuptim që një grup emrash të tillë, që shprehin lëndë të panumërueshme, të formojnë një gjini të veçantë, kurse një grup tjetër të bëjë pjesë në gjini të tjera dhe*

e dyta, mungesa e paradigmave rasore të tjera të veçanta të asnjansëve, pra veç emërores e kallëzores dhe jo edhe në rasa të tjera dhe kjo vetëm në trajtën e shquar, *prandaj mbetej të zëvendësohej* (vetëm një element formal mbase jo aq i domosdoshëm), pra mbetej të zëvendësohej *vetëm nyja shquese e gjinisë asnjansë -të*, e cila mbetej të përballej me nyjat konkurrenente të gjinive të tjera.

Ndërkaq, si dukuri që e kanë favorizuar çintegrimin e gjinisë asnjansë dhe shkrirjen e saj në gjinitë e tjera, sipas tij janë:

1) fundoret e njëjta *mish, lesh, elb, vaj* ndaj *gjysh, qelb*, përkatësisht *drithë, dyllë, djathë, emënë* ndaj *gjumë, lumë, gjarpënë* etj.;

2) në rasat e zhdrejta gjinia asnjansë ishte integruar prej kohësh, përgjithësisht në gjininë mashkullore dhe

3) edhe fakti se dallimi i emrave asnjans nga gjinitë e tjera ka karakter sintaksor, pasi dallimi i tyre bëhet vetëm me nyjën shquese ose nga përemrat dëftorë, pronorë etj si tregues të veçantë të implikuar në këtë gjini.

Për të gjitha këto përfundon autori, “*gjinia asnjans sot paraqitet me karakter reliktor, ngase emrat e tillë kanë kaluar në dy gjinitë e tjera, por kryesisht në gjininë mashkullore, ku janë integruar*”. (Shih Seminari 26/1, Prishtinë 2007 f. 212--213.)

Sidoqoftë, ne pa i kontestuar mendimet e prof. Topallit, që vlejné vetëm për asnjansit e tipit të parë, megjithatë, po shtojmë edhe këtë se në disa raste edhe te kjo dukuri që duket se është në proces e sipër të tkurrjes a mbase të zhdukjes përfundimtare(!), paraqiten disa përjashtime.

Me fjalë të tjera, mendojmë se varësisht nga konteksti, mund dhe duhet të frenohet subjektivisht dukuria e tillë rrëgjuese, në njërën anë, por edhe mund të përshpejtohet shuarja e trajtave përkatëse, në anën tjetër. Kjo varet, mendojmë ne, nga qëndrimi i faktorëve kompetentë (standardologëve) tanë ose nga vlerësimi objektiv kritik që duhet t’i bëhet çështjes. Gjithsesi, që është edhe fakt kryesor, ky proces varet nga vetë shqipfolësit, përkatësisht vetë krijuesit letrarë ose ligjëruesit me identitet të formuar gjuhësor. S’do mend, çështja duhet të vështrohet, duke e pasur për bazë interesin më të lartë thelbësor strukturor e më gjerë të sistemit emëror në kuadër të mbarëvajtjes së përgjithshme të sistemit të tërësishëm ligjërimit të gjuhës shqipe. Të jemi edhe më të qartë, në raste të tilla duhet vepruar me kujdes, gjithnjë duke e pasur parasysh interesin që del nga pasqyrimi i dukurisë së caktuar në vend të caktuar dhe në situatë të caktuar. Duhet bërë, pra, vlerësimin sipas nevojës, çka duhet të ruhet apo çka të mos ruhet më tutje si pasuri e trashëguar që është dhe që ka ndërlidhshmëri gjithsesi me asnjansit.

Na merr mendja se këtu është vendi të theksohet mendimi i Migena Ballës, e cila po për asnjansit e këtij tipi, pasi thekson se:

“... për rrethanën, sidoqoftë, të folmet (e qytetit të Vlorës) nuk janë kudo uniforme as në bjerrjen as në ruajtjen a gjallimin e kësaj dukurie” shprehet me këto fjalë:

“*Ndërkaq nuk mund të mos vëmë re se, se gjinia asnjans, edhe pse tashmë në rrudhje e sipër, ka edhe disa funksione me vlerë stilistike, për hir të të cilave, mendojmë se do të vijojë të ketë përdorim e vlerë shprehëse, si në gjuhën e shkruar, ashtu edhe në dialekte*”. (Shih: Seminari 26/1, Prishtinë 2007 f. 293.)

Pra, duhet të kihet parasysh fakti, nga standardologët tanë, që jo vetëm të shpëtohen disa raste të dobishme ose të domosdoshme për gjuhën letrare të tipit të asnjansëve të mirëfilltë (emërorë) të paparanyjzuar, siç janë *frazeologjizmat e trashëguar*, por edhe të *kultivohen shprehje të veçanta* sidomos në situata gjegjëse, të krijuara, qoftë nga gjuha e popullit, qoftë nga krijuesit e caktuar letrarë. Në të vërtetë, ndonjë rast efektiv i kësaj natyre do të ceket, paksa prej nesh, në kreun e fundit të këtij punimi. Po, këtë rast, po shtojmë një të dhënë me shumë rëndësi. Vetëm mbi bazë të emrit **ujë-t** në *Fjalorin Mehmet Elezit* janë regjistruar mbi **80 frazeologjizma** mjaft cilësorë, ndërsa mbi bazë të emrit **krye-t** mbi **100 të tillë**. Me fjalë të tjera, edhe format e këtij tipi asnjansish mund të shpëtohen jo aq si emërtime të veçanta të gjërave konkrete, por në togfjalsha e fjali kur shprehin ngjyrimet stilistike e përgjithësisht për koncepte abstrakte, siç janë frazeologjizmat e shprehjet e veçanta në këtë fushë.

Sidoqoftë, karakteristikë e këtij tipi asnjansish, siç u cek, është se aktualisht nocioni i emrit përkatës, por jo i shprehjes, shpjegohet po me të njëjtin emër, por të konvertuar në gjininë mashkullore. P.sh. :

*Fjala **mish-të** shpjegohet se kemi të bëjmë me gjininë asnjansë të emrit **mish-i** (njëjës) ose me **mishra-t** a **mishna-t** (shumës).*

Pra, kjo veçori dallohet më qartë kur të krahasohet, siç u pa, me trajtën përkatëse korresponduese të grupit leksiko-gramatikor të emrave të lëndës të gjinisë mashkullore njëjës, ku tash sa kohë po shkojnë duke u shkrirë funksionalisht treguesit e emrit asnjans të këtij tipi. dhe që të dyja trajtat mbi të njëjtin rrënjor normativisht janë të pranuar. Sidoqoftë, asnjansit e këtij tipi nuk na duket se kanë perspektivë prodhimtarie. Prandaj ndonëse zgjon interes, sipas mendimit tonë, shembulli **qallë-t**, sinonim për syzat (FGjSh 2006, f. 867) ai nuk motivon dhe nuk mund ta dimë sa do të ketë jetëgjatësi faktike në ligjërimin tonë aktiv aktualisht.

Si përfundim, asnjansi i tipit të parë, edhe pse nuk ka ndërtim analitik, po sintetik ka pësuar dhe po pëson çintegrim, sepse nuk e ka të specifikuar nënfushën e veçantë semantike, ngase për të njëjtat nënfusha semantike konkurrojnë tashti me sukses edhe disa tipa a nëntipa emrash të gjinive të tjera aktive gramatikore, sidomos të gjinisë mashkullore, andaj thjeshtëzimi i tillë evolutiv në gjuhën tonë parimisht del i drejtë.

## B.. ASNJANËZIMI I MBIEMRAVE TË PARANYJËZUAR

Para se të analizojmë emërzimin e mbiemrave të paranyjëzuar po e shfaqim mendimin tonë për një rast të shënuar në FGjSh 2006 si asnjans: **të papunët** (Aty f. 747), i cili sqarohet me zberthimin kuptimor: *papunësi (të qenët i papunët)*, shembull ky të cilin e konsiderojmë të diskutueshëm. Pra e konsiderojmë të diskutueshme këtë trajtë për këto dy arsye:

së pari, për mendimin tonë nuk ka mbështetje prejardhësore, as mbiemërore as prejppjesore, ndonëse është fjalë e paranyjëzuar dhe

së dyti, si antonim nuk është fort i qëlluar, ngase për të shprehur një nocion abstrakt në raportin antonimik: *punësi / papunësi*, përkatësisht *të punësuarit / të papunët*, më motivueshëm do të dilte antonimi *të papunësuarit*, d.m.th.: **të punësuarit/të papunësuarit**, jo **të papunët**, sepse emri të papunët (i papuni frymor), përkon me antonimin **mepunët** (!), ai që është me punë, d.m.th. i zënë me punë (i punësuar) ose të qenët i zënë me punë ose t; qen;t pa punë (si dukuri). Krahaso: është *pa punë*, është *me punë* (sikurse kjo është *punë e drejtë me rrugë ose është punë jo e drejtë, pa rrugë*).. Ndërkaq nëse mendohet të papunët si emër abstrakt, me të cilin shprehet një dukuri shoqërore papunësia, atëherë duhet vlerësuar se një koncept i tillë del i nevojshëm apo jo të shprehet në atë mënyrë?!

Sidoqoftë duke e lënë shembullin e tillë të diskutueshëm, ngase emrin e tillë nuk mund ta krahasojmë as me shembullin *të pangrënë*, që del nga paralelja e kundërt *të ngrënë*, kurse shembulli ynë nuk e ka një paralelizëm të tillë, nuk është as prejmbiemëror as prejppjesor, megjithatë, shpreh gjendje, andaj shembullin në fjalë mund ta quajmë si *përftim kontekstual* a si një fjalë të shpifur spontanisht, e ku ta dimë. Pra duke e lënë këtë çështje të hapur, tashti po i kthehemi shtjellimit të temës sonë sipas titullit të shënuar.

Asnjanësit prejmbiemërorë të paranyjzuar në tabelë-paraqitjen e prof. K. Topallit e ndeshëm vetëm me katër shembuj pa treguesin **etj.** ndërsa në FShS 2002 i ndeshim të regjistruar 34 shembuj, gjë që tregon rritjen e një numri të tillë.

Sido që të jetë ne këta 34 shembuj sipas nënfushës semantike që mbulojnë, i merendiam në dy grupe: së pari, ata që shprehin *një cilësi*, dhe së dyti, ata, me të cilët tregohet *një gjendje* ose *një të qenë*.

### a) Prejmbiemërorët me kuptimësi cilësie

Me kuptimësi të qartë cilësie në burimin në fjalë, të regjistruar, i ndeshim këta shembuj:

*të bardhë-t (bardhësi), të butë-t (butësi), të egër-it (egërsi), të ëmbël-it (ëmbëlsi), të fortë-t (fortësi), të ftohtë-t (ftohtësi), të keq-të (për/keqësi!), të kuq-të (kuqëlim), të lartë-t (lartësi), të lehtë-t (lehtësi), të hollë-t (hollësi), të mbarë-t (mbarësi), të mirë-t (mirësi a mirëni), të ngrohët-it (ngrohtësi), të thatë-t (thatësi), të verdhë-t (verdhësi), të zbehtë-t (zbehtësi), të zi-të (zi-a, zyrtësi),) – gjithsej 18 shembuj.*

Në të vërtetë, në burimin në fjalë sqarimi i asnjansëve të caktuar nuk del parësorisht për të gjithë shembujt me kuptimësinë, sipas barasvlerësve sinonimikë përkatës, siç i shënuam ne në kllapa, por vetëm për shumicën e tyre. Por me gjithë kuptimet polisemantike të ndryshme që i shoqërojnë shembujt, madje edhe me emra konkretë, kuptimi strumbullar i asnjansësit ose bërthama kuptimore nuk largohet nga kuptimi i përgjithshëm i ngjyresës përkatëse semantike, çështje kjo për të cilën do të ndalemi më në hollësi, pasi t' i përmendim edhe shembujt e grupit tjetër.

### b) Prejmbiemërorët me kuptimësi gjendjeje a të qeni

Si asnjans mbi bazë *mbiemërorësh* jocilësorë (a të ndonjë *sifoljori!*), me të cilët shprehet një kuptimësi jo e qartë cilësie po e ndërthurur me një dozë paksa më të theksuar gjendjeje a të qeni (ndjenjë, kohë) drejtpërdrejt ose në mënyrë të fytyruar i cilësuam disa shembuj, të cilët i ndeshim në numër jo aq të konsiderueshëm në Fjalorin në fjalë. I quajtmë rrëshqitazi edhe *sifoljorë (!)*, sepse në koncept, ashtu si vetë varianti prejfoljor i emrit përkatës edhe me ta shprehet një të qenë a gjendje ose një ndryshim i gjendjes. Edhe këta po i shënojmë duke i shoqëruar në kllapa me sinonimet e mundshme përkatëse, si p.sh.:

*të gjallët (n/gjallje, gjallëri), të lagët-it (lagështirë), të lig-të (ligësi, ligështim), të madh-të (madhështi), të mugët-it (mugëtirë), të ndotë-t (ndotshmëri!), të ndytë-t (ndytësi/rë), të nxehtë-t (nxehtësi, zjarrmi), të majmë-t (majmëri), të pështirë-t (pështirësi, neveri), të fikët-it (fikje, humbje e vetëdijes), të rëndë-t (rëndesë, rëndë-a, sëmundje), të pakët-it (m/pakje!), të ri-të (rini-a), të tepërt-it (tepri-a), të vështirët (vështirësim – gjithsej 16 raste.*

Ç'është e vërteta, ndonjë shembull që ne e cilësuam *sifoljor* ose *jocilësor*, nuk ka veçori aq të prera dallimi me cilësorët e mirëfilltë, në njërën anë dhe me asnjansësit



prejppjesorë, në anën tjetër, por ne e pagëzuam kështu për hir të veçorisë kuptimore që shprehin aktualisht shembujt e caktuar, sepse sipas këtij kriteri, nocioni i shprehur më tepër i takon nënfushës së asnjansëve prejmbiemërorë se atyre prejppjesorë ose në raste edhe atyre prejndajfoljorë. Krahaso raportin semantik: *të lagëtit* (nga i lagët-i, ndaj të lagurit (lagur me lagë) ose *të nxehtët* (nga nxehtë i nxehtë-i) ndaj të nxehurit (nxehur me nxehtë).

Prandaj në vazhdim po përpiqemi të sqarojmë se cili është a duhet të konsiderohet si kuptim strumbullar i përzgjedhur ose i parapëlqyer i asnjansëve prejmbiemëror të cilësisë dhe cili i prejppjesorit jociësor, sepse sipas përkufizimeve përkatëse në Fjalorin në fjalë kjo çështje nuk del e qartë.

Në burimin në fjalë, siç do të duhej, nuk respektohet kriteri që kuptimi i parë strumbullar të jetë ai i nocionit abstrakt dhe si i tillë ky kuptim duhet të zërë vendin e parë të radhës e pastaj të vijë kuptimet e tjera polisemantike që mund t'i ketë emri i caktuar. Aty (në Fjalor) jepet në mjaft raste si kuptim i parë në radhë nocioni i një gjë-sendi konkret që bie ndesh me destinimin historik burimor, por edhe të sotëm motivues të asnjansëve prejmbiemëror që iniciohet drejtpërdrejt nga tema e qartë fjalëformuese. Siç dihet emri i tillë, që e ka motivimin, ose që duhet ta kishte, qoftë në një koncept cilësie (pika a), qoftë në një koncept gjendjeje a të qeni (pika b), në radhë të parë, kuptimisht duhet me e shprehë nocionin që i takon fushës së abstraksionit. Këtë çështje po e qartësojmë sadokudo më në hollësi më poshtë.

## 1. Rreth kuptimit strumbullar të asnjansëve prejmbiemëror

Të vihet re se sinonimet e shënuara në kllapa për shembujt e paranyjzuar, qoftë nga hartuesit e Fjalorit në fjalë, qoftë edhe prej nesh, dallojnë qartë semantikisht nga nocioni parësor që kanë sot asnjansëve e mirëfilltë prejmbiemërorë, por megjithatë, ne, formën e tillë e konsideruam si barasvlerësin më të qëlluar semantik, më të përafërt me realitetin e sotëm, Këtë që sapo e thamë, për ta kuptuar më mirë, po përpiqemi ta shpjegojmë më poshtë, duke e ilustruar me ndonjë shembull konkret. Siç dihet, b.f., fillimisht formimi i asnjansëve të tipit *të bardhët*, *të kuqtë* e të ngjashëm është motivuar nga tema e qartë fjalëformuese e mbiemrit përkatës (asnjansë: *të bardhët* ose (i) *bardhë*, *të kuqtë* ose (i) *kuq* etj. dhe mbi këtë bazë është bërë emërimi për të shprehur konceptin përkatës në fushën e abstraksionit, por që ndërlidhej domosdo metaforikisht a drejtpërdrejt me konceptin e cilësisë nga tema prodhuese motivuese. Pra, nga fjalë-emri *të bardhët* do të shprehej një kuptimësi, qoftë drejtpërdrejtë me ngjyrën e bardhë, qoftë tërthorazi, siç u cek, me një kuptimësi metaforike simbolike e një dukurie përkatëse. Kështu mbase fillimisht mund të shpjegohej prejardhja e të gjitha emëzimeve nga mbiemrat e paranyjzuar.

Na është e ditur se po ato cilësi të emrit që shprehin mbiemrat e thjeshtë të mirëfilltë, siç janë:

- a) *madhësia e forma*, tipi i madh, i gjerë, i lartë etj,
- b) *ngjyra*: i bardhë, i kuq, i verdhë etj. si dhe
- c) *vetia fizike e shpirtërore*, si i butë, i fortë, i njomë, i bukur, i ëmbël etj. (Shih K. Topalli, vepra e cit. f. 32.)j

po ato dalin të mishëruara edhe tek asnjësit prejmbiemërorë, pra të emëruar mbi të njëjtën bazë.

Këtë fakt, që sa e shumë në gojë, po e theksojmë në mënyrë të veçantë për arsye se në FShS (2002) nuk është vepruar kështu në mjaft raste. Ndodh, jo rrallë që aty si kuptim i parë ose si veçori karakteristike e motivuar me dalë jo kuptimësia e një madhësie, e një ngjyre a e një vetie fizike, po një kuptimësi tjetër, pra jo ajo që ndërlidhet me temën fjalëformuese. P.sh. aty në vend se të shënohet parësisht karakteristika prejmbiemërore që ka të bëjë me cilësinë përkatëse, qoftë edhe simbolike me nocion abstrakt, del emërtimi i një gjë-sendi konkret, si b.f. kuptimi i parë për konceptin të *bardhët* në vend *bardhësi* del *krem-zbardhimi*, për të *kuqtë* del (*laps*) *buzëkuqi*, për të *hollët* është shënuar *ije* (pjesë e trupit), për të *lartët* del *vend*, ndërsa për të *verdhët*, të *zbehtët* del *verdhëza* (sëmundje, si shenjë pasojë), për të *lehtët*, të *rëndët*, të *hollët*, të *fikët*, del shpjegimi: *alivani*, *alivanosje* (d.m.th. sëmundje), të *ftohtët* ka barasvlerësin *plevit* (sëmundje dhe, po ashtu, trajtat: të *pështirët*, të *vështirët*, të *pështjellët*, të *ndotët*, shpjegohen me *krupë*, *neveri* (sëmundje), duke u larguar kështu nga kuptimi fillestar abstrakt që i takon edhe sot natyrës së mbiemrit përkatës ose edhe emrit cilësor me prapashtesën –*si*.

Ne, nuk kontestojmë të vërtetën se me rastin kur janë vjelë emrat e tillë, madje edhe në gjendjen e sotme me ta diku-diku ndodh të shprehet koncepti i sipërcekur përkatës, por tërheqim vërejtjen e ngulmojmë që këto koncepte asnjësi duhet a mund t'i ketë si koncepte të dorës së dytë a të tretë, dhe jemi të sigurt se, b.f., trajtat e emrave të tillë në konkurrencë lojale me emërtimet e zyrtarizuara, sidomos për gjë-sende konkrete ose të sëmundjeve, në ballafaqim me emërtimet zyrtare të sëmundjeve, do ta humbin atë konkurrencë, nëse deri tani nuk e kanë humbur, prandaj në fjalorët e tipit normativë shpjegues standard, patjetër së pari në radhë, duhet të shënohet kuptimi strumbullar që ndërlidhet me konceptin përkatës të abstraksionit të lartë që shpreh asnjësi sipas motivimit që e jep tema e qartë fjalëformuese e pastaj mund a duhen shënuar edhe kuptimet vargore polisemantike që ende mund t'i shprehë emri i tillë i gjinisë asnjësie.

Po ritheksojmë faktin se kur është fjala te shembujt që i jep prof. A. Zymberi, lidhur me mbiemrat e emëruar mbi bazë pjesoreje të shkurtë *kalbë* me *kalbë* (t' *kalbët* të *kalbëtit*) ose *ndrydhë* me *ndrydhë* (i *ndrydhët* të *ndrydhtit*), siç ishin rastet te mbemrit të *kalbëtit* (pjesa e *kalbët* e *mollës*), të *ndrydhëtit* (pjesa e *ndrydhët* e *këmbës*) etj. ku nuk ka sinonim alternativ me barasvlerësi të plotë zëvendësimi, emërtimet e tilla, duhet të legalizohen në përdorim normal. Pra, asnjësit e tillë që dalin të nevojshëm për mbulimin e koncepteve të veçanta për gjëra me cilësi konkretizimi duhet të vlerësohen si të pranueshëm në shqipen standarde, por, gjithsesi të shënjohen, si raste të veçanta për nënfushën semantike që mbulojnë.

#### a) Rreth sinonimisë së asnjësve prejmbiemërorë të cilësisë

Siç mund të shihet nga pasqyra e shembujve të grupimit të parë, të gjithë barasvlerësit sinonimikë të asnjësve prejmbiemërorë të cilësisë, ndonëse nuk shprehin plotësisht të njëjtin koncept, dalin me prapashtesën –*si*, përveç dy rasteve: *zi-a* për të *zi-të* dhe *kuqëlimi* për të *kuqtë*. Që sinonimet e caktuara nuk e shprehin të njëjtin koncept kemi si provë faktin se të gjithë asnjësit cilësorë mund të zërthehen me treguesin sintagmor: të *qenët a me qenë* + *mbiemri* (njëjës mashkullor). Letrarishtja e sotme rekomandon zërthimin: të *jesh* + *mbiemri përkatës*, por ne na duket sadopak më natyrshëm me dalë

zberthimi *me asnjanes ose me paskajoren e mirefillte + mbiemri perkatës se me formën e lidhores (veta e dytë njëjës)*. Andaj pritet me të drejtë rehabilitimi i trajtave të paskajores së mirëfilltë në standard, siç është kërkuar. Krahaso: *të mirët*, d.m.th, me qenë ose të qenët i mirë; të bardhët – me qenë ose të qenët i bardhë, e kështu me radhë (sigurisht jo *të jesh i bardhë!!*), ndërsa sinonimi në kllapa zberthehet me paskajoren e foljes ndihmëse: me pasë: *me pasë + emri perkatës*, ndërkaq letrarishtja e sotme rekomandon *të kesh + emri perkatës* (trajtë e lidhores veta e dytë njëjës). Pra me *mirësi* kuptohet *me pasë sjellje a cilësi të mira ose me qenë i pajisur me të mira*. Gjithashtu me emrin *bardhësi* kuptohet figurativisht se **duhet me pasë** (d.m.th., jo vetëm *të kesh* ti) **veçori të larta ogurbardha morale e të tjera**, por me kuptim përgjithësues që vlen për të gjitha vetat njëjës e shumës, përgjithësim ky që shprehet natyrshëm me trajtën e paskajores **me pasë**.

Këtë që sapo u përpoqëm ta shprehim rreth asnjanesit në raport me sinonimet përkatëse, po e ilustruam me këtë dialog të mundshëm:

-Këtë të **mirë** ta kthefsha me **të mirë** dhe me *të mira*.

-**E mira** është kat-kat, more vëlla, Ajo shihet më së miri jo me sytë e ballit po me sytë e mendjes.

-Sidoqoftë, me **mirësi** fitohet e këndellet më lehtë edhe çdo zemër e thyer!...

Pra, kemi vërejtur se të gjithë asnjanesit mund të zberthehen kështu, si u tha më lartë dhe njëherazi konstatojmë se mund të ketë ndër-këmbime në nuanca, ashtu siç mund të ketë edhe dallime në këtë trashë a katërsh sinonimik:

1) **të mirët** – asnjanes – koncept i përgjithshëm abstrakt,

2) **e mira**, po emër abstrakt, femëror i paranyjësuar, me të cilin gjithsesi paraqitet një veprim a ide e konceptuar, si të thuash e konstruktuar me ndonjë element konkretizimi, siç është treguesi *kat-kat*, ndërsa

3) me **mirësi** kuptohet, po emër abstrakt i gjinisë femërore, i prejardhur me prapashtesën *-si*, me të cilin paraqitet se shprehet diçka edhe më konkrete nga shembulli i mësipërm po i kësaj gjinie, si me thënë, shprehet sadokudo materializimi i vetë idesë së konceptuar ose rezultati i procesit përkatës si rrjedhojë e punës së mirë, d.m.th. *e së mirës*, nocion ky që ende qëndron në fushën e abstraksionit, po duket se del e pajisur me elemente të konkretizimit relativ.

Fundja këtë dhuratë që ia jep *copë në dorë a llokum në gojë* gjuhës sonë I lumi Zot, të breruar atavikisht edhe me hyjnizim magjik, duhet ta njohim më mirë, ta shfrytëzojmë që të gjithë ne shqipfolësit dhe ta trashëgojmë ogurbardhësisht e jo ta anashkalojmë, ta rrudhim ose edhe ta zhdukim subjektivisht. Këtu nuk e kemi fjalën për stilin administrativ sesa për stile të tjera. Sido që të jetë, ky është një fakt që tregon se kuptimi i formave të asnjanesit prejmbiemëror në raport me barasvlerësit sinonimikë (sidomos me emrat e prejardhur), ndryshon jo vetëm për nga forma e gjinia, por edhe për nga brendia, nga përmbajtja ndërlidhur me nënfushën semantike që mbulon e së këtejmi ndryshon edhe nga mënyra e zberthimit semantik. Në këtë kontekst, këtu mund të hetohet një çështje me shumë rëndësi. Ndërsa koncepti i asnjanesit mbetet në fushën e abstraksionit, ai i emrave të prejardhur me *-si* etj. tregon procesin e formësuar, mjaft të ravijësuar po në fushën e abstraksionit, por të pajisur shkallë-shkallë me elemente semantike gjithnjë e më afër konkretizimit.

Prandaj në asnjë rast sinonimet e tilla nuk duhen konsideruar si plotësisht identike ose që mund të zëvendësohen për të shprehur të njëjtin nocion në fusha të caktuara të dijes e të veprimtarisë. Këtë fakt po e ritheksojmë në mënyrë të veçantë, sepse disa

gjuhëtarë e krijues letrarë, madje edhe ndonjë përkthyes i pa përvojë të duhur, pa të drejtë, asnjësit prejmbiemërorë cilësorë po i zëvendësojnë me emrat përkatës të prejardhur, kryesisht me prapashtesën –si ose edhe me ndonjë tjetër, pa e vrarë mendjen se me një veprim të tillë subjektivist po e dëmtojnë shumë mozaikun e të shprehurit të tërësishëm të gjuhës shqipe.

## b) Rreth sinonimisë së asnjësitve prejmbiemërorë jociësorë

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, nën b), asnjësit jociësorë që shprehin një gjendje a të qenë, dalin me sinonimi mjaft heterogjene, prandaj edhe veçoritë dalluese të tyre janë edhe më të dukshme dhe më të ndërlikuar seç dilnin tek asnjësit prejmbiemërorë cilësorë. Siç mund të shihet, në 16 rastet nga pasqyra e nëngrupit të mësipërm dalin së paku njëmbëdhjetë (11) forma sinonimesh barasvlerës me prapashtesa a fundorë të ndryshëm. P.sh.

- 1) më -im: ligështim (të ligtë);
- 2) më –irë: lagështirë (të lagët), mugëtirë (të mugët), ndyrësirë (të ndytë);
- 3) më –je: n/gjallje (të gjallët), m/pakje (të pakët);
- 4) më –si: nxehtësi (të nxehtë), pështirësi (të pështirët), vështirësi (të vështirët);
- 5) më –i: tepri (prejndajfoljor i të tepërtit), zjarrmi (të nxehtë),
- 6) më –ni: rini (të ritë);
- 7) –shmëri: ndotshmëri (të ndotët), ngjashmëri (të ngjarët);
- 8) më -shti: madhështi (të madhtë);
- 9) më –ri: gjallëri (të gjallët), majmëri (të majmët);
- 10) me zero-mbaresë: rëndë-a, (të rëndët);

11) dy raste janë sqaruar me barasvlerës sinonimikë njëfjalësh mbi tjetër temë *neveri* (të pështirët) dhe *zjarrmi* (të nxehtë) dhe dy raste me togfjalësha: *humbje e vetëdije* (të fikët) dhe *ngjashmëri rasti* (të ngjarët).

Gjithashtu vërejmë se për dallim nga shembujt nga pika a) që trajtat e asnjësit zërtheheshin kryesisht me togun: *të qenët* ose *me qenë + mbiemri përkatës cilësor, shembujt e këtij grupimi (pika b) zakonisht zërthehen me ndihmësen tjetër të foljes kam: me pasë a të kesh + ndajfolja ose emri përkatës. P.sh. të lagët* tregon si me pasë *lagështi(rë), të ligtë* - me pasë *ligshti(m), të gjallët* – me pasë *gjallëri a n/gjallje* ose të qenët *gjallë a me qenë gjallë (jo me qenë i gjallë)* etj. Po ashtu edhe barasvlerësit në kllapa zërthehen por më foljen **me pasë**: *me pasë ose të kesh* + asnjësin përkatës në trajtën e pashquar. P.sh.: *lagështirë*, do të thotë *me pasë të lagësht, majmëri – me pasë të majmë, zjarrmi – me pasë të nxehtë (ngritje temperature)*, e kështu me radhë.

## 2. Sqarime të tjera rreth kuptimisë së prejmbiemërorëve

Me sa u tha, secili asnjësit shpreh një koncept abstrakt të përgjithësuar *cilësie, gjendjeje a të qeni*, që assesi nuk parakupton, sot për sot, se semantika e tillë domosdo ka të bëjë, qoftë me vetë zhvillimin e procesit, qoftë me rezultatin e atij procesi, prandaj duhen dalluar kuptimet a nuancat kuptimore të asnjësitve ndaj barasvlerësve të tjerë, ngase sinonimet përkatëse të caktuara dalin të specifikuar për nënfushën me elemente

gjithnjë e më konkrete të nocionit, qoftë të procesit të veprimit, qoftë të rezultatit konkret të atij veprimi dhe kështu nuk e rrezikojnë fare konceptin e asnjësisë përkatës. Në të vërtetë, asnjësi prejmbiemëror ndalet në perceptimin e vetë konceptit, si me thënë, e mban ravijëzimin e atij nocioni në nivelin më të lartë të abstraksionit, skajin e sipërm të synit të antenës a të litarit kabllor shprehjesor, por pa e shkëputur plotësisht konceptin për tërë shtrirjen e tij. Së këtejmi del se, sot për sot, me gjykie drejt mund të thuhet me gojën plot se emrat sinonimikë të prejardhur të paparyjëzuar e të tjerë nuk e rrezikojnë fare nënfushën që mbulon asnjësi përkatës i pararyjëzuar, i cili me u shprehë me fjalë të tjera specifikimin e vet e ka të karakterizuar tek shkalla më e lartë e abstraksionit morfosemantik të fjalës.

Sidoqoftë, për ta bërë edhe më të qartë të vërtetën se koncepti i asnjësisë të pararyjëzuar prejmbiemërorë cilësorë dhe ai i atyre jociësorë (sifoljorë) ka natyrë tjetër nga asnjësisë e parmë dhe emrat e tjerë të prejardhur me prapashitesat përkatëse e të tjerë, po japim skemën me nga një shembull karakteristik, nga të dyja grupimet e prejmbiemërorëve, me të ashtuqajturit barasvlerës sinonimikë, për të identifikuar kështu edhe më mirë nënfushën semantike të nocionit të asnjësisë përkatës, sipas këtyre rubrikave:

- 1) emri i nyjshëm si temë motivuese fjalëformuese,
- 2) asnjësi prejmbiemëror (emër abstrakt),
- 3) emri femëror i pararyjëzuar (abstrakt),
- 4) emri i përgjithshëm mashkullor i njeriut i pararyjëzuar (konkret).

#### Skema ndërsinonimike e prejmbiemërorëve

1	2	3	4	5
1) i mirë-i	të mirët	e mira/të mirat	mirësia/mirësitë	i miri /të mirët
2) i madh -i	të madhtë	e madhja	madhëria/madhëritë	i madhi/ të mëdhenjtë

### 3. Shembuj ilustrues fjalisor në përputhje me skemën e mësipërme

Po i ilustrojmë shembuj nga skema me fjalitë e mundshme të konstruktura, sipas dy grupimeve të asnjësisë prejmbiemëror:

#### a) Nga grupimi i prejmbiemërorëve me kuptimësi cilësie:

**/Të mirët shprehet me punë e me zemër. E mira nuk harrohet. Mirësia të fisnikëron. I miri dallohet me punë.**

1) **Të mirët** (tipari i së mirës, i mirësisë shpirtërore): *emër asnjësisë, vetëm, njëjës, me kuptimësi të një abstraksioni të lartë.*

2) **E mira** (puna e mirë, emër abstrakt, i pararyjëzuar, njëjës, gjinia femërore)  
**Të mirat** (punët e mira): *emër abstrakt shumëgjinisë gjinia femërore). Të dyja trajtat njëjës e shumë shprehin kuptimësi që lidhet në njëfarë mënyre me punën e mirë të konkretizuar a paksa edhe me rezultatin asaj pune, të atij veprimi.*

3) **Mirësia** (sjellja e mirë), emër abstrakt, emër i prejardhur, njëjës gjinia femërore. **Mirësitë** (sjelljet a veprat e mira), emër abstrakt, shumës, gjinia femërore, *Të dy trajtat njëjës e shumës shprehin kuptimësi të konkretizuar nga rezultati i sjelljes a i veprimit përkatës.*

4) **I miri** (njeriu i mirë): emër frymor njeriu (mbiemër i emëruar), njëjës, gjinia mashkullore. **Të mirët** (njerëzit e mirë): emër abstrakt njeriu, shumës, gjinia mashkullore. *Edhe I miri dhe Të mirët lidhet kuptimisht me një konkretizim edhe më të dukshëm, d.m.th. me njeriun a njerëzit konkretë, të pajisur me cilësinë përkatëse.*

#### **b) Nga grupimi i prejmbiemërorëve me kuptimësi jocilësore (gjendje a të qeni)**

**/Të madhtë qëndron në virtytet e larta të njeriut. E madhja qëndron në vlerat e larta morale. Madhëria e njeriut shihet nga veprat e kryera. I madhi ka përgjegjësi më të madhe se i vogli. Të mëdhenjtë kanë përgjegjësi më të mëdha se të vegjlit./**

1) **Të madhtë** (asnjanës, abstrakt, vetëm njëjës) *kuptimi qëndron në dukurinë që ka të bëjë me virtytet e larta të njeriut.*

2) **E madhja** (femëror i paranyjësuar, abstrakt, kryesisht vetëm njëjës), *kuptimi qëndron në vepra të larta të ravijëzuara morale.*

3) **Madhëria** (femëror, abstrakt, i prejardhur me prapashtesim, njëjës kryesisht), *kuptimi qëndron në veprat pozitive pothuajse të kryera.*

4) **I madhi /Të mëdhenjtë** (emër i përgjithshëm njeriu, njëjës e shumës), *kuptimi qëndron në përgjegjësinë e njeriut sipas pozitës që zë në shoqëri.*

\* \* \*

Nga shembujt e dy pikave të mësipërm, a) dhe b), mund të nxjerrim disa konstatime, ndër të cilat ne po i veçojmë këto dy, ngase vlejné për të gjithë shembujt e tipit të njëjtë:

Së pari, ndërlidhja semantike asnjanës/femërorja e paranyjësuar kanë afërsi kuptimore më të madhe se me sinonimet e tjera, por megjithatë ndryshojné, jo vetëm për nga gjinia, a forma, por edhe për nga përmbajtja.

Së dyti, ndërlidhja formale e josesantike e asnjanësit me shumësin e emrit mashkullor të paranyjësuar si te shembulli *të mirët* ndaj *të mirët (i miri)*, andaj një homonimi e tillë nuk duhet të na hutojë.

Në të vërtetë, edhe pse konstatimet e mësipërme dalin të qëndrueshme, megjithatë ne e shohim të arsyeshme që në këtë kontekst të vazhdohet edhe më me sforcimin ose me modifikimin e mëtejshëm të disa koncepteve të shprehura më përpara lidhur me disa probleme që janë të ndërlidhura me këtë çështje.

#### **4. Vazhdim i sqarimeve në raportin asnjanësi prejmbiemërorë / barasvlerësit sinonimikë**

Gjatë këtij vazhdimi të sqarimeve do të ndalemi në tri pika:

së pari përsërisim me qëllim sforcimin e faktit se të gjitha sinonimet e lartpërmendura bashkëjetojnë në ligjërimin tonë standard, andaj duhen dalluar më mirë specifika e nënfushave përkatëse semantike që mbulojnë,

së dyti, japim arsyetimin pse shembujt janë dhënë prej nesh vetëm në gjininë mashkullore dhe jo edhe në atë femërore dhe

së treti, jepen edhe shembujt ku disa prirje ende janë në fazën e formëzimit..

### 1) Specifikimi i nënfushave semantike kusht i bashkëjetesës sinonimike

Semantikisht asnjësi të mirët ose të madhtë, siç u pa, kanë njëfarë afrie formale sa i përket paranyjëzimit, por kanë edhe afri kuptimore me femërorët sinonimikë: *e mira të mirat*, ose *e madhe e madhja*, përkatësisht me trajtat: *mirësi-a*, *mirësi-të ose madhëri-a (madhorja a madhështorja) madhëritë (madhështitë)*, por femërorja si në njëjës si në shumës, siç u tha, tregon një gjendje si të themi të kryer, ndërsa asnjësi në krahasim me nocionet e tilla, ndalet vetëm te koncepti i pakonkretizuar me një shtrirje të lehtë gjithëpërfshirëse për tërë nocionin, d.m.th. ndalet në temën e perceptuar, prej nga mund të nënkuptohet e vërteta se asnjësi fillimisht do të ketë pasur shtrirje më të gjerë kuptimësie se që e ka sot. Prandaj identifikimi kuptimor në mes të këtyre dy trajtave që përmendet nga prof. Sh. Demiraj e të tjerë, gjoja se:

*“format e gjinisë asnjëse të mbiemrave të nyjshëm që ishin më të përshtatshëm për të shprehur nocione abstrakte më vonë kur gjinia asnjëse u dobësua në ndërgjegjen popullore, atëherë emrat asnjëse të paranyjëzuar u zëvendësuan pak nga pak ose me format e gjegjëse të gjinisë femërore ose me emra të prejardhur prapashësorë”*, (Shih: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988, f. 157.)

qëndron i saktë vetëm pjesërisht, d.m.th., vlen vetëm rreth të shprehurit të nocioneve në fushën abstrakte, por jo tërësisht edhe rreth zëvendësimit, ngase asnjësit prejmbiemërorë, siç u provua dhe u sprovua prej nesh, siç e tregon realiteti i sotëm, u zëvendësuan vetëm për një pjesë të nocionit të fushës së abstraksionit që (ndoshta) e mbulonin, por jo tani, pasi aty momentalisht kanë hise edhe emra të tjerë që e kanë fituar nënfushën përkatëse në luftën e konkurrencës, por megjithatë asnjësit nuk u zëvendësuan krejtësisht dhe assesi nuk u zhdukën, por u pozicionuan, duke akumuluar forcat, në një nënfushë tjetër po të asaj fushe të gjerë, duke kaluar, siç po ceket disa herë, në specifikim për të shprehur shkallën më të lartë konceptore të abstraksionit apo të dukurisë përkatëse.

### 2) Gjinia mashkullore si trajtë përfaqësuese e emërtimit të njerëzve sipas gjendjes a veprimtarisë së tyre

Asnjësin e njëjësit të emërores, në njërën anë me trajtën e gjinisë mashkullore në shumës, në anën tjetër: *të mirët // të mirët*, i lidh vetëm forma e njëjtë shkrimore, por nuk i lidh kurrfarë nënfushe semantike, sepse me shumësin e mashkullores tregohet diçka

konkretizuese, që ka të bëjë me njerëz të pajisur me cilësinë e mirësisë e jo me konceptin gjegjës si veçori e abstraksionit të lartë të nocionit që e shpreh asnjësi.

Dihet edhe ky fakt se emrat e përgjithshëm të njerëzve me prejardhje mbiemërore (shembulli 4) në gjuhën tonë dalin zakonisht në gjininë mashkullore, e cila konsiderohet si trajtë përfaqësuese, prandaj edhe ne i shënuam shembujt vetëm në këtë gjini. Kjo është arsyeja e parë. Ekziston edhe një arsye tjetër se po të shënohej edhe trajta përkatëse në gjininë femërore, jo vetëm do të bëhej një punë pa nevojë, por do të ndërlikohej çështja. Themi *do të ndërlikohej*, sepse format e emërtimit të njerëzve sipas gjendjes a veprimtarisë së tyre, të emrave mbi bazë mbiemërore të gjinisë femërore dalin formalisht identikë si homofoma me prejmbiemërorët abstraktë të gjinisë femërore. Krahaso emrin abstrakt të gjinisë gramatikore *e mira (vepër) të mirat (vepra)*, në njërën anë, me emërtimin e mbiemrave cilësorë si emërtime të gjinisë femërore natyrore: *e mira të mirat (e mira vajzë të mirat vajza)*, në anën tjetër.

Pra, kjo është arsyeja pse tek emrat e njerëzve (frymorëve) si trajtë përfaqësuese merret normalisht gjinia mashkullore dhe që kontekstualisht vetëkuptohet se femërorëzimi bëhet shumë lehtë me mjetet femërorizuese dhe me një veprim të tillë i iket ndërlikimit të panevojshëm formal të çështjes që ndërlidhet me trajta homoforme të emërtimeve në fjalë, të cilat, siç e pamë, janë identike si në njëjës ashtu edhe në shumës, në drejtshkrim e në drejtshqiptim. Dallimin e bën vetëm konteksti.

### 3) Rreth zhvillimit të strukturës sinonimike të prejmbiemërorëve

Shpjegimet që u dhanë për shembujt *të mirët* dhe *të madhtë* në parim vlejné pothuajse për të gjithë shembujt mbiemërorë cilësorë e jocilësorë, por jo të gjithë shembujt mbi bazë mbiemërore aktualisht kanë zhvillim të njëjtë për nga struktura, siç del nga burimi përkatës. Po japim edhe disa shembuj sipas këtyre rubrikave:

1. mbiemri i mirëfilltë,
2. asnjësi
3. emri femëror abstrakt i paranyjzuar dhe
4. emri me prapashtesim:

1	2	3	4
i bukur	<i>të bukurit</i>	e bukura	<i>bukur/i-a,</i>
i mirë	<i>të mirët</i>	e mira	<i>mirë/si-a,</i>
i gjallë	<i>të gjallët</i>	-	<i>gjallë/ri-a a gjall/ni-a,</i>
<i>i bardhë</i>	<i>të bardhët</i>	<i>e bardha</i>	<i>bardhe/ni-a,</i>
i dëlirë	dëlirët	-	dëlirë/ti-a
i dëlirshëm	<i>të dëlirshmit</i>	-	dëlirshmë/ri-a
i rritshëm	<i>të rritshmit</i>	-	<i>rritshmë/ri-a;</i>
i marrë	<i>të marrët</i>	<i>e marra</i>	<i>marrë/zi-a.</i>

Edhe nga këta shembuj, mund të nxjerrim, veç tjerash edhe këto përfundime:



1. Emrat femërorë abstraktë me paranyjëzim (ndonëse nuk mohohet mundësia), hë për hë, nuk dalin të zhvilluar në të gjitha rastet, madje ndodh që ende përdoren vetëm në numrin njëjës.

2. Emrat abstraktë të prejardhur mbi bazë të kuptimësisë mbiemërore (cilësorë e jocilësorë), përveç me –si, formohen edhe me prapashtesat: -i, -ri/-ni, -ti, -shmëri, -zi, siç shihet nga shembujt e mësipërm.

Dhe ç'është e vërteta, edhe këta shembuj asnjësisht zërthehen normalisht me ndihmën e paskajores *me qenë* ose të asnjësisht të *qenët + mbiemri përkatës*.

Pra, me *të bukurit* kuptohet **me qenë** ose **të qenët i bukur**, ndërsa me *bukuri*, kuptohet **me pasë cilësi** a **tipare të të bukurit** (me pasë bukuri) Sigurisht diçka më konkrete shprehet kur thuhet **me pasë bukuri** se **me pasë të bukur, sepse të bukurit** (si emër asnjësisht) **qëndron më në thellësi të shpirtit si koncept i abstraksionit të lartë se vetë fjala bukuri bukuria, e cila, si me thënë, edhe shihet edhe preket**, me fjalë të tjera, konkretizohet.

Ky zëbrthim vlen për të gjithë shembujt.

**Sqarim:** Shfrytëzojmë rastin të rrëfëhemi paksa pse gjatë zëbrthimit po e përdorim

paskajoren **me qenë** ose **me pasë** krahas trajtës së asnjësisht të *qenët* ose trajtave të *jesh* ose të *kesh* + *trajtën përkatëse* të emrit ose të mbiemrit. Veç arsyeve të tjera që janë përmendur në tjetër vend këtu po theksojmë se për një veprim të tillë kemi parasysh faktin se edhe prof. Androkli Kostallari e pati futur në përdorim trajtën e paskajores **me pasë** në kontekst të ngjashëm. Ai duke u ballafaquar me kuptimësinë e mbiemrave të përbërë të tipit *hundëshkabë* shpjegon se këto kompozita **”zërthehen me anë të foljes me pasë, përkatësisht **me pasë ose që e ka hundën si të shkabës**”** (Shih: *Studime mbi leksikon...I*, Tiranë 1972, f. 146).

Sidoqoftë, edhe nga këta shembuj kuptohet se asnjësisht e nyjshëm prejmbiemërorë të përfutur më herët se emrat e sipërshënuar sinonimikë me prapashtesat përkatëse me –i fundore variantesh të ndryshme e të tjerë, arritën të mbesin në përdorim normal për veçori të caktuara të abstraksionit, për të mbuluar kështu nuanca cilësie, gjendjeje a të qeni, që dallojnë dukshëm semantikisht nga sinonimet përkatëse që, siç u tha, lindën më vonë, edhe pse edhe këto përfutime dalin si emra abstraktë, po janë specifikuar për nënrafshe të tjera kuptimësie.

Nga sa u tha më lartë, duhet me u mbajtë mend se edhe sot e kësaj dite, si më herët edhe tashti e në vijim, po të shikohet hollë e hollë, nga format e reja, nuk rrezikohet fare qëndrueshmëria e përdorimit të asnjësisht prejmbiemërorë, sepse asnjësisht e tillë dalin të specifikuar vetëm për konceptin e cilësisë, të gjendjes a të të qenit të caktuar që nuk mbulohet plotësisht me asnjë sinonim tjetër, prandaj konstatimin e prof. Sh. Demirajt në versionin tjetër, po të ngjashëm, siç u cek më sipër, se

*“në një fazë të caktuar (pas emrave prejpjesorë me ë) procesi i mbiemrave të nyjshëm erdhi e u bë një nga mjetet kryesore për pasurimin e klasës së emrave me njësi të reja leksikore Në krye të herës për këtë qëllim emërzoheshin kryesisht format e gjinisë asnjësisht të mbiemrave të nyjshëm që ishin më të përshtatshëm për të shprehur nocione abstrakte Po më vonë kur gjinia asnjësisht u dobësua në ndërgjegjen popullore, atëherë emrat asnjësisht të*

*paranyjëzuar erdhën e u zëvendësuan pak nga pak ose me format gjegjëse të gjinisë femërore ose me emra të prejardhur prapashtesorë”, (Vepra e cituar f. 157.)*

ne e quajmë të drejtë, gjithashtu, vetëm pjesërisht, sepse pjesën rreth zëvendësimit e marrim me rezervë, ngase asnjësit prejmbiemërorë, siç u provua më sipër, nuk u zëvendësuan, por u specifikuan po në kuadër të fushës përkatëse të abstraksionit, duke e ndarë atë fushë *trizash* sinonimisht, qoftë me emrat e nyjshëm femërorë, tipi e *mirë e mira, të mira të mirat*, qoftë me emrat e prejardhur, tipi *mirësi mirësitë*, me të cilët bashkëjetojnë në harmoni relative, ashtu ngjashëm sikurse bashkëjetojnë me sinonimet përkatëse edhe asnjësit e paranyjëzuar mbi bazë pjesoreje, siç do të shohim në vijim.

## C. ASNJANËZIMI MBI BAZË PJESOREJE

### 1) Grupimi i asnjësitve prejpjesorë sipas profilit të nënfushës semantike

Edhe *asnjanësit prejpjesorë të paranyjëzuar* me të cilët shprehet një koncept veprimi, mbi bazë të tipit të trajtës së pjesores, sipas profilit të nënfushës semantike që mbulojnë, i ndajmë në katër grupe:

a) mbi temë me –ë fundore: *të bërë-t (bërje), të gdhirë-t (agim), të dalë-t (dalje), të dhënë-t (dhënie), të hyrë-t (hyrje), të larët I (larje), të larët II (pagesë), të marrët (marrje), të ngrënë-t (ngrënie), të ngjarët (ngjarje), të pangrënë-t (pangrënie), të parë-t I (shikim, pamje), të parët II (pasi, parëti), të pëgërë-t (pëgërje!), të prerë-t (prerje!), të pështjellë-t (pështjellje), të qenë-t (qenie), të qarë-t (qarje), të sharë-t (sharje), të vjelë-t (vjelje), të vjellë-t (vjellje) – gjithsej 21 shembuj.*

b) mbi bazë të një bashkëtingëlloreje në temë, me –ur fundor: *të ecur-i (ecje), të errurit (errësim), të folurit (e folur-a, gjuha), të ftohuri-t (ftohje), të lehurit (lehje), të ngrysurit ((ngrysjë, errësim), të ngjeshur-it (ngjeshje), të nuhatur-it (nuhatje), të njohur-it (njohje), të prekur-it (prekje), të qeshurit (qeshje), të sosur-it (sosje, sosë-a!), të shprehur-it (shprehje), të tekur-it (tekë-a, veprim i rastit) – gjithsej 14 raste;*

c) vetëm një rast mbi bazë të fundores –ier/ët: *të përzier-ët;*

ç) mbi bazë të fundores –uar, të pjesores së foljeve më –Oj dhe –UAJ: *të dëgjuar-it (dëgjim, dëgjesë), të menduar-it (mendim), të paguarit (pagim, pagesë), të qëlluarit (e qëlluar-a, qëlluarje, veprim rasti), të rruar-it (rrojë), të shkruar-it (shkrim, shkresë, shkruarje) – gjithsej 7 raste, 4 nga foljet më –oj dhe 3 nga foljet më -uaj.*

Gjithsej, në këto katër grupe mbi temë pjesoreje, janë përfshirë 43 shembuj. Bien në sy disa çështje të diskutueshme, ndër të cilat këtë rast po i veçojmë tri:

Së pari, përmendim rastin e vetëm nga pika c) me mbaresën –ë/t, shembulli: **të përzierët**, trajtë kjo që ndeshet edhe në Fjalorin rusisht –shqip (Moskë 1954). Mbetet të shihet, dhe këtë e kanë në dorë standardologët tanë se a do të përthithë kjo mënyrë ndërtimi edhe shembuj të tjerë nga foljet me –ier, yer dhe uar, apo jo?

Së dyti, pikërisht për tipin më prodhimtar dhe aktiv të foljeve më –o/j, janë dhënë vetëm katër shembuj *dëgjoj (të dëgjuar-it), mendoj (të menduar-it), mësoj (të mësuar-it)*

dhe qëlloj (të qëlluar-it), numër ky i pothuaj i barazuar mbase rastësisht, por pa të drejtë, me foljet më –uaj: *paguaj (të paguarit), rruaj (të rruarit) dhe shkruaj (të shkruarit)* që është tip joprodhimtar.

Së treti, po përmendim edhe shembullin e vetëm të *pangrënët*, me parashtesën PA- që emri ose mbiemri e këtë rast asnjësi shpreh mungesë ose mendim të kundërt. Përveç asnjësit të papunët, të cilën e diskutuam më përpara në FGJSH 2006 ndeshim mbi 70 shembuj të emrave të paranyjzuar me këtë parashtesë, ndërsa në Fjalorin e M. Elezit, përveç rastit të *papunët*, ndeshim edhe këta asnjësi: *të paatillë-t, të pacaktuem-it, të pafjetur-it, të pakrruar-it, të pamujtun-it, të pamaturit, të pazjarmë-t(!), të patrazuesh/ëm-it*, të cilët nuk na zgjojnë vetëm këshërinë, por na japin për të kuptuar se edhe në këtë mënyrë asnjësit kanë derë të hapur të pakufizuar shumimi.

Sidoqoftë, nga pasqyra e asnjësve prejpjesorë të sipërcekur, siç po shihet, edhe nëse i shikojmë shembujt si trajta përfaqësuese, përsëri përfaqësimi i tyre nuk del i denjë për të gjitha grupet e prejfoljorëve. Është e vërtetë e pamohueshme se në jetën tonë ligjërimore numri i tyre është shumë më i madh. Për foljet më –Oj, si me thënë, numri i tyre (i prejpjesorëve) del i pakufizuar, ngase nga çdo folje (pjesore) mund të formohet pothuaj normalisht asnjësi përkatës, prandaj pikërisht për këtë tip asnjësisht dhe përhapjen e tyre në kohë-hapësirë, do të ndalemi paksa më gjatë në krerët vijues të këtij punimi, por edhe këtu në këtë krye, tashti fill, s'do të anashkalohej kjo temë pa u shprehur ndonjë konstatim, ngase këtë po na imponon vetë natyra e lëndës që po trajtohet.

## **2) Disa nga karakteristikat e veçanta të asnjësve prejpjesorë**

Domosdo, siç mund të shihet nga grupimi i mësipërm i shembujve lypsen cekur, së paku, disa nga karakteristikat themelore të këtij tipi asnjësisht:

1. Në grupin e shembujve mbi bazë të foljeve më –ë fundore, siç mund të shihet, janë përfshirë disa raste a nëngrupe foljesh: vokalike, të parregullta, apofonike e të tjera, të cilat sa i përket tipizimit të modelit trajtëformues e fjalëformues nuk përkojnë njëri me tjetrin, madje në këtë kontekst dalin edhe mjaft raste problemore edhe në raportin *letrarishite / dialekt*, të cilat ndikojnë edhe në formimin e asnjësve mbi këtë bazë, çështje këto që kërkojnë sqarim si në aspektin normativ, ashtu edhe në atë dialektor, prandaj shembujt e paraqitur në pasqyrën e mësipërme, nuk mund të themi me plotgojë se mund të cilësohen si trajta përfaqësuese të dënja për emërtimin përkatës të asnjësve të krejt atij grupi a nëngrupi përkatës.

2. Vlen të theksohet gjithashtu se përveç rastit *pagesë për të larët* (e borxhit) dhe *pamje për të parët I* (shikimi) dhe *të parët II* (pasi-a) të gjithë shembujt e tjerë sinonimikë në kllapa, ndaj asnjësve përkatës, janë emra të veprimit me prapashtesën –JE: *bërje, dalje, dhënie, hyrje, marrje, ngrënie, ngjarje, pëgjërje, përzierje, prerje, pështjellje, qenie, qarje, sharje, vjelje, vjellje* si edhe *përzierje*.

3. Edhe në grupin e asnjësve mbi bazë të foljeve me bashkëtingëllore, përkatësisht me fundoren –ur (geg. –un) në pjesore, nuk dalin probleme të theksuara lidhur me përfitim e asnjësve, nëse çështja shikohet nga këndi i formimit të modelit fjalëformues, por edhe këtu, veç raportit ndër-dialektor del edhe raporti emër i nyjshëm

ndaj emrit të prejardhur më –je, ngase dalin ndryshime pikërisht rreth temës përkatëse emërformuese (temë e pjesores së zgjeruar / temë e pjesores së shkurtër), e cila (kjo e fundit) shërben si temë prodhuese. Krahaso: (me) qeshë - të qeshët ndaj me qeshun/qeshur – të qeshurit), (me) folë – të folët ndaj (me) folun/folur - të folurit etj., megjithatë shembujt e shënuar mund të konsiderohen të mjaftueshëm si trajta përfaqësuese të modelit për formimin e asnjansve mbi bazën e pjesores së letrarishtes, ndërsa ato me **-je** mbi bazë të pjesores së shkurtër (mbi bazë të ish-shqipës letrare mbi bazë të gegërishtes).

4. Ia vlen të theksohen rastet e veçanta sinonimike të shënuara në kllapa si: *e folur-a* (emër nyjshëm femëror) për *të folurit* dhe dy emrat prejpjesorë pandajshitesorë: *sosë-a* për *të sosurit* dhe *tekë-a* për *të tekurit*.

5. Edhe për grupin e foljeve më -Oj dhe -UAj mund të jepen vërejtje specifike. Kështu, ndërsa për foljet më –uaj tri trajtat e shënuara *të paguarit* (*paguaj*), *të rruarit* (*rruaj*) dhe *të shkruarit* (*shkruaj*), si trajta përfaqësuese mjaftojnë për nëntipin a nëngrupin e foljeve të tilla, për foljet më –Oj, tipi më prodhimtar i foljeve të gjuhës shqipe, që sipas rregullit prejpjesori i prejardhur i veprimi merr prapashtesën –IM ose -ESË, katër trajtat e shënuara në atë burim (*të dëgjuarit*, *të menduarit*, *të mësuarit* dhe *të qëlluarit*) nuk mjaftojnë as për së afërmi të merren si trajta përfaqësuese për modelin përkatës emërformues mbi këtë bazë, nëse nuk jepen e sqarime e interpretime plotësuese të nevojshme edhe më bindëse, sidomos për këto dy çështje:

E para, nëse mendohet se këto trajta asnjansish mbi bazë të foljeve më –Oj: *mësoj* *të mësuarit*, *dëgjoj* *të dëgjuarit*, *mendoj* *të menduarit* dhe *qëlloj* *të qëlluarit*, janë aktive në shqipen letrare e të tjerat jo, gabimi është i pafalshëm, ngase bie ndesh me realitetin, sepse mbi këtë bazë, siç u tha më sipër, prodhimtaria del e pakufizuar.

E dyta, nëse mendohet a dikujt i shkon ndërmend se koncepti i asnjansve si b.f. *të shkruarit* del i zëvendësuar plotësisht me prejpjesoren sinonimikë më –**im** (shkr-im shkrim) a –**esë** (*shkr-esë shkresë*) ose *të shkëlqyerit* me *shkëlqim* a *shkëlqesë* ose me –**je** *shkruar-je shkëlqyerje* e ndonjë trajtë tjetër, gabohet edhe më rëndë, ngase bie ndesh po ashtu me realitetin, sepse nocioni i asnjansit mbi këtë bazë del me nënfushë të veçantë dalluese të përcaktuar semantikisht që ndryshon nga nënfusha që mbulojnë prejpjesorët e prejardhur veprues me prapashtesën –**IM** ose –**JE**, e ndonjë tjetër, siç do të argumentohet në kërret vijues të këtij punimi.

6. Rasti të *përzierët* (*përzierje*) a do të përthithë apo jo, edhe shembujt të tjerë nga foljet me –ier ose -yer si zier të zierët, lyer të lyerët , kryer të kryerët, etj, mbetet çështje e hapur.

7. Po e theksojmë në fund si pikë të veçantë faktin, ndonëse duket si përsëritje se lidhur me foljet më –oj ashtu edhe -uaj, ia vlen të vihet në pah e vërteta se emrat sinonimikë, po mbi temë të njëjtë fjalëformuese, të shënuar në kllapa, veç atyre më –**IM** dalin edhe me prapashtesa a mënyra të tjera, si: për *të rruarit* del *rrojë-a*, për *të qëlluarit*, dalin dy trajta: *e qëlluar-a* dhe *qëlluarje* (jo *qëllim*); për *të dëgjuarit* del *dëgjesë*, për *të paguarit*: *pagesë*, ndërsa për *të shkruarit* veç trajtës *shkrim*, dalin edhe: *shkresë*, *shkruarje*, veçori kjo që do të trajtohet më gjerësisht në kërret vijues..

### III. FAKTOGRAFI RRETH SHTRIRJES SË PËRDORIMIT TË ASNJANËSVE PREJPJESORË NË GJUHËN SHQIPE

#### 1. Rreth qëndrimit jo të qartë teorik e praktik ndaj asnjansëve në shqipen e sotme letrare

E thamë haptazi dhe paksa tërthorazi më sipër se shembujt e asnjansëve të përfshirë në FShS (2002), nëse nuk kuptohen si shembuj të vetëm e jo si shembuj përfaqësues, sidomos e kemi fjalën për tipin e asnjansëve me prejardhje prejppjesore, atëherë lënda e tillë del shumë e mangët dhe e varfër në raport me realitetin. Së këndejmi, kjo mosnjohje e realitetit, madje mund të krijojë apo mbase edhe do të ketë krijuar keqkuptime në përmasa jo të vogla tek një numër i konsiderueshëm të konsultuesve të Fjalorit në fjalë. Kështu po themi, ngase një *manifestim* i tillë, në njëfarë mënyre, del i shfaqur subjektivisht te mjaft kuadro, të vjetër e të rinj: gazetarë e përkthyes, arsimtarë, kritikë e krijues letrarë e të tjerë, deri edhe tek disa hartues fjalorësh dygjuhësh (shqip-gjuhë e huaj dhe anasjelltas). Me fjalë të tjera del i shfaqur një keqkuptim i tillë i realitetit edhe te disa kuadro që nuk mund të konsiderohen joprofesionistë nga vendi i punës ose për punët e detyrat që i kryejnë ose për pozitat që zënë në shoqëri dhe konkretisht këtë qëndrim e ndeshim të zbatuar mjaft dallueshëm pas viteve '70 të shekullit të kaluar në disa burime tona normative (andej e këndej), sepse në ato burime leksikografike dhe përgjithësisht asnjansët nuk dalin të favorizuar sa do të duhej, kur kemi parasysh realitetin ligjërimit, nga i cili, gjithsesi ofrohen në vazhdimësi edhe mjaft shembuj të rinj e atraktivë, të cilët në kuadër të strukturës shprehëse dalin pothuajse të pazëvendësueshëm. Nderkaq, ndonëse si të tillë, nuk figurojnë në burimet përkatëse normative (!). Si fakt më konkret që jeta ofron shembuj të rinj po përmendim rastin se vetëm në revistën *Seminari...25/1* Prishtinë 2007 manipulohet me mbi 40 raste asnjansësh. Aty i ndeshim edhe këta shembuj që nuk dalin të shënuar në Fjalorin e shqipes së sotme (2002): *të nxënit, të emëruarit, të lexuarit, të jetuarit, të kënduarit* e ndonjë tjetër.

Pra nuk është i drejtë mendimi se mungesa e numrit të konsiderueshëm të asnjansëve në fjalorët përkatës lidhet me mungesën e tyre në realitetin tonë gjuhësor. Madje ka individë që këtë mungesë të asnjansëve në fjalorët përkatës e shprehen me ekstremisht tjetër, gjoja se kjo dukuri, është fjala për mungesën e përfaqësimit, mund të arsyetohet (hamendshëm) se gjoja ashtu është vepruar, sepse shembuj të tillë kanë shtrirje aq të gjerë, sa që kjo rëndomtësi s'ka nevojë të theksohet a të shënohet veçan në burime të caktuara, ngase do ta rëndonte pa nevojë fjalorin përkatës(?!).

Sido që ta marrësh, për mendimin tonë, veprimet e tilla rreth anashkalimit të asnjansëve të paranyjzuar në burimet përkatëse nuk dimë si mund të arsyetohen, qoftë nga autoritetet tona të larta gjuhësore, qoftë nga hartuesit e fjalorëve normativë përkatës, sidomos e kemi fjalën për ata autorë shqipfolës hartues fjalorësh (pas viteve të '70-a), të cilët edhe e kishin domosdo të ravijëzuar trashëgimisht tipin e asnjansëve të tillë në sistemin e tyre ligjërimit.

Për një dukuri të tillë pasivizimi të asnjësve, sipas gjase kanë ndikuar mendimet e disa studiuesve tanë, mendimet e të cilëve u çekën pak a shumë në fillim të këtij punimi, por aq më tepër ndoshta do të ketë ndikuar edhe mendimi i prof. A. Kostallarit i shprehur që në vitin 1967 në punimin e tij monografik: "Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, ku në kreun e tretë A te *Struktura e fjalorit*, pika 15, kryerreshti i dytë theksonte:

- a) *Emrat participorë asnjës e femërorë që kanë kuptimin e procesit të veprimit ose të rezultatit të veprimit nuk do të jepen për çdo folje, por në mënyrë të kufizuar. Zakonisht ato me të njëjtin kuptim, p.sh. të vjellët, të bëra e të pabëra etj.;*
- b) *kur i kundërvihen emrit parashtesor nga pikëpamja e kuptimit ose e ndonjë nuance kuptimore (krh, thënje dhe e thëna,, dhënje dhe të dhënat etj.);kur i kundërvihen emrit parashtesor nga pikëpamja e përdorimit (krh. p.sh. "shtënja në përdorim" dhe vras dy zogj me një të shtëne" etj);*
- ç) *kur janë diferencuar e veçuar në gjuhën letrare nga tipat prapashtesorë dhe kanë fituar kuptim e përdorim terminologjik (krh. në filozofi mendimi e të menduarit, procesi i të menduarit etj.). (Shih: Studime mbi leksikun...II, Tiranë 1972, f. 49.)*

Siç po shihet nga teksti i mësipërm, vetëm pika a) pjesërisht dhe pika ç) tërësisht, kanë të bëjnë me asnjësit e paranyjzuar, ndërsa dy pikat e tjera te pika a) pjesërisht vlejné për femërorët e paranyjzuar abstraktë, tipi *e mira të mirat*.

Lidhur me mendim-propozimin e tillë, paksa konfuz, të prof. A. Kostallarit pati reaguar me kohë prof. A. Xhuvani, i cili ndër të tjera pati theksuar:

*...Krahas me këto (formimet me –im e –je n.v.) duhet të regjistrohen në fjalor edhe gjithë emrat mashkullorë ose femërorë p.sh. e ftohta dhe të ftohtit, e zbehta dhe të zbehtit, e bukura dhe të bukurit, e dalmja e dalura dhe të dalët, e folmja dhe të folurit a të folët, e pamja dhe të pamët a të parët, e lidhura dhe të lidhurat, e ardhmja dhe të ardhurit a të ardhunit, e vena dhe të venët, të pyeturit dhe pyetja, të përgjigjurit dhe përgjigja, e ngrëna dhe të ngrënë etj. Këta emra janë të gjuhës së folur popullore dhe janë përdorur prej rilindësve... Pse ka marrë hov të madh në praktikën e sotme të gjuhës përdorimi i emrave sufiksorë me –im e –je, nuk do të thotë se emrat e substantivuar prej mbiemrash e foljesh të përdorur edhe këta në gjuhën e folur e të shkruar, të mos zënë vend në "Fjalor të gjuhës shqipe" ose të zënë vend të kufizuar, sikurse kuptohet nga ajo monografi". (Shih Studime mbi leksikun ...II, Tiranë 1972, f. 124.)*

Siç po shihet nga dy insertet (pasuset) e sipërcituara nuk ndahen mirë kuptimisht asnjësit nga emrat e substantivuar femërorë e mashkullorë, madje prof. A. Xhuvani nuk i përmend fare shembujt përkatës si asnjës, por i quan vetëm si *emra abstraktë të gjinisë mashkullore*, ndërsa prof. A. Kostallari, pothuajse i njëjtëson (i përziën) funksionalisht te shembujt përkatës: *substantivat prejpjesorë të nyjzuar asnjës me femërorët e paranyjzuar abstraktë*. Mjerisht një përzierje të tillë e ndeshim edhe në ndonjë shkrim të studiuesve të rij që rrahin çështje ti tilla.

Sidoqoftë, mendim-rekomandimi i prof. A. Kostallarit, i kuptuar sipërfaqësisht, mbase edhe i keqkuptuar si rekomandim uniform, për njerëz të uniformëzuar të kohës, do

të ketë ndikuar që përgjithësisht edhe në burimet leksikografike të botuara më vonë, numri i asnjansëve, të jetë sadokudo, i reduktuar ose pa shembuj të rij. E thamë *të keqkuptuar*, sepse nuk duam të besojmë se ai (profesori i nderuar A. Kostallari) i kishte zhvlerësuar tërësisht në atë kohë konstatimet rreth asnjansëve, siç u cekën në fillim të këtij punimi, ngase vepra “*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*”, qe botuar nën bashkautorësinë dhe përkujdesjen e tij, përkatësisht nën drejtimin dhe redaktimin e tij. Madje, prof. A. Kostallari, në një vend tjetër, pikërisht lidhur me zëvendësimin e asnjansëve me emrat e prejardhur me –im dhe –je tërhiqte vërejtjen si vijon:

*“Po kjo prirje tipologjike në strukturën fjalëformuese nuk duhet ngatërruar me përdorimin e emrave asnjans të paranyjëzuar e sidomos të atyre prejfoljorë në shqipen e sotme ngase përdorimi i tyre në raste ... është edhe sot në normë, ndërsa zëvendësimi i tyre me emra prejpjesorë (prapashtesorë) me -im ose -je që vihet re nganjëherë është i papranueshëm nga norma”.* (Shih: *Studime mbi leksikon...III*, Tiranë 1981.)

Pra, vërejtja e prof. A. Kostallarit rreth nënfushave përkatëse semantike të asnjansëve ka vlerë edhe sot, prandaj e thamë se mendimi i mëparshëm i tij për mospërfshirjen e një numri më të madh të asnjansëve në fjalorët përshkrues normativë, mbase për arsye thjeshtëzimi a ku ta dimë, do të jetë keqkuptuar.

Para se të kalojmë në analiza të tjera do të përmendim në vijim disa nga burimet leksikografike të më të hershme e më të vonshme, në krahasim me botimet zyrtare të pas viteve të '70-a, ku paraqitja e asnjansëve përkatës del, si me thënë, jo e plotë ose e diskutueshme për nga numri i përfshirjes. Si burime më të hershme do të përmendim disa tekste burimore si faktografi që nga Rilindja e këndeje si dhe disa nga botimet e më vonshme, për të fituar kështu idenë se si ishte gjendja e asnjansëve në periudha të caktuara, kur asnjansët, sidomos të paranyjëzuarit, si me thënë, herë frymonin lirshëm e herë jo aq. Është fjala për etapën e diskutueshme prej nesh, pa harruar edhe burimet e viteve të fundit, pas vitit 2002, kur mbase si reaksion ndaj qëndrimit inert në fazën e diskutueshme prej nesh, ndodhi, si të thuash, edhe ndonjë dukuri paksa shpërthyese rreth përfshirjen enorme të asnjansëve, jo gjithëherë funksionalë e në përshtatje me zhvillimin e sotëm.

## **2. Rreth përfshirjes së asnjansëve në disa burime të caktuara leksikografike të gjuhës sonë**

Në vazhdim, pra, duke shëtitur kronologjikisht nëpër titujt e disa burimeve leksikografike, fare shkurtazi, do të përmendim kalimthi praninë e asnjansëve, duke cekur edhe ndonjë veçori tjetër karakteristike gjuhësore të burimit përkatës.

1) Në **Fjalorin e K. Kristoforidhit** ku janë të regjistruara mbi 100 asnjans për nga numri mbizotëron tipi i prejpjesorëve si dhe i prejmbiemërorëve ndaj asnjansëve primitivë burimorë, çka na jep për të kuptuar se rrudhja e përdorimit të asnjansëve të mirëfilltë primitivë kishte filluar më herë se kjo periudhë që i takon fundit të shekullit XIX. Natyrisht në këtë burim ndeshin edhe trajta të shënuara në gegërishte dhe në toskërishte. Ndahet me vizël trajta e shquar me **-të** si p.sh. të ngjyemi-të / të ngjyerë-itë

etj., mbase nën ndikimin e ortografisë së emrave të tillë nga shkrimtarët tanë të vjetër (Budi, Bardhi, Bogdani).

2) Edhe në **Fjalorin e “Bashkimit”**, janë përshirë mjaft asnjans që me marrë numerikisht janë disa dhjeta më shumë nga fjalori e sapopërmendur i K. Kristoforidhit. Në këtë burim mbizotërojnë po ashtu shembujt e tipit të prejppjesorëve, të cilët shënohen në të dyja trajtat, por më shumë në trajtën e pashquar. Që të gjithë shembujt janë shënuar në dialektin e gegërishtes (shkodranishtes), madje edhe nyja e përparme (në emëroren e shquar shënohet pa –ë-në fundore. Krahaso: *t’ajmit, t’çamit, t’cnuem, t’cofun, t’llaptuem, t’kuptisun, t’qekunit, t’qejnuemit, t’qitunit, t’qethunit, t’murmruem, t’skajuem, t’pruum, t’shaam, t’shpejtuem, t’shpeshuem, t’teshun, t’trakulluem* etj. Asnjansit prejmbiemërorë, me sa pamë, nuk shënohen veçan nga mbiemrat a prejmbiemërorët e tjerë.

3) Edhe në **Fjalorthin e N. Gazullit**, ku paraqitet lëndë nga viset e Gegnisë ndeshim disa asnjans si në Fjalorin e Bashkimit, por tash ndiqet ortografia e Komisionit Letrar të Shkodrës, e cila u mbështet edhe në Kongresin e Lushnjës (1920). Nyja e përparme shënohet e plotë përgjithësisht. P.sh. të kaluem-t, të dhanun-t të shtimë-it, të ranë-t etj. Nuk gabohet nëse thuhet se Fjalorii i N. Gazullit karakterizohet me përdorimin e asnjansve si dhe të paskajores së mirëfilltë me + pjesore.

4) Pas Fjalorit të N. Gazullit po e radhisim **Fjalorin e Tahir Dizdarit** (*Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë 2004), i cili, ndonëse i përfunduar nga fundi i viteve ’60-a të shekullit të kaluar, kur njësimi i letrarishtes mbi bazë të toskërishtes konsiderohej i kryer, gjuha e autorit dhe e krejt veprës del si vazhduese e gjuhës letrare mbi bazë të gegërishtes, sipas ndikimit të vendimeve të Komisionit Letrar të Shkodrës (1917) dhe Kongresit të Lushnjës (1920).

Si veçori karakteristikë të gjuhës së kësaj vepre mund të veçojmë këto tri fakte:

së pari, shembujt ilustrues autori i ka marrë nga të gjitha trevat shqipfolëse, duke përfshirë edhe veprën letrare të Gj. Fishtes,

së dyti, autori e ka përdorur fare natyrshëm paskajoren e mirëfilltë me + pjesore si barasvlerës të infinitivave jo vetëm të gjuhëve të familjes indoevropiane (persishtes, sllavishtes etj), por edhe të gjuhës turke (si gjuhë aglutinante uraloaltaje) dhe të gjuhës arabe (si gjuhë semite), por edhe në gjuhën e vet autoriale.

së treti, ndonëse paskajoren e mirëfilltë e ka përdorur edhe për mbulimin e disa koncepteve abstrakte, të cilat mbulohej edhe me asnjansit prejfoljorë, ai megjithatë në veprën e tij ka manipuluar me mbi 100 asnjans, të cilët zakonisht dalin brenda togfjalëshave përkatës, si p.sh.:

*të dhanunit e fjalës, të marrunit nëpër gojë, të shkuemit për sajdi, të përmbytunit e botës, të shikuemit me kureshtje etj, ose vepri (veprimi n.v.) e të dalunit (të zbuluesit, të shtyemit, të gjetunit etj. ose dukunia a mënyra e të punuemit, zanati i të qepunit, friga e të rrëzuemit, lezeti i të ngranmës, ose një të ecun me kali etj.*



Siç po shihet shembujt janë të shënuar në gegërishte, mirëpo në atë vepër ndeshim edhe ndonjë shembull të tillë të shënuar në toskërishte si p.sh: *të pshuarit (të shfryerit), të hequrit, të bitisurit* e ndonjë tjetër.

Pra, siç po vërehet, nga gjuha e T. Dizdarit (1900 -1972), i cili ishte punonjës i Institutit të gjuhësisë të Tiranës kuptojmë se në atë Institut vazhdonte të përdorej gegërishtja edhe pas LDB-së deri në vitet '50 - '60 jo vetëm nga prof. A. Xhuvani, por edhe nga punonjës të tjerë, siç ishte edhe T. Dizdari.

5) Pra kjo trashëgimi e ish shqipes letrare mbi bazë të gegnishtes që vazhdoi si të themi zyrtarisht deri në vitet e '40-a të shekullit të kaluar, përkatësisht pas LDB-së, po që ndërroi kahe që në vitet e para pas LDB-së, duke dalë i favorizuar shkallë-shkallë dialekti i toskërishtes, siç shihet edhe nga gjuha sqaruese **Fjalorit serbokroatisht -shqip** (grup autorësh, Tiranë 1948), ku shihet qartë animi drejt toskërishtes edhe në trajtat shkrimore të asnjansëve. Pra si veçori e këtij Fjalori (1948) është se tashti, mbizotëron letrarishtja mbi bazë të toskërishtes. Po përmendim faktin se aty ndonëse mbizotërojnë trajtat e toskërishtes, nuk mungojnë edhe trajta të gegërishtes, por vetëm për disa shembuj të tillë shënohet sigla (*g*), d.m.th. trajta dialektore geqe. Edhe në këtë burim mbizotërojnë barsvlerësit asnjans të shqipes në trajtën e shquar dhe numri i tyre është relativisht i madh në krahasim me gjendjen në Fjalorin e shqipes së sotme (2002).

6) Pothuajse e kundërta ndodh, sa i përket gjuhës dialektore ose variantit letrar, në Fjalorin e Henrik Bariçit me titull **Fjalor i gjuhës serbishte ose kroatishte dhe i shqipes (a-o)** (Zagreb 1950), sepse në këtë burim mbizotëron pothuaj tërësisht varianti i gegërishtes, edhe pse aty-këtu ndeshim ndonjë trajtë-fjalë me rotacizim, si p.sh. *djalëri, arshikri*, ndonjë folje me paskajoren e mirëfilltë me + pjesore, por të toskëzuar me -r-në karakteristike, si: me u kurvëruë (kurvënuë) me dashurue (me dashtë, me dashunue), si dhe asnjansësi të *paralajmëruar-it* (të paralajmëruem-it). Autori njeh emrat e veprimit me -im dhe me -je, por këta për nga numri janë shumë më të paktë në krahasim me asnjansësit e paranyjëzuar përkatës sinonimikë, të shënuar mbi temë të njëjtë fjalëformuese. Asnjansësit a shembujt e tillë janë me qindra. Sa për ilustrim po i shënojmë nja tre-katër shembuj:

**dubljenje** – të dhenun-it, të gërmuem-it, të gërryem-it, të lugosun-it, të biruem-it (birim-i), të ndejunit në krye;

**grčenje** – të gërmuqun-it, të cenguem-it, (cengim-i), të garravaçuem-it, të galucuem-it, të drynuem-it;

**ljutnja** – hidhënim-i, zemërim-i, acari--ja, egërsim-i, të ashpëruem-it, bufitje-a, të dufitun-it, inat-i;

**diranje** – prekje-a, prekë-a, ngucë-a, gërgim-i, të gërgam-it, ngallmim-i, gëzatë-a, gëzmim-i, cytë-a, të cytun-it, dukuni-je-a, të dukunisun-it.

Siç po shihet nga shembujt e sipërm autori e ndan shquarsinë e emrave të numrit njëjës të tri gjinive, ndërsa njëjës-mbaresën e shumësit nuk e shënon fare.

Sidoqoftë, te ky burim ndeshim forma të ndryshme emërformuese, veç tjerash edhe mjaft raste të emrave prejpjesorë pandajshësorë, si: *prekë-a, ngucë-a, gëzatë-a, cytë-a* pastaj: *dhanë-a, falë-a, bindë-a, ethë-a, përmbysë-a, pasë-a* etj.

7) Në **Fjalorin serbokroatisht-shqip** të Sokol Dobroshit, (Prishtinë 1953), i cili ka luajtur rol shumë pozitiv në ruajtjen sadokudo të gjuhës shqipe edhe në administratën e përkthyer të kohës dhe në vazhdimësi të ne, si barasvlerës të emrave asnjans foljorë të serbokroatishtes të tipit me *-a/nje* ose *-e/nje* dalin të shënuar në shqipe afro 2000 shembuj asnjansish, kryesisht mbi bazë pjesoreje. Kuptohet se, pothuajse, që të gjithë janë shënuar sipas variantit të gegërishtes, duke e respektuar ortografinë e kohës mbi këtë bazë. Pothuaj që të gjithë shembujt janë shënuar në trajtën e pashquar, mënyrë kjo që, siç do të shohim, nuk do të praktikohet në fjalorët e tjerë, me ndonjë përjashtim.

7) Në **Fjalorin rusisht-shqip**, Moskë 1954 (rib. Prishtinë 1966), nën redaktimin e A. Kostallarit (rib. Prishtinë 1966) ndeshim me qindra asnjans prejpsorë e prejmbiemërorë. Trajtat janë shënuar tërësisht mbi bazë të variantit të toskërishtes letrare. Si trajtë përfaqësuese mbizotëron njëjësi i shquar. Bie në sy fakti se ka më shumë raste që shënohet vetëm asnjansi i paranyjëzuar, d.m.th. i pashoqëruar me prapashtesorët sinonimikë të tipit me *-im* ose *-je*. Në këtë burim bie në sy gjithashtu se prapashtesorët shënohen vetëm për kuptimin e dytë d.m.th. vetëm kur del, si me thënë, i formëzuar koncepti i emëzimit të rezultatit të veprimit, por përgjithësisht përherë asnjansit zënë vendin e parë ndaj prejpsorëve të prejardhur. Ka edhe veçori të tjera me interes në raportin gjuha ruse (sllave) ndaj gjuhës shqipe, njëra prej tyre si më e rëndësishme, për mendimin tonë, del fakti që po e veçojmë: asnjansi i shqipes nuk del kurdoherë si barasvlerës i asnjansit të rusishtes, madje nuk janë të rrallë shembujt, kur asnjansi i shqipes del si barasvlerës edhe për emra, qoftë të gjinisë femërore, qoftë të asaj mashkullore të rusishtes. Po e ilustruam këtë të vërtetë me këta dy shembuj:

**odvod** m. – të shpuarit, të hequrit, të larguarit; të mospranuarit, të refuzuarit;  
**zatjzhka** f. - të zgjaturit, zgjatje; të hequrit, të thithurit.

Nga shembujt e tillë konstatojmë edhe diçka tjetër me shumë interes se shumimi asnjansit të shqipe (siç ishte në Fjalorin e S. Dobroshit) nuk është pasojë e ndikimit të serbokroatishtes, por ishte dukuri e zhvillimit të brendshëm të gjuhës sonë, ngase asnjansit tanë do të kenë lindur a do të kenë pasur përdorim shekuj para se shqipja të ketë kontaktuar me gjuhët sllave e neolatine.

Këtu është vendi, për mendimin tonë të përmendim konstatimin me vend të prof. Idriz Ajetit se *“huazimet e gjuhës shqipe me gurrë sllave e riogreke duan veçuar nga huazimet lashtogreke e latine, sepse asnjansit sllavë e riogrekë nuk u pasqyruan në neutra”* në gjuhën shqipe. (Vepra e cit .f. 94.) Po ky fakt u vërtetua, pra, edhe me shembujt tanë ilustrues.

9) Në **Fjalorin terminologjik serbokroatisht-shqip** (grup autorësh), Prishtinë (1961), të gjithë asnjansit dalin të shënuar në trajtën e shquar, kuptohet edhe këta në variantin e gegërishtes letrare, p.sh., prejmbiemërorët: *të nxehtit, të randët, të ftohët, të fikët, të pakët* etj.; prejpsorët: *të ndëgjuemit, të shijuemit, të mësuemit; të pamit, të ndymit, të bamit, të qenunit, të ulunit, të prekunit, të rrahunit* etj.

10) Natyrisht botimi i **Fjalorit të gjuhës shqipe** (1954) edhe lidhur me asnjansit paraqet interes tejet të rëndësishëm. Në këtë burim, me sa pamë, ndeshim të shënuar afro

60 shembuj asnjansish, prej të cilëve nja 10 janë asnjans të paparanyjzuar (të mirëfilltë), mbi 20 prejmbiemërorë dhe afro 30 janë prejpjesorë. Disa prej tyre janë shënuar në variantin e gegnishtes letrare si: *të hasunit, të pakunit, të pamët (!)*, pasi paraqitnin koncepte të veçanta, të paplotësuara me trajtat e toskërishtes. Ndonëse dalin mjaft mbiemra të shënuar në gegërisht si: *i kenuni, të kenun-it, i shnjëruemi, të shnjëruemit, i shëmtueti, të shëmtuetit*, asnjëri prej tyre nuk del i cilësuar edhe si asnjans. Me këqyrë hollë e hollë, prejmbiemërorët dhe prejpjesorët dalin të regjistruar në zëra pothuajse të përafërt, ose edhe të barabartë dhe në numër relativisht të vogël, mirëpo sa i përket realitetit duhet theksuar, në mënyrë të veçantë, se në atë Fjalor manipulohet me mbi 1000 shembuj asnjansish kryesisht prejfoljorë, të cilët janë përdorur si fjalë sqaruese brenda tekstit përkatës që jepet lidhur me përkufizimet e fjalëve a të koncepteve përkatëse. Të mbahet mend se të gjithë asnjansit prejpjesorë, me të cilët manipulohej në sqarimin e fjalëve në fjalorin përshekruar FGJSSH (1980) dhe FSHS 1984, 2002, nuk futen më në veprim, sepse sqarimi tani bëhet me trajta foljore, veta e parë njëjës e mënyrës dëftore e jo me asnjans.

Në përgjithësi shihet njëfarë konsolidimi i trajtave të asnjansëve edhe drejtshkrimisht edhe përmbajtësisht, prandaj ky material është shfrytëzuar, përkatësisht del i shënuar (kopjuar), me ndonjë përjashtim, edhe në fjalorët e tjerë të mëvonshëm. Tashti po i përmendim nja tri raste përjashtimi që nuk dalin të shënuara në FShS (2002): *të përqethët, të prirët, të përthyerit* (ky i fundit cilësohet si term në fizikë). Sa i përket trajtës përfaqësuese vazhdon një larushi, por megjithatë, mund të thuhet se mbizotëron trajta e shquar si trajtë përfaqësuese.

11) Në **Fjalorin serbokroatish - shqip**, grup autorësh, botim i IA të Prishtinës, (1974, rib, 1986) respektohet drejtshkrimi i pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972), përkatësisht ndiqet, pra, drejtshkrimi i njëzuar i vitit 1973. Në këtë burim mbizotëron trajta e shquar ndaj së pashquarës, por kjo ndërdyshje *trajtë e shquar / trajtë e pashquar* dallon nga autori në autor. Sa i përket numrit të asnjansëve mund të thuhet se është shënuar numër i konsiderueshëm i tyre. Në këtë burim përgjithësisht asnjansi nuk del i injoruar në krahasim me trajtat përkatëse sinonimike të emrave të veprimit me prapashtesat –im ose –je. Një injorim i tillë vërehet në fazat e pak mëvonshme, kur në përgjithësi shprehej njëfarë rezerve lidhur me të shënuarit e trajtave të asnjansëve. Këtë që e thamë po e ilustruam me një fakt që lidhet me *Shtojcën* që i është bërë këtij Fjalori me rastin e ribotimit, 12 vjet më vonë. Në këtë *Shtojcë* mbizotërojnë emrat e veprimit me prapashtesim, por dalin të shënuar vetëm nja 20 shembuj asnjansish të paranyjzuar, nga të cilët si më karakteristikë po i përmendim shembujt, d.m.th. të shënuar në trajtën e shquar, në njërën anë, si: *të niveluarit, të nivelizuarit, të ngurtësuarit, të programuarit, të shmalkkuarit* e ndonjë tjetër, por edhe vetëm në trajtën e pashquar, në anën tjetër, si *të rrafshuar, të respektuar*, në anën tjetër. Një larushi të tillë e ndeshim veç *Shtojcës* edhe në brendinë e Fjalorit në fjalë dhe për tipa prejfoljorësh të tjerë. Në këtë burim që nuk është rast i vetëm, bie fjala, për barasvlerësin e serbokroatishes *rastenje* dalin të shënuara të dyja trajtat veç e veç: *të rritur* dhe *të rriturit* (f. 705) e jo si një fjalë e vetme me nyjëmbaresën e ndarë me vizël nga trajta e pashquar: *të rritur-it*.

Nuk e shohim të arsyeshme të përmendim edhe raste të tjera të diskutueshme, edhe pse nuk janë të pakta, po tash po përmendim një çështje tjetër që zgjon interes Bie në sy, gjithashtu, se asnjansi i nyjshëm i shqipes, siç e pamë edhe në Fjalorin rusisht –shqip,

përdoret nganjëherë edhe si barasvlerës togfjalësh edhe për ndonjë emër të gjinisë femërore të serbokroatishtes me *-ost* fundor, si p.sh.:

progresivnost – të qenët progresiv, akromatiçnost – të qenët akromatik, rastvorenost – të qenët të shkrirë, desnorukost – të qenët djathtak, raspoloživost – të qenët në qejf etj.

Pra asnjësi i shqipes (në togfjalësh); përdoret edhe për shembuj të gjinisë femërore me *-ost* fundor të asaj gjuhe. Po shtojmë edhe këtë se zakonisht koncepti i emrave më *--ost* të serbokroatishtes (të gjuhëve sllave) në shqipe ka si barasvlerës emrat me *-shmëri* të shqipes, p.sh.,

rastvorenost – shkrishmëri, kurse në huazime ka barasvlerësi me emrat me *-itet* fundor progresivnost – pogresivitet, e kështu me radhë.

Sigurisht mund të përmenden edhe çështje të tjera që dallojnë, siç u tha, edhe nga hartuesit, autori në autor, por si veçori, po përsërisim edhe njëherë, se në këtë burim është përfshirë numër i konsiderueshëm i asnjësve, gjë që ndryshon paksa kjo praktikë në versionin tjetër të fjalorit shqip-serbokroatisht të hartuar pothuajse nga autorët e njëjtë.

12) Në ***Fjalorin shqip-serbokroatisht*** të Mikel Ndrecës (Prishtinë, 1976), duke pasur parasysh fondin jo të madh të fjalëve ndeshim numër jo të vogël asnjësisht, afro 50 sish. Gjithsesi barasvlerësit serbokroatisht e ndërsjellazi dalin të qëndrueshëm. Megjithatë zgjon interes fakti se aty b.f. shënohen dy trajtat të asnjësit të shqipes mbi temën e njëjtë: *të qeshët* (pjesore e shkurtër) dhe *të qeshurit* (pjesore e zgjeruar) që aty jepen në serbokroatishte me barasvlerës të njëjtë: *smešanje* dhe *osmeh*. Në këtë burim bien në sy edhe trajta geqe *të pakunit*, d.m.th. veç trajtës letrare *të pakëtit*, pastaj edhe trajtat drejtshkrimisht të diskutueshme: *të pamë-it*, *të thermë-it* (në vend: *të pamë-t*, *të thermë-t*), po marrë në përgjithësi asnjësit janë paraqitur konsiderueshëm.

13) Veç këtyre, për ne siç u cek pak më parë, edhe më shumë interes, zgjon lënda e asnjësve e përfshirë në ***Fjalorin shqip-serbokroatisht***, Prishtinë (1981). Ky fjalor mjaft voluminoz për kohën, te ne ka shërbyer shumë pozitivisht për mirëmbajtjen dhe kultivimin e letrarishtes së shqipes në administratën e ringjallur dygjuhësore e më gjerë. Duke e konsideruar këtë Fjalor si burim normativ, edhe lëndën sa u përket asnjësve e konsultuam më vëmendshëm.

Edhe në hartimin e Fjalorit në fjalë sa u përket asnjësve vërehet lehtë qëndrimi jo i qartë ose kryesisht jofavorizues i shumicës së hartuesve, që përputhet me atmosferën jo favorizuese rreth asnjësve që mbretëronte në botimet e Tiranës në atë kohë. Supozojmë se ndoshta pas mendim-rekomandimit të përmjegullt ose të keqkuptuar nga të shprehurit e prof. A. Kostallarit dhe të tjerëve, siç e pamë në *Konstatimet hyrëse* të këtij punimi, tek autorët tanë ishte e pranishme njëfarë rezerve ndaj asnjësve të shqipes. Sidoqoftë, ndoshta edhe ky ishte shkaku që hartuesit tanë, nuk e kishin lehtë, pra, të vendosnin, ngase ishin të ballafaquar me dy skajet, në njërën anë me realitetin, ku asnjësit paraqiteshin shumë të gjallë në jetën tonë gjuhësore dhe në anën tjetër, duke pasur në dijeni konstatimin jofavorizues që u bëhej, si me thënë, subjektivisht gjithandej emrave të tillë në burime të caktuara.

Sidoqoftë, ndërsa prof. **Mehdi Bardhi**, hartues i materialit për shkronjat: A, B, C, Ç, D, DH, E, Ë, F është mjaft dorëlibër, ngase shënon numër të konsiderueshëm asnjansish, afro 70 sish, pothuajse të gjithë mbi bazë foljore (prejjesorë) të cilëve u shënon dhe e barasvlerësin sinonim me prejardhje të shqipes veçan, të tjerët si **Abdullah Zajmi**, hartues i materialit për shkronjat L, LL, M, N, NJ, P, Q, T, U, V është paksa më i kursyer me asnjansit. Vërtet, shënon disa asnjans në zëra të veçantë, por ka mjaft raste që ata i fut në kllapa pas prejjesorit përkatës të veprimit me –JE ose –IM, si: *pallje (të pallurit)*, *pohim (të pohuarit)* etj., duke u dhënë kështu përparësi formave të prejjesorëve sinonimikë me prapashtesat përkatëse, d.m.th. emrave të veprimit ndaj asnjansve të nyjshëm përkatës. Edhe **Sulejman Drini** për shkronjat G,GJ, H, I, J, K, shënon disa asnjans, por edhe ky është mjaft i kursyer e dorështrënguar, sidomos tek prejjesorët asnjans. Prof. **Latif Mulaku**, hartues i materialit për shkronjat O, R, RR nuk e rrudh fort dorën në paraqitjen e asnjansve edhe atyre prejjesorë, por edhe ky asnjansit i vë zakonisht nën hije të emrave sinonimikë të prejardhur, ngase si trajtë sinonimike parësore e vlerëson emrin e veprimit me prapashtesën përkatëse me –im ose me –je e në kllapa vendos sinonimin asnjans të nyjshëm. Kështu me një veprim të tillë, si me thënë, jep për të kuptuar se e përqafton subjektivisht pasivizimin e asnjansve përkatës, pasivizim ky që del edhe më haptazi nga prof. **Gani Luboteni**, hartues i lëndës për shkronjat SH, TH, ashtu si edhe nga **Sitki Imami**, i cili trajton materialin për shkronjat S, X, XH, Y, Z, ZH dhe veç ndonjë rasti si *të zbehurit, të zitë ose zdrypje (të zbriturit)* nuk shënon asnjë shembull tjetër asnjansi të nyjshëm prejjesor të paranyjzuar.

14) Edhe hartuesit e fjalorëve të tjerë dygjuhësh të hartuar pas viteve të '70-a kanë ndjekur kriterin e Fjalorit të shqipes së sotme, d.m.th. numri i asnjansve del i kufizuar, ngase u janë dhënë përparësi emrave sinonimikë të veprimit me prapashtesat përkatëse. Është interesant se edhe në aktivitete të ndryshme rreth gjurmimeve gjuhësore shkencore asnjansit nuk i vërejnë fort, madje nuk i shënojnë mjaftueshëm as disa nga mbledhësit e folklorit ose vjelësit e fjalëve të reja, edhe pse në bazë, siç dihet, siç e dëshmon edhe prof. A. Zymberi, ndeshin mjaft shembuj të tillë, që nuk figurojnë në fjalorët tanë përshkrues normativë. Po e përmendim si shembull *Fjalorin e fjalëve të reja* të Ali R. Berishës, Klinë 2006, ku nuk shënohet asnjë fjalë e re nga asnjëri tip i asnjansit.

Meqenëse, siç dihet, gjuha jonë është plot e përplot me shembuj të tillë dhe që përdoren fare natyrshëm nga të gjitha shtresat e shoqërisë sonë dhe nuk dalin të shënuar në FShS, atëherë mendojmë se hartuesve të fjalorëve ose mbledhësve të fjalëve të reja dhe sidomos studiuesve të profileve përkatëse, duhet t'u tërhiqet vërejtje që të kenë parasysh edhe tipat e asnjansve dhe t'i shënojnë dhe t'i përdorin sa herë që këtë e kërkon konteksti.

15) Për ekzistimin e asnjansve në gjuhën shqipe në përgjithësi, nuk dëshmojnë vetëm fjalorët dialektorë ose lënda përkatëse e vjelë së voni e folklorit tonë, por kjo dëshmohet katërçipërisht edhe nga *Fjalori i gjuhës shqipe* i Mehmet Elezit (Tiranë 2006), ku dalin të regjistruar në zëra të veçantë mbi 1000 (njëmijë) asnjans, ndërsa në sqarime numri i tyre del edhe më i madh. Sidoqoftë, shumica prej tyre janë gjallues në sistemin tonë ligjërimor, por ka edhe raste që autori i ka vjelë në burimet përkatëse nga e kaluara, të cilët nuk kanë sot për sot përhapje të gjerë, madje mbase edhe të ardhme përdorimi në atë trajtë

Po e theksojmë edhe një veçori tjetër të këtij burimi. Shumica e shembujve, ndonëse të vjelë nga trevat e gegërishtes ose nga dokumentacionet të shkruara në variantin e këtij dialekti, aty dalin të shënuar në trajtën përfaqësuese të shqipes së sotme letrare (toskërisht), por ka edhe përjashtime, çka e bëjnë çështjen mjaft të diskutueshme. Gjithsesi, kur kemi të bëjmë me trajta shkrimore asnjësisht të shënuar sipas drejtshkrimit të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, ose të vjelë, qoftë nga burime shkrimore letrare të reja, qoftë nga goja e popullit ose nga burimet folklorike e të tjera, çështja, siç u tha, del e diskutueshme. Këtij problemi ne do t'i silllemi në kreun e parafundit të këtij punimi, por këtu s'mund të lëmë pa e dhënë një mendim tonin për punën e autorit.

Mehmet Elezi me vjeljen e fjalë-trajtave të tilla ka bërë një punë shumë të mirë, të madhe - për admirim, ngase ka dëshmuar atë që e kanë konstatuar edhe të tjerët, ashtu edhe ne, kur ka të bëjë me shtrirjes së emrave të tillë në të gjitha stilet dhe në të gjitha trevat e gjuhës sonë, por edhe për faktin se ka sjellë në dritë mjaft shembujsh asnjësisht të paranyjzuar me të cilët pasurohet gjuha jonë letrare, edhe pse ndonjë trajtë mund të jetë e diskutueshme. Ja disa shembuj të përfshirë në veprën e M. Elezi që zgjojnë interes:

1. të ardhur-it, të arritur-it, të baritur-it, të britur-it etj. etj.
2. të binduar-it, të avulluar-it, të bjeshkuar-it, të brishuar-it, të cikluar-it, të cakluar-it, të cubuar-it, të gemuar-it etj. etj.
3. të pëlqyer-it, të pëlkyer-it
4. të kllinj-të, të ledh-të, të mbram-të, të klluq-të,
5. të ligsht-it, të largët-it, të kthjellët-it, të nalt-it të lëmykët-it, të qethët-it
6. të gjallë-t, të bardhë-t, të gjatë-t, të kuqimë-t, të larë-t, të lënë-t, të llanë-t, të mamë-t, të mbarë-t, të mbjellë-t, të mirë-t, të ngranë-t, të nxehtë-t, të panë-t (edhe të tëpanë-t), të prunë-t, të rënë-t, të verbë-t, të zgjerdhanë-t etj.

Në të vërtetë, edhe nga kjo përzgjedhje ka raste që kërkojnë sqarim plotësues, ngase nuk përputhen drejtshkrimisht me normën e sotme në fuqi dhe perspektivën e saj, por me një përpunim të lehtë ato mund të harmonizohen e në raste të veçanta edhe mund të tolerohet lojalisht konkurrenca e tyre.

16) Po nga qendra e Tiranës, jo fort moti, doli një fjalor i ri shpjegues normativ me titull **Fjalor i gjuhës shqipe** (2006) i hartuar nga një grup autorësh nën redaktimin e prof. Jani Thomait. Shumica e hartuesve si dhe materiali i shfrytëzuar vijnë nga FGjSSH (1980, përkatësisht i FShS 1984, 2002), materiali i të cilëve është shfrytëzuar, por nuk do të thotë se nuk ka risime e material të ri të përfshirë në këtë burim. Pikërisht lidhur me lëndën që po e trajtojmë ne, ofrohet material me shumë interes, i cili tregon se hartuesit tani kanë qëndrimi më të liberalizuar se përpara ndaj asnjësve. Përveç shembujve që ishin përfshirë në FShS (2002) me sa pamë, janë shtuar edhe shembuj të tjerë, por jo tek të gjitha grupimet ka shumësi të ndjeshme numri. Sidoqoftë, materialin e tillë, siç thuhet, po e marrim nëpër duar dhe po e vëmë në pah më poshtë në tri pika, duke e sistemuar sipas tre tipave të asnjësve:

1. Kështu grupimit të parë, d.m.th, tipit të asnjësve primitivë të paparanyjzuar i është shtuar shembulli **qallë-t**, sinonim për *syzet*. Nuk mund ta dimë sa do të ketë shtrirje dhe sa do të jetë funksional ky emër kur ka për ballë një fjalë të njohur dhe të përgjithësuar, pra, sinonimin **syzet a syzat**. Sidoqoftë edhe ky rast i vetmuar na zgjon

vëmendjen, ngase edhe tek tipi i parë i paparanyjësuar është shtuar një shembull sinonimik që bën pjesë tani në fjalorin e shqipes standarde me *prestigj detyrimi(!)*.

2. Grupimit të dytë, d.m.th. asnjansëve mbi bazë prejmbiemërore, me sa pamë, i janë shtuar dy shembuj: **të shkuntë-t** dhe **të njomë-t**, shembuj këta që ngjallin interes, sepse sipas nevojës rritja e tyre del me mundësi të hapur, ndonëse këtu shumimi i tyre është simbolik, vetëm me **dy shembuj**.

3. Grupimit të tretë, asnjansëve prejpjesorë u është shtuar një numër relativisht i madh shembujsh. Kështu:

a) **mbi temë të pjesores** me –RË ose -NË fundore dalin **5 raste**:

*të palarët, të mpirët, të shkrirët; të shpënët, të shtënët;*

b) **mbi temë të pjesores më –ur**, të foljeve me bashkëtingëllore që në emërore shumë marrin një-mbaresën -t dalin të regjistruar këta shembuj:

*të bërturit, të diturit, të ikurit, të kalburit, të pasurit, të kënaqurit, të kërrusurit, të kosurit, të kurdisurit, të mahisurit, të magjepsurit, të majmurit, të maturit, të mëkëmburit, të meshuarit, të ngjeshurit, të përkurit, të përkulurit, të përsëriturit, të qepurit, të qethurit, të qokurit, të qukurit, të qullurit, të qullulosurit, të rastisurit, të rendurit, të ndenjurit, të shkrepurit, të shprehurit, të shtrydhurit, të shmangurit, të sosurit, të shpikurit, të shoshiturit, të shtrydhurit, të shthururit, të zbathurit, të zbehurit, të zbrazurit, zdrypurit, të zbuturit, të zhyturit, të zhagiturit – gjithsej **43 shembuj**;*

c) **mbi temë të foljeve me –Oj** (-uar/ue): janë shtuar këta shembuj, që zgjojnë interes:

*të çaluarit, të çuarit I të çuarit II, të dëgjuarit, të kopjuarit, të korigjuarit, të krahasuarit, të qerthulluarit, të qetuarit, të qetësuarit, të qëruarit, të qorruarit, të qulluarit, të penduarit, të shijuarit, të shikuarit, të shkuarit, të shoqëruarit, të shpëtuarit, të shpjeguarit, të shpuarit, të shtruarit, të shtrënguarit, të shndërruarit, të tradhtuarit, të vepruarit, të zbatuarit - gjithsej **28 raste**;*

ç) **mbi temë të foljeve me -UAj** (-uar/uajt), janë shtuar këta **3 shembuj**:

*të kruarit, të shquarit; të quajturit;*

d) **mbi temë të foljeve me -IEj** (-yer/ye) janë shtuar nja **6 shembuj** :

*të shkëlqyerit, të shqyerit, të ushqyerit, të zbardhëllyerit, të zhgënjyerit, të zhgërryerit.*

Pra në krahasim me numrin e pranishëm të asnjansëve në FShS (2002) këtu janë shtuar mbi **80 shembuj**. Kështu në letrarishiten e sotme, kur kemi parasysh numrin shembujve të regjistruar dhe ata të futur në përdorim në FShS (2002) që numri i tërësishëm i afrohej 100 -shit si dhe këta të shtuarit mbi 80, atëherë numri i tërësishëm i “legalizuar” për përdorim të asnjansëve në shqipen e sotme letrare, sipas fjalorëve shpjegues normativë, arrin shifrën **180**, në mos më tepër. Madje kur kemi parasysh edhe numrin e shembujve që sqarohen me ndihmën e trajtës së asnjansësit *të qenët* + fjala përkatëse, e ndonjë tjetër, që në FShS 2002 sillej aty rreth 300-shit dhe që në këtë burim (FGjSh 2006) kalon **500-shin**, atëherë nuk duhet të ketë më ankesë nga askush se numri i asnjansëve del i injoruar. Me fjalë të tjera, çështja e asnjansëve në përfaqësimin strukturor të prejpjesorëve dhe prejmbiemërorëve numerikisht pothuajse del në gjendje

reale, por kur është fjala të përfaqësimi i tyre me shembuj konkretë sipas tipave sipas bazës foljore mund të kërkohet një kriter edhe më i pranueshëm.

17) Lidhur me asnjansit konsultuam edhe burimin më të ri, **Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe** (Tiranë 2011), me autorë: *Ali Dhrimo* e *Rami Memushaj* dhe ndër të veçantat që dalin nga kjo vepër lidhur me temën tonë po i shënojmë më poshtë të përmbledhura në tri pika:

Së pari, ndërsa në Fjalorin drejtshkrimor (1976) ndeshim afro 30 asnjans në këtë fjalor (2011) ndeshim afro 200 shembuj të regjistruar. Kështu në Fjalorin e vitit 1976 nga grupi i asnjansve të mirëfilltë paparanyjzorë ndeshim vetëm këta dy shembuj: *dhjamët, kryet*, në Fjalorin e vitit 2011 hasëm nja dy shembuj më shumë: *leshtë dhe ujët*. Pra numri i tyre është më i vogël se në FGJSH 2006. Madje nuk ndeshim aq rritje numri lidhur me grupin e asnjansve mbiemërorë. Por sa u përket asnjansve prejpsore raporti del mbi 160 shembuj ose del pak më shumë nga shembuj e regjistruar FGJSH 2006, por, kur kemi parasysh numri e tërësishëm të fjalëve që FD 1976 kishte 32.000, ndërsa ky i vitit 2011 ka 73 mijë njësi, në burimin e fundit dalin mbi 5-6 herë më shumë njësi asnjansish ndaj atij të vitit 1976.

Edhe nga ky fakt shihet se gjatë periudhës 30 vjeçare në shqipen letrare, sipas dëshmisë së hartuesve të fjalorit përkatës, numri i asnjansve nuk ka shkuar duke u paksuar, por ka shkuar duke u rritur për 6-7 herë, kjo dëshmon gjithashtu se asnjansit prejpsorë më shumë e prejmbiemërore më pak janë aktivë e prodhimtarë në standardin e shqipe së sotme.

Së dyti, në Fjalorin e 2011 dalin edhe disa gjëra të veçanta që ia vlen të vihen në pah

a) Brenda fjalësit të fjalorit ndeshim këta shembuj pa siglën **as**. *të përkiturit, të shpënë*t dhe *të verdhët*, por sipas formës së të shkruarit që kanë këta shembuj padyshim janë dhe duhet përfillur si asnjans. Mbase kemi të bëjmë me gabim shtypi.

b) Aty ndeshëm edhe nja dy shembuj: *të shtriquat dhe të shirat* të shenjuar me siglën **as**, d.m.th. emra asnjans, të cilët, në të vërtetë, për të qenë asnjans do të duhej të merrnin mbaresë-prapashtesën **-ë/t** e jo **-at**, Dhe për këto dy raste mendojmë se ka ndodhur gabim shtypi, andaj duhen korrigjuar, qoftë duke i përforcuar me mbaresën **-ë/t**, qoftë duke ndërruar siglën në vend **as** të vehej **f**, d.m.th. emra të gjinisë femërore. Një veprim a korrigjim i tillë duhej bërë edhe në Fjalorin 1976 për shembullin *të korrat*. Për të qenë emri në gjininë asnjansë, shembulli i tillë, ai patjetër duhet me marrë mbaresë-prapashtesën **ë/t**, Pra format *të shtriquret, të shirët, të korrët* konsiderohen emra asnjans, përndryshe nëse mbajnë trajtat me **-a/t** fundore konsidrohen si shumësia të gjinisë femërore.

c) Ndeshim në këtë burim (2011) në zëra të veçantë edhe këta 6 shembuj me siglën **as**, të prirë nga nyja e përparme e rrjedhoes së:

**së kënduari, së luajturi, së qeshuri, së prituri, së punuari, së vrapuari**, të cilët kanë kuptim vetëm nëse paraprihen nga një folje si **plasa, u lodha, u mëzita** etj. P.sh.: **plasa (...)** **së prituri** (së punuari, së foluri etj). Në këto raste nuk kontestohet karakteri asnjans i shprehjeve të tilla. Mirëpo edhe pse ne fillimisht nuk e patëm paramenduar si objekt trajtimi këtë çështje, tashti na u imponua, prandaj edhe e shënuam për arsye se edhe në këtë mënyrë e tjera janë gjurmë që ka lënë asnjansi, kur në shqipe



kishte prani e shtrirje më të madhe, më të thellë e më të gjerë sa që ka sot. Pikërisht, kjo gjurmë a dukuri tregon se kjo gjini e emrit kishte edhe eptim më të zhvilluar, pra kishte lakim edhe në rasën rrjedhore ndërsa sot asnjësi merr pjesë në lakimin e katërt dhe si forma të veçanta aktive ka vetëm dy rasa: *emëroren e kallëzoren* dhe këto vetëm në njëjës in e shquar.

Sido që të jetë, te *shprehjet e ngurosura si më sipër* e raste të tjera, nuk kontestohet asnjësi në formën: *së punuari, së mbari, së bashku* etj., madje formimet e tilla kanë model të pranuar fjalëfomues, dhe gjithsesi, siç do të shohim në kreun e fundit të këtij punimi, kanë pjesën a ndihmesën e vet në identifikimin e asnjësit në gjuhën tonë.

3. Kemi vërejtur nga lënda e këtij burimi se një numër i konsiderueshëm i shembujve të regjistruar shpreh gjëra konkrete, të cilat ende nuk janë zëvendësuar me emrat e prejardhur sinonimikë që janë më të ditës. Lidhur me këtë po ritheksojmë se ne nuk i kontestojmë trajtat e tilla që ende mund të jenë në përdorim e sipër për të mbuluar nocione të tilla konkrete, por kemi bindjen se vendi i kuptimisë së asnjësve prejmbiemërore e prepjesorë të rasës emërore nuk është te gjësendet ose dukuritë konkrete, por në mbulimin e nocionit në fushën abstrakte, andaj insistojmë siç e kemi arsytuar më përpara e do ta ritheksojmë edhe më që në fjalorët e ardhshëm përshkrues normativë, së pari, duhet të shënohet nënfusha abstrakte që mbulon ose priret të mbulojë emri përkatës asnjës prepjesor ose prejmbiemëror e pastaj të shënohen edhe nocionet e tjera që mund t'i ketë trajta e caktuar, por për gjëra të tilla pritët të dalin sqarime edhe më kompetente nga ekspertët e standarologjisë së gjuhës sonë.

Sidoqoftë, për normalizimin e plotë të asnjësve në sistemin emëror të shqipes, po përsërisim, lypsen edhe sqarime teorike, ngase siç e pamë vlerësimet e duhura në burimet tona relevante normëzuese mungojnë. S' do mend se në gramatikën normative të Akademisë dhe në burime të tjera, duhen bërë korrigjimet dhe (ri)interpretimet e përpunimet e nevojshme, sepse siç po tregojnë faktet tipat e caktuar të asnjësive assesi nuk dalin si "mbeturina", por dalin si fjalë aktive e produktive me perspektivë të qartë dhe me prirje shumimi si aktualisht ashtu dhe në të ardhmen.

Nga sa u tha, në fund të këtij kreu, po ripërsërisim kërkesën që gjithsesi duhen njohur edhe më mirë nënfushat përkatëse semantike që mbulojnë a priren të mbulojnë tipat përkatës të asnjësve dhe atyre duhet me u dhënë haku ose vendi i merituar në burimet normative standarde të gjuhës sonë.

Po ashtu duhet tërhequr vërejtje që kurrsesi nuk është e drejtë të zëvendësohen arbitrarisht asnjësit e nyjshëm prepjesorë, në çdo rast, me trajtat e prejardhura sinonimike me prapashtesat –IM ose -JE, ose me femërorët e nyjshëm e ndonjë tjetër, siç kanë bërë e po bëjnë aktualisht disa hartues fjalorësh, ose përkthyes të papërvojë, sepse, siç do të argumentohet edhe në kreun vijues e në vijim, asnjësit e paranyjësuar prepjesorë e kanë vendin e posaçëm të pazëvendësueshëm në kuadër të sistemit ligjërimor brenda strukturës emërore të gjuhës shqipe, sidomos ose kryekëput në fushën e abstraksionit.



## V. VENDI I ASNJANËSVE PREJPJESORË NË KUADËR TË PREJPJESORËVE TË TJERË

### 1) Treshi sinonimik dhe emërtimi i proceseve tekniko-teknologjike në gjuhën shqipe

Siç e pamë vendi i asnjansve të paparanyjzuar ose të parmë si emra të mirëfilltë me kuptim të hershëm burimor përfshihej në kuadër të nënfushës që emërtoheshin përgjithësisht koncepte të *gjësendeve a të lëndëve konkrete të panumërueshme e të tjera*, vendi i asnjansve prejmbiemërorë të nyjshëm që në fillim bënte pjesë në nënfushën e emrave *abstraktë të profilit të cilësisë të një gjendjeje a të qeni* që motivohej nga tema e qartë fjalëformuese mbi bazë mbiemërore, ashtu siç motivohej edhe emërtimi i asnjansve të paranyjzuar prejppjesorë nga tema foljore (pjesorja përkatëse) për të shprehur *veprime të caktuara po nga fusha e abstraksionit*, por të *profiluar* ndërkohë parësorisht në një nënfushë të veçantë semantike, që kishte të bënte me emërtimin e koncepteve të veprimeve përkatëse po brenda fushës së gjerë të abstraksionit, ashtu siç ngjan edhe me asnjansit prejmbiemërorë. Në të vërtetë, këtë nënfushë semantike të asnjansve prejppjesorë e shpjegoam dhe e konceptuam në një farë dore në kreun e mëparshëm, ndërsa tashti në këtë krye e në të tjerët në vazhdim na mbetet që ta qartësojmë edhe më mirë e më në hollësi po të njëjtën gjë, ngase në këtë mënyrë identiteti i asnjansve të këtij tipi, del më i përkapshim. Pra, na mbetet që në vazhdim të bëjmë përpjekje që gjatë shtjellimit të ekspozojmë sa më shumë fakte të qarta dhe bindëse jo vetëm për lexuesit dashamirës, por edhe për studiuesit me ambicie të zgjuar shkencore e pragmatike të gjuhës sonë.

Ç’është e drejta, rreth nënfushës semantike të asnjansve prejmbiemërorë të paranyjzuar dhe për nënfushën semantike të asnjansve prejppjesorë deri më tash nuk kemi ndeshur në ndonjë punim monografik të hollësishëm, por konstatime me interes patëm rastin të lexonim nga materiali i përfshirë në *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, të dhëna këto të vlerësuara shumë pozitivisht prej nesh në fillim të këtij punimi dhe në disa artikuj të prof. A. Zymberit. Mirëpo, në të vërtetë, ne, spontanisht në mënyrë të pavarur, pa i konsultuar burimet që bëjnë fjalë për temën në shqyrtim, specifikimin a prirjen rreth përcaktimit të nënfushës semantike të asnjansve prejppjesorë e kemi pasë vënë re kalimthi qysh para 20 e sa vitesh në një punim, kur i patëm trajtuar emërtimet e proceseve tekniko-teknologjike të shqipes në ndërmarrje prodhimi.

Meqë ishte pothuaj rast unik sa i përket trajtimit të temave të tilla ndër ne e më gjerë dhe me qëllim që edhe sot përmbajtja e atij konstatimi të jetë më e qartë për lexuesin, po e riprodhojmë këtu vetëm pjesën që ka të bëjë me temën tonë të nxjerrë nga trajtesë-kumtesa me titull “*Çështje rreth emërtimit të proceseve tekniko-teknologjike me foljet më -o/(-zo-)*”, botuar në *Seminari...1987* dhe të ribotuar në librin *Foljet më -o- në shqipen e sotme* (Prishtinë 2002, f. 24), ku tekstualisht theksohet:

Në këtë kompleks çështjesh (d.m.th., rreth emërimit të proceseve tekniko-teknologjike) po cek vetëm dukurinë e bashkëjetesës së **treshit sinonimik** (emrave prejfoljorë) nga tema e njëjtë motivuese, si p.sh. shkrim / shkruarje / të shkruarit, çmim / çmuarje / të çmuarit, lëshim/ lëshuarje / të lëshuarit, shtrim//shtruarje / të shtruarit, kthim / kthyerje / të kthyerit etj., dukuri kjo që është e pranishme në jetën tonë të përditshme dhe ka raste të këtilla që dalin të shënuara e të përligjura edhe në fjalorin tonë shpjegues normativ. Gjithsesi studimi me kompetencë i kësaj dukurie, me mprehtësinë që meriton, mbase do të nxjerrë në pah se treshi sinonimik i sipërcekur në gjuhën tonë, mos vallë, do të konsiderohet si një begati, jo vetëm për të shprehur ngjyime stilistike për të njëjtin koncept, por ato do të mund të cilësoheshin edhe si fjalë të veçanta (terma) për të shprehur koncepte të ndryshme, varësisht nga konteksti ose nga vetë dukuria që shprehet. Ç'është e vërteta, nga aspekti që po trajtohet këtu ndonjëri nga shembujt që u konstatuan mund të shërbejë si sprovë për një kundërvënie kuptimore, ngase me emrat e tipit: shkrim, çmim etj. shprehet **rezultati i veprimt**, me emrat e tipit: shkruarje çmuarje etj.- shprehet vetë **veprimi si proces në vazhdim** (kryesisht) dhe së fundi, me emrat asnjans të tipit të shkruarit, të çmuarit – shprehet **koncepti i temës a i procesit të caktuar**.

Gjithsesi, theksonim aty, një kundërvënie e tillë kuptimore e sinonimeve në fjalë del më e qartë në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhëve të huaja, jo vetëm në gjuhën e përkthimit, kur kemi të bëjmë me terminologji tekniko-shkencore e teknologjike, por edhe për koncepte të tjera të fushave të caktuara, ngase jeta shtron nevojën edhe për aso shprehjesh e nuancash konceptore, të cilat deri më tash nuk ishin aq të ndjeshme dhe të domosdoshme për t'u shprehur.

Ne, atëherë këtë çështje e lamë të hapur, e cila mjerisht nuk zgjoi interesim e duhur te faktorët tanë përgjegjës normëvënës, ashtu si mjaft çështje të tjera të iniciuara ndërkohë prej nesh. E themi me keqardhje pse kërkesa jonë mbeti amull, d.m.th. ende vendnumron, sepse nuk pati lëvizje as jehonë tash a sa vite, ndonëse mendojmë, siç tregojnë faktet, se kishim plotësisht të drejtë. Edhe sot ngulmojmë se numri i asnjansëve të ngjashëm, të tipit si b.f. të menduarit, të folurit, të përthyerit që dalin si terma të mirëfilltë të njohur ligjërish, sipas terminologjisë tekniko-shkencore të shkencave filozofike, filologjike ose fizike, mund dhe duhet të shtrihen lirshëm edhe në nënfusha të tjera të veprimtarive përkatëse, madje me shembuj ligjërish të drejtë që mund të kalojnë në model a si me thënë në *prodhim serik*, ngase këtë e mundëson vetë struktura përkatëse në kuadër të sistemit emëror e foljor të gjuhës sonë, strukturë kjo që ndërlidhet në mënyrë komplekse me të gjitha nënfushat e caktuara përkatëse semantike.

## 2) Shembuj tipikë të treshit sinonimik të gjuhës shqipe në krahasim me dy gjuhë të huaja në kontakt

Atë që e thamë rreth specifikimit të nënfushës semantike në kuadër të treshit sinonimik, duke e pasur parasysh gjithnjë në qendër të vëmendjes asnjansin prejpjesor në raport me prejpjesorin e prejardhur më -im ose -je e vërteton vetë praktike edhe në krahasim me gjuhët e tjera, krahasim ky i domosdoshëm kur kemi parasysh faktin se në jetën bashkëkohore të gjitha proceset tekniko-teknologjike që ndërlidhen pothuajse me të njëjta fusha të prodhimtarisë së të mirave materiale e të tjera janë pothuajse të ngjashme. Sa për ilustrim po i shënojmë dy shembuj të emërtimeve përkatëse në të tri gjuhëve në kontakt: shqip, serbisht dhe italisht:

shqip	serbisht	italisht
1. të bindurit bindje-a	ubedjivanje ubedjenje	convicimento, condizione;
2. të detyruarit detyrim	obavezanje obaveza	obbligazione, obligo.

Shembuj të ngjashëm në përdorim të përditshëm janë të shumtë. I ndeshim normalisht si barasvlerës, patjetër, siç shihet nga shembujt e mësipërm, edhe në raport me gjuhët e tjera, andaj vendi i asnjansit si element i domosdoshëm assesi nuk duhet të sillet në dyshim. Në të vërtetë, ne jo vetëm nuk e sjellim në dyshim as dukurinë e treshit sinonimik, por e quajmë të domosdoshme në kontekste të caktuara, andaj kërkojmë që diferencimi kuptimor sipas nënfushave që mbulojnë trajtat e caktuara detyrimisht duhet të njihet më mirë nga të gjithë. Kështu, pra gjithsesi përkufizimet e dhëna në fragmentin e punimit tonë të riprodhuar më sipër sipas tipave të treshit sinonimik prejpjesorë, mund të vërtetësohen mjaft mirë në kontekste të tjera të caktuara, siç do të përpiqemi ta bëjmë tash fill. Pra, sa për ilustrim po japim edhe dy shembuj të tjerë po nga këto tri gjuhë fqinje me përmbajtje të treshit sinonimik:

shqip	serbisht	italisht
1	2	3
1) çmoj (me çmue) çmim çmuarje të çmuarit	ceniti (oceniti, proceniti) cena cenjenje ocenjivanje, procenjivanje	apprezare prezzo estimo volutazione;
2) rrit (me rritë) rritë-a rritje të rriturit	rastiti rast porast rastenje	crescere crescita creosciuto crescione.

(Shih për këtë FSHSK 1981 dhe Fjalor shqip-italish, Durrës 1992, Fjalori i Toçit (1993) dhe Taliansko-hrvatshki ili srpski rječnik, Zagreb 1980 e në burime të tjera.)

Jemi të vetëdijshëm se barasvlerësit përkatës që mund të ndeshen sigurisht në raport edhe me gjuhë të tjera, për koncepte të caktuara mund të këmbëhen edhe me sinonime të tjera mbase edhe më të përshtatshme, varësisht nga natyra e gjuhës përkatëse, por ne kemi për qëllim të vëmë në pah ose të tregojmë se kjo vlen sidomos për përkthyesit, pse jo edhe për studiuesit përkatës, se në gjuhën shqipe për konceptin e caktuar nuk ofrohet vetëm njëra nga trajtat e prejpjesorit me prapashtesën me **-im** ose **-je** që zakonisht del e favorizuar në fjalorët tanë përkatës si barasvlerësi më tipik për korresponduesit përkatës të gjuhëve të huaja, por për të njëjtin destinim mund të paraqiten edhe të dy trajtat e tjera sinonimike e ndër to nuk duhet anashkaluar assesi as trajta e asnjansit përkatës si trajtë e padiskutueshme barazvlerëse për konceptin përkatës.

Me thënë të drejtën, atëherë, kur ne e patëm shprehur konstatimin e mësipërm, aspak nuk sillnim në sprovë-dyshimi qëndrueshmërinë e asnjansit, siç nuk e sjellim as

sot, por dilte i diskutueshëm për ne raporti i prejpjesorëve të panyjësuar prapashtesorë i emrave të veprimit me -im dhe -je, të cilët kanë fjalë-temë të njëjtë prodhuese Ngase, siç na është e njohur nga gramatika, prapashtesa -je, sipas rregullës fjalëformuese semantike del e specializuar vetëm për temat e foljeve me bashkëtingëllore, kurse prapashtesa -im del e specializuar mbi temë të foljeve me zanore a tog zanor -oj, -uaj dhe -ej (pjesërisht).

Atëherë shtrohet pyetja pse u shfaq kjo dukuri, brendapërbrenda emrave të veprimit, që nuk është pa gjurmë edhe pa prirje jetësimi edhe sot? Përgjigja s'mund të jepet aq lehtë e thjeshtë. Do të përpiqemi ta elaborojmë sadopak pa humbur kohë. Sigurisht një alternativë e tillë doli nga nevoja, nevojë kjo që për mendimin tonë ekziston edhe sot. Këtë e ndjejnë më së miri ata që merren ose ballafaqohen me probleme të tilla barazvlerësie, jo vetëm në kuadër brendapërbrenda gjuhës sonë, por aq më tepër në raport me gjuhët e huaja. Atëherë në notes, përveç shembujve të sipërcekur që i kishim ndeshur në burimet tona përkatëse të kohës që e ndiqnin zyrtarisht e rigorozisht normën, i kishim të shënuar edhe shembuj të tjerë po mbi bazë të foljeve më **-oj, -ej** dhe **-uaj** tek të cilat veç prejpjesores më **-im** dilte në përdorim mbi të njëjtën temë prodhuese edhe ajo e diskutueshmja me prapashtesën **-je**, Ja disa shembuj që po i nxjerrim nga notesi:

zgjuarje (zgjim, të zgjuarit), dërguarje (dërgim, të dërguarit), vluarje (vlm, të v(a)luarit), rrezuarje (rrezim, të rrezuarit), dëbuarve (dëbim, të dëbuarit), paguarje (pagim e pagesë, të paguarit), limuarje (limim, të limuarit), ftuarje (ftim e ftesë, të ftuarit), lëmuarje (lënim të lëmuarit), shfryrje (shfrim, të shfryrët), shkëlqyerje (shkëlqim, të shkëlqyerit, e ndonjë tjetër.

Këto janë, pra disa nga trajtat që i patëm vërejtur, madje disa herë të përdorura në burime të ndryshme të kohës, por për të njëjtin destinim, po me kuptimësi të dalluar në kuadër të treshit sinonimik. Po e përsërisim me të tjera fjalë se këtë dukuri e kemi pasë vërejtur, pikërisht atëherë, kur norma në fuqi te ne respektohej edhe në mënyrë të disiplinuar dhe me eufori, andaj, siç e thamë, dilnin të diskutueshme vetëm trajtat me -je dhe assesi trajta e asnjësve përkatës ashtu si edhe trajtat me -im.

Meqë rregulla e cekur prej nesh është gjithnjë në fuqi po rrëfëhemi se për mendimin tonë rastet e tilla me -je, kur përdoren nga nevoja që shtron konteksti, asnjëherë nuk duhet të cilësohen *si shkelje e normës*. Themi kështu, sepse në raste të tilla emrat përkatës me -im si dhe -esë (që theksohen sipas rregullës), si b.f. te folja **shkruaj**: *shkrim, shkresë*, konstatohet se kishin kaluar në nënfushën tjetër semantike, jo në emërtimin e procesit a të veprimit përkatës. Pra kishin kaluar përkatësisht në emërtimin e rezultatit të veprimit ose të një gjësendi konkret, ndërsa koncepti i emërtimit (abstrakt) të vetë procesit ose ishte zbehur shumë ose kishte mbetur i pambuluar. Prandaj në raste të tilla u ofrua dhe u pranua menjëhershëmërisht (automatikisht) trajta sinonimike mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme, siç është tipi **shkruarje** (emërtim i procesit). Krahaso: *shkrim-i* (emërtim i dokumentimit të veprës reale të shkruar), *shkresë-a* (emërtim i dokumentit konkret), ndërsa *shkruarje-a*, (shkruar+je), pra, *emërtim i procesit të veprimit ose veprimi i konceptit të të shkruarit*. Për të qenë edhe më të qartë, po përsërisim, kur emri më -im kalon në fushën e emrit konkret ose mbulon koncept të përafërt me të, atëherë vetvetiu emri me -JE fiton të drejtën e ndërhyrjes në përdorim, ashtu si edhe trajta e asnjësit përkatës. Por, kur trajta më -IM mbetet si emërtim i veprimit, atëherë, as asnjësi përkatës, jo e jo, por as trajta më -JE s'ka vend aty, ngase s'del e nevojshme me u

përdorë, por ajo, duke e lënë nën hije asnjësin, si me thënë, qëndron, si e parë në radhë në pjesën e rezervës dhe kështu si forcë e rezervës brenda sistemit ligjërimitor pret rastin për aktivizim ose, si të thuash, qëndron e gatshme si rezervë për shërbim. Fundja, kur dihet se pjesorja e letrarishtes mbaron me konsonant, atëherë si temë fjalëformuese formalisht nuk qëndron kundër rregullës, që nga të gjitha foljet me konsonant emri prejpjesor i veprimit merr prapashtesën -je. Me fjalë të tjera, kur koncepti i emërtimit abstrakt i vetë procesit del i zbehur ose mbetet si kuti e zbrazur *vacuum*, andaj trajta me -je, kur gjen kuti të zbrazët, s'ka arsye të mos e zërë vendin e liruar nga sishoqja me formantin -IM (mësim / mësuarje), madje sipas prirjes që kemi vërejtur, trajta me -JE më shumë ka të drejtë të intervenojë se sa asnjësi përkatës, pra në këto raste kur është çështja tek emërtimi i vetë procesit, por jo të konceptit, ngase këtë të drejtë e ka të fituar asnjësi..

Sipas shembujve që dhamë shihet qartë se të gjitha trajtat dalin të shënuara sipas modelit të pranuar nga trajta e pjesores së letrarishtes, d.m.th. të toskërishtes. Nuk dimë se nga trajtat barasvlerëse të versionit të gegërishtes do të ketë pasur shfaqje të tillë apo jo.? Dihet se edhe më përpara miratimit të normës në fuqi, në toskërishte një dukuri e tillë kishte përhapje të dukshme, e cila u la jashtë norme, për arsye thjeshtëzimi. Pra, norma e sotme në fuqi e përjashton trajtën *hutarje*, duke e pranuar për të njëjtën koncept të normëzuar vetëm trajtën **hutim** nga folja **hutoj** (me (u) hutue), e kështu me radhë.

Pasi trajta paralele e gegnishtes, si te shembulli *hutarje /hutuemeje*, nuk dimë se do të jetë cekur diku, prandaj për ne shembulli *nduemeje (me ndue)* si dhe ai *vumje (me vu)* të shënuara krahas trajtave të asnjësve të **nduemit** dhe të **vumit**, që i ndeshëm të regjistruara në Fjalorin e M. Elezit (Aty f. 387.), dilnin mjaft simptomatike dhe jo pa interes. Mendojmë se këtu erdhi rasti të rikujtojmë se ka shpjegime, që nuk kontestohen se edhe emri me -im qysh në lashtësi, kishte dalë nga pjesorja e foljes me zanore,(mbase \*paskajorja e hershme sintetike!) si p.sh.: -Oj. (\*-ONj, \*On\*Oj), ndërsa O-ja me rastin e emërformimit ka rënë, por që në raste të tjera është diftonguar (\*OU/UO)-UA/UE pra, \*shkrONj: shkrO + IM - **shkrim**, e kështu me radhë, proces ky që për gjendjen e sotme nuk del fort i qartë dhe i lehtëpërkapshëm, sikurse del b.f. rregulla tjetër mbi bazë të pjesores së sotme të foljeve me konsonante fundore që mbi te temën e qartë prodhuese formohen prejpjesorët me -JE, si b.f. dal(ë) (me dalë) dal-je, analogjikisht: shkruar shkruar-je ose shkruem (me shkruem) shkruem-je.

Sidoqoftë, edhe kjo e vërtetë del e nevojshme të thuhet dhe njëherazi edhe të njihet edhe më mirë. Së këndejmi, atë që e thamë lidhur me prapashtesën -JE, vërtetohet edhe nga asnjësit prejpjesorë të nyjshëm te nëngrupi a) të vjelë nga Fjalori i shqipës së sotme (2002), ku të gjitha sinonimet sqaruese janë dhënë me tipin e emrave më -JE, përveç një rasti pagë+esë pagesë (të paguarit), ashtu si edhe te nëngrupi b) ku janë dhënë dy raste me mbaresë zero: sosë-a (me (u) sosë të sosurit) dhe tekë-a (me u tekë, të tekurit), ndërsa në nëngrupin c) emrat sinonimikë dalin të llojlojshëm sa i përket ndërtimit, veç me prapashtesën -je qëlluarje, shkruarje e me -im: *dëgjim, mendim, shkrim, pagim*; dalin në veprim edhe formante të tjera si -esë pagesë (të paguarit), pastaj, pjesore e emëruar (sipas mënyrës pandajshitesore): rrojë (të rruarit), emër i nyjshëm: e qëlluar-a (të qëlluarit), d.m.th. në gjashtë raste kemi 9 sinonime alomorfe të ndryshme. Pra, përveç atyre me prapashtesën -im dhe -je kemi nga një rast me -esë (pagesë-a), një me -ojë fundore (rrojë-a) dhe një emër të nyjshëm me mbaresë zero ( e qëlluar-a).

Nga sa u tha më sipër kuptojmë një fakt me interes se rrëgjimi i asnjansëve është zbatuar vetëm tek emrat e parmë a asnjansësit e mirëfilltë të paparanjësuar, ndërsa tek asnjansësit e paranjësuar prejmbiemërorë dhe sidomos tek asnjansësit prejppjesorë nuk shfaqet, pothuajse, fare një dukuri e tillë rrëgjuese, por ata dalin kuptimisht të spostuar në një nënfushë tjetër semantike jo të largët, por të përafërt me procesin e veprimit përkatës.

### 3) Nënfushat semantike në raportin asnjansësi prejppjesor/ barasvlerësi sinonimik

Pra, është fakt se edhe asnjansësit e nyjshëm prejppjesorë, por jo si ata të panyjshmit, por ngjashëm me prejmbiemërorët, konkurrohen vetëm për ndonjë pjesë koncepti nga format e tjera, por jo për konceptin e temës së procesit përkatës.

Prandaj, për me pasë më të qartë këtë fenomen, d.m.th. nënfushat semantike në raportin asnjansësi prejppjesor ndaj barasvlerësit sinonimik, ashtu siç e morëm nga një shembull (*të mirët e të madhtë*) për prejmbiemërorët, tashti, nga tipi e asnjansëve prejppjesorë nga foljet më -oj, po e veçojmë shembullin: *të mësuarit*, të cilin po e zbërthejmë, duke e krahasuar ndërsinonimisht me përgjegjësit e tjerë, brenda këtyre fjalive:

a) Të mësuarit sjell fitim b) Nga mësimi ose Nga mësimet vjen fitimi. c) E mësuara nuk harrohet lehtë ose Të mësuarat nuk harrohen lehtë. ç) Nga e mësuara ose të mësuarat kanë dobi të gjithë. d) Nga i mësuari ose të mësuarit kanë dobi të gjithë.

Po përmendim ndonjë veçori gramatikore (morfologjike) e semantike të emrave të nënvizuar në fjalitë e mësipërme, sipas radhës:

a) **Të mësuarit** - emër abstrakt, njëjës, i shquar, gjinia asnjansëse, d.m.th. shprehet koncepti vepror që ndërlidhet me veprimin e të mësuarit, përgjithësisht.

b) **Mësimi** ose **mësimet** - emër abstrakt, njëjës e shumës, shprehet procesi i veprimit i të të mësuarit me elemente të rezultatit të veprimit.

c) **E mësuara** ose **të mësuarat** – emër abstrakt, gjinia femërore njëjës e shumës, d.m.th. shprehet vepra e mësuar ose veprimi i njohur më parë i procesit të të mësuarit.

ç) **E mësuara** ose **të mësuarat** – emër njeriu, gjinia femërore, njëjës e shumës, emër i përgjithshëm me kuptim pësor, jo vepror.

d) **I mësuari** ose **të mësuarit** - em njeriu, gjinia mashkullore njëjës e shumës, emër i përgjithshëm me kuptim pësor, jo vepror.

Nga shembujt e mësipërm po veçojmë këto veçori dalluese:

1) Nga shembulli i parë, pika a), shohim se asnjansësi si emër abstrakt ka njëfarë afrie semantike vetëm me emrin gjithashtu abstrakt të gjinisë femërore në njëjës e shumës, pika c), por që gramatikisht u ndryshon gjinia gramatikore dhe një-mbaresa shquese. Krahaso: *të mësuarit / e mësuara, të mësuarat*, Kuptohet se *e mësuara ose të mësuarat* si koncept abstrakt shprehin një proces që tashmë nënkuptohet si i kryer, d.m.th. ka ngjarë në të kaluarën, ndërsa me asnjansësin **të mësuarit** shprehet koncept që nuk del si veprim i konkretizuar kohësisht, madje as që nënkupton qartësisht procesin e



veprimi dhe as të rezultatin e një veprimi të tillë, i cili shprehet më mirë me trajtën tjetër *mësim mësimi* ose *mësimet*.

2) Është e vërtetë se me shumësin e shembullit d) emër i përgjithshëm i gjinisë mashkullore njëjësi i asnjësisit ka ngjashmëri formale, por semantikisht ka mospërputhje diametralisht të kundërt. Njëjësi i emrit abstrakt, në njëërë anë dhe shumësi i emrit të njeriut, në anën tjetër semantikisht u takojnë, si me thënë, dy poleve të ndryshme kuptimore, sepse, përveç treguesve kategorial njëjës/shumës ndryshimi del shumë më i thellë në fushën tjetër: **abstraksion i lartë / konkretizim** si dhe dallimi në karakterin diatezor **vepror/pësor**. Megjithatë, ka propozime që asnjësi në rasën emërore të marrë një-mbaresën -ët, të mësuarët, ndërsa shumësi i mashkullorit të paranyjëzuar ta ruajë një-mbaresën -it. Krahaso: të mësuarët (\*të mësuënët ose të mësuem't a të mësuemët) ndaj të mësuarit (të mësuemit – njerëzit e mësuem).

3) Siç po shihet te shembuj nën pikën c) dhe ç) që të dy shembujt janë emra femërorë që si homoforma që janë kanë ngjashmëri të plotë formale: shqiptimore e shkrimore. Dallimin i tyre mund të bëjë vetëm konteksti, andaj në analiza praktikohet që si trajtë përfaqësuese për emërtimet e njerëzve mjafton të merret vetëm trajta e gjinisë mashkullore.

4) Te rasti i dytë nën b) nuk u shënuar sinonimi **mësuarja (Mësuarja(!) sjell fitim)**, që cekej si mundësi zëvendësimi në raport me treshin sinonimik, mundësi kjo e njohur për të shprehur konceptin e veprimi, sepse në fjalinë (kontekstin) që e shprehëm ne nuk shihet se është lënë vend i zbrazët (vacuum), ngase trajta **mësimi** nuk ka kaluar në nënfushë tjetër semantike që ka të bëjë me rezultatin e veprimi, ku nënkuptohen të implikuara edhe elemente konkretizimi.

\* \* \*

Sidoqoftë, për të treguar dhe përforcuar faktin se ashtu siç nuk goditet kuptimisht në gjendjen e sotme trajta e emrit *asnjanës prejmbiemërorë* në koncept nga emrat e tjerë sinonimikë, siç ishin edhe *emrat e prejardhur* me prapashtesat: **-si, -i, -ri** etj., po ashtu edhe trajta e *asnjanësit prejpjesor*, aspak nuk goditet nga *emrat prejpjesorë të prejardhur* me prapashtesat përkatëse: **-im, -je, -esë** e të tjera dhe për të pasur ide edhe më të qartë lidhur me këtë, më poshtë po paraqitim skemën e treshit sinonimik të një numër të konsiderueshëm të shembujve ku mund të dallohet një zhvillim i tillë sipas kuptimësisë përkatëse.

Mirëpo, tani, para se të japim skemën me shembuj konkretë që lidhen me tri nënfusha të ndryshme semantike të treshit sinonimik po japim një **konstatim** me vlerë që çdo lexues mund të këtë vërejtur, nëse gjatë përcjelljes së analizës së deritashme e ka pasur vëmendjen zgjuar:

**Ndonëse prejmbiemërorët dhe prejpjesorët i dallon tema e ndryshme, por e qartë motivuese fjalëformuese sipas prejardhjes përkatësisht *mbiemërore / pjesore*, këta tipa i bashkon nënfusha e njëjtë semantike që e mbulojnë, d.m.th. **abstraksioni i veçantë që ka të bëjë pikërisht me konceptin në shkallën më të lartë të procesit në kuadër të fushës së shkallëzuar të abstraksionit.****

E theksuam këtë konstatim të rëndësishëm, i cili edhe do të sforcohet, në vijim me material të ri, sipas skemës së paralajmëruar, prandaj ia vlen të ndjekim paraqitjet vijuese edhe më vëmendshëm:

**4) Skema e shembujve të treshit sinonimik,  
sipas nënfushave semantike të tyre**

Pra, në skemën e mëposhtme në rubrika të veçanta do të ndahen tri nënfushat e cekura semantike (3, 4, 5), por do të parashoqërohen edhe me dy rubrika të tjera (1,2), të cilat u janë rezervuar trajtave përfaqësuese të foljes:

1. njëjësi i dëftores,
2. paskajorja e mirëfilltë,
3. koncepti i veprimit si abstraksion i lartë (asnjanësi),
4. emërtimi i veprimit (emër kuptimi),
5. emërtimi i rezultati konkret të veprimit.

1	2	3	4	5
<u>Folja përkatëse</u>	<u>Paskajorja e mirëfilltë</u>	<u>Koncepti i veprimit</u>	<u>Emërtimi i veprimit</u>	<u>Emërtimi i rezultatit të veprimit etj.</u>
bluaj mësoj fundërroj	me blue me mësue me fundërrue	të bluarit të mësuarit të fundërruarit	bluarje-a mësim fundërrim	blim-i blojë-a mësojë-a, e mësua fundërresë, fundërri, fundërrojë, fundërrinë
kulloj	me kullue	të kulluarit	kullim	kullojë, kullore, kullojë, kullor
trajtoj çoj shkarkoj	me trajtue me çue me shkarkue	të trajtuarit të çuarit të shkarkuarit	trajtim çarje shkarkim shkarkuarje	trajtesë, trajtë-a çojë-a, çueshmëri shkarkesë, shkarkojë shkark-u, shkarkor-i
shtroj	me shtrue	të shtruarit	shtruarje	shtrim,shtrësë,shtrojë shtromë, e shtruar-a
dëshmoj hutoj kafshoj rralloj prodhoj	me dëshmue me hutue me kafshue me rrallue me prodhue	të dëshmuarit të hutuarit të kafshuarit të rralluarit të prodhuarit	dëshmuarje hutim kafshuarje rrallim prodhim	dëshmi, dëshmim hutojë, hutesë, hutosë kafshim, kafshatë rrallojë, rrallesë prodhimtari, prodhueshmëri
qëlloj shkruaj	më qëllue me shkruue	të qëlluarit të shkruarit	qëlluarje shkruarje	e qëlluar, qëllatë-a shkrim,shkresë, shkrojë e shkruara, shkruesi-a
ushqej çaj kthej ngrij rrit (rris) vij dal	me ushqye me ça me kthye me ngri me rritë me ardhë me dalë	të ushqyerit të çarit të kthyerit të ngrirët të rriturit të ardhurit të dalët	ushqyerja çarje kthyerje ngrijje rritje ardhje dalje	ushqim, ushqyeshmëri çajë-a, çallë e çallatë kthim, kthesë ngrijë-a, ngricë-a, rritë-a, rritshmëri e ardhura, të ardhurat e dala, të dalat

dredh bërtas fryj	me dredhë me bërtitë me fry	të dredhurit të bërtiturit të fryrët	dredhje bërtitje fryrje	dredhë-a, dredhi-a(!) bërtimë-a, së bërtituri frymë-a, e fryme-ja, frysë-a
pres pres (prej) tres (tret) përziej lyej begenis	me pritë me pre  me tretë me përzie me lye me	të priturit të prerët  të treturit të përzierët të lyerët të	pritje prerje  tretje përzierje lyerje  begenisje	pritë-a, e pritura, e preme-ja, presë-a, presore tretësirë (tretje*) e përzierja, e pëziemja e lyera, e lymja begeni, së begenisuri
çudit kërcej kris ngut	me çuditë me kërcye me krisë me (u) ngutë	të çuditurit të kërcyerit të krisurit të nguturit	çuditje kërcim krisje ngutje	çudi, çudë kërcejë-a*, e kërcyera krisinë, krisë-a ngutësi, së nguturi

### Konstatime nga skema e mësipërme

Nga skema mësipërme mund të nxjerrim disa konstatime e ne po i veçojmë këto:

E para, nga konkretja *mësoj* (e tashme e dëftores) në sistemin foljor ngjitet abstraksionit deri te kulmi *me mësoje* (*paskajore e mirëfilltë*), ndërsa nga asnjësi *të mësuarit a të mësuarët*, d.m.th. nga kulmi i abstraksionit të sistemit emëror më të lartë zbritet në emërtimin e procesit *mësim dhe kalon shkallë-shkallë* drejt konkretizimit, rezultatit të veprimit *mësojë-a, mësimmarrje e më tutje: e mësuara, mësojtore, mësuës-i* etj.

Po marrim një shembull tjetër: nga *shkruaj* (*me shkruaj*) doli *të shkruarit a të shkruarët*, së këtejmi doli procesi i veprimit *shkruarje-a* dhe si rezultat i veprimit: *shkrimi* (dokument a vepër e shkruar) dhe pastaj emrat gjithnjë më afër konkretshmërisë: *e shkruara, shkresa, shkroja, shkrola, shkruësja, shkruëshmëria*, për të dalë edhe në nënfusha të tjera semantike, siç janë emërtimet e njerëzve *shkruës-i*, emërtimi i vendshërbesave: *shkrimtore, shkresori*, të sendeve konkrete *shkresor-i*, *shkresore-ja* etj.

Sidoqoftë, ndër lidhja kuptimore e tyre del e shprehur edhe më qartë në kontekste të caktuara, e vërtetë kjo që do të ritheksohet ose do të qartësohet edhe më mirë kur të bëhet fjalë rreth identitetit plotësues të asnjësve të paranyjzuar në kreun vijues.

E dyta, vihet re se vetëm *koncepti i veprimit*, d.m.th. asnjësi i nyjshëm prej pjesor (rubrika 3) mbetet i pandryshuar shkrimisht, kurse në nënfushën tjetër (rubrika 4) lëvizin tipat e emrave prej pjesorë të veprimit më **-im** ose më **-je**.

E treta, në rubrikën 4 dhe atë 5 lidhur me emërtimin e procesit ose të rezultatit të veprimit etj. dalin të dyja trajtat e emrave me **-im** dhe me **-je**. Në të vërtetë, siç mund të shihet më shumë raste dalin me **-im** te rubrika 5 (rezultati i veprimit), por nganjëherë sipas kontekstit ka ndonjë rast që del edhe me prapashtesën **-je**, siç është shembulli *trejtje* e ndonjë tjetër. Në të vërtetë, në FSHS më tepër emra konkretë më **-je** formohen mbi

termë emërore, si barkje, bishtje, kripje, rrethje, bukje etj. (Shih: N. Veselaj, *Çështje të shqipes standarde ... I*, Prishtinë 1997, f. 83.)

E katërta, ndonëse nënfushat semantike të sipërcekura nuk dalin përherë të specifikuar qartësisht, ato parimisht shënojnë prirje për një specifikim të tillë të pranueshëm dhe të kuptueshëm ligjërisht që mund të formëzohet lehtë si model, ndërkohë e me kohë, prandaj poqëse favorizohet institucionalisht nga faktorët tanë normëzues, specifikimi i tillë sipas metodës së përdorur prej nesh, atëherë mendojmë se gjuha jonë do të fitojë shumë dhe do të ishte edhe më e denjë t'u përgjigjej më me sukses të gjitha sfidave që i imponohen nga koha, duke përfshirë edhe presionin e globalizmit të sotëm që vjen nën ndikimin e gjuhëve të huaja ose nga vetë zhvillimi i bashkëkohor i shoqërisë.

E pesta, zgjojnë interes foljet e huazuara, tipi me **-is** e **-it**, tipi: *begenis*, *çudit*, nga të cilat me prapavajtje, në analogji me emrat abstraktë të shqipes me prapashtesën **-i**, u formuan jo vetëm asnjansit **të begenisurit**, **të çuditurit**, por edhe emrat e tipit *begeni* (nga *begenis* me *begenisë*) si dhe *çudi* (nga *çudit*, me (u) *çuditë*, shembuj këta që aspak nuk i konkurrojnë opozicionisht konceptit të trajtës së asnjansit përkatës të tipit: *të begenisurit*, *të çuditurit*. Po sqarojmë se në turqishte *begeni* nuk është emër po *preterit*, është trajtë e foljes përkatëse, po ashtu *çudi* (nga *çuditi*) nuk është emër në serbishte, po rrënjor i infinitivit të saj. Këta emra në shqipe dalin të përfshirë në emrat e formuar me prapashtesë-mbaresën **-i** dhe kanë qëndrueshmëri përdorimi.

E gjashta, në rubrikën e rezultatit të veprimt (rubrika 5) që i afrohet pothuajse plotësisht konceptit të konkretizimit, siç po shihet nga shembujt përveç emrave më **-im**, dalin edhe emra me prapashtesa e forma të ndryshme. Më poshtë po japim të gjithë shembujt duke i dalluar elementet e caktuara fjalëformuese:

- 1) më **-j/ë** fundore: mësojë, ndërrojë, shkro(n)jë, hutojë rrallojë, kërcëjë, shkarkojë, shtrojë, çojë ose çajë, ngrijë;
- 2) më **-im**: shtrim, kafshim, shkrim, ushqim;
- 3) me **-ë** fundore: pritë, derdhë, nisë;
- 4) me **-esë**: presë, kthesë, trajtesë, shkresë, hutesë, rrallesë, fundërrësë;
- 5) me **-atë**: kafshatë, qëllatë, çallatë;
- 6) me **-së** e **-cë**: frysë, hutosë, kullojsë, ngricë;
- 7) me një të përparme: e mësuar-a, e shkruar-a, e qëlluar-a, e fryme, e preme, e përzieme, e kryeme
- 8) me **-më**: krismë, shtromë, frymë, britmë
- 9) me **-i**, **-shmëri**, **-si**: njohuri, dëshmi, dredhi, fundërrri; prodhimitari çueshmëri, ushqyeshmëri, pritshmëri, prodhueshmëri, ngutësi;
- 10) me prapashtesa të tjera sipas shembujve: **-inë**: *fundërrinë -ore*; *kullore*, *presore*, **-or**: *kullor*, **-irë**: *tretësirë*, **-je**: *tretje*.
- 11) me formime prapavajtëse: *begeni*, *çudi*.
- 12) me pluralia tantumët femërorë të nyjshëm: *të ardhurat*, *të dalat*.
- 13) po në këtë rubrikë i kemi shënuar tre shembuj që në të vërtetë edhe këta janë asnjansë prejpesorë, por të formuar me një arkaike **së**, si:  
*së bërtituri*, *së begenisuri*, *së ngrehuri* etj.

të cilët për arsye të tipareve të veçanta që kanë, ngase përdoren zakonisht në shprehje prejrrjedhore, në punimin tonë, siç e kemi cekur më sipër e do të shohim më poshtë, trajtohen si tip më vete.

## Sipërfundim

Të gjitha këto formime me prapashtesa e forma të ndryshme që pothuajse të gjitha kanë mbështetje në pjesoren e foljes përkatëse si temë prodhuese fjalëformuese bashkëjetojnë dhe nuk rrezikojnë njëra tjetrën, ngase i kanë të specifikuar nënfushat semantike që mbulojnë, ndonëse nuk mohohet as konkurrenca lojale, kur sadokudo prekin kufijtë në nënfushat semantike që mbulojnë, brenda fushës së gjerë zakonisht të abstraksionit, por edhe me elemente dalluese të konkretizimit, prandaj e pranojmë me rezervë dhe vetëm pjesërisht i quajmë të drejta konstatimet e prof. Sh Demirajt, kur thotë se:

*“Në një fazë të caktuar (pas emrave prejpjesorë me -ë, procesi i mbiemrave të nyjshëm erdhi e u bë një nga mjetet kryesoren për pasurimin e klasës së emrave me njësi të reja leksikore” dhe “në krye të herës për këtë qëllim emërzoheshin kryesisht format e gjinisë asnjane të mbiemrave të nyjshëm që ishin më të përshtatshëm për të shprehur nocione abstrakte, po më vonë kur gjinia asnjane u dobësua në ndërgjegjen popullore, atëherë **emrat asnjane të paranyjzuar erdhën e u zëvendësuan pak nga pak ose me format gjegjëse të gjinisë femërore ose me emra të prejardhur prapashtesorë** (Shih: Gram. historike .... f. 157.),*

ashtu si edhe konstatimet e prof. I. Ajetit (vepra e cit. 95) dhe të tjerëve, ngase ne nuk e shohim aq të mënjanuar as të zëvendësuar asnjanesin prejmbiemëror (as atë prejpjesor), sepse, siç u provua prej nesh, emrat e tillë nuk u zëvendësuan, por dolën të specifikuar. për të shprehur vetëm një pjesë të nocionit të gjerë të abstraksionit që, si të themi, e ndanë përpjesëtimisht atë fushë, qoftë me emrat e nyjshëm femërorë, tipi **e mira të mirat**, qoftë, me emrat e prejardhur me prapashtesim, tipi, *mirësi mirësitë* me të cilët bashkëjetojnë sot e gjithë ditën në harmoni relative, duke u specifikuar për të shprehur konceptin që ka të bëjë me cilësinë, gjendjen ose të qenët të procesit përkatës.

Gjithashtu edhe mendimin tjetër të prof. Sh Demirajt që ka të bëjë ekskluzivisht me prejpjesorët e tipit **të bërë-t**, tip ky i cili sipas tij:

*“ka ardhur duke u mënjanuar gjithnjë e më shumë pas krijimit të formave të pashtjelluara të tipit për të bërë, me të bërë, një të bërë, duke u zëvendësuar kështu ose me emra prejfoljorë prapashtesorë, ose me formën femërore të emrave prejpjesorë të paranyjzuar. Natyrisht në rastin e fundit ka ndikuar edhe dobësimi i gjinisë asnjane”.* (Shih Sh. Demiraj, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1988, f. 1009.),

pjesërisht e quajmë të drejtë, ngase edhe asnjanesin prejpjesor nuk e shohim të zëvendësuar, madje as aspak të dobësuar ose të rrudhur tek format e pashtjelluara foljore të sipërcekura, ngase pikërisht asnjanesi prejpjesor sipas nesh del i ndërlikuar qëndrueshëm për nënfushën e qartë semantike të formave të tilla si dhe për rastet që kanë të bëjnë me konceptin primar të veprimit, por pa e përjashtuar tkurrjen a spostimin për nivele a nënfushë tjetër të caktuar kuptimore po në kuadër të fushës së gjerë të abstraksionit, siç u sqarua më sipër me shembuj konkretë prej nesh.

Po ashtu edhe mendimin e prof. A. Kostallarit, kur thotë se:

*“Shqipja e sotme letrare njih vetëm tipin e paranyjzuar të emrave asnjane si tip veprues si: të dalët të ecurit, të ftohtët, por ...(sipas tij) “edhe ky tip po*

*rrudhet dhe po përvijohet ndaj një sistemi njëgjinator me ndarje dihotimike në emra mashkullorë e femërorë. Vendin këtyre emrave **po e zënë** në shkallë të gjerë emrat foljorë me -im dhe -je. Kjo është një prirje ligjësore e shqipes së shkruar që nga Rilindja e këtej, (Shih Studime mbi leksikun... III, Tiranë 1980, f. 22.)*

pjesërisht e quajmë të drejtë. E marrim me rezervë pjesën që ka të bëjë “zëvendësimin shkallë - shkallë” etj., ngase faktet tregojnë se kjo rruhdje që nga Rilindja e këtej, madje edhe më përpara, vlen vetëm për tipin e asnjansve të mirëfilltë (primitivë) të paparanyjzuar, dhe jo edhe për dy tipat e tjerë. Është e vërtetë se si në burime të caktuara, por më fort këtë e vërteton realiteti ynë ligjërimor, sepse aktiviteti i asnjansve të tillë të paranyjzuar asesi nuk ka pushuar së vepruari që nga Rilindja e këndej, andaj gramatikanët a standardologët e sotëm këtë fakt të pamohueshëm, duhet ta kenë parasysh dhe ta zbardhin më mirë.

Vetëm kështu, duke e respektuar të vërtetën në mënyrë normale mund të arsyetohet përdorimi i formave të caktuara të tri a katër formave ndërtimore dhe njëherazi qartësohet rruga se nga secila pjesore ose mbiemër mund të përftohen emrat përkatës e në këtë kuadër edhe ai i asnjansve paranyjzorë, të cilët duke qenë të pozicionuar në mbulimin e nënfushës përkatëse të veçantë semantike patjetër kanë dhe do të kenë edhe të ardhme.

Së fundi, po përsërisim sqarimin tonë se asnjansit **prejpjesorë e prejmbiemërorë** mbesin të qëndrueshëm për të shprehur *konceptin e veprimit*, por jo edhe emërtimin e *vetë veprimit* ose të *rezultatit të veprimit*, aq më tepër, kur këto koncepte ndërkohë janë mbuluar me emra tipash të tjerë, kryesisht me emra të prejardhur, ashtu siç është cekur nga profesorët tanë të nderuar: Sh. Demiraj, A. Kostallari, Idriz Ajeti e të tjerë.

Prandaj njohja e një fakti të tillë rreth diferencimit dhe bashkëjetesës së asnjansve të paranyjzuar me sinonimet përkatëse do të shërbejë sigurisht për të mirë të zhvillimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të gjuhës sonë sipas stileve përkatëse funksionale, por njëherazi do të ndihmojë e sforcojë dukshëm ballafaqimin me sukses të gjuhës sonë me gjuhë të tjera.

Pra, patjetër lypset riinterpretuar dhe qartësuar disa konstatime, ngase me të vërtetë asnjansit në nënfushën e procesit të veprimit dhe të rezultatit të veprimit, mund të thuhet se e kanë humbur luftën e konkurrencës, po ata kanë gjetur jetë në një nënfushë tjetër të përafërt dhe aty me forca të akumuluar e ruajnë identitetin e vet, vetëvetësi kjo që do të sqarohet dhe përforcohet edhe më mirë në kreun vijues.

## V. KONSTATIME TË TJERA PLOTËSUESE RRETH IDENTITETIT TË ASNJANËSVE TË PARANYJËZUAR

Në këtë krye të punimit do të bëjmë fjalë: së pari, diçka-diçka rreth përplotnisë së identitetit formal gramatikor të asnjansve dhe së dyti, rreth identitetit semantik plotësues të asnjansve në raport me sinonimikë të tjerë.

### 1. Rreth identitetit formal gramatikor

Siç e pamë gjatë analizës të tre tipat e asnjansve (asnjansit e mirëfilltë primitivë, prejmbiemërorët dhe prejpjesorët) e tregojnë identitetin e vet edhe nga ana formale kundrejt trajtave të dy gjinive të tjera, dallim ky që shihet në bazë të nyjë-mbaresës shquese të emërores në numrin njëjës e shumës: as. **-t(ë)-it**, ndaj m. **i,u** dhe f. **-a, -ja**, fakt ky që do të shihet më qartë nga nyjë-mbaresat në raportin ndërgjinisor dhe nga pjesëza paracaktuese dhe nyja e përparme.

#### a) Raporti ndërgjinisor: asnjans/mashkullor/femëror

Raporti i nyjë-mbaresave të shquarsisë për të tria gjinitë, sipas numrit njëjës e shumës (ose *nj/sh*) del kështu:

	nj/sh	nj/sh	nj/sh
1. as.	ujë-t - krye -t -	m. ujë-i - krye kreu /krerët (krena-t) -	f. - ujëra-t(?) - -
2.	të mirë-t -  të gjallë-t -	i mirë-i /të mirë-t  i gjallë-i/ të gjallë-t (të gjall-it!?)	e mirë-a /të mira-t  e gjallë-a /të gjalla-t
3.	të prerë-t - (të prenët a të premët) të folur -it - (të folurët?, të folunët) të folët	i prerë-i /të prerët (të prerit ? të premit a të prenit) i folur-i /të folurit	e prerë-a/ të prerat  e folur-a /të folura-t

**Shënim:** Sipas shembujve të mësipërm pranohet se asnjansi në gjendjen e sotme nuk ka shumës. Shumësi i rastit ujët ose uji del në gjininë femërore: ujnat/ujnat. A do të diferencohet apo jo, siç u cek më sipër, njëjësi i asnjansit me -ËT të rastet e asnjansve të paranyjzuar ndaj shumësit mashkullor më -IT, mbetet çështje e hapur. Rasti *të folët* del trajtë e përfutur nga pjesorja e shkurtër folë (me folë), mundësi kjo që ofrohet si rezervë e hapur

## b) Raporti nyjë-përcaktuese e përparme joshquese ndaj emrit të gjinisë përkatëse

Edhe sipas nyje-mbaresës së përparme përcaktuese: në njëjës in e pashquar: *nj/ata*, *një/këta* + emri asnjanes ose *ky këta* + emri mashkullor ose *kjo këto* + emri femëror, del sheshazi identifikimi i asnjanesit, si p.sh.:

- |        |                                      |                 |                                      |                 |                               |
|--------|--------------------------------------|-----------------|--------------------------------------|-----------------|-------------------------------|
| 1) as. | <i>nj/ata</i> ujë-t (të ftohtë)      | m.              | <i>ky</i> ujë(i ftohtë)              | f.              | (ca) <i>ujëra</i> (të ftohta) |
|        | <i>nj/ata</i> , <i>një/këta</i> krye |                 | <i>ky</i> krye (disa) krerë krena(!) |                 | -                             |
| 2)     | <i>një</i> të mirë                   | (një)           | <i>i</i> mirë të mirë                | (një)           | <i>e</i> mirë (ca) të mira    |
|        | të gjallë                            | <i>i</i> gjallë | të gjallë                            | <i>e</i> gjallë | të gjalla                     |
| 3)     | të prerë                             | <i>i</i> prerë  | të prerë                             | <i>e</i> prerë  | të prera                      |
|        | të folur                             | <i>i</i> folur  | të folur                             | <i>e</i> folur  | të folura                     |

Krahaso përcaktorin **një** ose **disa (ca)** bashkë me nyjën e përparme në trajtën e pashquar :

as. **një të ..** m **një i** ose **disa të ...** f. **një e** ose **disa të...**

Trajta e shumësit të asnjanesit, pra, del e shkrirë në një rën nga dy gjinitë aktive.

## c) Raporti asnjanes/mashkullor sipas nyje-mbaresës shquese

Siç e pamë edhe nga disa shembuj nga nënpikat e pikës a) raporti asnjanes/mashkullor sa i përket nyjë-mbaresës së shquarsisë dilte në disa shembuj i përbashkët e në disa me dallime ose me prirje dallimi ndër gjinior, si p.sh: **-ët** njëjës i gjinisë asnjanesë, ndërsa **-it**, nyjë-mbaresë e shumësi të gjinisë mashkullore. Një ndarje e tillë kërkohet të shtrihet, edhe për disa tipa të pjesoreve nga foljet me tog zanor, si b.f. të krahasohen trajtat: **të shkruarit, të kryerit, të shkëlqyerit, të zhgënjyerit, të ushqyerit, të punuarit**, të ndierit, *të përzierit(!)*, në një rën anë me *të shkruarët, të kryerët, të shkëlqyerët, të zbardhëlyerit, të punuarët, të ndierët, të përzierët.*, në anën tjetër. Trajatat e bollduara (të nxira) prej nesh janë të normëzuara e ato të tjerat jo ose nuk dalin të shënuara në burimet përkatëse.

Në të vërtetë, trajtat me **-ËT** jo me **-IT** fundore i ndeshim sporadikisht në burime të caktuara edhe sot, por në mënyrë të dukshme i ndeshëm në veprën e prof. Seman Rizës *të folunët, të trupsuenët, të mishnuemët, të lëndësuenët, të lanët, të padrejtët* e ndonjë tjetër. (Shih. S. Riza Vepra 1, ASHAK, Prishtinë 1996.) Edhe nga prof. I Ajetri është përdorur një formë e tillë, si p.sh. *të shkruemËt* etj. (Shish: edhe te R. I. "Në gjuhë" dhe "për gjuhë", Pejë 1998 f. 133). Ndërsa nga Fjalori i Mehmet Elezit (2006) dalluam këto dy trajta: *të panët, të prunët*.

Kjo çështje, siç u tha, mbetet e hapur. Për mendimin tonë një mundësi e tillë dallimi në të shkruar, duke e specifikuar nyjë-mbaresën përkatëse, në raportin ndër gjinisor **asnjanes/ mashkullor (-ËT/-IT)**, është e mundshme dhe mund të jetë funksionale.



## 2. Rreth identitetit semantik plotësues të asnjansve në raport me sinonimikë të tjerë

Siç e pamë gjatë analizës vetëvetësia a identiteti i asnjansve të paranyjzuar (prejmbiemërorë dhe prejppjesorë) karakterizohet jo vetëm me prejardhjen e tyre, por edhe me nënfushën përkatëse të specifikuar semantike që mbulojnë në kuadër të fushës së gjerë të abstraksionit, nënfushë kjo, e cila dallohet qartë kundrejt nënfushave të tjera që mbulojnë emrat e dy gjinive të tjera po në kuadër të asaj fushe. T'i rikujtojmë përkimet dhe dallimet në raportin asnjans prejmbiemëror me emrat femërorë me paranyjzim (tipi *e mira*) ose me prapashtesim (tipi *mirësia*) ose asnjansin prejppjesor me emrat e veprimit me prapashtesat -im e -je, ngase këta, emrat e gjinive aktive femërore e mashkullore, siç u tha më sipër, janë të pajisur dukshëm me elemente konkretizimi në krahasim me asnjansit përkatës të paranyjzuar që mbesin si me thënë parësorisht në fushën e abstraksionit

Sidoqoftë, përveç asaj që u tha më sipër, identiteti i asnjansit të paranyjzuar në fushë të abstraksionit del i pacenueshëm edhe sipas disa kriterëve e veçorive të tjera, fakte këto që edhe më mirë e ndriçojnë specifikën e asnjansve të paranyjzuar dhe, me sa dimë, këto specifika a raportet sinonimike semantike të ndërsjella nuk dalin aq të prekura e jo më të trajtuara me gjerësinë e duhur në studimet e deritashme mbi këtë temë. Ndërkaq, identiteti i asnjansve, sidomos i prejppjesorëve del i identifikueshëm edhe në situata të tjera që ne po i trajtojmë në vijim në disa pika sipas këndvështrimeve të tjera plotësuese dhe gjithsesi në raport me sinonimikë të tjerë përkatës:

E para, kuptimi i asnjansve prejppjesorë në sistemin emëror, siç e provuam paksa në kreun e mëparshëm, mund të krahasohet me kuptimësinë e **paskajores së mirëfilltë** (me+ppjesore) të sistemit foljor. Siç dihet me paskajoren e mirëfilltë shprehen kuptime abstrakte kryesisht përgjithësuese në krahasim me mënyrat e tjera me të cilat shprehen kuptime më të veçanta, d.m.th. gjithnjë e më konkretizuese. Është e vërtetë se edhe me asnjansin prejppjesor, siç e pamë, shprehet një nocion pak a shumë i ngjashëm me atë të paskajores së mirëfilltë. Kur themi kështu kemi parasysh se edhe tek asnjansit e paranyjzuar, sidomos te prejppjesorët në kohën tonë po abstraktohet jo vetëm gjinia, duke u rrudhur në gjysmëgjini, por edhe numri i rasave, i cili po reduktohet ose po ngushtohet më fort vetëm në dy rase të veçanta të njëjësit të shquar (emërore e kallëzore) si trajtë mbizotëruese a si koncept abstrakt jashtëkohor, ta quajmë kushtëzimisht kështu. Ngjashëm me këtë ndodh edhe me paskajoren e mirëfilltë, ku del i përjashtuar numri, gjinia dhe disa nuanca të qarta kohore. Është e vërtetë se në situata të caktuara të ligjërimeve të gjuhës sonë në vend të asnjansit mund të përdoret paskajorja e mirëfilltë ose anasjelltas. Siç e pamë gjatë analizës zëvendësimi i ndërsjellë logjikisht del i pranueshëm dhe semantikisht i lejueshëm. Dhe për të vërtetuar këtë që e thamë, d.m.th. kulmin e ndërkëmbimit reciprok të këtyre dy mjeteve shprehëse **asnjans prejppjesor / paskajore e mirëfilltë** po e ilustruam më poshtë me dy shembuj::

- 1) *Procesi të shkruarit* ose *të shkruarët do të thotë me shkruet*, ose **Të folurit a të folurët a të folët do të thotë me folë**, e kështu me radhë, ose anasjelltas:

- 2) *Folja me shkrue nënkupton të shkruarit ose me folë nënkupton të folurit a të folët.*

Gjithsesi ndërlidhja reciproke e këtyre dy formave nuk mund të mohohet.

E dyta, siç u provua në punimin tonë para se të shprehet rezultati, qoftë i veprimit, qoftë i cilësisë, të gjendjes a të qenit si ide, qëndron a zhvillohet një proces jo i thjeshtë, por mjaft i ndërlikuar, i cili si realitet shprehet mjaft natyrshëm me fjalë-shenja tashmë të ravijëzuara në gjuhën tonë, siç u tha, qoftë me asnjësin e paranyjësuar, qoftë me paskajoren e mirëfilltë me + pjesore, pra, qoftë nga çdo folje e rëndomtë, qoftë edhe me trajtat e foljeve ndihmëse: me qenë +... ose me pasë + ...

*“Emrat prejpjesorë asnjës, shkruan prof. Sh Demiraj,- e kanë ruajtur mjaft lidhjen kuptimore me foljet përkatëse e kjo u ka dhënë mundësi atyre të marrin edhe kundrina të drejta e rrethanorë që janë gjymtyrë plotësuese karakteristike për foljet; të ngrënë bukë; të hyrët brenda”* (Shih Gram. historike.... f. 992.),

shprehje këto, të cilat, siç konstatojmë edhe ne, me ndonjë nuancë kuptimore fare të vogël mund të zëvendësohen mjaft natyrshëm me paskajoren e mirëfilltë: **me ngrënë bukë; me hy brenda.**

Sipas kësaj mënyre mund të shkëmbehen edhe shprehje të tëra frazeologjike. Së këtejmi, me hy pakëz më thellë në sinkroni del se shprehjet me paskajoren e mirëfilltë mund të përdoren në disa versione e farë fjalish dhe me forma të tjera me të cilat shprehen situata me elemente konkretizimi, por, gjithsesi, karakteristikë e saj themelore (e paskajores së mirëfilltë) mbetet, vetëm për vetëm, të shprehurit e koncepteve abstrakte, pikërisht ngjashëm siç mbetet edhe karakteri i koncepteve abstrakte të asnjësit të paranyjësuar të ditëve tona.

Po sjellim edhe dy shembuj konkretë nga përditshmëria jonë:

1) *S'ka rrugë tjetër vetëm të shpërngulurit e tyre ose S'ka rrugë tjetër vetëm me u shpërngulë ata.*

2) *Të pavarësuarit ishte rruga dhe qëllimi ynë. ose Me u pavarësue ishte rruga dhe qëllimi ynë.*

Si duket këto dy forma: asnjësi prejpjesor e paskajorja e mirëfilltë me + pjesore, janë formëzuar kuptimisht në atë kohë kur gjuhës shqipe i janë nevojitur forma të reja për të shprehur koncepte abstrakte, ndonëse paskajorja e mirëfilltë mund të ketë moshë më të hershme. Sidoqoftë, këto dy forma i bashkon nënfusha e abstraksionit të lartë.

Mirëpo, meqë në letrarishten e sotme të gjuhës sonë, si duket, e mbështetur në kontekst të ngushtë (zyrtar) më tepër në fushën praktike të konkretizimit pa u thelluar edhe në fushën kuptimore të abstraksionit, u lanë nën hije të normëzimit ose u anashkaluan pikërisht të dy format e përmendura prej nesh, duke mos u dhënë vendi i merituar në kuadër të normëzimit, qoftë, paskajores së mirëfilltë, qoftë edhe asnjësit të paranyjësuar, trajtat e nënvizuara prej nesh tek shembujt e mësipërm të pikës së parë praktikisht dalin të zëvendësuar me barasvlerës të tjerë të pajisur me më shumë elemente konkretizuese se ata që i shënuam fillimisht. Te ne, rëndomë nuk po përdoret përkatësisht

as *me u shpërngulë*, ose *me u pavarësue*, madje as *të shpërngulurit* as *të pavarësuarit*, por emrat sinonimikë të prejardhur përkatës: *shpërngulja*, *pavarësia si p.sh.*:

S'kishte rrugë tjetër vetëm **shpërngulja** e tyre ose

**Pavarësia** ishte rruga dhe qëllimi ynë.

Pra, mesazhi shprehet po me emra abstraktë, por këta, siç u përpoqëm ta tregojnë ne, ngase me fjalë-termat e prejardhur *shpërngulja*, *pavarësia* procesi i veprimit përkatës del më i formëzuar me elemente konkretizimi të veprimit ose të rezultatin e veprimit në krahasim me dy format e sipërshënuara. Kjo, madje mund të jetë arsyeja që më fort parapëlqehet në stilin përkatës fjalë-termi **pavarësia** se prejppjesori **pavarësimi**.

Ta kemi të qartë ne nuk kontestojmë ligjshmërinë trajtave të fundit, por as trajtat e mësipërme nuk i kundërshtojmë, të cilat e kanë vendin e vet në kontekste të caktuara. Natyrisht, aty ku shprehen koncepte të abstraksionit më të lartë ato fjalë (të shpërngulurit, të pavarësuarit) duhet të përdoren pa ndonjë ngurrim, ngase dhe në këtë kompleks identiteti i asnjansit të paranyjzuar del mjaft i dukshëm.

E treta, dihet se pikërisht forma e asnjansit të pashquar ndërkohë ka shërbyer për të formuar trajtat e pashtjelluara të foljes, siç janë: paskajorja ashtuquajtur e dytë: **për të punuar** (për + pjesore e nyjzuar ose e asnjansuar) e dy format e tjera a) të tipit: **me të punuar** (me + pjesore e nyjzuar ose e asnjansuar) dhe b) **një të punuar** (një + pjesore e nyjzuar ose e asnjansuar) Edhe dukuria e shprehur me këto forma tregon qartë vetëvetësinë a identitetin e asnjansit në funksion të një veçorie formëformuese të një abstraksioni gjithashtu të lartë.

E katërta, asnjansit e nyjshëm me ndonjë singularia tantum i lidh kuptimi, ndërsa me pluralia tantumët i lidh forma e shumësit, e cila, në të vërtetë, tashmë i takon gjinisë femërore. Sidoqoftë, këto veçori i japin tërthorazi identitetin asnjansit më tepër se çdo trajte tjetër brenda sistemit emëror. Në të vërtetë, edhe nga ky fakt del në pah specifika identifikuese e asnjansëve të paranyjzuar

Sidoqoftë, për të pasur njohuri më të plotë rreth kësaj pike po njoftojmë lexuesin e nderuar se në FShS (2002) zakonisht **paranyjëzorët**, qoftë si *pluralia tantumë*, qoftë të *përzier* (njëjës e shumë), qoftë si *singularia tantumë* dalin në gjininë gramatikore femërore dhe nuk mashkullorëzohen dot dhe se numerikisht përfshirja e tyre në këtë burim është si vijon: pluralia tantumë të tipit: *të dhemburat*, *të fshirat* dalin mbi 30 shembuj, trajta të *përziera* njëjës e shumë, tipi *e bardhë të bardhat*, *e dashur të dashurat* mbi 60 shembuj, ndërsa singularia tantumë të tipit: *e tashme e tashmja*, *e djathtë e djathta*, *e veçantë e veçanta etj*, sillen rreth 20 -shit.

E pesta, edhe asnjansit e tipit *të pasurit*, *të pandehurit*, *të ftuarit*, *të lumturit* që në **emëroren e njëjësit të shquar** marrin një-mbaresën **-it** me emrat e nyjshëm mashkullorë (prejppjesorë e prejmbiemërorë: *i pasuri të pasurit*, *i pandehuri të pandehurit*, *i ftuari të ftuarit*, *i lumturi të lumturit*), *i lidh forma*, *jo me njëjës*in e shquar, por me trajtën **e emërores të shumësit të shquar**, por i ndan kuptimi kategorial, veç atij *njëjës/shumës* edhe ai diatezor: *vepror / pësor*.

Ja si shpjegohet dallimi i mbiemrit të emëruar **i dituri të diturit** ndaj asnjansit **të diturit** në FGJSH 2006, f. 191:

**I dituri, të diturit** m. - ai që di shumë, dijetar.

**Të diturit** as. - mundësia për të ditur diçka;  
gjendja kur di diçka.

Siç po shihet, karakteristikat dalluese që i përmendëm më sipër dalin mjaft qartë në formulimin e mësipërm. Sigurisht, teksti i shpjegimit të asnjësit mund të ishte formuluar edhe më ndryshe, por edhe kështu si është, bie në sy shpjegimi se tek asnjësi me emrat abstraktë ceket *mundësia* dhe *gjendja* etj. Sidoqoftë, nga konteksti dallohen mjaft mirë nocionet e dy fjalëve (ndonëse të formuar mbi temë të së njëjtës temë motivuese fjalëformuese): emrit të paranyjzuar, të përgjithshëm të gjinisë mashkullore, njëjës e shumës, ndaj emrit të gjinisë asnjëse, vetëm në trajtën e njëjësit të shquar.

Megjithatë, siç u përsërit disa herë prej nesh, nëse gramatikanët, përkatësisht standardologët tanë e shohin të nevojshme dhe të arsyeshme mund të zbatohet një sugjerim yni, që nuk është i papërkapshëm: *asnjanësit me marrë nyje-mbaresën -ËT*, si b.f.: *të pasurët, të pandehurët, të ftuarët, të fortët, të lumturët, të diturët*, e kështu me radhë, ndërsa emrat e tillë të njerëzve (frymorëve) në shumësin e shquar të gjinisë mashkullore me e riejtë nyje-mbaresën *-IT*: *të pasurit, të pandehurit, të ftuarit, të fortit, të lumturit, të diturit*, e kështu me radhë.

Lidhur me këtë lypsen sqarime edhe më të hollësishme. Këtë rast po shtojmë edhe këto të dhëna anësore, por që nuk janë pa interes. Emrat e tillë në gjininë mashkullore të regjistruar në FShS 2002 për nga numri dalin më shumë se asnjësit mbi të njëjtën temë fjalëformuese, kështu si trajta përfaqësuese të gjinisë mashkullore, tipi: *i pasuri të pasurit* i ndeshëm mbi 30 raste, por sipas gjedhes shumimi i tyre, varësisht nga konteksti, mund të jetë i pakufizuar ashtu si edhe numri shembujve të asnjësesve mbi të njëjtën temë prodhuese.

Prandaj, për ta pasur edhe më të qartë këtë çështje po japim në vazhdim pasqyrëskemën me nga dy shembuj karakteristikë (për dy tipat e asnjësesve të paranyjzuar), duke tërhequr vëmendjen në një-mbaresën përkatëse për secilen gjini:

### Skema e dallimeve ndër gjinisore sipas nyjës së përparme dhe të një-mbaresës së shquarsisë

Numri	N ë n f u s h a s e m a n t i k e		
	abstrakte	konkrete	abstrakte
1. njëjës shumës	as. të mirë-t -	m. i mirë-i të mirë-t	f. e mirë-a. të mira-t
ose			
2. njëjës shumës	të folur-it -	a të folur-ët i folur-i të folur-it	e folura ?
ose			
3. njëjës shumës	të ditur-it -	a të ditur-ët i ditur-i të diturit	e ditur-a ?

Siç po shihet, siç u cek edhe më sipër, njëjësi i pashquar merr nyjën *një*, prandaj le të krahasohen trajtat e njëjësit të asnjësit me ato njëjës e shumës të mashkullores në shembuj-fjalitë e mëposhtme:

1) Ma bëj *një të mirë* o ti njeri i mirë.

2) Ma bëni një të mirë o ju njerëz të mirë.

Pra, siç po shihet ndërtimisht nyja e njëjësit të asnjësisë formalisht ka homofonë, jo me njëjës, po me trajtën e shumës të gjinisë mashkullore, po kjo semantikisht nuk paraqet kurrfarë problemi në kontekst, ngase asnjësi ka të bëjë me nënfushë abstrakte veprorë që nuk i afrohet në asnjë mënyrë konkretes, ndërsa emri në mashkullore, zakonisht ka të bëjë me emërtimin e njeriut si emër i përgjithshëm, që lidhet domosdo me konkretin dhe ka kuptimësi *pësore*. Prandaj, mund të thuhet se trajtat e tilla nuk mund të paraqesin assesi homonimi të vrazhdët me ndikim oponence për të rrezikuar zhdukjen e njëra - tjetrës nga ana përmbajtësore, por kur është fjala tek ana formale, një dukuri e tillë nuk mund të quhet e padiskutueshme ose aq e papërfillshme. Ky është shkaku që ne propozuam që asnjësi me marrë një-mbaresën *-ë/t*, ndërsa shumësi i mashkullores me *-i-* anapetike, *-i/t*, siç po përsëritet herë-herë në punimin tonë.

E gjashta, asnjësi del si forma më e përshtatshme (në letrarishten e sotme) për të sqaruar kuptimet e fjalëve të caktuara si p.sh

dekretim do me thënë të caktuarit (caktimi!/ me caktue) me vendim zyrtar në një detyrë,

tatuazh	–	të vizatuarit (vizatimi!/ me vizatue) në lëkurën e njeriut,
shfrim	–	të nxjerrët (nxjerrja!/me nxjerrë) e duftës,
virgjër	–	të qenët (qenie!/me qenë) i padjallëzuar,
shtegtim	-	të ikurit (ikja!/me ikë) në një vend tjetër,
mikpritje	–	të priturit (pritja/me pritë) e mikut me përzemërsi,
frymëmarrje	–	të marrët frymë (marrje frymë/me marrë frymë),
frymëzënie	–	të zënë e frymës(zënie frymë/me t'u zënë fryma!) etj.,

prandaj zëvendësimi i asnjësisë me emrat sinonimikë prapashtesorë në kllapa me pikëçuditje, për mendimin tonë, siç u argumentua deri tashti prej nesh, nuk është aspak i drejtë për dy arsye:

së pari, sepse emrat e tillë, siç u cek disa herë, tregojnë diçka të kryer, ndërsa me asnjësisë shprehet koncepti i veprimit kohësisht i papërcaktuar, koncept ky që megjithatë karakterizohet me një shtrirje të lehtë semantike (që mund të jetë një nocion që shpreh nën hije, një diçka të kryer ose në kryerje e sipër, por jo vetëm një veprim të kryer, siç shprehin tipat e emrave të tjerë me trajtat e veta, qoftë të gjinisë mashkullore, qoftë të asaj femërore) dhe

së dyti, me një zëvendësim të tillë përkatës polisemantik, duke e përjashtuar asnjësinë, varfërohet dukshëm (pa kurrfarë kompensimi e arsyeje) të shprehurit përkatës i gjuhës shqipe, ngase asnjësi edhe në gjendjen e sotme përmban shumë elemente të njohura pozitive të trashëguara dhe me shumë vlerë në të mirë të të shprehurit më të qartë e më të plotë të koncepteve, zakonisht nga fusha abstrakte, pa i munguar edhe shtrirja e lehtë në nënfusha të tjera stilistike. Vlera këto që e njomin të shprehurit shqip po aq edhe më tepër (në raste) seç bëjnë format e tjera të caktuara sinonimike.

Gjithsesi, në shumicën e rasteve zëvendësimi i asnjësisë me paskajoren e mirëfilltë del më natyrshëm se me emrin përkatës të veprimit.

E shtata, edhe kur bëhet fjalë për *valencën* si tipar karakteristik të emrit prejfoljor, asnjësisë e paranyjëzuar prejpjesorë domosdo ofrohen si material i imponueshëm, si

element më i përshtatshëm, prandaj asnjësit e tipit të tillë patjetër duhen pasur parasysh në analizat përkatëse, ngase pikërisht këta, madje më tepër se emrat e veprimit me prapashtesat **-im, -je** ose me **-esë, -si,** etj., shprehin nocione abstrakte dhe bartin në vete *struktura argumentale*, sepse nga të gjithë emrat prejfoljorë, asnjësit prejpjesorë të paranyjësuar, nga pikëpamja e tipareve të brendshme që kanë, janë më abstraktë se të tjerët. Siç e pamë pikërisht emrat asnjës të paranyjësuar si emra me valencë të theksuar këmbëshin kuptimisht me foljet (paskajoren). Krahaso edhe njëherë, raportin **paskajore e mirëfilltë/ asnjësi prejpjesor**, ku të dyja kategoritë gramatiko-sintaksore, si të thuash, i lidh konkretisht e njëjta bazë *argumentale*, prandaj edhe nga ky këndvështrim konstatimi që dhamë më sipër për paskajoren del i drejtë.

Duke bërë fjalë për këtë temë, studiuesi ynë i mirënjohur Thoma Dhima, ndonëse nuk i kishte në qendër të vëmendjes asnjësit prejpjesorë, po emrat prejpjesorë të veprimit me prapashtesat **-im, -je** e të tjera e zë në gojë edhe kundërvënien folje-emër dhe konstaton mirë kur thotë se *“kjo kundërvënie si nga ana morfologjike ashtu edhe nga ajo sintaksore dhe semantike (tregon) se kemi të bëjmë me forma që vërtet kundërvihen, por që nga ana tjetër hyjnë në marrëdhënie plotësimi me njëra tjetrën.* (Aty f. 324.)

Sidoqoftë, pritet që jo vetëm ky autor, por edhe të tjerë t’i qasen këtij problemi, duke i pasur si objekt qendror pikërisht asnjësit e paranyjësuar, ngase këta u prijnë për nga abstraksioni të gjithë prejfoljorëve të tjerë që bëjnë pjesë në mozaikun e emrave abstraktë dhe ku valenca është më e dallueshme.

E teta, kur kemi parasysh ngurtësimin e asnjësit në shprehje të caktuara, jo vetëm në terma të ashtuquajtur teknikë, por edhe në frazeologjizma e thënie të qëndrueshme, shohim njëfarë ngjashmërie të asnjësit me natyrën e termit të mirëfilltë. I vetmi ndryshim qenësor ndërmjet tyre është se termi përgjithësisht paraqitet si njësi e terminologjisë *me veçori të veçanta sipas nënfushës së caktua konkrete, të shkencës, të artit, të organizimit të punës* etj., ndërsa asnjësi nuk i përket vetëm një njësie të veçantë, sipas fushës së caktuar konkrete, por **një nënfushë të specifikuar në kuadër të fushës së abstraksionit.** Megjithatë, asnjësit si terma mund t’i përkasin çdo fushe të veprimtarisë përkatëse, goftë, të shkencës, të artit, të organizimit të punës etj., kur del e nevojshme me u shprehë koncepte të veprimit të një abstraksioni të lartë. Në të vërtetë, siç mund të ketë përjashtime edhe në terminologji, ngase përkundër parimit që çdo term shpreh vetëm një nocion, ngase edhe te termat në nivel pak më të gjerë në profil, por jo në nënprofil, po ashtu dalin përjashtime, por, përjashtime mund të ketë edhe lidhur me asnjësit. Vërtet, nocioni i asnjësit ndërlidhet me konceptimin e emërtimit përkatës, por ai koncept mund të ketë shtrirje edhe në ndonjë nënfushë tjetër semantike, siç ndodh shpesh që përdorimi nga stili neutral jo të fytyruar, të dalë i shprehur me asnjës edhe në stilin e fytyruar etj.

Sidoqoftë, edhe nga krahasimi i tillë **term/asnjës** sa i përket nënprofilimit rreth një nocioni të vetëm të përcaktuar, duket se ka ngjashmëri. Pra, edhe nga kjo pikëpamje a nënprofil, sadopak, del në shesh në njëfarë dore edhe identiteti i asnjësit.

E nënta, së fundi, si pikë të veçantë në kontekst të identifikimit të asnjësit po e përmendim *raportin: mbiemër prejpjesor / asnjësi prejpjesor.* Ky raport del i trajtuar mjaft mirë në veprën e studiuesit Valter Memisha me titull *“Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe (monografi)”* ( Gjirokastër, 1999),

ku ndër të tjera autori kur thekson aftësinë fjalëformuese të mbiemrave të tillë me anë të konvertimit, ndër emra prejpjesorë të tjerë domosdo përmend emërzimin e tyre si asnjans të tipit prejpjesorë, siç janë shembujt:

*të ardhurit, të hyrët, të menduarit, të vepruarit, të folurit, të qarët, të qeshurit, të kafshuarit, të ecurit, të dalët, të korrurit etj.,*

njëherazi duke sqaruar se:

*“E rëndësishme të theksojmë këtu është veçoria kuptimore dhe lidhja (e tyre) me mbiemrat prejpjesorë. Kuptimi i këtyre mbiemrave gjatë procesit të emërzimit nuk largohet nga ai i foljeve përgjegjëse, ata e bartin bërthamën kuptimore duke shënuar veprim abstrakt, gjendje ose rezultat veprimi, veçan për emrat e gjinisë asnjans. Kur folja përgjegjëse e mbiemrit që emërzohet, është moskalimtare edhe emri e ruan këtë përbërje, si të ardhur, të ecur, të dalë, të hyrë të shkuar etj.”, por “kur folja përgjegjëse e mbiemrit prejpjesor është kalimtare, atëherë edhe emri në gjininë asnjansë përdoret sipas rrethanave me kuptim vepror: të pasurit; me kuptim pësor: të korrurit, të vjelët, të prerët etj.; madje dhe me kuptim vetvetor e mesor: të dashuruarit (si proces), të fejuarit, të martuarit, të ankuarit, të dëshpëruarit, të zemëruarit etj.” (Aty f. 70-71.)*

Edhe pse pjesorja e shqipes ka përgjithësisht kuptim pësor dhe kjo vlen sidomos për foljet kalimtare, pjesorja e foljeve jokalimtare ka kuptim vepror dhe kjo kuptimësi reflektohet si te mbiemri ashtu dhe te asnjansë prejpjesor, por dallimi në raportin **mbiemër prejpjesor / asnjans i paranyjzuar prejpjesor** është tejet i madh, andaj identiteti i asnjansit del i pacenueshëm edhe nga ky aspekt, sepse siç e thekson prof. Shaban Demiraj, ndonëse emrat e tillë “*në origjinë kanë qenë mbiemra prejpjesorë asnjans të substantivuar, por nga pozita e shqipes së re nuk mund të interpretohen veçse si emra prejfoljorë asnjans*” (Aty, f. 70.), sepse ndërkohë asnjansit e tillë kanë fituar të gjitha tiparet leksiko-gramatikore të emrit.

Gjithsesi edhe pse kanë një mbështetje burimore *mbiemrat prejpjesorë dhe emrat prejpjesorë asnjans* kanë identitet të ndryshëm, ngase u takojnë dy klasave, përkatësisht dy pjesëve të ndryshme të ligjëratës.

\* \* \*

Prandaj të gjitha këto veçori dhe ndonjë tjetër, përveç atyre që u cekën gjatë analizës në krrerët përkatës të këtij punimi, siç janë asnjansit e emërzuar nga ndajfoljet e e shprehjet ndajfoljore të formuara nga kategori të tjera leksiko-gramatikore, sidomos ato të rasës rrjedhore me nyjën e përparme së (tipi: plasa së foluri), i japin shtat nga aspekti formal dhe ai përmbajtësor identitetit të asnjansit të paranyjzuar dhe njëherazi, padyshim, shtrojnë nevojën me e ruejtë dhe me e sforcue përdorimin e asnjansit në gjuhën tonë letrare për konceptet përkatëse, sidomos në fushë të abstraksionit.

Është e vërtetë se për të mbuluar pikërisht koncepte abstrakte dolën edhe forma të tjera, qoftë të përgjithësuara me konotacion të ri, qoftë me shkallëzimin e niveleve të abstraksionit si dhe ndërlidhur me nivele të konkretizimit, por asnjansë që tani mbulon konceptin kulmor si nënfushë të veçantë të abstraksionit nuk u trondit dhe, si duket, nuk ka gjasa dhe as që do të ketë rast me u tronditë natyrshëm as në të ardhmen nga asnjëra

nga ato forma sinonimike me të cilat tani bashkëjeton. Pra, diferencimi i niveleve semantike të fushës së abstraksionit në nënfusha përkatëse, nuk dëmton, përkundrazi ndihmon dhe qartëson më mirë nënfushën semantike të asnjësit ashtu siç qartësohen edhe profilimet e formave të tjera sinonimike në gjuhën shqipe.

Pra, meqë edhe në të ardhmen gjuha jonë, si çdo gjuhë e gjallë e një populli të civilizuar në rritje e sipër, gjithnjë e më tepër do të ketë nevojë për të shprehur nocione të llojllojshme si në fushën konkrete e sidomos në atë abstrakte, atëherë si prejpjesorët pandajshesorë, prejpjesorët prapashtesorë, ashtu edhe prejpjesorët e prejmbiemërorët e paranyjësuar të gjinisë asnjëse duhet t'i ruajë dhe t'i kultivojë në bashkëjetesë sinonimike ashtu si edhe tipat e emrave të tjerë. Kur themi *duhet t'i ruajë dhe t'i kultivojë* kuptohet pa e përjashtuar konkurrencën lojale për koncepte të caktuara polisemantike e ndonjë formë tjetër.

Me një veprim të tillë, duke u dhënë vendin e merituar emrave të gjinisë asnjëse në gjuhën tonë standarde, mendojmë ne, do të kontribuohet pa mëdyshje, në të mirë drejt kristalizimit të nënfushave përkatëse semantike e stilistike që mbulojnë emrat sinonimikë, duke i ruajtur ngjyrimet e mozaikut të strukturës përkatëse emërore, pa rrezikuar ekzistencën e njëri-tjetrit.



## VI. ANASHKALIMI I VLERAVE REALE TË ASNJANËSIT NË SHQIPEN E SOTME LETRARE PASOJË E VEPRIMEVE TË NXITUARA, APO JO?

Arritëm në kreun e gjashtë të këtij punimi dhe nuk dimë se e kemi gjetur apo jo, përgjigjen e plotë dhe të duhur në pyetjen pse lindi ky farë keqkuptimi ndaj asnjansve të paranyjzuar që nga vitet e '50 deri nga vitet e '90-a të shekullit të kaluar dhe që në njëfarë mënyre pasojat e një veprimi të tillë ndihen edhe sot?

Ne, siç po shihet nga titulli i këtij kreu, kemi bindjen personale se një dukuri e tillë e anashkalimit të vlerave të asnjansit, është shfaqur, si të thuash, subjektivisht dhe ishte kryesisht pasojë e konstatimeve spontane të nxituara të standardologëve tanë të kohës. Po si dhe pse ndodhi kështu? Si u formëzua dhe si u sendërtua një qëndrim i tillë? Mos vallë, atëbotë, nuk njiheshin mirë vlerat reale të emrave të kësaj gjinie apo jo?

Sidoqoftë, pyetjeve të saposhtuara lidhur me këtë mbase më mirë mund t'i përgjigjeshin standardistët e atyre viteve dhe pasuesit e tyre sot, nëse mendojnë esëll, megjithatë, neve situata e trajtimit të temës ose vetë përmbajtja e titullit që u vumë këtij kreu na imponon që të shprehim mendimin tonë rreth kësaj çështjeje, ashtu siç na merr mendja, madje qoftë edhe guximtarisht.

Natyrisht, e do puna, të tregojmë se ku e mbështesin mendimin tonë, në cilat fakte?

Këtu, pra, pa hyrë thellë në pyllin ende të pashkelur mirë të çështjes përkatëse në shqyrtim, ne përgjigjen tonë e mbështesim në këta tre faktorë:

së pari, në reagimin e E. Xhuvanit, të viteve të '50-a;

së dyti, në zëvendësimin e asnjansit prej pjesor të paranyjzuar me trajta foljore në fjalorin tonë shpjegues FGJSSH të vitit 1980 dhe

së treti, do të ndalemi rreth një konstatimi të nxituar, paksa kundërthënës të prof A. Kostallarit.

Të shohim tani radhazi pak më në hollësi rreth përmbajtjeve të fakteve të sapocekura prej nesh lidhur me temën në shqyrtim

### 1) Çka mësojmë nga reagimi i prof. A. Xhuvanit

Prof. Aleksandër Xhuvani, nga fundi i viteve '50 të shekullit të kaluar, duke mos e pëlqyer zëvendësimin e trajtave të asnjansve si: *të ecurit, të ngrënët, të qepurit, të ngrirët, të priturit, të fjeturit* që bëheshin me emrat e prejardhur me -je: *ecje, ngrënie, qepje, ngrirje, pritje, fjetje*, pati reaguar, mjaft fuqishëm, ku veç tjerash pati theksuar si vijon:

*“Duket faqezi se asht ba nji përdorim i tepërm i emnavet abstraktë me prapashtesa e sidomos me prapashtesën -je, tue nxjerrë jashtë emrat prejpjesorë të gjinisë asnjane” dhe më tej konstatonte se kjo dukuri kishte ardhur “nga gjuha e shkrimit e më fort ajo e shtypit të përditshëm, e cila ka marrë nji tendencë theksuese në të përdorunit e emrave abstraktë me -je dhe kjo vjen jo nga shtjellimi historik i gjuhës sesa nga influenca e gjuhëve të hueja neolatine ose sllave, qofshin këto nga të cilat përkthejnë e në të cilat zotëron ky proces i konstruktit sintetik të frazës me emra sufiksorë”.* (Shih: Aleksandër Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980, f. 173.)

Kështu nga ky reagim shpjegues medietues, kuptojmë faktin se dukuria e zëvendësimit të asnjansve të paranyjzuar me emra prapashtesorë *nuk ishte pasojë e “shtjellimit historik”*, d.m.th. nga evoluimi i brendshëm i gjuhës sonë, po vinte nga ndikimi i jashtëm, d,m,th, nga ndikimi i gjuhëve të huaja në gjuhën e shtypit, (pra nga gjuha e përkthimit), ndikim ky formal subjektiv i gazetarëve pa përgatitje të duhur gjuhësore ose siç del nga shpjegimi i tij, se përkthyesit e gazetarët nuk e njihnin aq mirë natyrën e gjuhës popullore dhe kështu të ndikuar nga gjuhët e huaja përkatëse dhënëse këta fushin në përdorim pa kriter emrat sintetikë, me prapashtesim, ndërsa asnjansit (prejpjesorë e prejmbiemërorë) i anashkalonin, vetëm pse ata ishin analitikë, d.m.th. të parashoqëruar me nyjën e përparme që nuk i kishin ashtu barasvlerësit përkatës gjuhët e huaja, sllave e neolatine.

Pra, mendimi i prof. A. Xhuvanit nënkuptohet se anashkalimi me tepri i asnjansve të paranyjzuar bëhej, ngase nuk njihet sa duhej vlera e asnjansve dhe për këtë shkak në gjuhën e gazetave e të përkthimit nuk përfillej natyra e gjuhës shqipe.

Si duket reagimi i prof. A. Xhuvanit nuk e pati ndikim e jehonë të duhur në atë kohë, jo vetëm te gazetarët e përkthyesit, por as tek standardologët e kohës, sepse anashkalimi i trajtave të asnjansve, jo vetëm nuk u frenua, por përkundrazi, ndërkohë u përkrah, jo vetëm nga masmedia, por edhe nga njerëzit autoritarë të institucioneve shoqërore-shtetërore të kohës, përkatësisht nuk u mbështet kërkesa e prof. A. Xhuvanit as nga kuadrat gjuhësorë që aktivisht punonin ose që kryesonin a udhëheqnin veprime lidhur me procesin e konsolidimit, më drejt të njëzimit të normës së shqipes letrare në atë periudhë me plot sfida. Kur themi kështu kemi parasysh hartimin e teksteve shkollore e shkencore të asaj periudhe e më vonë që ndërlidhet me periudhën organizuese të ngutshme dirigjuese para e pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972), kur prof. A. Xhuvani fizikisht nuk ishte më.

## **2) Pasojat nga zëvendësimi i asnjansit prejpjesor me trajta foljore në FGjSSH (1980)**

Si fakt a veprim tjetër me rëndësi me të cilin për pasojë u degraduan nga përdorimi asnjansit e paranyjzuar, sidomos ata prejpjesorë, përveç zëvendësimit me trajta të emrave të prejardhur me prapashtesim asnjansit prejpjesorë me -im, -je, ku duhej e ku nuk duhej, po përmendim edhe faktin se në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980), në vend të asnjansit që praktikohet në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1954) në mbi 1000 raste për shpjegimin e kuptimit të prejpjesorëve edhe të emrave përgjithësisht, tashti në *fjalorin*

shpjegues normativ (1980), nuk përdorej më, sepse në vend të tij futet në përdorim një shprehje tjetër me folje. Konkretisht në këtë formulim të ri. prejpjesori përkatës me prapashtesën **-im** ose **-je** shpjegohet jo me sinonimin në trajtën përkatëse të asnjësit, po me tekstin sqarues: *kuptimi sipas + folja përkatëse* (nga e cila shënohet veta I njëjës e dëftores (veprore dhe pësore).

Në mënyrë që lexuesi ta ketë më lehtë me e kuptue këtë ndryshim formulimi dhe veprimi, po japim në vijim 5-6 shembuj nga të dy burimet, për të njëjtën fjalë, ku shihet se si është bërë konkretisht zëvendësimi i asnjësit nga trajtat përkatëse foljore:

#### 1 Në FGJSH 1954:

GUFIM – të gufuarit

ARNIM - t'arnuarit.

BLERJE - veprimi i të blerit.

GDHENDJE -të gdhendurit.

MBYTJE - të mbyturit.

PRITJE- të priturit.

PËRMIRËSIM - të përmirësuarit, të sjellët në një gjendje më të mirë.

#### 2. Në FGJSSH 1980:

GUFIM – 1. Veprimi sipas kuptimit të foljeve *gufoj, gufohet*.

2. Pjesë e fryrë a e ngritur e diçkaje.

ARNIM - Veprimi sipas kuptimit të foljeve *arnoj, arnohem*.

BLERJE - Veprimi sipas kuptimit të foljeve *blej blihem*.

GDHENDJE - veprimi sipas kuptimit të foljeve *gdhend gdhendem*

MBYTJE - Veprimi sipas kuptimit të foljeve *mbyt mbytem*.

PRITJE - Veprimi sipas kuptimeve të foljeve *pres II pritem II*.

PËRMIRËSIM 1. Veprimi dhe gjendja sipas foljeve *përmirësoj përmirësohem*. 2. Tërësia e ndërtimeve, ndreqjeve.

Për mendimin tonë formulimi në FGJSSH (1980, pa e kontestuar zgjidhjen e tillë sinonimike ndoshta më atraktive, e cila nuk duket se është aq shumë i qëlluar semantikisht sa ta zhvlerësonte a ta rrëzonte tërësisht si të pa vlerë formulimin me asnjësin nga FGJSH (1954). Sigurisht zëvendësimi i tillë kërkon sqarim. Lidhur me këtë mund të shtrohet pyetja: Është marrë parasysh fakti, apo jo, se nga *veprimi i kuptimit të foljes* nuk del vetëm kuptimi i veprimit a i gjendjes së emrave me **-im** ose **-je**, por edhe ai i gjendjes në raste, por sidomos edhe i rezultatit të veprimit etj, por edhe i prejfoljorëve të tjerë, siç janë prejpjesorët pandajshtesorë, asnjësit prejpjesorë e prejmbiemërorë, emrat me *-esë, -si, shmëri* etj., pastaj femërori me paranyjëzim, ai me prapavajtje e të tjerë!? Madje, mund të kërkohet sqarim pse të dyja trajtat diatezore (veprore e joveprore) emërtohen në shumës si me qenë dy folje?! Krahaso tekstin: *Veprimi sipas foljeve...(?)* Po ashtu mund të shtrohet pyetja, edhe pse del përgjigjja e qartë: Një veprim i tillë i zëvendësimit sa la rrjedhojë në pasivizimin e asnjësit, pasi është fjala për mbi 1000 raste?!

Sidoqoftë, sigurisht pyetjet e tilla hapin diskutim, por për mendimin tonë, assesi, nuk insistojmë sot të vënë në dyshim ligjshmërinë e mënyrës së tillë të formulimit. Madje, duke e ndjerë veten jo kompetent as që mendojmë se duhet kërkuar rishikimi e një

përdorimi të tillë sinonimik. Qëllimi ynë është të konstatohet se edhe ky fakt, përveç zëvendësimeve pjesërisht arbitrare, do të ketë ndikuar në një mase jo të vogël në pasivizimin e emrave të paranyjzuar të gjinisë asnjëse. Pra, zvogëlimi i numrit të asnjësve në Fjalorin normativ (1980), do të ketë ndikuar që edhe në kontekste të tjera asnjësi në fjalë të mos e ketë tretmanin e duhur. Për mendimin tonë lidhur me këtë rast-veprim është dashur të jepet sqarimi i duhur, ngase mungesa e një shpjegimi a trajtimi të tillë mendojmë se ka lënë pasoja të konsiderueshme rreth përdorimit të asnjësit në gjuhën tonë standarde, gjë që nuk është punë e pavërejtshme edhe sot.

Po e sqarojmë kalimthi edhe një fakt tjetër. Edhe në Fjalorin e M. Elezit është praktikuar një zëvendësim i tillë i asnjësit, sepse edhe aty prejpjesori shpjegohet me foljen përkatëse, por jo me të tashmen e dëftores, po me trajtën e paskajores së mirëfilltë. Në të vërtetë asnjësi prejmbiemërorë shpjegohet me formulimin “**emërzimi sipas + mbiemri përkatës**, ndërsa prejpjesorët (edhe asnjësi) sqarohen me formulimin “**veprimi sipas + infinitivi: me + pjesore**, d.m.th. shpjegimi bëhet sipas trajtës së paskajores së mirëfilltë, zakonisht edhe këtu me të dyja format diatezore (veprore e pësore), si p.sh:

*Grizatje f.- Veprimi sipas me grizatë me u grizatë*

*Të grizaturit as. Veprimi sipas me grizatë, me u grizatë; grizatje*

ose

*Çermim m. Veprimi sipas me çermue, me u çermue.*

*Të çermuarit as. Veprimi sipas me çermue, me u çermue, çermim.*

Pra, M. Elezi, të dy prejpjesorët sinonimikë abstraktë i shënon veç e veç. Asnjësin dhe të prejardhurin me **-im** ose **-je** i shpjegon njësoj me paskajore, por pas shpjegimit të kuptimit të asnjësit e shton sinonimin e prapashtesorit me **-im** ose **-je**, duke i dhënë kështu njëfarë përparësie prejpjesorit përkatës prapashtesor, ndërsa dy trajtat e foljes nuk i emërton në shumës dhe nuk e përmend fare fjalën *folje* në togfjalësh: Pra jo **Veprimi sipas foljes a foljeve** që praktikohet në Fjalorin e Akademisë (FGjSSh 1980, përkatësisht FSHS (1984, 2006), por vetëm **Veprimi sipas + paskajorja e mirëfilltë**.

Sidoqoftë, pa marrë parasysh faktin se nuk e kontestojmë një zgjidhje të tillë me trajtën a trajtat përkatës të foljes a të foljeve, që praktikohet në fjalorin përkthues normativ, mund të themi se një dukuri e tillë nuk ka ngjarë nga evoluimi i brendshëm i formave të asnjësit të paranyjzuar, por nga *të shpikurit* (!) të një mënyre të re të shprehurit sinonimik, nga hartuesit fjalorit normativ shpjegues të gjuhës shqipe, sigurisht me bindje se kjo mënyrë është zgjidhje më e mirë se shpjegimi me asnjësi.

### 3) Rreth një konstatimi të nxituar kundërthënës të prof. A. Kostallarit

Arkitekti, i pari me emër e mbiemër, ndër hartuesit e *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980), **prof Androkli Kostallari**, pothuajse pas 20 vjet distance nga reagimi i prof. A. Xhuvanit, përkatësisht pas afro 30 vjetësh pas botimit të FGjSh (1954), lidhur me asnjësit riparacet mendimin e vet, duke parashtruar këtë rast edhe të dhëna me interes, të cilat mund të shërbejnë e të shfrytëzohen edhe si përgjigje edhe për çështjen e shtruar

prej nesh, ndonëse ne, siç shihet nga formulimi i nëntitullit e quajtmë *konstatim të nxituar kundërthënës*.

Në të vërtetë, paraqitja e diskutueshme e prof. A. Kostallarit ka ndodhur më 1989, pothuajse 10 vjet pas botimit të FGjSSH (1980), ku asnjësi, vërtet, kishte përfaqësim jo të plotë, të diskutueshëm si nga pikëpamja numerike ashtu edhe nga ajo përmbajtësore. Sido që të jetë, ja tani inserti integral lidhur me çështjen e asnjësve i nxjerrë nga një punim mjaft i gjatë i prof. A.Kostallarit:

*“Në shqipen e sotme letrare nuk mund të flitet më për emra asnjës të panyjshëm si **kategori e gjallë leksiko-gramatikore**. Struktura morfologjike e gjuhës sonë letrare **njeh vetëm tipin e paranyjzuar të emrave asnjës si tip veprues** (emrat prejpjesorë të tipit: **të hyrët, të ngrënë, të menduarit dhe emrat prejmbiemërorë të tipit: të bardhët, të kuqtë, të zitë, të ftohtët**. Kalimi i emrave asnjës (të panyjshëm, d.m.th. i emrave asnjës të vjetër të mirëfilltë të shqipes) si **ballë, brumë, grurë, ujë** etj. në një rën anë në klasat e emrave mashkullorë e ka thjeshtëzuar më tej strukturën morfologjike të shqipes së sotme letrare. Po edhe emrat asnjës të paranyjzuar nga pikëpamja morfosintaksore sot paraqiten si **kategori gjsmasnjës gjysmëmashkullore** (p.sh. thuhet **të ftohtët e dimrit**. E duron të ftohtët. Ka marrë të ftohtë. por **të ftohtë i madh, jo të madh**. E kaluam të ftohtin e madh etj.) Kjo lidhet në radhë të parë **jo me humbjen pothuajse plotësisht të gjinisë asnjës të fjalëve përcaktues** (të mbiemrave, të përemrave dëftorë e pronorë), por me vetë rrudhjen a **shuarjen e kategorisë së asnjësit tek emrat e shqipes**, dukuri që ka sjellë pasojat e veta në gjithë sistemin emëror, pra edhe tek mbiemrat, numërorët e përemrat. **Kjo dukuri ka nevojë të sqarohet më tej me studime të vecanta, duke iu nënshtruar një analizë të thelluar shkencore**. Në përgjithësi mund të thuhet se **me shuarjen e asnjësit në fushën e emrave të mirëfilltë të shqipes** është krijuar sot në gjuhën letrare **një sistem i ri gjinisor me ndarje pothuajse dihotimike, në emra mashkullorë e femërorë**”.*

(Shih: *Studime mbi leksikon...*III, Tiranë 1989 f. 54-55.)

Të vihet re se nga ky tekst i shkurtër i prof. A. Kostallarit, i cili në shikim të parë sipërfaqësor të lë përshtypje se mund të merret si shembull se si me pak fjalë mund të thuhet shumë, por kur hyn në brendi të tij fiton bindjen se aty janë shprehur vërtet konstatime, si të thuash, të përziera, disa të mbështetura mirë, por njëherazi edhe konstatime disi të nxituara kundërthënëse dhe si të tilla dalin edhe të diskutueshme ose jo aq të qëndrueshme.

Ne, pak si tërthorazi, por edhe drejtpërdrejt në konstatimet e tij, shohim çështje kundërthënëse, prandaj kërkojmë nga lexuesi që paraprakisht të përgatitet për t'i vlerësuar sa më drejt këto dy çështje të diskutueshme:

e para, në këtë paraqitje të prof. A. Kostallarit ka apo jo vërtet kundërthënie jo vetëm brenda këtij teksti, por edhe në krahasim me konstatimet e mëparshme të parashtruara ose të miratuara prej tij dhe

e dyta, një qëndrim i tillë, edhe pse paksa i përmjegullt, sa ishte ndikues tek kuadrat pasues ose keqkuptues të mësimëve të tij dhe ato pasoja rreth pasivizimit të asnjësve ndjehen ende sot, apo jo, në shqipen e sotme letrare?

Në vazhdim, po shfaqim, pra, ndonjë vlerësim tonin, siç thuhet: **për e kundër**.

Së pari po përmendim faktin se nga ai insert si anë pozitive parimore që s'mund të mohohet dot, po theksojmë kërkesë-porositë e autorit, shumë me vend, që dukuria rreth asnjansve patjetër duhet t'i shtrohen **një analize të thellë shkencore**. Me një kërkesë të tillë, si të thuash, ai e pranon se kjo temë atbotë nuk dilte e trajtuar mirë, andaj lë vend të vëzhgohet me qëndrim kritik ose të verifikohet edhe qëndrueshmëria e konstatimeve të tij.

Së dyti, po shprehim rezervën tonë, në disa pika e nënpika, rreth disa mendimeve të paraqitura në atë tekst:

E para, që në fillim po theksojmë se konstatimin e tij se: *“në gjuhën e sotme letrare nuk mund të flitet më për emra asnjans të panyjshëm si **kategori e gjallë leksikogramatikore**”*, kemi vetëm një dozë të vogël rezerve, sepse na duket se ai qëndrim mund të kuptohet si fort kategorik, ngase edhe *gjuha e sotme letrare*, kuptohet në domen të ngushtë ka *emra asnjans të ndërlidhur me fjalë e fraza të gjalla*, të cilat janë të pazëvendësueshme si të tilla gjithsesi janë të pranueshme edhe për standardin. Ne kemi e trajtuar sadopak këtë çështje, ndërsa këtu po e shtojmë vetëm një rast. Bie fjala te kjo fjali – periudhë:

*: Me e la kryet me ujët të ftohtë, mendja e zemra të ndiejnë të ngrohtë(!).*

*Emrat kryet dhe ujët* janë asnjans të paparanyjzuar nga emrat e mirëfilltë, të pranuar nga standardi, madje edhe fjala *mendja mendtë* mund të konsiderohet se ende mund të ruajë ndonjë gjurmë a element të emrit asnjans të paparanyjzuar dhe siç dihet këto fjalë, jo vetëm në këtë fjali, por edhe në të tjera, janë të gjalla ashtu siç gjallërojnë edhe disa shprehje frazeologjike e idioma me emra në gjininë asnjansë që e kanë bekimin e standardit.

E dyta, te konstatimi tjetër, kur pranon autori se *“emrat asnjans të paranyjzuar nga pikëpamja morfosintaksore, sot paraqiten jo me humbjen tërësisht të gjinisë, por si kategori **gjysmasnjansë gjysmëmashkullore**”*, nuk mund të quhet mendim i pambështetur, madje nuk mund të kundërshtohet as konstatimi tjetër kur kjo ndërlidhet *jo me humbjen pothuajse plotësisht të gjinisë asnjansë të fjalëve përcaktuese (mbiemrave e të përemrave dëftorë e pronorë)*, po ashtu nuk shprehim aq rezervë as *me vetë rrudhjen*, siç e thotë autori, kur kemi të bëjmë me ndonjë nënfushë semantike, por e quajmë konstatim shumë të diskutueshëm ose të pa menduar mirë kur shprehet *en bloc* për **shuarjen e kategorisë së asnjansit tek emrat e shqipes**. Pra, ky konstatim na duket i nxituar dhe kundërthënës sepse këtu, thuajse harrohet ajo që është thënë dy tre rreshta më sipër nga vetë autori se paranyjzorët (prepjesorët e prejmbiemërorët) quhen siç janë; në të vërtetë, **dy tipa veprues**. Po këtë konstatim rreth tipave veprues e neutralizon edhe më keq në përfundim të insertit, se **“me shuarjen e asnjansit në fushën e emrave të mirëfilltë të shqipes është krijuar sot në gjuhën letrare një sistem i ri gjinisor me ndarje pothuajse dihotimike, në emra mashkullore e femërorë**, duke përjashtuar, apo jo, ose duke mos e përmendur fare lakimin IV, të emrave të gjuhës shqipe, lakim ky që u kushtohet pikërisht dy tipave veprues të asnjansve të paranyjzuar: prejpjesorëve, tipi **të folurit** dhe prejmbiemërorëve, tipi **të ftohtët**. (Shih Gramatikën e Akademisë – morfologjia f 117-118.)

Pra, kjo **dihotimi si sistem** a mund të quhet si e tillë, si punë e mbaruar (!?), siç e thotë ai, “**jo me zhdukjen**” po “**me shuarjen e asnjansit si kategori e gjallë**”, apo jo, kur anashkalohen **dy tipat prodhues e veprues**(?!).

Në kundërshtim me pjesën e mendimin kategorik të prof. A. Kostallarit rreth shuarjes së asnjansit, sidomos atij prejpesor në shqipen standarde, shprehet edhe studiuesja Rosana Rushiti. Në të vërtetë, kjo studiuese, ndonëse nuk e sheh problemin plotësisht me qartësinë e duhur, siç e kemi interpretuar ne, megjithatë nuk bën keq, po bën shumë mirë, kur konstaton se “*ka raste, që emri prejfoljor (asnjanësi prejpesor i paranyjësuar n.v.) i cili e ka më të theksuar kuptimin e procesit është i pazëvendësueshëm*”, sepse, sipas saj, *emrat prejfoljorë prapashtesorë janë përgjithësuar me kuptimin e rezultatit të veprimit.* (Vepra e cit. f. 365.)

Pra, kur koncepti del i pazëvendësueshëm me fjalë të tjera, atëherë vërtet s’ mund të bëhet fjalë për “**shuarjen e gjinisë asnjansë tek emrat e shqipes**”?! as në perspektivë, **sigurisht, jo**, siç i del prof..A. Kostallarit!

E treta, kemi vërejtje edhe rreth shembullit ilustrues të cekur aty: **të ftohtë i madh** ndaj **të ftohtët të madh**, ku atakohet struktura vetëm me një shembull nga tipi i asnjansëve prejmbiemërorë e jo edhe nga ata prejpesorë, ku na duket se profesori edhe këtu del paksa kundërthënës, sepse ai kur përmend **shuarjen** ose zhdukjen (!) ka paryshtë gjithë tipat e asnjansëve, apo jo?! Aandaj lidhur me këtë shembull vërejtjet tona po i shprehim në vijim në këto katër nënpika:

1. Një shembull i vetëm, (një) *të ftohtë i madh* ndaj (një) *të ftohtë të madh*, siç dihet nuk mjafton për t’u kualifikuar një dukuri e tillë si përgjithësuese (së paku jo edhe për prejpesorët) ose të konsiderohet si një punë e thënë e bërë për të gjithë asnjansit prejmbiemërorë), përkatësisht, nuk mjafton që të shpallet kategoria e asnjansit si një kategori jo e gjallë, apo e shuar menjëherë ose e dalë kohe evolucionisht, kur në shqipe ende gjallërojnë katër tipa asnjansish.

2. Ç’është e drejta, njëjësi i mbiemrit të emëruar mashkullor, siç e pamë më sipër, ndonëse i specifikuar a i rezervuar vetëm për emërtimin e njerëzve ose të ndonjë dukurie a një gjësendi konkret mund të jetë dëgjuar si e thënë spontanisht nga ndokush edhe në domen tjetër, si: *njeri i ftohtë / i ftohti (njeri)*, përkatësisht (*na erdhi*) *dimni i ftohtë / i ftohti dimën (na erdhi)*, *i ftohti i madh na ngriu*, por gjithnjë thuhet *të ftohtët e dimnit është i rrezikshëm*. Pra nuk është jashtë logjikes gjuhësore prirja që mund të dëgjohet e shprehur në të dyja trajtat, si b.f. në fjalitë vijuese të tipit:

1) *Nga të ftohtët e madh të dimrit qenë ngrirë edhe njerëz rrugës(!).*

2) *I ftohti i madh i këtij dimri ka ngrirë edhe njerëz rrugës(?).*

Emri *të ftohtët* i fjalisë së parë gjithsesi është emër asnjans në numrin njëjës, shpreh kuptim të përgjithshëm të fushës abstrakte, gramatikisht e normativisht është trajtë e rregullt, i takon lakimit të katërt. Ndërkaq, emri tjetër me të njëjtën rrënjor, në trajtën *i ftohti* (i këtij dimri) është emër i gjinisë mashkullore, po në numrin njëjës, po shpreh një dukuri gjithsesi më konkrete dhe jo përgjithësuese abstrakte si rasti i mëparshëm, normativisht ende, si me thënë, semantikisht nuk e ka mbështetje të plotë normëzuese, ngase është krijim spontan.

Pra, shprehje të tilla mund të jenë dëgjuar edhe në kohën e prof. Kostallarit, siç mund të dëgjohej edhe sot, po kjo nuk do të thotë se rasti spontan me koncept konkret rrezikon zhdukjen e trajtës së asnjansit me koncept abstrakt, sepse sipas studimit që bëmë të dyja rastet të *ftohtët e madh*, emër i gjinisë asnjansë dhe *i ftohti i madh* emër i gjinisë mashkullore, mund të bashkëjetojnë fare natyrshëm në kontekste të caktuara, ngase i kanë të specifikuar nënfushat semantike. Gjithsesi, ndërsa tofjalëshi *i ftohti i këtij dimni*, mund të zëvendësohet me sinonimin: **acari i këtij dimni**, tofjalëshi **të ftohtët si dukuri** nuk mund të zëvendësohet dot, ngase nënfusha e asnjansit si koncept abstrakt mbetet e pambuluar, siç është argumentuar më përpara, po në këtë punim. Edhe këtë fakt duhet ta ketë parasysh standardologu i sotëm. Pra standardologu, për të ruajtur strukturën mozaike të gjallë, ngase ruajtja e tillë është me interes, duhet të tërheq vërejtjen që trajta *i ftohti* mos të përdoret për kuptime ideshë abstrakte, kur për atë nocion tashmë është e normëzuar trajta **të ftohtët**, po nëse del e nevojshme edhe trajta **i ftohti**, nuk përjashtohet të mos përdoret për nënfusha të tjera semantike që karakterizohen me elemente të qarta konkretësie.

Me fjalë të tjera, ne mendojmë se rastet e tillë edhe në tregofshin prirje nuk duhet të na shqetësojnë fare, ngase edhe në këto raste nuk duket se do të ketë zhdukje po bashkëjetesë trajtash, siç u cek më sipër.

Së këtejme, trajta e asnjansit, tipi: **të ftohtët**, si koncept gjithsesi mbetet në nënfushë të përgjithshësuese abstrakte, ndërsa trajta, ta quajmë të re, **i ftohti** i gjinisë mashkullore shpreh një si koncept, pak a shumë individualizues, jo abstrakt, po gjithsesi të ndërlidhur me konkretizim.. Pra dallimi i tillë nëse sqarohet mirë gramatikisht raporti **abstraktizim / konkretizim**, atëherë me siguri, nuk do të ketë zhdukje, po pasurim strukturash sinonimike gjuhësore.

Ne u ndalëm paksa më gjatë rreth kësaj dukurie që syri i mprehtë i profesor Kostallarit e ka hetuar mirë, por ai në paraqitje nuk del fort i qartë. Themi kështu se pikëprisht ky shembull **të ftohtët**, siç u cek, është shënuar në *Gramatikën e Akademisë* (f. 160), si rast përfaqësues që duhet ruajtur nga rreziku i zhdukjes nga ndonjë trajtë spontane antinormë ose sinonimike, apo jo?!

Me fjalë të tjera më mirë do të ishte për studiuesit të merrej ndonjë shembull tjetër i diskutueshëm që t'i përgjigjej më mirë dukurisë së caktuar kundër normëzimit të sotëm, nëse vërtet ekziston, por sidoqoftë raporti *abstraksion/konkretizim* duhet pasur parasysh edhe në analiza të kësaj natyre.

3. Në të vërtetë, po në vazhdë të asaj që u cek më sipër, po shtojmë paksa se mund të dëgjohej e të thuhet normalisht të ftohtët e madh si dhe të ftohtit e madh, ashtu *si të ecurit e drejtë dhe të ecurët e drejtë*, por për ne ka rëndësi se masivisht nuk po thuhet *i ftohtët i madh* a *i ftohti i madh*, përkatësisht *i ecuri i drejtë ose e ecura e drejtë*, por po përdoret e po shqiptohet normalisht nyja e përparme, **të ecurit, të ftohtët**, e cila (nyja e përparme) që është karakteristike e parë a pjesë e pandarë e asnjansit në njëjësin e pashquar e të shquar të emërores (e të kallëzore) po respektohet, pothuaj denjësisht në vazhdimësi në kontekste përkatëse.

Siç dihet, nyja e përparme **të** në gjuhën tonë kryen dy funksione edhe si formant fjalëformues edhe si element gramatikor, dhe si e tillë (nyja e përparme) del e qëndrueshme, pikërisht si karakteristike a pjesë përbërëse e pandarë e asnjansit të paranyjëzuar.



Ç'është e vërteta, në dobi të zgjidhjes së çështjes së prekur nga prof. A. Kostallari, po sjellim disa shembuj nga gjuha e thjeshtë popullore, ku të ftohtët del me nyjëmbaresën shquese -it, por nyja e përparme e emrit kryesisht del e qëndrueshme, siç janë këto shprehje popullore nga trevat e Veriut:

*“T’ftoftin kodra e përcjell e lugu e mbledh. T’ftoftit e hjek t’ftoftin me t’ftoftë. T’ftoftit e ka fajin e brymës po i jet dami. T’ftoftit edhe bryma e shkretë, s’i lenë laknat tona me rritë krye si donë vetë. T’ftoftit t’nishkon, fjala t’shiton. (Shih: D. Bajraktari, Fjalë të urta dhe thënie popullore shqipe, Prishtinë, 1994, f. 517.)*

Të vihet re se te shembujt e tillë, sidoqoftë nyja e përparme si karakteristikë e veçantë e asnjansit të paranyjësuar, është stabile, pra edhe në viset veriore ashtu si edhe në ato jugore, andaj siç u tha, përherë në të gjitha situatat ajo kryesisht po del e qëndrueshme. Sidoqoftë, nëse spontanisht në të folur të shkujdesur nga individë të caktuar mund të dalë edhe ndonjë fjalë a shprehje, kur nyja e përparme del e konvertuar në **i**, ose përzihet ndonjë trajtë lakimi me paradigmën e emrit në gjininë mashkullore njëjës e shumës), kjo nuk mund të godasë rregullën gramatikore në fuqi, e cila e mbron strukturën e asnjansit me nyjën e përparme **të** dhe me të prapmen **-t(ë)**. Fundja, ky rast nuk mund të krahasohet me dukurinë e *rrudhjes*, madje as me atë të bashkëjetës, siç ka ngjarë me asnjansit e mirëfilltë emëror si b.f. **ujtë** ndaj **ujë-i ujrät**, por që mund të ngjajë edhe me **i ftohti të ftohtit**, gjinia masdhkullore ndaj **të ftohtët**, gjinia asnjansë.

Në të vërtetë, edhe kjo dukuri lypset ndjekur, por përgjithësimi prej një përftimi të rastit nuk është për me u pranue si fakt ose për t’u përgjithësuar si prirje ose arsye për shuarje të plotë es ë këtejmi edhe për ndryshim rregullash leksiko-gramatikore.

4. Edhe nga shembujt e tjerë që do t’i sjellim më poshtë sa për ilustrim (prejmbiemërorë e prejpjesorë), një konvertim i tillë (**të/i**) siç e kemi trajtuar edhe më përpara në këtë punim dhe siç do ta sprovovjmë tani, në dy versionet e mundshme rindërtuese, del i pa qëndrueshëm, si p.sh.:

a) Ata kishin një **të bardhë** (*të ngrohtë, të ecur, të folur, të buzëqeshur etj.*) **joshës** ose **Të bardhët** (*të ngrohtët të ecurit, të folurit, të buzëqeshurit*) **e tyre ishte joshës**. Pra jo i bardhë-i apo e bardha e tyre po **një të bardhë /të bardhët**.

b) E kishte përvetësuar mirë **artin** e **të shkruarit** (*të folurit, të recituarit, të gatuarit etj.*) ose E kishte përvetësuar mirë **të shkruarit** (*të folurit, të ecurit, të recituarit, të gatuarit etj.*) **si art**. e kështu me radhë.

c) Fenomeni i **të ftohtit** (*të folurit, të aguarit, të dridhurit, të kollituri etj.*) **është i njohur prej nesh** ose **Të ftohtët** (*të folurit, të aguarit, të dridhurit, të kollituri etj.*) **si fenomen është i njohur prej nesh**.

ç) Mënyra e **të kënduarit** (*të vallezuarit, të kërcyerit, të luhaturit, të kollituri etj.*) **ishte karakteristikë e veçantë për ta** ose **Të kënduarit** (*të vallezuarit, të kërcyerit, të luhaturit, të stolisurit etj.*) **si mënyrë, ishte karakteristikë e veçantë për ta**.

Siç po shihet prof. Kostallari nuk e zë në gojë fare asnjansin e tipit ablatival, sepse atbotë e sot, ende nuk cilësohej qartë si tip i veçantë.

Pra, për të gjitha këto arsye të cekura në katër pikat e nën-pikat përkatëse konstatimi i prof. A. Kostallarit u quajt *kundërthënës* ose paksa *inxituar*.

Fundi i fundit, për ne nuk është aq kontestues fakti nëse ndodh ndonjë rast që asnjësi prembiemër të konvertohet në emër të nyjshëm mashkullor ose nëse lakimi i katërt, ku përfshihen asnjësit e nyjshëm mund të inkorporohet brenda lakimit të emrave të gjinisë maashkullore me vërejtje si rast i veçantë. Për ne e rëndësishme është se asnjësit e paranyjzuar nuk i shtrohen as **zhdukjes**, as **shuarjes**, madje as **rrudhjes**, sepse e kanë temën e qartë motivuese fjalëformuese, e kanë të specifikuar nënfushën semantike që e mbulojnë dhe paraqiten aktivë e produktivë në jetën gjuhësore, ashtu si edhe asnjësi ablatival, të cilët paraqiten të motivuar edhe nga mënyra fjalëndërtuese me **së-në** dhe fundoren **-i** ose **-u** karakteristike të emrit të pashquar të rasës rrjedhore dhe si të tillë, edhe pse në formën e ngurëzuar kanë mundësi shumimi për nënfushat e caktuara gramatiko-semantike ku përdoren.

### Sipërfundim

Nga sa u tha në këtë krye mund të nxjerrim si përfundim se në realitetin tonë gjuhësor zëvendësimi me sinonimikë të tjerë nën ndikimin e gjuhëve të huaja që ceket në reagimin e prof. A. Xhuvanit, as zëvendësimi i konceptit përkatës të asnjësit me forma të tjera, siç ishte rasti në fjalorin shpjegues të shqipes letrare, madje as konvertimi i asnjësve në gjini të tjera, nuk mund t'i kenë dëmtuar asnjësit e shqipes sa të përçmohet ose të tronditet ekzistenca e tyre. Në të vërtetë, me tejkalimin e sprovave në fjalë asnjësi tregoi forcën e identitetit të vet, sepse përkundër të gjitha këtyre sfidave vitaliteti i asnjësve të paranyjzuar assesi nuk ka shënuar jo vetëm zhdukje, po as tkurrje, përkundrazi, kur kemi parasysh nënfushën e qartë semantike që e mbulon, kemi rritje numri të asnjësve të tillë në standardin e sotëm gjuhësor.

Së këtejmi, po përsërisim, meqë asnjëra nga tri-katër faktet e sipërpërmendura, *as ndikimi i gjuhëve a i konstrukteve të huaja, as zëvendësimi me sinonimet përkatëse që nga Rilindja e këndej*, as zëvendësimi i koncepteve të asnjësit me format foljore, madje *as supozimi i konvertimit në gjininë tjetër*, nuk kishin mbështetje të forta e të përligjura evolucionore, anashkalimi i emrave të gjinisë asnjëse në burimet e caktuara normëzuese mund të quhet si veprim arbitrar e me pasoja të shkaktuara nga keqkuptimi normëvënësve përkatës.

Fundja, siç u cek më sipër, standardologët tanë të sotëm nuk duhet të bien pre e prirjes së tejdukshme që treguesit anësorë të asnjësit pothuajse tërësisht janë shpërbërë, duke kaluar në gjininë mashkullore (përemra, mbiemrat e numërorët) e vërtetë kjo e padiskutueshme, por në radhë të parë duhet ta shikojnë interesin e shqipes si sistem, sidomos përplotninë e strukturave të shqipes standarde, sistem ky i ravijëzuar sipas stileve funksionale, jo vetëm për sot e për nesër, por edhe për pasnesër e deri në pa kufi.

Të jemi më të qartë, duke pasur parasysh njëjën e përparme karakteristike të asnjësit të paranyjzuar si dhe nënfushën e qartë semantike që mbulojnë emrat e tillë në kuadër të fushës së gjerë të abstraksionit, atëherë kategoria e tillë emërore duhet ta merret, si me thënë, *në mbrojtje*, në mënyrë që mos të ndodhin në të ardhshmen përçmime të trajtave të tilla, siç kanë ndodhur në etapën nga vitet '50 –'90 të shekullit të kaluar, periudhë kjo e diskutueshme, pasojat e të cilave po ndihen ndjeshëm edhe aktualisht.

Në këtë kontekst po ripërmendim për të mirë hartuesit e Fjalorit të gjuhës shqipe 2006, të cilët kanë futur në standard numër të konsiderueshëm të asnjansve dhe ky veprim i tyre le të shërbejë jo si gjest, po si shembull i mirë që edhe standardologët e tjerë të ndjekin të njëjtën rrugë, duke e vlerësuar drejt edhe rolin e emrave asnjans dhe përdorimin e tyre në burimet përkatëse normative të gjuhës shqipe.



## VII. ÇËSHTJE TË HAPURA SPECIFIKE RRETH ASNJANËSIT NË SHQIPEN E SOTME

Ndonëse pothuaj krejt punimi i paraqitur në krerët e mëparshëm mund kuptohet se e trajton gjininë asnjane si çështje të hapur, megjithatë, ne, në këtë krye të parafundit, do të shkëpusim si më specifike disa çështje të një natyre paksa më të veçantë, po në kuadër të çështjeve të hapura, edhe pse ndonjëra prej tyre, në njëfarë mënyre, mund të jetë përmendur a trajtuar, por do si do më përpara.

Konkretisht do të bëjmë fjalë tash fill për këto katër çështje:

së pari, rreth përkufizimit terminologjik të tre tipave të asnjane të identifikuar të rasës emërore,

së dyti, rreth identifikimit të asnjane në tofjalësja e shprehje ndajfoljore në rasën rrjedhore,

së treti, çështje rreth përforcimit të përkufizimit të fushave semantike të asnjaneve dhe

së katërti, disa vërejtje të veçanta lidhur me asnjane.

### 1) Rreth përkufizimit terminologjik të tre tipave të identifikuar të asnjaneve

Siç e pamë nga analiza e deritashme studiuesit jo vetëm nuk kishin ide e së këtejmi as qëndrim të qartë rreth funksionimit të asnjaneve, madje ata nuk ishin as të një goje edhe rreth emërtimeve dhe interpretimeve përkatëse lidhur me ta. Kështu, bie fjala, nga disa studiues e dashamirës të gjuhës asnjane e tipit të parë konsideroheshin si asnjane të vetëm, të cilët edhe vazhdojnë të quhen *asnjanës të mirëfilltë* ose *asnjanës primitivë*, Po ashtu edhe dy tipat e asnjaneve të paranyjzuar jo të definuar mirë nga disa gjuhëtarë siç del në burime të caktuara, andaj quhen edhe me emërtime të ndryshme si p.sh.: të dy tipat e paranyjzuar quhen *emra abstraktë të gjinisë mashkullore* (A. Xhuvani), nga ndonjë tjetër *asnjanës të nyjshëm* ose *asnjanës të nyjzuar*, *asnjanës të paranyjzuar* (Sh. Demiraj), madje u quajtën edhe si *emra abstraktë të gjinisë gjysmëasnjanësë / gjysmëmashkullore* (Kostallari), d.m.th pa u ndarë në tipa të veçantë, të cilët dallohen sipas prejardhjes: **prejmbiemërore** ose **prejppjesore**. Ka raste që si asnjane të paranyjzuar të quhen vetëm *emrat prejfoljorë* ose vetëm *prejppjesorët*. Ashtu i ndeshim të emërtuar b.f. te libri shkollor, *Gjuha shqipe* 6, Tiranë 2003, f. 12, po edhe në punimin e studiueses Rosana Rushiti. (Shih: *Seminari* 26/1 f. 365) Po këtë tip prof. K. Topalli e quan të formuar nga **mbiemra prejfoljorë** që shoqërohen me nyjën e përparme, ndërsa nga autorët e tjerë quhen edhe vetëm si **emra foljorë**.

Ne edhe pse nuk pretendojmë se kemi plotësisht të drejtë, duke marrë për bazë njëjtesin e emërores si formë përfaqësuese të emrit në trajtën e pashquar, për të tre tipat e identifikuar i kemi përvetësuar *kryesisht* këto emërtime:

- tipi i parë, *asnjanës i mirëfilltë i paparanyjzuar*;
- tipi i dytë, *asnjanës i paranyjzuar prejmbiemëror dhe*
- tipi i tretë, *asnjanës prejpjesor i paranyjzuar*.

Natyrisht trajtat si shembuj në analiza janë përdorur më dendur *kryesisht* në njëjësin e shquar. E thamë *kryesisht*, sepse ne varësisht nga konstrukti a konteksti i fjalisë kemi përdorur edhe variante të tjera rasore, por kur është çështja tek emërtimet p.sh. tipin e parë kemi quajtur edhe si asnjans primitiv, asnjans i mirëfilltë emëror, asnjans i paparanyjzuar etj.; tipin e dytë: asnjans prembiemëror ose prejmbiemëror asnjans dhe tipin e tretë asnjans prejpjesor. Madje, për këta dy tipat e fundit e kemi futur në përdorim shpesh herë edhe termin asnjansit paranyjzorë ose paranyjzorët e rasës emërore (kuptohet si trajtë përfaqësuese). Në analiza e kemi përvetësuar më tepër si koncept të formës përfaqësuese të asnjansit të paranyjzuar, njëjësin e shquar të rasës emërore.

Sidoqoftë, edhe pse mendojmë se edhe rreth emërtimeve që bëjnë ne, ashtu edhe nga të tjerët lypset vënë rregull. Fundi i fundit, nuk do të ishim kundër që në të ardhmen asnjansit e të dy tipave paranyjzorë të pagëzohen mbase edhe ndryshe, ndoshta edhe vetëm si **emra abstraktë të gjinisë mashkullore të një tipi të veçantë(!)**, e ku ta dimë, sepse, kjo çështje si emërtim tash për tash për ne nuk heq aq në peshë, sa ka rëndësi përcaktimi i fushës kuptimore që mbulojnë asnjansit në fjalë, varësisht nga tipi i tyre. Prandaj, duke e lënë këtë çështje (të emërtimeve) të hapur, si punë për ekspertët, më poshtë e shohim të arsyeshme të bëjmë fjalë rreth asnjansve me shprehje ablativale (prejrrjedhore).

## 2) Rreth identifikimit të asnjansit ablatival (në shprehje prejrrjedhore)

Siç dihet asnjansin e mirëfilltë emëror të paparanyjzuar sipas ndërtimit, në njëjësin e rasës emërore si formë përfaqësuese në njëjësin e shquar, e karakterizon *nyjëmbaresa e prapme -t(ë)*: misht-**të**, ujë-**t**, ndërsa prejmbiemërorët dhe prejpjesorët përveç nyjës së prapme -**t(ë)** i karakterizon edhe nyja e përparme **të** si p.sh. **të** mirë-**t**, të keq-**të**: **të** menduar-**i/t**, të ecur-**i/t**, mirëpo në gjuhën tonë dalin edhe disa asnjans zakonisht prejmbiemërorë e prejpjesorë apo nga ndonjë njësi tjetër leksiko-gramatikore i ndeshim sishprehje prejrrjedhore në funksion të shprehjeve sindajfoljore, qoftë së njësi të veçanta ose në kuadër të një togfjalëshi të lirë foljor, siç janë shembujt: **së kënduari, së foluri; së pari, së koti** etj., ku tiparet nyjëzore të parme e të prapme të shquarsisë së emrit të këtij tipi ndaj tre tipave të mësipërm, u ndryshojnë, jo vetëm nyja e prapme -**t(ë)** në zero mbaresë ose në -**i** fundore të trajtës së pashquar të emrit të gjinisë mashkullore e asnjansë, por edhe nyja e përparme **të** në **së**, sepse s'kemi të bëjmë me të njëjtën fjalëformë përfaqësuese, njëjësin e rasës emërore, por me trajtën arkaike të rasës rrjedhore. Atëherë shtrohet pyetja, ku u bazuam të tjerët para nesh, po edhe ne, që këta shembuj të quhen *asnjanës*, madje pse ne po i trajtojnë si tip më vete, kur në fjalorët normativë shpjegues (1980, 1984, 2002, 2006) nuk i ndeshnin të shënuar fare shembujt të tillë si asnjans. Sidoqoftë, meqë këto forma asgjekundi nuk kategorizohen si tip më vete asnjansish, atëherë shtrohet pyetja shembujt e tillë janë injoruar apo nuk njiheshin, pasi nuk ishin studiuar në thellësinë e duhur.

Sido që të jetë, ne në vijim po përpiqemi që, sado pak, ta zbardhim këtë çështje, duke u mbështetur në këta katër faktorë a burime, ku përmenden a trajtohen në një farë

dore shembujt e tillë, siç janë: 1) *Gramatika e Akademisë*, 2) *Studimi e prof. Shaban Demirajt rreth kësaj teme*, 3) *Konstatimi e prof. Kolec Topallit po mbi këtë temë dhe 4) materiali i regjistruar në Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe* (Tiranë 2011).

T'i shohim tash fill si trajtohen asnjësit prejrrjedhorë ose format në fjalë sipas faktorëve a burimeve të sipërcekura.

## 1. Nga Gramatika e Akademisë

Ndonëse në mënyrë simbolike, mbase aq sa e meritojnë, apo jo, asnjësit e tillë dalin të pranishëm në Gramatikën e Akademisë (2002) ose në *Gramatikën e gjuhës shqipe 1 dhe 2, Tiranë 2002, d.m.th.*, edhe në morfologjinë edhe në sintaksën e shqipes.

Së këtejme, ne volëm materialin nga këto dy burime, ku bëhet fjalë për këtë tip asnjësisht dhe sipas disiplinave që u paracekën, me ndonjë fjalë sqaruese tonën, po e paraqitim më poshtë.

### a) Nga morfologjia e gjuhës shqipe

Në Gramatikën e gjuhës shqipe – morfologji (Tiranë 2002), ku bëhet fjalë rreth **formimit të ndajfoljeve, pika c**), thuhet shprehimisht:

*Një grup më vete përbëjnë fjalët (d.m.th. grup ndajfoljesh n.v.) që lidhen me formën e ngurosur të rrjedhores së mbiemrave të emëruar asnjësisht: së afërmi, së andejmi, së brendshmi, së gjalli, së gjati, së jashtmi, së këtejmi, së koti, së largu, së larti, së mbari, së qeti, së sipërmi, së shprejti, së tepërmi, së toku, së voni etj. që përdoren rregullisht si ndajfolje. Ndajfoljet e këtij tipi kanë humbur çdo lidhje me klasën e mbiemrave të emëruar, nga kanë dalë. Disa janë edhe analogjike, si: së toku, së bashku.*

Dhe në fjalitë ilustruese jepen këta dy shembuj: *së bashku, së tepërmi*. Mirëpo, për mos me thënë vetëm kaq, në të vërtetë, është me interes të ceket se te *ndajfoljet përcaktore sasie*, ndër shembuj të tjerë përfaqësues sinonimikë del edhe shembulli: *(për) së tepërmi* (Aty f. 362), ndërsa te *ndajfoljet rrethanore kohe* del shembulli: *së lashti* (Aty f. 363), madje edhe te shkallëzimi i ndajfoljeve del shembulli antonimik i këtij tipi: *më së keqi ndaj më së miri* dhe ky i fundit ilustron me fjalinë: **E kreu punën më së miri**. (Aty f. 370.)

Pra siç mund të shihet krijimet e tilla cilësohen aty si grup më vete dhe se numri i tyre i shënuar në atë burim, kap shumë mbi 20 dhe përfundon me treguesin **etj.**, megjithatë me sa pamë, numri i tyre i regjistruar në fjalorët përkatës nuk është edhe aq i madh. Sillet aty rreth 30-shit.

Si e veçantë tjetër që del nga konsultimi i këtij burimi është se pa marrë parasysh faktin se aty janë shënuar, ndoshta rastësisht, vetëm dy shembuj të tillë ilustrues përkatësisht në kuadër të *ndajfoljeve përcaktore sasie (së tepërmi)* dhe te *ndajfoljes rrethanore kohe (së lashti)*, sipas temës fjalëformuese që kanë ose që marrin trajtat e tilla mund të kuptohet se shembujt e këtij grupi kanë shtrirje edhe në llojet e tjera të ndajfoljeve përcaktore e sidomos atyre rrethanore, po për këtë kërkohet verifikimi nga ana e ekspertëve. Sido që të jetë, del i drejtë konstatimi se mbiemrat si dhe ndonjë

kategori leksiko-gramatikore tjetër të emëruar tani si asnjësi dalin vetëm në funksion ndajfoljeje. Ku përveç shkallëzimit shprehjet e tilla ndajfoljore mund të përfordohen edhe me parafjalët përkatëse në mjaft raste, siç është parafjala **për** si:

*për së shpejti, për së mbari, për së afërmi, për së dyti, për së gjati, për së gjeri, për së hollë, për së mbari, për së largu, për së drejti (drejtpërsëdrejti) etj,*

të cilat edhe i ndeshim të shënuara në burimet përkatëse normëzuese, por në realitetin tonë gjuhësor ndeshim edhe shembuj të tillë me parafjalë të tjera, si b.f. me parashtesën **prej**, si:

*prej së largu a prej së largti, prej së afërmi, prej së larti a prej së nalti, prej së brendshmi, prej së jashtmi, prej së tepërmi, prej së thelli, (mos u çoj peshë) prej së miri, prej së keqi, e ndonjë tjetër;*

pastaj në shprehje të tjera me parafjalëzimet përkatëse, si:

*(Po ta them) pikë së pari se..., (E mundova) pak së tepërmi, (U paraqit) si më së miri, e ndonjë tjetër*

Meqenëse shembuj si këta të fundit nuk i ndeshim as në burime të tjera përkatëse normative që konsultuam, prandaj kërkohet nga gramatikanët e gjuhës sonë që të sqarojnë mungesën ose pse kanë ndodhur anashkalimet e tilla. Sidoqoftë duhet t'i vlerësojnë shembujt e tillë dhe nëse është e mbëhishme le të plotësojnë atë mangësi, apo jo?!

Pra, mund të përfundojmë se zakonisht mbiemrat e emëruar në këtë formë të konvertuar si asnjësi të rasës rrjedhore të këtij grupi dalin të specifikuar vetëm në funksion ndajfoljeje dhe është mirë të gjurmohet e vërteta se a mund të kenë ndonjë lidhje kuptimore, me asnjësinë e grupit tjetër të formuar ose të trashëguar po sipas kësaj mënyre përfitim, nga rasa rrjedhore, apo jo. Po theksojmë faktin se po në këtë burim (morfologji), aty ku bëhet fjalë për foljet që shprehin mënyrën e veprimit nën **pikën ç**), trajtohen togfjalëshat e tipit të veçantë që kanë si gjymtyrë të dytë jo asnjësinë prejmbiemëror si më sipër, po asnjësinë prejfoljor po të rasës rrjedhore. Shprehimisht aty thuhet kështu:

*Për të shprehur mbarimin e një veprimi, në gjuhën shqipe përdoret edhe togfjalëshi i tipit **mbarova së foluri**. Në këtë tip togfjalëshi si gjymtyrë e parë përdoret kryesisht folja **mbaroj** ose **pushoj**, e ndjekur nga forma e ngurosur e rrjedhore së një emri prejfoljor asnjësi në trajtë të pashquar. Në kuptimin e përgjithshëm të togfjalëshave të këtij tipi rolin kryesor e luan gjymtyra e dytë (emri prejfoljor asnjësi), kurse gjymtyra e parë shërben për të shprehur vetëm mbarimin e veprimit të emërtuar nga gjymtyra e dytë. (Aty f. 265.)*

Dhe për ilustrim brenda 5 fjalive sa jepen aty dalin këta shembuj me togfjalëshat përkatës:

*mbaronte së foluri, nuk pushuan së mbledhuri..., kishte mbaruar së referuari, mbaroi së rrëfyeri, pushojmë së ekzistuari.*

Pra nga ajo që u paraqit më sipër, sipas trajtimit morfologjik, del se tipi asnjësi me prejardhje mbiemrore i rasës rrjedhore si trajtë e ngurosur është ndajfoljezuar plotësisht si tip i veçantë ndajfoljesor, ndërsa asnjësi prejfoljor mbi bazë pjesoreje po i rasës rrjedhore si formë e ngurosur është togfjalëzuar plotësisht si tip i veçantë togfjalëshor. Natyrisht kjo formë e ngurosur funksionon, pothuajse si ndajfolje, kategori kjo që si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës emërton një tipar të veprimit si dhe



rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim etj. Pra asnjësi prejrrjedhor në fjalë tani funksionon, si me thënë, me tipare morfologjike që ka ndajfolja, por po ashtu konstatohet se kjo formë e asnjësit prejpjesor funksionon si trajtë e ngurosor, edhe në kuadër të togfjalëshit përkatës.

Sidoqoftë, përveç veçorive morfologjike që u përmendën më sipër rreth asnjësit prejrrjedhorë që dilte edhe si togfjalësh e tofjalëshi, siç dihet, del *si njësi sintaksore strukturore që përftohet nga bashkimi gramatikor e kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes që tregon marrëdhënie midis sendeve, dukurive, etj.*, atëherë del e domosdoshme që kjo temë pikërisht asnjësi i tillë i togfjalëzuar të shihet se si është trajtuar në kuadër të sintaksës së gjuhës shqipe.

## b) Nga sintaksa e gjuhës shqipe

Në pjesën tjetër të Gramatikës së Akademisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 2* (sintaksë), lidhur me togfjalëshat thuhet se:

*Togfjalëshat sintaksorë të mirëfilltë shprehin 1) marrëdhënie objektore, 2) marrëdhënie përcaktore dhe 3) marrëdhënie rrethanore.*

Ndërsa lidhur me temën tonë, përkatësisht rreth asnjësit prejrrjedhor të togfjalëzuar ose të ndajfoljezuar, tek togfjalëshat foljorë të zgjeruar pa parafjalë ndeshim këtë shpjegim:

*Kallëzuesi i përbërë i formuar nga një folje gjysmëndihmëse si **mbaroj** a **pushoj** në format kohore të dëftores, më rrallë në format kohore të lidhores, të habitores a të dëshirores. dhe nga një emër foljor asnjësi në rrjedhore shpreh mbarimin e veprimit. Folja gjysmëndihmëse shpreh mbarimin e veprimit dhe lidhjen me kryefjalën, kurse emri foljor asnjësi shpreh përmbajtjen leksikore. (Aty, f. 187.)*

Dhe brenda fjalive përkatëse janë dhënë këta shembuj: *do të mbarojnë së **mbjelli**, kishin pushuar së **korruri**, pushoi së **thyeri**, mbaronte së **mbjelli** dhe pas fjalive me këta shembuj ilustrues vazhdon shpjegimi:*

*Në formën mohore, duke mohuar mbarimin e veprimit ky kallëzues shpreh një veprim që zgjat*

dhe për ilustrim brenda fjalive jepen këta shembuj: *s'pushonin së **hedhuri** (bomba), s'pushonte së **foluri**.*

Po aty lidhur me kuptimësinë e shembujve të tillë thuhet:

*Togfjalëshat folje + emër në rrjedhore janë të kufizuar nga kuptimi leksikor i emrit ose nga kuptimi leksikor i foljes. Pranë disa foljesh trajta e rrjedhores njëjës e një emri të pashquar tregon shkaku e veprimit, si p.sh. u lodha së **nxituari**, U ngjira së **kënduari** (Aty f. 91),*

po më poshtë përforcohet po ky fakt:

*Me disa folje dhe me emra rëndom abstraktë mund të shprehen marrëdhënie më së tepërmi shkakore, si p.sh.: Foshnja u këput nga të qarit. I dhemb koka nga të ftohtit. (Aty f. 92.)*

Po në këtë burim si shembull të një rrethanori shkaku pa parafjalë jepet shembulli: **këputeshin së qeshuri**. (Aty f. 275.)

Edhe pse pritnim më shumë tekst dhe saktësi më të madhe lidhur me asnjansit prejpesorë të rasës rrjedhore, megjithatë na u desh të mjaftohemi me kaq. Sidoqoftë, nga sa u tha në këtë burim mësojmë se togfjalëshi folje + emri asnjans në rrjedhore është shprehje e përbërë prej dy gjymtyrësh të lidhura kuptimisht, folja gjysmëndihmëse si gjymtyrë e parë i prin asnjansit në fjalë, i cili shërben ose bën pjesë në përbërje të kallëzuesit, pra është në funksion të kallëzuesit të përbërë foljor një siemëror dhe që të dyja gjymtyrët e togfjalëshit zakonisht në mënyrën dëftore dhe në mënyra të tjera shprehin *mbarimin e veprimit* ose *zgjatjen e veprimit*, qoftë të natyrës pohore, qoftë të asaj mohore. Në raste të tilla folja ruan lidhjen me kryefjalën dhe rrjedhojën e veprimit, ndërsa asnjansi përmbajtjen leksiko-gramatikore, pra gjymtyra e dytë (asnjansi, si të themi i ndajfoljezuar) në kuptimin e përgjithshëm ka rolin kryesor, ndërsa folja shërben për të shprehur vetëm *mbarimin*.

Siç mund të shihet, edhe pse në gramatikën e gjuhës shqipe, si në morfologji ashtu edhe në sintaksë, ne na duket se ky tip asnjansish zë vend, pothuajse, simbolik, megjithatë brenda tërë kompleksit ose mozaikut të strukturave përkatëse leksiko-gramatikore asnjansi i tillë zë një vend jo aq anësor, madje edhe prodhueshmëria dhe aktiviteti i tyre, varësisht nga konteksti, nuk del i përçmuar.

Sigurisht koncepti ynë lidhur me këtë tip do të jetë më i plotë dhe më i qartë, pasi të konsultojmë edhe burimet e tjera, sidomos punimin e të ndriturit prof. Shaban Demiraj.

## 2. Nga punimi i prof. Shaban Demiraj

Studiuesi ynë i mirënjohur **prof. Shaban Demiraj** në veprën *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988, me sa dimë, paraprin në trajtimin e këtij tipi asnjansish, ekskluzivisht të grupit prejpesor ablatival, ngase në mënyrë mjaft të hollësishme dhe në thellësi si në planin historik, ashtu edhe në atë sinkronik, zbardh mjaft çështje që nuk njiheshin mirë më përpara dhe që nuk i ndeshëm të sqaruara qartë, jo vetëm në gramatikën e Akademisë, por as në burime të tjera.

Sido që të jetë, autori në punimin e tij si shembuj ilustrues përfaqësues shënon këta dy togfjalësha:

### *mbarova së foluri* dhe *plasa së qari*

dhe shpjegon se togfjalëshi i tillë përbëhet nga dy gjymtyrë dhe se gjymtyra e dytë nuk është “**gjë tjetër, veçse një rrjedhore e emrit prejpesor asnjans**”, pra, prof. Sh. Demiraj gjymtyrën e tillë e quan **asnjans prejpesor** të rasës rrjedhore.

Kështu nga studimi i prof. Shaban Demiraj, edhe pse këtë rast nuk i trajton asnjansit e grupit tjetër në shprehjet ndajfoljore, por vetëm *asnjansit prejpesorë* ablativalë, siç u cek pak përpara, mësojmë dhe do t'i kemi më të qarta mjaft gjëra, lidhur me këtë temë. Së këndejmi ne këtu më poshtë po i shënojmë disa nga mësimet që na u servuan nga ky punim, të cilat në tetë pika po i japim përmbledhtas, të parafrazuara prej nesh:

E para, këto shprehje si togfjalësha me asnjans prejpesorë në përbërje të kallëzuesit i kemi të trashëguara në të dy dialektet, të cilat nuk dalin në gjymtyrësh, por si dygjymtyrësh. Gjymtyra e parë është folja, e cila i paraprin asnjansit dhe kështu formohet togfjalëshi gjysmë i lirë, dhe së këtejmi të dyja gjymtyrët janë të pandara gramatikisht e kuptimisht.

E dyta, zakonisht togfjalëshit të tillë nuk i prin çfarëdo folje, po një folje *terminative* ose *aspektore* gjysmëndihmëse, si p.sh.

1. *mbarova së foluri*: dhe 2. *plasa së qari*.

Te shembulli i parë autori konstaton se emri *së foluri* në kontekst shpreh **marrëdhënie objektore** fjalimore d.m.th. asnjësi del si **kundrinë**, pra e thënë ndryshe në shqipen e sotme ky koncepti mund të shprehet: me sinonimin përkatës, krahaso: *përfundova ose mbarova të folurit / përfundova ose mbarova së foluri*, ndërsa te shembulli i dytë, asnjësi *së qari* del në **marrëdhënie rrethanore**, konkretisht të **një rrethanori shkaku**, e thënë ndryshe, pra koncepti mund të shprehet me sinonimin. *krisa (plasa) nga të qarit/ krisa (plasa) së qari*. Pra nga dy shembujt përfaqësues kemi të bëjmë me dy nëntipa a grupe nënfushash a profilimesh të ndryshme semantike.

E treta, aty shpjegohet se pjesëza *së* është në të vërtetë *nyjë e përparme arkaike* e asnjësit në rasën rrjedhore, e cila, siç mund të shihet edhe nga shembujt tanë arbitrar barasvlerës(!) që i shtuam më sipër në shqipen e sotme, sipas lakimit të rregullt në vend *së* del të. Krahaso: *të folurit/së foluri; të qarit/së qari*, prandaj shprehjet e tilla më njëjën *së*, profesori i quan me të drejtë *shprehje arkaike, të vjetra*.

E katërta, fundorja **-i**, siç e shpjegon autori nuk është zanore anaptetike, por është mbaresa **-i** e emrit mashkullor e asnjësit në njëjës in e *pashquar* të rasës rrjedhore, e trashëguar nga koha, kur kjo rasë, për këtë tip emrash, ishte më e eptueshme se sot.

E pesta, edhe pse është fjala për togfjalëshja, siç e quan ai, *gjysmë të lirë* të tipit *mbarova së foluri* ose *plasa së qari*, pra, të përbërë nga dy gjymtyrë: *folja + asnjësi prejjesor i njëjzuar i rasës rrjedhore*, siç u tha pak më sipër, konsiderohen si gjymtyrë të pandara dhe zakonisht a fare natyrshëm *këto dy gjymtyrë formojnë një njësi të vetme kallëzuesore me mundësi që shembujt e tillë, sipas kontekstit përkatës, të kenë marrëdhënie kundrinore ose rrethanore shkaku ose të tjera* në kuadër të fjalisë ose të të thënit përkatës, megjithatë trajta e asnjësit nuk mund të quhet si formë e çemërzuar (d.m.th. e konvertuar plotësisht nga sistemi emëror në atë foljor), ngase ajo trajtë ruan gjithsesi edhe tipare të emrit, përveç atyre të foljes, d.m.th. të kallëzuesit të përbërë foljor. Lidhur me këtë profesori krahason shembujt si: *plasa vape* ndaj *plasa së foluri*, ngase që të dyja gjymtyrët e dyta të këtyre togfjalëshave ose shprehjeve arkaike janë emra të rasës rrjedhore (*vape/së foluri*), *sintaksisht* në funksion të një rrethanori shkaku.

E gjashta, vërtet, trajtat e shprehjeve në shqyrtim, mendojmë ne, mund të krahasohen sinonimisht edhe me versione të tjera, t'i quajmë, *të gjalla* ose *gjalluese* sinonimisht, në shqipen e sotme, varësisht nga diateza apo funksioni që ka folja në kontekstin përkatës si gjymtyrë e parë, si b.f.:

*mbarova* ose *u lodha së punuari*, *mbarova* ose *u lodha nga puna ose prej pune*,  
*mbarova* ose *u lodha duke punuar*, *mbarova* ose *u lodha me punë*

apo një shembull tjetër:

*vazhdova së foluri*, *vazhdova me folë*, *vazhdova fjalën*, *vazhdova të folurit (të folët)* e ndonjë variacion tjetër,

ku, siç mund të shihet nga versionet e mësipërme, vërtet del se gjymtyra e dytë ka barasvlerësi sinonimike me trajtat e emrave përkatës (*nga puna, prej pune, me punë*), por edhe me dy format foljore të pashtjelluara: **përcjelloren** (*duke punuar*) dhe **paskajoren** (*me folë*).

E shtata, autori konstaton se këto shprehje arkaike që ishin të pranishme në gjuhën tonë popullore pas L2B u aktivizuan ose u gjallëruan në gjuhën letrare dhe vazhdojnë të

përdoren relativisht më dendur se në të kaluarën, sidomos në veprat e shkrimtarëve tanë të njohur, ku, sipas tij, shihej një prirje e shkrimtarëve drejt gjallërimit të disa mënyrave të të shprehurit të gjuhës popullore e së këndejmi edhe të kësaj forme të të shprehuri.

E teta, madje sipas autorit, ndonëse gjymtyra e parë folja e togfjalëshit në shqyrtim mund të ketë njëfarë kufizimi në përdorim, sepse, e marrim me mend se të gjitha foljet nuk janë *terminative* ose *aspektore* në funksion të foljes gjysmëndihmëse, trajtat e gjymtyrës së dytë, përkundrazi, d.m.th. trajtat e asnjansit prejpesor nuk kanë kufizim, ngase asnjansi i tillë *potencialisht mund të ndërtohet (përftohet) nga çdo folje*, sipas vetave e kohëve e numrit, por trajta e asnjansit mbetet e ngurëzuar, pra ndërtimi e përdorimi i tyre numerikisht ka mundësi të pakufizuar shumimi si gjymtyrë e dytë, madje nga e njëjta folje, si me thënë, paraprirëse (drejtuese). Pra, siç e pamë edhe në shembujt e mësipërm mund të përftohen disa shembuj me gjymtyrën e dytë, por njëherazi, edhe nga disa folje të tilla (nga gjymtyra e parë) mund të përdoret e njëjta formë e gjymtyrës së dytë dhe anasjelltas. Krahaso: **U lodha së lexuari** (së shikuari, së punuari, së recituar, së dëgjuar ... etj), në njëren anë, por dhe nga ana tjetër, po shtojmë ne, dalin shembuj jo të aq të kufizuar, si: *U lodha (u molisa, u kënaqa, u kënaq, u kënaqën, u josh, u joshët, u frymëzova, ishin frymëzuar, u ngroha...etj) së punuari*.

Pra një mundësi e tillë shumimi të shprehjeve me të dyja gjymtyrët, veç e veç, pa e dëmtuar kuptimin e shprehjes përkatëse, në shqipen e sotme është e pakufizuar.

Sidoqoftë edhe pse nga punimi i prof Sh. Demirajt mund të nxjerrim edhe kontribute të tjera, ne, këtu, po mjaftohemi me kaq.

### 3. Nga konstatimi i prof. Kolec Topallit

Prof. Kolec Topalli, siç e pamë në fillim të këtij punimi konstaton drejt kur thotë se, edhe pse i goditur prej *shekulli në shekull*, nga forma të tjera të dy rasave aktive gramatikore: mashkullore e femërore, asnjansi në përgjithësi ka mbijetuar dhe pikërisht për tipin e fundit të asnjansit në trajtim autori përmend shembuj nga të dyja grupet: prejpesorët e paranyjzuar të rasës rrjedhore dhe shprehjet ndajfoljore po të kësaj rase. Dhe këtë e bën në dy pika të veçanta:

së pari, tek emrat prejpesorë në rasën rrjedhore, si trajta përfaqësuese, ku shënon këta tre shembuj: *mbarova së foluri, plasa së qari dhe u lodha së punuari* dhe

së dyti, si pikë më vete kur bën fjalë për *ndajfoljet e shprehjet ndajfoljore*, të formuara nga emërzimi i mbiemrave dhe të *katëgorive të tjera leksiko-gramatikore në rasën rrjedhore*, ku shënon këta nëntë shembuj përfaqësues, 5 ndajfolje: *së largu, së shpejti, së afërmi, së bashku, së pari* dhe 4 shprehje ndajfoljore: *për së mbari, për së gjati, për së gjalli, kot së koti*.

Pra, si të veçanta nga konstatimet e prof. K. Topallit po veçojmë këto tri fakte:

E para, vëmë re se autori jo vetëm dallon edhe me shembuj konkretë emërzimet e dy grupeve: prejpesorët dhe prejmbiemrorët ablativale, por edhe brenda prejmbimërorëve dallon ndajfoljet e thjeshta nga shprehjet ndajfoljore ablativale.

E dyta, të dyja grupet prejpesorët prejrrjedhorë dhe ndajfoljet e shprehjet ndajfoljore prejrrjedhore, ndonëse të goditur nga format e tjera sinonimike gjatë shekujve, siç thekson ai, kanë arritur t'u shpëtojnë rrymave të kohës nga zhdukja dhe të

mbijetojnë deri në ditët e sotme në formën e asnjansit, pikërisht me elemente arkaike të rasës rrjedhore.

Së treti, kuptojmë gjithashtu se jo vetëm kanë arritur të mbijetojnë, por edhe të kenë përdorim pothuajse normal në strukturat përkatëse, qoftë si togfjalësha në funksion të kallëzuesit të përbërë, qoftë si shprehje në marrëdhënie përcaktore e rrethanore, madje *si ndajfolje a shprehje ndajfoljore*, duke u bërë kështu pjesë e mozaikut të strukturës ndajfoljësore për të shprehur segmente a nënfusha përkatëse semantike.

Pra, duke kryer funksione të caktuara aktualisht në formën e asnjansit në rasën rrjedhore, edhe pse jo si emra të mirëfilltë asnjans, por të transformuar sipas procesit të emërzimit a çemërzimit të pjesshëm, qoftë si prejpjesorë, qoftë si prejmbiemërore të konvertuar në ndajfolje nuk mund të anashkalohen e të mos kihet parasysht identiteti i tyre si emra asnjans të tipit të veçantë, pra si asnjans prejrrjedhorë (ablativalë).

#### **4. Nga Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (2011)**

E kemi cekur po në këtë punim se Fjalori drejtshkrimor (2011) nuk karakterizohet vetëm për shumësi fjalësh që përmbledh, por edhe për diçka të veçantë që ka të bejë me temën tonë, aty ndeshim numër të konsiderueshëm të ndajfoljeve dhe të shprehjeve ndajfoljore mbi bazë të asnjansit prejrrjedhor, që shembujt e tillë kalojnë 30-shin

Mirëpo për ne edhe më i veçantë del fakti se aty (në këtë Fjalor), dalin të regjistruar në zëra të veçantë edhe këta emra asnjans prepjesorë ablativalë:

#### **së kënduari, së luajturi, së qeshuri, së prituri, së punuari, së vrapuari**

pra, të veçantë janë për nyjën e përparme të rrjedhores së dhe për i-në fundore të emrit mashkullor e asnjans në njëjësin e pashquar.

Mbase për dikë, duket pak e çuditshme, pse në atë Fjalor janë shënuar vetëm gjashtë shembuj, kur kemi parasysh prodhimtarinë dhe aktivitetin e formave të tilla në jetën tonë gjuhësore, ku numri i tyre del më i madh dhe me perspektivë shumimi. Ne konsiderojmë se sa për fillim shembujt e tillë mjaftojnë, nëse konsiderohen si shembuj përfaqësues, kur kemi parasysh faktin se fjalë-format e tilla mungojnë në fjalorët e deritashëm normativë përshkrues të gjuhës sonë. Pritet që në të ardhmen fjalë-format e tilla të figurojnë edhe në burime të tilla, madje numri i tyre me siguri do të jetë më i madh.

Sidoqoftë, edhe kjo prani e fjalëformave të tilla në *Fjalorin (e ri!) drejtshkrimor* ka ndikuar si faktor jo pak i rëndësishëm që ne asnjansit e tillë t'i merendojmë si tip më vete.

\* \* \*

Sigurisht lexuesi i vëmendshëm mund të ketë vërejtur edhe gjëra të tjera të veçanta, nga katër burimet a faktorët e sipërpërmendur, përveç atyre që u potencuam prej nesh. Me fjalë të tjera jemi të vetëdijshëm se kanë mbetur edhe paqartësi të tjera në kuptimin që duhen përpjekje, interpretime e hulumtime të mëtejshme rreth asnjansve nga aspekti i qëndrueshmërisë gramatikore e semantike të tyre, pra edhe të asnjansve të

këtij tipi, prandaj nga ky kontekst është krejt e natyrshme të kërkoen nga ekspertët e gjuhës sonë, jo vetëm sqarime, por edhe studime e interpretime përkatëse më të nivelizuara, ngase përveç harmonizimit, verifikimit të konstatimeve të shprehura deri më tash, nevojiten edhe përplotësime që mund të dalin nga hulumtimet e mëtejshme. Pikë së pari, pritet edhe konsolidimi i vetë terminologjisë sa më adekuat të këtij tipi dhe tipave të tjerë të kategorisë së asnjansit në gjuhën tonë..

Sido që të jetë, ne duke pasur për mbështje faktet e mësipërme, e pamë të arsyeshme që në temën tonë **Rreth identitetit të asnjansit në shqipen e sotme**, t'i përfshijmë e trajtojmë asnjansit e tillë, si tip më vete dhe i quajtn kryesisht asnjans ablativalë, ose prejrrjedhorë, d.m.th. të rasës rrjedhore. Siç jemi deklaruar në parathënie të këtij punimi, me këtë emërtim përfshimë si grupin e ndajfoljezuar prejmbiemërorë ashtu dhe ata të kategorive të tjera leksiko-gramatikore, pra, edhe rastet e prejpjesorëve të togfjalshëzuar. Patëm të drejtë apo jo, le të vlerësohet.

Ne, në të vërtetë, rreth profilimeve a nënfushave semantike që mbulojnë asnjansit në shprehjet e tilla, qoftë kallëzuesore, qoftë ndajfoljore, ashtu edhe për tipat e tjerë, do të bëjmë fjalë në nëntitullin më poshtë si dhe në kreun vijues, ku bashkë me shembuj karakteristikë do të sjellim edhe ndonjë kontaktim plotësues.

### 3) Çështje rreth përkufizimit të nënfushës semantike të asnjansëve

Pra, kur është fjala tek çështja e përcaktimit a e përkufizimit të fushës e të nënfushave të qartë semantike që mbulojnë asnjansit, duhet pasur kujdes së pari rreth njohjes së lëndës e pastaj edhe përcaktimit më me kompetencë të nënfushave semantike, jo vetëm sipas gjasave, po sipas realieve që mbulonin ose që realisht mbulojnë sot ose prirën t'i mbulojnë në të ardhmen.

Në të vërtetë, lidhur me asnjansit primitivë të paparanyjzuar nuk do të ndalemi gjatë, ngase tashmë dihet se shumica e tyre janë shkrirë në dy gjinitë aktive femërore e sidomos në njëjës e gjinisë mashkullore që po ashtu janë emra sintetikë, por do të ndalemi patjetër pikërisht tek dy tipat e asnjansëve analitikë që i quajmë ndryshe, siç e pamë më sipër edhe asnjans të paranyjzuar të rasës emërore, prejardhja e të cilëve është e ndryshme, por fusha kuptimore që mbulojnë, sot për sot ka të bëjë kryesisht me të shprehurit ose me emërtimin e konceptit abstrakt të *idesë, cilësisë, gjendjes a të qenit* - për prejmbiemërorët, përkatësisht të *konceptit të veprimit* të caktuar - për prejpjesorët. Pse po e (ri)theksojmë në mënyrë të veçantë këtë nënfushë semantike të asnjansëve të paranyjzuar? Menjëherë po përgjigjemi se këtë po e bëjmë për disa arsye, të cilat po i përmendim më poshtë, në pesë pika:

Së pari, sepse kjo nënfushë ose nënprofilet e kësaj nënfushe semantike, sipas burimeve përkatëse, me s a dimë, nuk dalin të vërejtura mirë nga studiuesit e deritashëm. Arsyeja qëndron edhe në faktin se sipas gjase ata, asnjansit e paranyjzuar në shqyrtim, i kanë shikuar jo mirë vetëm si forma të çemëruara që në faza më të hershme nuk mbulonin vetëm një fushë të ngushtë semantike lidhur me fushën e abstraksionit, por e kishin më të gjerë fushën e kuptimësisë së tyre, pra, kishin shtrirje edhe në nënfusha të tjera semantike që sot nuk i kanë, dhe nuk e kanë vërejtur faktin se emrat e tillë nuk

ndeshen vetëm në raste ose vetëm si gjurmë që ende ruhen si relikte në nënprifile të caktuara kuptimore, por që edhe sot ata (asnjanësit e tillë), gjëllijnë, madje të specifikuar qartë në nënfusha të caktuara të veçanta semantike.

Kështu themi pasi ka raste, siç është cekur më përpara, asnjanësit e tillë dalin të shënuar në FShS, së pari, jo për kuptime abstrakte, por për kuptime të nënfushave të tjera semantike, qoftë për të emërtuar gjë-sende konkrete ose të ndonjë profili tjetër, siç janë emërtimet e ndonjë sëmundjeje ose të ndonjë gjendjeje të caktuar psikike të njeriut, por që tashti rastet e tilla, në konkurrencë me termat përkatës zyrtarë, siç mendojmë ne, bazuar në realitetin aktual, kanë pak gjasa ta mbajnë plus edhe atë ose ato kuptime të rastësishme polisemantike. E kemi nxjerr në shesh në krerët e mëparshëm se asnjanësit e paranyjzuar në fjalë janë aktivë dhe produktivë, pikërisht pse e kanë të specifikuar (sipas rregullit të paracaktuar të motivuar nga tema prodhuese) nënfushën e veçantë semantike abstrakte që e mbulojnë, andaj edhe dalin të pazëvendësueshëm me sinonimet përkatëse për atë nënfushë të abstraksionit. Besojmë se lidhur me këtë, në krerët e mëparshëm, kemi dhënë mjaft prova me sqarime të qëndrueshme. Në këtë kontekst po shtojmë se ndonëse ne kemi bindje se konstatimet tona kanë saktësi të qindpërqindtë, megjithatë ajo ende mbetet çështje e hapur, sepse ajo saktësi e qëndrueshmëri duhet të verifikohet, të përkrahet dhe të rekomandohet edhe nga të tjerët, sidomos nga standardologët e gramatikanët e gjuhës sonë.

Së dyti, në kontekst të fakteve, na merr mendja se duhet sqaruar edhe një argument tjetër, jo pak të rëndësishëm. Është fjala se studiuesit e deritashëm, të cilët asnjanësit *en bloc* i kanë konsideruar si joaktivë ose si relikte mbeturinore, dhe për këtë kanë pasur si bazë vetëm një nënfushë semantike, nënfushën e procesit të veprimit përkatës, ku me të vërtetë edhe asnjanësit e paranyjzuar në konkurrencë me format rivale më të reja, femërorë e paranyjzuar si dhe emrat me prapashtesat përkatëse të gjinisë mashkullore ose femërore kanë pësuar rrudhje, por ata (studiuesit) nuk kanë mundur të shohin se asnjanësit e tillë, ç'është e verteta, nuk dalin të rrëgjuar plotësisht, por janë përforcuar, jo fort larg nënfushës së atakuar, duke qëndruar po në të njëjtën fushë të abstraksionit, pra, në një nënfushë tjetër ku *shprehet koncepti i veprimit* përkatës dhe pikërisht në atë nënfushë dalin të pozicionuar fort.

Së treti, kur themi *të pozicionuar fort* kemi parasysh tre faktorë që nuk janë vërejtur sa duhet nga studiuesit e deritashëm e që janë:

E para, **tema e qartë motivuese prejmbiemërore ose prejpjesore** që si të themi drejtpërdrejt reflektohet tek kuptimi i emrit, d.m.th. tek asnjanësi përkatës i paranyjzuar; e dyta, **nënfusha e qartë e specifikuar semantike** që e mbulojnë emrat në fjalë, e cila ka të bëjë kryesisht me majat e fushës së gjerë të abstraksionit dhe e treta, duke e pasur temën e qartë motivuese edhe nënfushën e qartë semantike që e mbulojnë **aktiviteti dhe produktiviteti i emrave të tillë**, varësisht nga konteksti, del me mundësi të pakufizuar shumimi.

Pra, pikërisht këta tre faktorë:

1. **tema e qartë fjalëformuese motivuese,**
2. **specifikimi i nënfushës së qartë semantike** që mbulojnë si dhe
3. **aftësia vepruese dhe prodhimtare** e tyre pa kufizim shumimi,

u ka dhënë jetë e fuqi që emrat e tillë jo vetëm të mbijetojnë me sukses përcëimin a mohimin arbitrar, pa mbështetje, të shqiptuar nga disa studiues jo pa emën, por të shënojnë rritje cilësore.

Sidoqoftë, e keqja qëndron se pikërisht këta tre faktorë, si duket, si koncepte u kanë munguar studiuesve të mëparshëm dhe për të vetmen arsye se tema ose lënda në fjalë, nuk ishte trajtuar atëbotë (vitet '50-'90 të shekullit të kaluar) në hollësinë, thellësinë dhe gjerësinë e duhur. Rreth kësaj çështjeje, ne, kemi bërë fjalë mjaft gjerësisht në krerët e mëparshëm, këtu do të shtonin se problemi në fjalë kërkon zgjidhje të arsyeshme. Sigurisht pasi të verifikohen të tre faktorët e sipërpërmendur, si të saktë, për çka ne nuk dyshojmë, ngase kemi mbështetje në realitetin tonë gjuhësor, por që duhet të miratohen edhe nga kompetentët, atëherë e menjëherë duhet të merret e masat e sanimit të gjendjes sa më parë aty ku duhet e si duhet, pa harruar edhe burimet tona normëzuese.

Së katërti, jo vetëm për pikën e sipërcekur, por edhe për gjëra të tjera, gjithsesi sa më parë lypset neutralizuar mendimet e pasakta dhe përcësuese që kanë mbetur, jo vetëm tek personat e caktuar që më mirë e kanë studiuar ndonjë gjuhë të huaj se të veten dhe tani pak si vështirë e kanë të ndërrojnë atë botëkuptim që u është pjekur në mendje, por aq më tepër ka rëndësi të bëhen korrigjimet e duhura jo aq te personat e tillë, por në burimet e caktuara normative, siç u cel më sipër, në mënyrë që ky proces t'i kthehet normalitetit institucionalisht. **Është fjala për futjen në përdorim të asnjësit të paranyjzuar ashtu si edhe të paskajores së mirëfilltë (me + pjesore e shkurtër) në fushën e abstraksionit, ngase mungesa e këtyre dy komponenteve e ka dëmtuar e do t'i dëmtojë edhe më shumë fushat e kumtimësisë, në radhë të parë të asaj abstrakte në gjuhën tonë.**

Së pesti, s'do mend se çështja duhet të trajtohet esëll, realisht e pa paragjykime, ashtu siç duhet. Në kontekst të kësaj që thamë po e japim edhe një shembull (fjalë-periodhë), që besoj se do të mirëpritet, nga ata që duan ta kuptojnë edhe më mirë se ku qalon ende zgjidhja e problemit:

*E dimë se të shkruarit është një proces i ndërlikuar, por ti vazhdo me shkruarje (së shkruari, me shkruarje, të shkruash, me shkrime, me të shkruar!), sepse vetëm shkrimi i përfunduar dhe i publikuar të nderon intelektualisht.*

Me fjalë të tjera, po sqarojmë se: me të shkruarit, kuptohet koncepti i veprimit, kurse: vazhdo: me shkruarje (me shkrime, me të shkruar a së shkruari) kuptohet vetë procesi i veprimit, ndërsa me emërtimin: shkrimi nënkuptohet rezultati i veprimit (të përfundua a veprat e botuara).

Atë që e thamë se koncepti i asnjësit të shkruarit, si koncept i veprimit nuk konkurrohet plotësisht asesi as nga sinonimi shkruarje as shkrimi, që për procesin e



**veprim** a si ide e konceptuar mund të ndërëmben, ashtu edhe me foljen gjysmëndihmëse **vazhdo (me vazhdue)** që në shprehjen e ngurosor del: *vazhdo + asnjësi në versionin tjetër: Vazhdo së shkruari ose Me vazhdue së shkruari(!)*. Nuk e shohim të arsyeshme të komentojmë më tej versionet e tjera të mundshme sinonimike si: **Vazhdo me shkruar, Vazhdo të shkruash, Vazhdo me shkrime ose Vazhdo të shkruarit(!)**, por po theksojmë edhe diçka që duhet mbajtur mend se për mendimin tonë, nëse dikush tenton ta zëvendësojë asnjësin **të shkruarit** me barasvlerësit sinonimikë **shkruarje** ose **shkrim** si p.sh. *E dimë se shkruarja (!) ose shkrimi (!) është një proces i ndërlikuar*, tregon se nuk e njeh mirë natyrën e të shprehurit të shqipes sot. Në të vërtetë, nëse dikush ka menduar a mendon edhe sot se me një veprim të tillë përkrahet **thjeshtëzimi** në gjuhë, le ta dije se me një *thjeshtëzim(!)* të tillë lëndohet pikërisht **pasurimi** trashëgimor i gjuhës, dëmtohet kultura e gjuhës, zhvillimi e pasurimi i saj, pasurim ky, i cili është përherë më i rëndësishëm dhe më frytdhënës se çdo *thjeshtëzim* arbitrar.

Pra këto ishin disa nga arsyet që ne tërhoqëm vërejtjen për këto çështje, si të thuash, të përgjithshme, sepse del e nevojshme me u njohë e me u precizue më mirë nënfusha e qartë semantike që mbulojnë asnjësit përkatës, pa mohuar në raste edhe ndërëmbimin sinonimik, por vërejtje duhet të tërhequr edhe për disa çështje të tjera të veçanta si me thënë, të jashtme, që po i cekim në vijim.

## 2. Disa vërejtje të tjera për çështje të veçanta

Këtu më poshtë si çështje të veçanta që duhen tërhequr vërejtje për të tre a katër tipat e asnjëseve do të përmendim disa sosh, të cilat i kemi përmbledhur në këto tetë pika:

E para, asnjësit e mirëfilltë të paparanyjëzuar, të cilët tashmë kanë kaluar a janë konvertuar me shkrirje në gjininë mashkullore, as që duhet tentuar t'i kthejmë në gjininë e mëparshme, pos atyre që i njeh standardi ose atyre rasteve të rralla, të lejuara për shkaqe shkencore, letrare-artistike si tipizime, ekzotika, idioma etj.

E dyta, le të dihet se emrat e paranyjëzuar që i ndeshim në shumësin e pashquar në trajtat me mbaresat a fundoret **-a** ose **-e**, edhe nëse ende mund të bartin në vete koncepte të pjesërishme të gjinisë asnjëse, pa mëdyshje, duhet të konsiderohen si emra të gjinisë femërore. Pra, shembujt:

të ëmbëltat, të djerga-t, të qetha-t,  
të vermet-t, të pame-t, të kine-të.

dhe të ngjashem a identikë me ta tashmë duhet me i kategorizue në kuadër të emrave të gjinisë femërore. Ata në shumicën e rasteve përveç formës së shumësit e formojnë pothuajse normalisht edhe numrin njëjës po në gjininë gramatikore femërore. Së këndejmi del se konstatimet e tilla me shenjën (siglën) e asnjësit, që mund t'i ndeshen ende në burime të caktuara, si në Fjalorin e M. Elezit e gjetiu, madje edhe në Fjalorin drejtshkrimor, duhen korrigjuar ose duhen cilësuar si konstatime të vjetruara për letrarishten e sotme,

E treta, trajtat e shënuara sipas ish-variantit letrar të gegërishtes, që i ndeshim në burime të caktuara si dhe disa shembuj në Fjalorin e M. Elezit, si p.sh.:

1) *të cirkun –it, të çiluni-it, të dejun-it, të dekun-it, të djergun-it, të hasun-it, të marrun-it, të vyejtun-it, të pakunit etj.*

2) *të ambëltuem-it, të burruem-it të emnuem-it, të gjatuem-it, të gjimuem-it, të nduem-it, të qëndruem-it, të rruemit, të rryem-it, të sharruem-it, të shtruem-it, të vetuem-it etj.*

3) *të për bamë-t, të për bimë-t, të zhbëmë-t, të ramë-t, të vumë-t etj.*

4) *të famë-t, të kshten-ët, të mbarshëm –it, të mujshëm –it, të cegëm –it të kien-it, të hangërn-it!, të për hijem-it, të për marrshëm –it etj.*

sipas mendimit tonë, është mirë me i përpunue paksa semantikisht, ndërsa drejtshkrimisht, nuk bëhet aspak keq të harmonizohen me normën në fuqi. Por, duam të themi, se gjatë këtij përpunimi a verifikimi, duhet veçuar ndonjë ose jo pak raste si shembuj të veçantë, të cilët mund të jenë të lejueshëm të konkurrojnë edhe në trajtë-formën e ish gegërishtes letrare, nëse kemi të bëjmë me karakteristika të veçanta të jashtëzakonshme ose nëse kemi të bëjmë me shfaqje të një koncepti të ri ose të pambuluar mirë me trajtat e letrarishtes së sotme (toskërishtes), siç janë, b.f. shembujt: *të tëpanët, të emnuemit, të burruemit* e ndonjë tjetër. Rastet e tilla të nevojshme arsyetohen, madje edhe më me shumë të drejtë seç arsyetohen fjalët e shprehjet lapidare me paskajore si dhe shprehjet e huaja karakteristike si slogane që *kopjohen në origjinal*, ose kalkëzohen, për të cilat për hir të autenticitetit që shprehin gjuha, stili ose situata i pranon, sigurisht kur ka nevojë për to. Nuk është fjala vetëm për terminologji tekniko-shkencore, por edhe për ekzotika a raritete ose për fjalë e shprehje karakteristike të jashtëzakonshme, të cilat, po të për vetësohen me kriter po në atë formë shkrimore gjithsesi do ta pasuronin edhe shprehjen e gjuhës sonë me koncepte të reja pa e rënduar dukurinë e polisemisë. Në të vërtetë, kështu edhe gjuha jone letrare (standarde) duhet të pasurohet me fjalë e shprehje (koncepte) të reja karakteristike të trevave përkatëse, siç është vepruar në FGJSH 2006 me trajtat geqe: *gjakhupës, lëshuemas, shkueni, burri, cucëni, çikëni* përkrah *vajzëri, çupëri* e ndonjë tjetër. Aq më tepër një veprim i tillë është i lejueshëm, kur një e drejtë e tillë universale del e arsyeshme kur koncepti i veçantë mbulohet natyrshëm nga norma globale e vetë gjuhës amtare.

E katërta, të diskutueshme drejtshkrimisht dalin edhe trajtat me fundoren *–ë, si të brutë-it, të çarë-it, të dhimë-it, të hymë-it, të ndrytë-it, të për qethë-it, të sëmutë-it, të shpejtë-it, të shumtë-it, të vrantë-it*, të cilat, siç e pamë nga shembujt e vjelë nga FShS (2006), sipas rregullës duhet të shquhen me *–t* jo me *–it*, pra asnjësi *të brutë-t* sipas rregullës në fuqi duhet drejtshkruar *të butët* etj., ngase siç u pa nga pasqyra, asnjësit që mbaronin me *–ë* fundore në temë e ruanin *ë-në* e temës në trajtën e shquar, kur në shumës marrin një-mbaresën *–t*. Nuk shohim kurrfarë arsyeje që mos të respektohet kjo rregull drejtshkrimore edhe në rastet e tilla kur kemi të bëjmë me asnjësit.. Por nuk duhet të na hutojnë shembujt e tillë nga tradita ose nëse i ndeshim me *–it* mbiemrat e emëruar të këtij tipi në shumësin e gjinisë mashkullore, krahaso mbiemrin (të emëruar mashkullor): *i butë i buti të butë të butit* (emëzim njeriu) ndaj *të butët* (asnjanës).

Sigurisht kjo rregull që i dallon formantet e shquarsisë në raportin: *asnjanës i paranyjzuar prejmbiemëror / emër (njeriu) i paranyjzuar prejmbiemëror*, si b.f. trajta **të drejtët** do të përforcohet apo jo, varet nga standardologët tanë. Në drejtshkrimin e

rinuar të ardhshëm mund të futet rregulla që trajtat me **-ËT** fundore t'i takojë asnjansit përkatës, kurse trajta tjetër me **-IT** fundore, tipi **i drejti** (njëjësi shquar) **të drejtit** (shumës) t'i takojë emrit të përgjithshëm të njeriut, atëherë do të zgjidhej edhe kjo dilemë. Krahaso, në një rën anë asnjansit e paranyjësuar. *të përzierët*, (g. *të përziem't ose të përzien't*, *të lyerët (të lyem't ose të lyenët)*,, *të ngjyer-ët (të ngjyem't ose të ngjenët)*), *të marrët a të çmendurët (të çmendun't)* etj ndaj emrave të përgjithshëm frymorë të gjinisë mashkullore (prejmbiemërorë e prejppjesorë) në anën tjetër: *të përzierit* (g. *të përziemit*), *të lyerit-t (të lyemit)*, *të ngjyerit të ngjyemit*), *të marrit a të çmendurit (të çmendunit)*. Gjithsesi trajtën e letrarishtes së sotme shkrimisht ne e quajmë me konkurrencë të fituar. Përndryshe, rastet e tilla mund t'i bashkohen grupit të prejppjesorëve nga foljet përkatëse, ngjashëm si shembujt me prapashtesën **-I/T** si të ardhurit, të shkëlqyerit etj., me një **i/** anapetike para nyjë-mbaresës **-t** të shumësit.

Nuk dimë sa ka të drejtë prof. Kolec Topalli, që përkundër rregullës, të parapëlqejë për asnjansit nyjë-mbaresën e mashkullores **-it**, ndaj asaj të normuarës **-ë/t** tek rastet: *të ftohtit të ngrohtit*. (Shih: *Seminari 26/1*, Prishtinë 2007 f. 213. Siç e pamë në disa shembuj të folmet veriore përhapje më të madhe ka trajta me **-IT**. Sidoqoftë, po përsërisim, kjo mbetet punë për standardologët për ta përcaktuar e rekomanduar më mirë zgjidhjen e duhur.

E pesta, çështja e trajtës përfaqësuese të asnjansit të paranyjësuar mbetet problem paksa i hapur. Themi *paksa*, sepse mbizotëron logjika që si trajtë përfaqësuese e asnjansit të paranyjësuar të shërbejë trajta e njëjësit të shquar e jo ajo e pashquara. Kështu është vepruar në të shumtën e rasteve në fjalorët përkatës dygjuhësh që konsultuam, por edhe në raste të trajtimit të temës në fjalë. Sidoqoftë, meqë, siç u cek më sipër, mëdyshja rreth përcaktimit të trajtës së pashquar ose të shquar te asnjansit, nuk del e zgjidhur edhe sot e kësaj dite, andaj del e drejtë kërkesa që standardologët (komisioni përkatës) ta thonë fjalën e tyre përfundimtare më me kompetencë.

Ç'është e vërteta, për emrat e mbiemrat në përgjithësi (femërorë e mashkullorë) përmendet trajta e pashquar si trajtë përfaqësuese, po a vlen kjo edhe për asnjansit apo bën përjashtim kjo nënkategori lypset sqaruar. Siç e pamë në *Fjalorin e shqipes së sotme* nuk përcaktohet trajta përfaqësuese, ngase mbaresa e shquarsisë ndahet me vizël nga trajta e pashquar, andaj siç u tha, kjo mbetet çështje e hapur. Për mendimin tonë trajta e emrit të paranyjësuar e njëjësit të shquar të emërores, si trajtë e ngurosur përfaqësuese, në kontekste të caktuara, del më e përkapshme formalisht e semantikisht, kundrejt trajtës së pashquar. Themi kështu ngase tema bazë e trajtës së pashquar nuk dallohet formalisht nga trajtat e dy gjinive të tjera. Krahaso: m. i mirË, e mirË ndaj të mirË, ndërsa njëjësi i shquar përveç nyjës së përparme dallon edhe sa u përket nyje-mbaresave të shquarsisë: m. i mirë i miri-i të mirë të mirët, f. e mirë e mira të mira të mirat, ndërsa asnjansi (vetëm njëjës): të mirë të mirët.

Prof. Sh. Demiraj rreth kësaj teme, ka dhënë shpjegim të pranueshëm me këto fjalë:

*“Në gjuhën shqipe ashtu si edhe në gjuhë të tjera të pajisura me nyje, përdorimi i emrit me nyjën shquese ose me përcaktorë të tjerë të paravendosur është pakrahasim më i rëndomtë se përdorimi i trajtës së pashquar të paraprirë me ndonjë përcaktor a parafjalë. Një dukuri e tillë është pasojë e drejtpërdrejtë e*

*kufizimit gjithnjë e më të madh të aftësisë së emrit për të qenë i vetëmjaftueshëm në gjuhët e pajisura me nyjë, sidomos në një varg funksionesh sintaksore, ku emri përdoret më fort me kuptim të individualizuar, siç janë funksionet e kryefjalës, kundrinorëve, rrethanorëve dhe të përcaktorëve emërore. Në këto funksione trajta e shquar zakonisht i kundërvihet trajtës së pashquar të prirë nga nyja joshquese ose nga ndonjë tjetër përcaktor individualizues”. (Shih: Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1988, f. 406.)*

Prandaj në përputhje me shpjegimin e prof. Sh. Demirajt edhe ne po shprehemi në dobi që trajta e shquar e njëjësit të asnjansit të shërbejë si trajtë përfaqësuese (ose mbizotëruese) siç del në vërtetë, sidomos në analiza, mirëpo në situata të caktuara varësisht nga konteksti të dyja trajtat e asnjansit (e shquara edhe e pashquara), mund të përdoren normalisht, sidomos kur është fjala tek shprehjet frazeologjike të trashëguara si dhe në të gjitha rastet e tjera kur natyra e të shprehurit lejon.

E gjashta, çështja e përzgjedhjes së pjesores së shkurtër ose të zgjeruar, sipas praktikës së deritashme të normës në fuqi, pothuajse del e zgjidhur, ngase nuk vihet në dyshim pjesorja e shqipes letrare tek formimi asnjansit prejpjesor, ashtu si edhe tek mbiemrat prejpjesorë, por në raste të veçanta pjesorja e shkurtër mund të shfrytëzohet, siç ishin shembujt paralelë, tipi: *të qeshët* (me qeshë) dhe *të qeshurit* / *të qeshunit!* (nga qeshur me qeshun!!) etj.

Pra, për mendimin tonë pjesoret e zgjeruara me **-un** veç ndonjë rasti tejet karakteristik: *të pakunit*, *të hasunit*, me kuptimet e veçanta nga FGjSh 1954), që të gjitha duhet me dalë të zëvendësuar me **-ur** fundore të letrarishtes, ndërsa ato më pjesore të shkurtër mund të jenë të tolerueshme, pse jo, vetëm si pjesë e rezervës në raste kur paraqesin kuptimësi të veçantë, që mund t'i kundërvihet me ndonjë arsye pjesores së zgjeruar të letrarishtes.

Sido që të jetë, një mënyrë e tillë fjalëformimi që sfidon në ligjërime (pjesorja e shkurtër) shpesh qëndron si rezervë e gjallë, po përsërisim, sa herë që e kërkon nevoja, sidomos për ato koncepte që nuk janë mbuluar tërësisht ose kënaqshëm me formën e pjesores së zgjeruar të letrarishtes së sotme dhe kjo mundësi e rezervuar për mendimin tonë mund të quhet si pasuri rezervë potenciale ose si thesar rezerv që në rast nevojë nga ligjërimi përkatës mund të shfrytëzohet a të gjallërohet edhe në standardin e përbashkët.

E shtata, gjithsesi, mendojmë se nuk duhet përfillur kursesi kërkesën që asnjansit mbi bazë të foljeve apofonike dhe të tjera me pjesore të shkurtër të shkruhen ndryshe nga norma, me arsyetimin se gjoja ashtu kanë përdorim të gjerë në burime të traditës. Pra jo. *të nxjerrurit*, *të sjellurit*, *të qenunit* a *të qenurit*, *të marrunit* a *të marrurit*, *të pjellurit*, *të vjellurit*, po: *të nxjerrët*, *të sjellët*, *të qenët*, *të marrët*, *të pjellët*, *të vjellët*, e kështu me radhë.

E teta, edhe tek tipi i katërt asnjansit në shprehjet ablativale (prejrrjedhore), si p.sh.

**Mbarova së foluri, u lodha së prituri, plasi së qari; ecëm së bashku, u përsëndetëm prej së largu a për së largu; së paku e së toku ; për së pari a pikë së pari, së joshuri, së bleri etj.**

që përfundojnë padyshim me mbaresën–**u** ose **-i** të mashkullores në njësin e shquar, padyshim dëshmojnë konstatimin e drejtë të prof. Sh. Demirajt, që fundorja **–i** ose **–u**, është tipar i njëjësit të emrit të pashquar të rasës emërore e rrjedhore, por lidhur me këtë mund të shtrohet edhe këto pesë çështja që kërkojnë sqarim:

Së pari, kjo **–i, fundore**, (edhe pse refleksi arkaik i rasës rrjedhore) sa ka lidhje me reflektimin analogjik të tingulli anapetik, si të shembujt kur *plasi së qari, u kënaqa së pari etj.*, kur dihet se pjesorja si temë prodhuese e shembujve të tillë pjesorja *parë, qarë*, përfundon me zanoren **–ë** (prapashtesa **–rë**). Krahaso *qarë, parë*, dhe se asnjësi prej pjesor mbi këtë bazë, tipi i tretë, siç e pamë, dilte me **–ë/t fundore: të qarët, të parët**.

Së dyti, është e vërtetë se në ligjërimi të lira dëgjohet edhe trajta e emrave të tillë me **–i/t** ose **–u/t** fundore si b.f: **u lodha së priturit, plasa së qarit, pikë së parit: paraqitu së pakut, përshëndetje prej së largut** etj., me fjalë të tjera sa është e lejueshme prirja e tillë e hetueshme që mbarësia e asnjësi të tillë me kaluar në trajtën e mbarësës së shquar. **–i/t** ose **–u/t**.

Së treti, *gjymtyra e dytë*, (asnjësi prej rrjedhor, nga shprehjet e tilla si p.sh *u përshëndetëm prej së largu* (nga larg!), objekti *u kontrollua* (prej) *së jashtëmi* e (prej) *së brendshmi* (nga jashtë e nga brenda) mund të ketë edhe marrëdhënie të tjera rrethore e jo vetëm atë të shkakut që e përmend prof. Sh. Demiraj, apo jo?

Së katërti, mendojmë se trajtimi i raportit ndërkuptimor i dy grupeve të asnjësve prej pjesorë, kur kemi parasysh edhe implikimin e rasave (prej emërore dhe prej rrjedhore), do të na jepte rezultate, jo të parëndësishme, apo jo? Lidhur me këtë, tash për tash, mund të themi, se të dy tipat i lidh procesi i veprimt. Ndërsa asnjësi prej pjesor i rasës emërore kryesisht del i specifikuar për të shprehur konceptin e veprimt në fushën më të lartë të abstraksionit, ndërkaq anjanësi prej pjesor i rasës rrjedhore del i specifikuar për të shprehur një pikë të atij procesi që ka të bëjë me mbarimin e veprimt ose rrjedhojën (pasojën) e atij veprimi. Le të krahasohet konstrukt i dhe kuptimi i kësaj fjalie, në tri versione:

**Të punuarit bashkë na kënaqi / U kënaqëm së punuari bashkë/Të punuarët së bashku na kënaqi**

Së pesti, edhe lidhur me **togfjalëshit gjysmë të lirë**, tipi: folje + asnjësi ablatival si p.sh. *mbarova së foluri* ose *mbarova së ftohti*, si veçori e parë konstatohet se vetëm asnjësi del i ngurëzuar, ndërkaq folja jo. Nga shembujt që i volëm nga burimet përkatëse të përmendura si faktorë kemi këtë gjendje: 5 shembuj me foljen **mbaroj** (me mbarue): *mbaronte, mbaroi, mbarova, kishte mbaruar* + asnjësi, gjithashtu: 5 raste me foljen pushoj (*me pushue*): *pushova, kishin pushuar, pushojnë, pushoi*, mirëpo dalin edhe folje të tjera si: *u lodha së.., u ngjira së.., këputesha së..* – me fjalë të tjera folja si gjymtyrë e parë nuk është e ngurëzuar, ngase ajo eptohet sipas numrit, vetes, kohës, diatezës.

Sidoqoftë, harmonizimi dhe verifikimi i konstatimeve edhe lidhur me këtë del i nevojëm.

## **Sipërfundim**

Siç po shihet rastet e hapura janë të lehtëzgjithshme dhe të lehtëpranueshme, vetëm se duhet me pasë vullnet për respektimin e të arriturave të deritashme shkencore dhe njëherazi shtrohet nevoja që të bëhen harmonizimet e nevojshme me normën në fuqi të gjuhës shqipe, e cila në ndonjë rast edhe mund të përplotësohet e përkryhet, po kjo ndërhyrje eventuale duhet bërë ose mirartuar në mënyrë institucionale.

Po e përmbylim këtë krye të punimit me konstatimin se do t'i ishte mëkat i madh nëse nuk përfilllet prodhueshmëria e asnjansëve, përkatësisht nëse vazhdohet edhe më me praktikën përçmuese të deritashme të viteve '70-'90, rreth kësaj kategorie gjinore, do t'i bëhej dëm i pafalshëm ndaj gjuhës shqipe, sepse me një veprim të tillë do të vijojë të varfërohej edhe më ligjërimi i shqipes në përgjithësi dhe të shprehurit normal ti natyrshëm i shqipes standarde në veçanti.

Edhe trajtimi i mëtejshëm asnjansëve prejpjesorë të rasës rrjedhore që në këtë punim u trajtua si tip më vete shtron nevojën që kjo temë kur të studiohet edhe më në hollësi e thellësi dijes sonë mbi gjuhën e gjuhësinë do të sjellë me siguri rezultate dobiprurëse..

## VIII. MENDIMI PËRMBYLLËS PËRGJITHËSUES RRETH IDENTITETIT TË ASNJANËSVE NË SHQIPEN E SOTME

### 1. Konstatime përgjithësuese

Nëse deri këtu kemi arritur me përpjekjen tonë sadopak ta paraqesim çështjen rreth vetëvetësisë a identitetit të asnjansve në shqipen e sotme, atëherë na mbetet që në fund ta japim mendimin përgjithësues përmbyllës rreth kësaj teme.

Nga analiza doli se për nga forma dhe koncepti që mbulonin dhe mbulojnë në kuadër të strukturës emërformuese të shqipes në përgjithësi, asnjansit, që të katër tipat, dalin të identifikueshëm, si tipi i asnjansit primitiv (të paparanyjëzuar), dy tipat e paranyjëzuar (prejmbiemërorët dhe prejpsesorët) si dhe tipi i asnjansit ablatival, i togfjalshëzuar me folje dhe i ndajfoljezuar me shprehje prejrrjedhore.

Mirëpo, ndërsa tipi i parë ka pësuar pakësim numri në përdorim, ose rrudhje, madje edhe zhdukje jo në pak raste, duke u shkrirë kryesisht në trajta të dy gjinive të tjera aktive, sidomos në njëjës in e mashkullores, dy tipat e tjerë, qoftë prejmbiemërorët, qoftë prejpsesorët, edhe pse kanë prejardhje të ndryshme motivuese, dalin të specifikuar në një nënfushë të veçantë të abstraksionit dhe janë mjaft aktivë e prodhimtarë në ligjërimin e sotëm. Kështu këta dy tipa arritën, jo vetëm të mbijetojnë në luftën e konkurrencës me sinonimet përkatëse, por edhe të shënojnë rritje numri, ngase nënfusha semantike që mbulojnë u mundëson atyre një gjallërim të tillë. Me fjalë të tjera, ndonëse prejmbiemërorët u ballafaquan me emrat me prapashtesat më **-i** (disa versionesh, sidomos ato me **-si, -ri, -shmëri**) që këta si emra kuptimi kryesisht i përkasin po ashtu fushës së abstraksionit, ashtu si edhe prejpsesorët e tjerë, të cilët u ballafaquan me emrat me prapashtesat **-im, -je, -esë** e ndonjë tjetër, por sidomos me dy të parat, që dalin edhe këta të specifikuar për emërtimin e koncepteve abstrakte, megjithatë ata (asnjansit e paranyjëzuar të rasës emërore), të dy tipat, mbeten, jo vetëm të pandryshueshëm formalisht sa i përket nyjës së përparme, por për çka është edhe më e rëndësishme, ata mbeten të pacenueshëm edhe nga ana semantike, sepse në konkurrencë e sipër u specifikuan, siç është cekur disa herë, në këtë punim në një fushë të veçantë për mbulimin e një nënfushe sinonimike në kuadër po të fushës së abstraksionit, ashtu ngjashëm si edhe emrat sinonimikë prapashtesorë, me të cilët, si me thënë, i ndanë nënfushat semantike fqinjësisht, *trizash*, siç e kemi argumentuar mjaft qartë e bindshëm në kërret e mëparshëm të këtij punimi.

Tipi i katërt, edhe pse del si emër asnjans i formuar (emërzuar) qoftë nga pjesorja, qoftë nga mbiemri ose edhe nga ndonjë kategori tjetër leksiko-gramatikore, ai sa u përket veçorive fjalëndërtuese e kuptimore ndryshon nga dy tipat e paranyjëzuar. E thamë *fjalëndërtuese*, sepse prejardhja e tij nuk është nga rasa emërore, si e dy tipave të sapocekur, por nga rasa rrjedhore, nga e cila e ka të trashëguar nyjën e përparme arkaike **së** dhe fundoren **-i** nga njëjësi i pashquar i emrit dhe këto dy tipare të emërzimit i bart në të gjitha funksionet që i kryen si trajtë e ngurëzuar. Së këtejmi, kjo formë ndërtuese me

funkcionet kuptimore që kryen në nënfusha të caktuara semantike në gjuhën e sotme letrare shqipe gjithnjë e më shumë priret të specifikohet, qoftë si pjesë e togfjalëshit kallëzuesor, qoftë si kundrinor, qoftë edhe si ndajfolje ose si shprehje ndajfoljore.

Sidoqoftë, anashkalimi a injorimi pa qëllim të keq, që u është bërë në të kaluarën, jo të largët të tre tipave të asnjansëve të paranyjzuar, duke mos u dhënë vendin e merituar teorikisht, gramatikisht e leksikisht në ndonjë burim normativ ose praktikisht në krijimtarinë letrare-artistike, po edhe në stile të tjera, nuk dimë sa mund të cilësohet si lëshim i falshëm, pasi supozojmë se funksioni i tyre nuk njihej sa duhet, por, me sa u shtrua deri këtu, mund të themi me plot bindje se një veprim i tillë injorues ka lënë pasojat të pamira, jo edhe aq të vogla përgjithësisht në opinionin tonë të gjerë ligjërimit, te ne e gjithandej dhe aq më keq edhe te ndonjë intelektual me profesion gjuhëtari ose krijuesi letrar. Fundi i fundit, ndodhi si ndodhi në periudhën që konsiderohet e sapokaluar (vitet '50-'90 të shekullit që sapo lamë pas, ne ngulmojmë që sot e tutje, çështja e këtyre asnjansëve, duhet me u rishikue patjetër, ngase mund të bëhet mëkat edhe më i madh dhe i pafalshëm, nëse tashembastashti në burimet tona normative nuk i jepet vlerësimi i duhur ose vendi i merituar kësaj kategorie, në kuadër të mozaikut të sistemit tërësor emëror të shqipes.

Për mendimin tonë ia vlen të ritheksohet fakti se asnjansësit e paranyjzuar tipi prejmbiemëror dhe sidomos ai prejppjesor i rasës emërore për konceptin e abstraksionit të lartë që shprehin nuk bënë të cilësohen assesi të zëvendësueshëm me emrat e caktuar abstraktë të prejardhur, përkatësisht me emrat me **-si** e variantet e tjera, *tipi të mirët, mirësi ose e mira, i gjallë – gjallëri* etj. ose me emrat prapashtesorë tipi prejppjesor me **-IM** ose **-JE**, tipi i asnjansësit prejppjesor: *të shkruarët a të shkruarit - shkrim, shkruarje, të ecurët e të ecurit - ecje*, e kështu me radhë. Madje duhet pasur kujdes që edhe nëse ndodh ndonjë rast konvertimi i përcaktuesve të emrit përkatës me gjininë mashkullore jashtë suazave të lejuara, ajo anomali duhet të korrigjohet ose të konstatohet si rast e jo si prirje përgjithësuese që duhet përkrahur ose sanksionuar normativisht.

## **2. Përkufizimi përmbyllës rreth profilimit të nënfushavesemantike që mbulojnë të katër tipat e asnjansëve**

Në fund do të përpiqemi që me një tekst të shkurtër përmbyllës të përfshijmë të gjitha profilet e nënfushave semantike të diktueshme që mbulojnë të katër tipat e asnjansëve:

### **a) Asnjansësit si emra primitivë të paranyjzuar**

Është konstatim i drejtë që asnjansësit e mirëfilltë primitivë, tipi: *drithë-të* (drithi), *djathë-të* (djathi) etj. për arsye se si fusha e asnjansësisë së shembujve si dhe vetë nënfusha semantike që mbulojnë del heterogjene dhe e konkurrueshme me trajtat e dy gjinive të tjera aktive, evolucionisht kanë pësuar, si me thënë, shkrirje, sidomos në njëjës in e gjinisë mashkullore, proces ky që arsyetohet me veprimin e thjeshtëzimit që mbretëron atavikisht, ashtu siç ndodh edhe në gjuhë të tjera. Mirëpo lidhur me asnjansësit



e shqipes në fjalë, shkrirja e tilla nuk është kryer në disa raste, siç janë **ujë-t**, **krye-t** e ndonjë tjetër që ende në atë gjini qëndrojnë aktivë në përdorim të përditshëm. Po si këta ka edhe emra të tjerë me kuptimësi të veçantë që dalin herë-herë në stile të caktuara përdorimi, aq më tepër në frazeologjizma ose në togfjalësha a shprehje të ngurosura të qëndrueshme, të cilët si drejtshkrimisht, ashtu edhe semantikisht janë të tolerueshëm, ngase konsiderohen, siç janë në të vërtetë, një pasuri e trashëguar, pasuri kjo që hyn në punë, madje mund të ripërtërihet me ndonjë shembull të ri prodhues e veprues, por në raste të rralla, dhe analogjikisht.

Sidoqoftë, edhe tipin e tillë e ndeshim në këto profile në kuadër të nënfushave përkatëse semantike:

1. në disa frazeologjizma a shprehje të veçanta si: *Më ngjethët mishtë; të hëngërsha grurët. me leshtë përpjetë; rrushtë e qenit, gruntë e (h)ashures; vajtë e nuses nën duvak; mos ia nxirr ujë-t (kësaj pune - mos e tepro), leshtë e Currit, e ndonjë tjetër;*

2. në situata, kur emrat e parmë ruajnë një kuptim të veçantë, të specifikuar, madje edhe si terma popullor, jo zyrtar, si b.f.: *dhjamët* (në mjekësi), *ujët e hollë, ujët e trashë, tëlyntë për laknorë, tëlyntë për pushkë* etj., ashtu si edhe në shprehjen: *Mjerë pitja e shpisë që pret tëlyntë (gjalpët) e kojshisë*, e ndonjë tjetër.

3. në raste përdorimi të emrave në trajtë të veçantë, si:

a. **ballë-t**: *Me ballët lart!, Mos e rrudh fort ballët se t'plasin damarët: Puhia ballët ta lëmon, zavallet t'i largon*, e ndonjë tjetër;

b. **krye-t** (me kuptimin kokë): *Më dhemb kryet, e sidomos në fjalë të urta: frazeologjizma: Kallini i lehtë kryet përpjetë. Shëndosh kryet se kësula (kapuç) ka boll. Me çue fort nalt kryet, para nuk të shohin sytë. Më mirë me të mbytë se me pallavra me ta mbushë kryet. I vërteti, kryet me veti* etj.

Marrë në tërësi aktivizimi i emrave të rij të këtij tipi nuk del i favorizuar në stilin neutral të shqipes standarde, prandaj karakteri mbeturinor i përgjigjet, pothuaj, plotësisht vetëm këtij tipi të asnjansve, por siç e kemi cekur edhe më përpara edhe emrat ose format. e asnjansve të paparanyjzuar mund të shfrytëzohen për koncepte të caktuara, sidomos në fushën e abstraksionit në formë frazeologjizmesh ose të shprehjeve të veçanta.

## **b) Asnjansit mbi bazë të mbiemrave të paranyjzuar**

Asnjansit prejmbiemërorë të paranyjzuar për konceptin që shprehin janë aktivë dhe nuk i shtrohen tkurrjes as zëvendësimit me sinonimet përkatëse me emrat e prejardhur cilësorë me prapashtesat fjalëformuese, **-si**, **-ri** e ndonjë tjetër (me të cilët qëndrojnë në sinonimi), ngase kuptimisht dalin të specifikuar për mbulimin e nënfushës së veçantë semantike sinonimike po në fushën abstrakte.

Shembuj të këtij tipi i ndeshim në këto nënfusha semantike të profiluara:

1) për të treguar koncepte cilësie, me shembujt e nëntipit:

*të mirë-t, të gjallët, të keq-të, të kuq-të ...etj.*, si b.f.: *As të mirët as të keqtë nuk harrohet lehtë. Të bardhët e shpirtit shprehet me buzëqeshje, ndërsa të zitë e shpirtit shprehet me rrudha të ballit. Të mërroltë e të murrte nuk ia pëlqen, ndërsa të çeltë e kuqtë, po. Hiq të mbrapshtë, merr të mbarët!* etj.

Me fjalë të tjera mundësia e përdorimit a e shfrytëzimit të asnjansve prejmbiemërorë cilësorë nuk del e kufizuar;

2) për të treguar një gjendje a të qenë (kohë, ndjenjë), si p.sh.:

*të ftohtët, të fikët, të ligët mos i provofsh, po nëse të bien hise duhet t'i durosh. Shkoi të shumtë mbeti të paktë. As të shmajtë as të djathtët, por të drejtë e të naltë duhet me i përkrahë. Të përmaltë si të përhantë ashtu si të përfushtët dhe të ngushtët - janë sjellje që nuk durohen dot.*

Edhe aktivizimi i asnjansit të këtij profili që tregojnë gjendje etj., varësisht nga konteksti, del me mundësi të hapur, të pakufizuar shumimi;

3) Në disa ndërtime me parafjalën **për**, si:

*E mori për të butë e ai ia qiti trutë. E bleu për të lirë. Ia bleu për të kuq, Ia mori për të keq etj.;*

4) Në disa shprehje a lokucione ndajfoljore të formuara nga parafjala **me** + **mbiemri** i **substantivuar** i **gjinisë asnjansë**, si: *E mori me të keq, I foli me të mirë, I foli me të butë. Iu përgjigj me të qeshur, U soll me të urtë (me të egër). Mos e merr punën me të nxehtë, po me të ftohtë e me të ngrohtë. Mos folni me të mujshëm etj.;*

5) Tek emërtimet e gjë-sendeve konkrete ose në shprehje figurative, p.sh.:

*të trashtë e surlës, të zitë e ullinit, të bardhët e syrit, të kuqtë e mollës, të verdhët e synit etj.;*

6) Në shprehje të veçanta, si:

*(zgjidh) jo të keqtë e të përdreqtë, po ti mirët e të ndreqtë. Vetëm me të kuqtë e të bardhët, puna s' merr të mbartë! etj.*

Materiali i përmendur në të gjashtë nënfushat, përkatësisht, në të gjitha pikat e mësipërme, tregon shtrirjen e përdorimit të këtij tipi dhe njëkohësisht aktivitetin dhe prodhimtarinë e hapur ose të pakufizuar shumimi të këtij tipi, në kontekste të caktuara, varësisht nga numri i vetë mbiemrave.

### **c) Asnjansit prejpjesorë të paranyjësuar në rasën emërore**

Asnjansit e paranyjësuar mbi bazë pjesoreje të cilët janë aktivë e produktivë, andaj si të tillë nuk i shtrohen tkurrjes as zëvendësimit me emra prejpjesorë prapashtesorë me **-im** ose **-je** dhe të tjerë, ngase edhe këta, si asnjansit prejmbiemërorë të rasës emërore, madje edhe më tepër se ata, dalin të specifikuar kryesisht për mbulimin e nënfushës së veçantë semantike në kuadër të fushës së gjerë të abstraksionit, që ka të bëjë ekskluzivisht me konceptin e procesit të veprimit abstrakt ose të idesë së konceptuar të dukurisë a të veprimit të caktuar në zhvillim e sipër ose jo, numri i të cilëve varësisht nga konteksti del i shtrirë në disa profile a nënfusha semantike, si p.sh.

1) Tipi: i prejpesorëve me kuptim përgjithësues në kuadër të togfjalëshave, shih të dy versionet:

a) *të punuarit* (të kënduarit, të ecurit, të vjershëruarit, të shprehurit, të. *shkruarët a të shkruarit, të ecurit, të hyrët, të ngrënë, të menduarit a të menduarët etj.*) si *art, është një veprim, mënyrë a dukuri etj.* shumë e pëlqyeshme ose

b) *arti* (veprimi, mënyra, dukuria..) i (e) *të punuarit* (të kënduarit, të ecurit, të vjershëruarit, të shprehurit...) etj. është një punë shumë e pëlqyeshme.

2) Në disa fjalë-terma të mirëfilltë, kur emri i nyjshëm asnjans del i terminologjizuar, si *të folurit* (në gjuhësi), *të menduarit* (në logjikë, filozofi), *të rrezatuarit* (në fizikë, në fizioterapi), *të ushtruarit* (në fizkulturë) etj. Edhe në këto nënfusha si raste, asnjansi ka mundësi të pakufizuar shumimi;

3) Në shprehjet: *në të hyrë të vjeshtës, në të dalë të dimrit, në të ngrysur të ditës, në të përfunduar e sipër të veprimit, në të hyrë të syrit të pranverës etj.*

4) Në disa frazeologjizma a togfjalësha të veçantë, me togun: *me një + pjesore e nyjzuar*, si: *me një të goditur, me një të shtënë, me një të rënë; me një të ramë dy të vramë ose me një të ranë dy të vranë!* etj.;

5) Në disa togfjalësha të tipit: *trajtë e foljes me pasë + pjesore e nyjzuar*, si: *s'ka të sosur, s'ka të mbaruar, ka të sjellë të mbarë, ka të prurë të begatë; ka një të goditur të fortë, keni të shkuar të shkëlqyer, kishte një të ecur të bukur etj.*

6) Në shprehje sqaruese kumtimi, si *të bërët sehir, të qenët i drejtë, të dhënë e fjalës, të qeshurit e fytyrës, të marrët me të mirë, të sjellët me të keq, të kthyerit mbarë, të marrët me mend etj.* Edhe në këso rastesh përdorimi i asnjansit pothuajse është i pakufizuar.

7) Në shprehje të veçanta, si: *jo të lyentë e të ngjyentë, por të vyemtë; të ngrënë e të pirët, të sjellin të mirët;*

8) Në shprehje të togfjalësha të lashtë, si: *sa të blemit, sa të zbutunit, sa të prashitunit etj (A. Zymberi)*

9) Në shprehjet *nëpër të korrin, nëpër të mihun, nëpër të lavrueme etj.* (sipas A. Zymberit).

10) Në shprehjet kur para asnjansit përdoret parafjala **në**, si p.sh: *çështja nuk qëndron vetëm në të shqiptuarit (të shikuarit, të analizuarit) e drejtë etj., por...* - numër i pakufizuar;

11) Në shprehjet ku para asnjansit përdoret parafjala **për**, si: kur është. *fjala për të gjykuar (për të shqiptuar, për të imituar ...etj)* - numër i pakufizuar.

12) në shprehjet: *çfarë të punuari, çfarë të shkruari, çfarë të arsyetuari?! etj.* (sipas A. Zymberit).

13) Në formimin e formave të pashtjelluara a të togjeve të foljeve si p.sh.:

a. me+pjesore të nyjzuar (paskajorja e dytë): *për të dalë, për të folur, për të lëvduar, për të punuar, për të qarë etj.*

b. me + pjesore të nyjzuar: *me të punuar, me të qeshur, me të ngjeshur, me të shtirë e me të pështirë dhe as me të lyer e me të ngjyer (nuk çohet dot jeta), u tërhoq me të bartur të trupit, s' mbahet shpija me të lypur etj. si dhe*

c. një+pjesore të nyjzuar: *një të punuar, një të lehur të qenit, një të ecur, një të shkelur (të syrit) etj.*

14) Në njësi frazeologjike, me parafjalën **më**: si *më të djathtë, më të ngrysur, më të lumtët etj.;*

15) me parafjalën **ndaj**, si: *ndaj të gdhirë, ndaj të ngrysur;* (qëndrimi) *ndaj të mësuarit, ndaj të punuarit etj.;*

16) në sqarimin e kuptimit të emrave, si p.sh: *mbarësi - të qenët i mbarë, sefallëk - të bërët sefa, dhimbshuri - të qenët i dhembshur etj.*

Siç mund të shihet nga 16 nënfushat semantike të profiluara ose sipas materialit të paraqitur në 18 pikat e nënpikat përkatëse, del se asnjësi i këtij tipi ka shtrirje të gjerë dhe të pakufizuar në shumë segmente të gjuhës, kryesisht në nënfushën përkatëse të fushës së abstraksionit, ku bashkëjeton në sinonimi me emra të tjerë, po nuk rrezikohet asnjëherë kuptimisht nga ata, ngase, pothuajse i kanë të ndara nënfushat semantike që i mbulojnë. Ndërkaq me tipin e prejmbiemërorëve bashkëjeton në të njëjtën fushë, në pikën më të lartë të abstraksionit.

### **ç) Asnjësit e ndafoljezuar në shprehje prejrrjedhore (ablativale)**

Edhe në tipin e asnjësve të ndajfoljezuar me shprehje ablativale, d.m.th të rasës rrjedhore dallohen 5 profilime a nënfusha semantike që asnjësit e tillë mbulojnë ose janë të implikuar në shprehjet a nënfushat e tilla semantike:

1) Në togfjalësha emrash përpjesorë që prof. M. Çeliku, i quan formime me rrjedhore e gerundit, tipi: *u ngopa së foluri, mbarova së ngrëni, s'pushon së hedhuri romuze, s'lodhet dot së kënduari, s'ngopej së shikuari rrethinën; do të fillojnë së shpërnguluri, pushoi së gjëmuari, mbaroi së lëvduari, vazhdo së kënduari etj.;* në funksion të kundrinës së drejtë, ose të një rrethanori a përcaktori, me mundësi të pakufizuar shumimi.

2) Si ndajfolje nga mbiemrat e substanivuar ose nga njësi të tjera leksiko-gramatikore në zëra të veçantë, që mund të konsiderohen si trajta përfaqësuese, si: *së pari, së bashku, së fundi, së thelli, së voni, së kthjellti etj.* – numër i pakufizuar.

3) Në shprehjet: ndajfolje + emër asnjans emërzimi në rrjedhore, si: *kot së koti, pak së paku, tok së toku, prap së prapi, mbar së mbari* (B. Hajrullaj, K. Topalli).

4) Në lokucione ndajfoljore të formuara prej mbiemrash të substantivuar të gjinisë asnjans në rasën rrjedhore të paraprirë nga parafjala **për**, si: *për së afërmi, për së gjati, për së gjeri, për së largu, për së larti, për së mbari, për së shpejti* etj. (B. Hajrullaj, K. Topalli).- numër i pakufizuar.

5) Në shprehje togfjalëshash me parafjalën **prej**, si: *Qëlloi prej së largu, Peni këputet prej së holli, zullumi këputet prej së trashi. Plasi prej së keqi, Është punë që s'hahet prej së ëmbëli.* (A, Zymeri, H.. Hajrullaj).- numër i pakufizuar.

\* \* \*

Sido që të jetë, para se të japim përfundimin rreth profilimit të nënfushave semantike të të katër tipave të asnjansve po paraqitim raportin **trajtë e shquar** ndaj **trajtë e pashquar**, sipas nënfushave semantike si më sipër po për katër tipat e sipërtrajtuar:

Ndërsa tek emrat asnjans të paparanyjëzuar në njësin e emërores dallohet shquarsia si p.sh. *ujë/ ujët, mish/ mishtë*, tek paranyjëzorët kemi këtë situatë. Tek emrat prejmbiemërorë në 6 *profilimet* rezultati del **3 me 3**, ndërsa tek prejpjesorët prej 18 *profilesh e nënprofilesh* rezultati del **8 me 9**, plus një rast i diskutueshëm nëntipi: **çfarë të shkruari**, ku nyja e përparme është **të**, por shquarsia mbaron me **-i**-në anapetike që ë njëherazi përkon me një-mbaresn e njëjësit të shquar të rasës emërore të emrit të gjinisë mashkullore.

Ndërkaq në tipin me shprehje prejrrjedhore tek të 5 profilet para emrit ose emërzimit përkatës të shprehjes asnjansore del nyja **së** dhe të gjithë shembujt përfundojnë me **-i**, ose **-u**, d.m.th. me një-mbaresën e emrit të gjinisë mashkullore e rrjedhore **-i**, ose **-u**, në trajtën e pashquar.

Sidoqoftë, këto të dhëna imponojnë që ekspertët t'i kenë parasysh me rastin e konstatimeve rreth shquarsisë së asnjansve në gjuhën shqipe.

### **Përfundim rreth profilimit të nënfushave semantike të asnjansve**

Nga lënda e paraqitur më sipër, ndër të tjera, mund të nxirren këto përfundime:

E para, vetëm kur është fjala te frazeologjizmat e trashëguar me *asnjansit përkatës primitivë si emra të mirëfilltë*, por jo për fjalë të veçanta, që mund të përdoren shembujt e tillë pa ndonjë rezervë, por ofrohet mundësi e hapur për me u krijuar shembuj të tjerë të rij të ngjashëm, qoftë, në ligjërimin e lirë të përditshëm, qoftë, në vepra të krijimtarisë letrare-artistike.

E dyta, siç u konstatua disa herë gjatë analizës, asnjansit e paranyjëzuar, qoftë prejmbiemërorë, qoftë prejpjesorë, varësisht nga konteksti mund të përftohen në mënyrë të pakufizuar, sepse këtë e mundëson motivimi i temës prodhuese fjalëformuese dhe specifikimi i nënfushës së qartë semantike që mbulojnë.

E treta, në këtë kontekst, rreth numrit të pakufizuar, imponohen një varg çështjesh, që kërkojnë sqarim, jo vetëm rreth raportit me emra të gjinive të tjera lidhur me nënfushat semantike që mbulojnë, por edhe në raportin e tyre të brendshëm të tipit të asnjansëve aktivë, siç janë: **trajta përfaqësuese/trajta e rëndomtë ose mbizotëruese, kategoria njëjës/shumës, trajta e shquar/ e pashquar**, si dhe vendi i tyre në kuadër të njëjësive përkatëse sinonimike e të tjera, pastaj si qëndron ndërlidhja me të gjitha njësitë përkatëse brenda strukturës së sistemit emëror e të atij foljor të shqipes, madje edhe raporti barasvlerës me gjuhë të huaja etj.

E katërta, edhe kur është fjala rreth tipit të katërt, ndonëse nuk mund të flasim me kompetencë, sa i përket nënfushës semantike ose profilimit që mbulojnë, mund të thuhet se shprehjet e tilla e njomin të shprehurit e standardit të gjuhës shqipe, dhe përdorimi ose prodhueshmëria e tyre nuk vihet në dyshim, por nuk dimë shprehjet e tilla sa janë të përhapura në të folmet popullore jugore e sa në ato veriore, por gjithsesi është i drejtë pohimi se kjo dukuri tashmë është karakteristikë e gjuhës së sotme standarde.

Sido që të jetë, për të gjitha çështjet që prekëm në krerët e mëparshëm u përpoqëm me dhënë përgjigje ose së paku me bë paraqitje sa më të plotë dhe transparente para auditorit të gjerë, çështje kjo që gëzon, dhe njëherazi do të thotë se duhet të nxisë edhe hulumtime të mëtejshme përplotësuese, për katër tipat e asnjansëve, e sidomos rreth tipit të katërt, madje presim që konstatimet tona të përplotësohen, sepse është temë e hapur e jo e studiuar në mënyrë shteruese.

Pra, nga tërë kjo, sa u tha, del se shqipja e sotme ka në përdorim, një tip, me disa shembuj pjesërisht aktivë asnjansësh të paparanyjzuar, një tip tjetër që karakterizohet me shprehje prejrrjedhore, jo mjaft i studiuar dhe dy tipa aktivë asnjansësh të paranyjzuar, prejmbiemërorët dhe prejpjesorët të rasës emërore (si rasë përfaqësuese) të cilët sa i përket prejardhjes a temës fjalëformuese motivuese (mbiemëre/pjesore), pothuajse mbulojnë të njëjtën fushë semantike që lidhet me konceptin *e procesit të veprimit* përkatës ose *të cilësisë, gjendjes a të qenit të motivuar nga tema prodhuese*. Përdorimi e kultivimi i të cilëve patjetër duhet të sforcohet teorikisht e praktikisht, pikërisht në shtratin e destinuar të specifikuar të tyre, d.m.th. në majat e fushës së abstraksionit përkatës..

## **2. Edhe disa konstatime përgjithësuese rreth asnjansëve të shqipes**

Në fund, për të tërhequr vëmendjen rreth asaj që u trajtua në këtë punim, po ritheksojmë edhe këto nëntë veçori karakteristike që i quajtmë përgjithësuese të asnjansëve, duke lënë vend edhe për ndonjë element polemizues:

1) Po ritheksojmë faktin se numri i regjistruar i asnjansëve në FShS 2002, 6 primitivë dhe 78 të paranyjzuar, gjithsej 84, assesi nuk mund të konsiderohet si numër shterues i asnjansëve në përdorim të përditshëm, madje as si numër përfaqësues nuk del i mjaftueshëm për të prezantuar të gjithë nëntipin përkatës të asnjansësit. Sigurisht lënda në

Fjalor duhet kuptuar, jo vetëm si lëndë detyruese lidhur me respektimin drejtshkrimo-gramatikor, por më tepër si strumbullar orientues rreth të cilit duhet të sillemi, por jo në mënyrë të verbër. Me këto fjalë duam të themi se, sidoqoftë, lypset verifikuar që shembujt në atë burim janë apo nuk janë të mjaftueshëm si përfaqësues të tipave a nëntipave përkatës apo vetëm janë hedhur ashtu pa ndonjë kriter?

2) Lypset verifikuar faktet sipas kontekstit përkatës dhe assesi nuk duhet pranuar konstatimet e dhëna pa mbulesë se gjoja sinonimet e emrave të prejardhur me **-si** ose me **-im** a **-je** janë të mjaftueshme si barasvlerës për të zëvendësuar asnjësit përkatës për të gjitha konceptet, qoftë në fushën e abstraksionit, qoftë në raste në atë me elemente të konkretizimit. Sigurisht për shkak të mosverifikimit të fakteve e saktësisë së tyre ka ndodhur, madje edhe ndonjë keqkuptim a veprim arbitrar rreth raportit *aktivizim / pasivizim të asnjësit*, siç janë edhe rastet e mospërfshirjes ose të mospërdorimit të tyre gjithandej e këndeje në mbarë truallin shqipfolës edhe për ato koncepte që nuk kanë mbulesë të mjaftueshme përkatëse sinonimike nga barasvlerësi konkurrues.

3) Konstatimi tjetër që lypset ritheksuar ka të bëjë me zberthimin e kuptimit të asnjësve sipas tipave përkatës:

a) Me plot të drejtë konstatohet se asnjësit e mirëfilltë primitivë u krijuan në kundërvënie ndaj emrave femërorë/mashkullorë ose për të përmbushur ndonjë zbrazësi strukturore në sistemin nominal të shqipes, por duhet pranuar, siç është vërtetuar ndërkohë se emrat e kësaj gjinie, veç specifikimit të pjesshëm rreth emërtimit të gjësendeve të pandara në ekzemplarë, nuk kishin ndonjë nënfushë të plotë semantike të specifikuar të dalluar nga emrat e dy gjinive të tjera gramatikore. Sidoqoftë, këta edhe dalloheshin prej tyre me formantet përkatëse mbaresore formale në njëjës in e shuar dhe me treguesit asnjës, mirëpo, ndërkohë duke i humbur treguesit përkatës filluan shkallë-shkallë edhe ndërtimisht e kuptimisht të pësojnë ndryshime, duke u inkorporuar në gjininë tjetër aktive gramatikore, qoftë në gjininë femërore e aq më tepër në atë mashkullore, duke e pranuar edhe një-mbaresën përkatëse të tyre. Prandaj, edhe zberthimi i tyre sot bëhet me emrin e gjinisë përfaqësuese të grupit leksiko-semantik të emrit të lëndës. P.sh. trajta *mishtë* tregon se është emër i gjinisë asnjësve të emrit aktiv të gjinisë mashkullore: **mish mishi, mishrat (mishnat)**, e kështu me radhë, por megjithatë janë disa raste që ende emrat e tillë po në formën e asnjësit dalin të inkorporuar në kuadër të shqipes letrare.

b) Të gjithë prejmbiemërorët asnjës cilësorë zberthehen me mbiemrin përkatës cilësor të njëjës të pashuar të gjinisë mashkullore, si trajtë e gjinisë përfaqësuese, p.sh. të mirët, d.m.th. të qenët i mirë ose *me qenë* i mirë (a të jesh i mirë, e kështu me radhë. Ndërsa prejmbiemërorët asnjës të nëntipit me të cilët shprehet një gjendje a të qenë zberthehen mjaft natyrshëm me trajtën e paskajoren së foljes *me pasë* + sinonimi përkatës i emrit prapashtesor, si p.sh. të gjallët, d.m.th. *me pasë gjallëri*, të lagët (vendi) *me pasë lagështi(rë)*, të ligët - *me pasë ligësi* (gjendje ligësie) e kështu me radhë.

Në të vërtetë, asnjësit që tregojnë një gjendje a të qenë, kanë barasvlerësi sinonimike heterogjene, barasvlerësi kjo që mund të jetë e shprehur a e zberthyer edhe me ndonjë emër jo mbi temë të njëjtë fjalëformuese dhe gjithsesi me prapashtesa a ndërtimesh të ndryshme, p.sh. të nxehtët - zjarrmi, e ndonjë rast tjetër.

c) Në të vërtetë, të gjitha rastet e asnjansëve të paranyjzuar të rasës emërore, por edhe të asaj arkaike rrjedhore, mbi bazë pjesoreje zërthehen po ashtu mjaft natyrshëm me ndihmësen e foljes përkatës të paskajores së mirëfilltë, p.sh.: të qarët, d.m.th. me qa, të qeshurit - me qeshë, të qëlluarit - me qëllue, të shkruarit- me shkruet etj. Krahaso se edhe trajta e paskajores zërthehet me sinonimin në trajtën e asnjansësit, p.sh. folja *me shkruet* tregon veprimin e të shkruarit, por kur është fjala te rezultati i veprimit, atëherë zërthimi del edhe më qartë me emrat e prejardhur .Bie fjala: *cili është rezultati i + ...* (kupto asnjansësin përkatës), p.sh cili është rezultati i të qarit (të qeshurit, të qëlluarit, të shkruarit ...), përgjigja del: *qarja, (qeshja, e qëlluara, shkrimi...)*, e kështu me radhë. Gjithashtu edhe rastet si *Vazhdo së lexuari / Vazhdo me lexue* etj. Këto raste mund të shërbejnë si mundësi e ndërkëmbimeve sinonimike

4) Siç u pa konkretisht nga analiza për asnjansësit prejpjesorë të rasës emërore si rasë përfaqësuese nuk del normalisht ose del fort rrallë ndonjë emër sinonim i prejardhur me prapashtesat *-si, -i, -ri* etj. sepse prapashtesat e tillë (versionet me *-i* fundore) kryesisht dalin të rezervuara pothuajse kryekëput për prejmbiemërorët cilësorë, ndërsa për prejpjesorët e mirëfilltë të rasës emërore dalin pothuajse, tërësisht sinonimet me prapashtesën *-im* ose *-je*, po edhe ndonjë tjetër.

5) Për prejpjesorët në raste të veçanta, dalin edhe emrat si emërzime të pjesores, sipas mënyrës pandajshësore, d.m.th. me mbaresë zero, si p.sh.: *rëndë-a* (të rëndët), *zi-a* (të zitë), *ujë-a* (të uriturit), *tekë-a* (të tekurit), *rrojë-a* (të rruarit), *pritë-a* (të priturit) etj. Konstatohet se prejpjesorët e tillë pandajshësorë, pothuajse të gjithë, ndërkohë kanë kaluar në fushën e semantike të konkretizimit.

6) Po përmendim si të saktë konstatimin se numri i asnjansëve prejmbiemërorë për nga sasia del shumëfish më i madh në krahasim me numrin e regjistruar të tyre në burimin në fjalë (FShS 2002), por megjithatë mund të thuhet se numri i prejmbiemërorëve në krahasim me numrin e prejpjesorëve del në numër të kufizuar, sepse edhe vetë numri i mbiemrave të nyjshëm del i kufizuar. Ndërsa sa i përket numrit të asnjansëve prejpjesorë numri del shumë më i madh, del pa kufizim, ngase nga çdo folje ka mundësi të formohet, përkatësisht një mbiemër prejpjesor ose një asnjans prejpjesor.

7) Ka raste që edhe asnjansësi i paranyjzuar të përftohet nga të dy trajtat e pjesores, të pjesores së zgjeruar dhe të pjesores së shkurtër, madje një mundësi e tillë në rast nevojë paraqitet si rezervë e deponuar, e cila edhe si e tillë mund të aktivizohet, siç janë rastet të foljet konsonantike si p.sh.: të qeshët dhe të qeshurit, të folët dhe të folurit, të dëlirët të dëlirurit etj., por gjithsesi, le të dihet, se trajtat e letrarishtes së sotme duhen parapëlqyer, ngase, sot për sot, dalin me konkurrencë të fituar, kur është fjala për të njëjtin koncept. Këtu po shtojmë edhe një fakt tjetër. Ndodh që asnjansësi të përftohet edhe mbi të njëjtën rrënjë-temë të fjalës, edhe mbi bazë të mbiemrit (mbiemrit të mirëfilltë) edhe mbi bazë të pjesores (mbiemrit foljor) dhe që të dy janë normativë, vetëm nëse shprehin koncepte a nuanca të ndryshme semantike.

8) Ç’është e vërteta, sa i përket mënyrës së ndërtimit që të tre tipat e asnjansësit (primitivi, prejmbiemërori dhe prejpjesori) e kanë të përbashkët nyje-mbaresën në trajtën e shquar **-t(ë)** të emërores (sipas versioneve: *-t, ët, it, -të*), mirëpo këtë nyje-mbaresë



shquese në njëjësin e emërores e ka vetëm asnjësi, ndërsa dy gjinitë e tjera (mashkullore e femërore) e kanë vetëm në emëroren e shumësit të shquar, ndërsa tipi i katërt, siç është përmendur edhe më përpara, karakterizohet me njëjën e përparme **së** dhe me fundoren **-i** ose **-u**, në njëjësin e pashquar të rasës rrjedhore.

9) Siç dihet, tre tipat e asnjësit (prejmbiemërorët dhe prejppjesorët edhe ata mbi bazë të rrjedhore) quhen asnjësi të paranyjësuar sepse janë të pajisur me njëjën e përparme **të**, përkatësisht **së** në ballë të tyre (*të mirët, të ecurit, së ecuri*) Mirëpo formant *së* nuk del ashtu tek dy gjinitë e tjera, sepse në këto raste emri (mbiemri i emëruar) i gjinisë mashkullore si nyje të përparme merr **i** (*i miri, i ecuri*), ndërsa ai i gjinisë femërore **e** (*e mira, e ecura*). Ky fakt u theksua prej nesh se pikërisht është nyja e përparme **të** dhe nyja e prapme po **-t(ë)** në njëjësin e shquar që gramatikisht e identifikojnë asnjësin e paranyjësuar (prejmbiemëror e prejppjesor) të rasës emërore e kallëzore, duke e dalluar kështu nga emrat e tjerë të paranyjësuar.

\* \* \*

Si rezultat i kësaj që u tha në këtë punim del përfundimi se lënda mbi asnjësit patjetër duhet të rimerret në shqyrtim nga gramatikanët e studiuesit tanë, nga të cilët pritet një riinterpretim edhe më i saktë dhe më i plotë rreth këtij problemi, që ne e vumë në tryezë për rivlerësim dhe për këtë, na duket se kemi paraqitur material të mjaftueshëm.

Sidoqoftë, edhe nga analiza që bëmë ne del mjaft bindshëm e vërteta se është fort pa vend sugjerimi se emrat asnjësi të paranyjësuar mund të zëvendësohen për të gjitha konceptet nga emrat sinonimikë të prejardhur me prapashtesim e të tjerë, sepse asnjësit e paranyjësuar ruajnë identitetin e vet formalisht e përmbajtësish, qoftë me temë të qartë fjalëformuese, qoftë me nënfushën e veçantë semantike që e mbulojnë, andaj si të tillë, jo vetëm duhet njohur, por edhe duhen kultivuar dhe gjithsesi duhen sendërtuar si duhet në shqipen standarde, natyrisht pasi të përcaktohet edhe më mirë dhe të njihet edhe më në hollësi vetëvetësia a identiteti i tyre.

## Konstatime përmbyllëse

Emrat e gjinisë asnjane në gjuhën shqipe edhe nga pikëpamja sinkronike nuk janë të patrajtuar nga gramatikanët tanë, mirëpo disa nga konstatimet rreth tipave, përdorimit dhe shtrirjes së tyre, jo vetëm nuk janë të plota, por janë të shoqëruara me paqartësi ose edhe me ndonjë zbrazëti jo të vogël. Nuk përjashtohet edhe ndonjë mangësi në keqinterpretim. Në këtë punim, me sa dimë, u identifikuan më qartë se në çdo burim tjetër katër tipat e asnjansit në shqipen e sotme që janë:

- 1) *tipi i asnjansve të mirëfilltë primitivë të paparanyjzuar,*
- 2) *tipi i asnjansve të paranyjzuar prejmbiemërorë,*
- 3) *tipi i asnjansve prejpjesorë të paranyjzuar dhe*
- 4) *tipi i asnjansit në shprehje prejrrjedhore (ablativale).*

Duke pasur parasysh këtë ndarje të asnjansve në gjuhën shqipe, tema u shtjellua në tetë krerë, të cilët në pika fare të shkurtra, veç tjerash, kanë këtë përmbajtje:

1. Në kreun I për të konstatuar praninë e asnjansve në shqipen e sotme letrare u vol materiali nga Fjalori e shqipes së sotme (2002) për tre tipat e parë, sepse tipi i katërt nuk del i identifikuar në këtë burim. Sipas tipave asnjansit u ndanë në tri grupime. Në fjalorin në fjalë u gjetën të regjistruar 84 shembuj, prej tyre:

- a) nga tipi i parë, 6 emra të mirëfilltë të paparanyjzuar,
- b) nga tipi i dytë, 35 prejmbiemërorë të paranyjzuar dhe
- c) nga tipi i tretë, 43 asnjans prejpjesorë të paranyjzuar.

Edhe grupet e caktuara në bazë të një-mbaresës së emërores që marrin në njëjës in e shquar u grupuan në nëngrupe të caktuara.

Kështu:

a) asnjansit e mirëfilltë të paparanyjzuar u ndanë në 2 nëngrupe, 4 shembuj me një-mbaresën **-t** dhe 2 me një-mbaresën **-të**;

b) prejmbiemërorët, po sipas një-mbaresave të emërores së njëjës in të shquar u ndanë tri nëngrupe, me **-t** 22 shembuj, me **-të** 6 dhe me **-it** 7 shembuj dhe

c) prejpjesorët sipas tipit të pjesoreve dhe një-mbaresave të njëjës in të shquara, u ndanë 4 nëngrupe: me **-t** 21 shembuj, me **-it** 21 shembuj (2 sinëngrupe 14+7) dhe me **-ët** 1 shembull që gjithsej bëjnë 22 (ose 14+7+1) shembuj.

Pasqyra e numrit të tërësishëm (totali) del kështu:

a) me një-mbaresën **-t** : 47 (ose 4+22+21) shembuj,

b) me një-mbaresën **-të**: 8 (2+6) shembuj,

c) me një-mbaresën **-it**: 28 (7+14+7) dhe

ç) me një-mbaresën **-ët** 1 shembull.

Pra, totali:  $47+8+28+1 = 84$  shembuj.

Në të vërtetë, u konstatua se në atë Fjalor, përveç shembujve të regjistruar manipulohesh edhe me 13 asnjans prejpjesorë të tjerë, përkatësisht edhe me mbi 300

shprehje të paraprira nga asnjani të *qenët* + ..(fjala a togu sqarues). Kështu në atë burim manipulohet me afro 100 shembuj asnjansish, përkatësisht me afro 400 raste që përdoret ose del i shënuar asnjansi.

2. Në kreun II, asnjansit u trajtuan nga këndvështrimi i nënfushës semantike që mbulojnë. Të 84 shembujt e asnjansve të regjistruar në FShS 2002 sipas tipave u ndanë në grupe e nëngrupe përkatëse dhe për secilin grup a nëngrup u hetuan veçori dalluese semantike.

a) U konstatua se me asnjansit si emra të mirëfilltë (të paparanyjësuar) fillimisht shprehej një fushë mjaft e gjerë konceptesh, por më tepër emërtoheshin gjë-sende konkrete ose një sasi lënde e panumërueshme në ekzemplarë, por konkrete, fushë kjo semantike që tanimë, pothuajse tërësisht po mbulohet me trajta të emrave të gjinisë mashkullore, prandaj ky tip asnjansish, ndonëse ka përdorim në frazeologjizma etj. mund të quhet me prirje konservimi për fjalë të caktuara, përkatësisht karakterizohet përgjithësisht me një pasivizim potencial, ngase ka pushuar tashmë nevoja për krijimin e shembujve të rij mbi këtë bazë.

b) Me asnjansit e paranyjësuar prejmbiemërorë gjendja qëndron ndryshe. Ndonëse edhe këta dalin të goditur, më mirë të konkuruar nga femërorët e nyjshëm si dhe formimet me emra prapashtesore ti tipit më –**si**, e variante të tjera, megjithatë dalin të mbijetuar, përkatësisht të pazëvendësueshëm në fushën e abstraksionit për të shprehur *koncepte cilësie gjendjeje a të qeni*. Së këtëjmi prejmbiemërorët u ndanë në dy nëngrupe: nëngrupi i parë, prej 18 shembujsh të prejardhur prej *mbiemrave cilësorë*, të cilët edhe mbulojnë koncepte cilësie dhe nëngrupi i dytë mbi bazë të mbiemrave *jocilësorë*, i përbërë prej 17 shembujsh, me të cilët shprehen koncepte të gjendjes ose të qenit. Pra, gjithsej në atë Fjalor janë regjistruar 35 prejmbiemërorë.

c) Edhe prejpjesorët u ndanë në katër nëngrupe sipas tipit të foljeve:

1) mbi temë me –ë fundore 21 shembuj,

2) mbi bazë të një bashkëtingëlloreje në temë 14 raste.

3) mbi bazë të fundores –ur të pjesores së foljeve më –oj e -uaj 7 shembuj, dhe

4) një shembull me fundoren -ier,

që gjithsej bëjnë **43 shembuj prejpjesorësh**, të cilët mbulojnë koncepte veprimi dhe janë në konkurrencë sinonimike zakonisht me emrat prejpjesorë të prejardhur me prapashtesat **-im** ose **-je**.

Pra, sipas burimit në fjalë dalin 6 emra asnjansish primitivë të mirëfilltë, 35 asnjans prejmbiemërorë dhe 43 asnjans prejpjesorë, që gjithsej bëjnë 84 shembuj.

3. Në kreun III u konstatua me fakte se shtrirja e përdorimit të asnjansve të paranyjësuar sidomos të prejpjesorëve në gjuhën shqipe në realitet, ishte dhe është shumë e gjerë. Kështu numri i asnjansve të regjistruar, b.f., në Fjalorin e S. Dobroshit i afrohet 2000-shit, ndërsa në Fjalorin e M. Elezit dalin të regjistruan afro njëmijë shembuj, pothuaj, po aq sa dalin të përdorur në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954). Edhe në burime të tjera ndeshim me qindra shembuj asnjansish të paranyjësuar, prandaj e quajmë me vend kërkesën që prania e tyre, sidomos e prejpjesorëve po edhe e prejmbiemërorëve në burimet përkatëse normative, duhet të jetë e përfaqësuar në mënyrë më të plotë dhe më korrekte

Vlen të theksohet fakti se në *Fjalorin e gjuhës shqipe* 2006 përveç numrit 84 janë shtuar edhe mbi 80 shembuj të tjerë, pothuajse të gjithë të tipit prejppjesor. Po ky numër pothuajdel edhe në tekstin e *Drejtshshkrimit të gjuhës shqipe* (2011), ku dalin të shënuar në zëra të veçantë 6 raste të asnjaneve të tipit të katërt, prejrrjedhorë.

Gjithsesi, jo vetëm sipas tipave, por edhe sipas nëntipave, më drejt sipas grupeve a nëngrupeve përkatëse përfaqësimi i tyre në burimet përkatëse normative duhet të jetë më i denjë. Njëherazi u konstatua se në burimet përkatëse që u konsultuan sa i përket shquarsisë, mbizotëron trajta e njëjësit të shquar, si trajtë përfaqësuese e asnjaneve të përgjithshme, por nuk përjashtohet as trajta e pashquar, varësisht nga konteksti..

4. Lënda e trajtuar në kreun IV zgjon interes të jashtëzakonshëm, ngase aty bëhet fjalë për vendin e asnjaneve prejppjesor në kuadër të prejppjesorëve të tjerë sinonimikë. Nga skema e paraqitur del se vendi i asnjaneve të paranyjzuar prejppjesorë, ashtu si edhe ai i prejmbiemërorëve, në krahasim me prejppjesorët a prejmbiemërorë të tjerë, ka vetëvetësi a identitet të plotë që dallon nga ata, jo vetëm nga pikëpamja formale, por, aq më tepër nga pikëpamja e specifikimit të nënfushës semantike të majave më të larta në kuadër të fushës së gjerë të abstraksionit. Kjo nënfushë kryesisht del e specifikuar për konceptin e veprimit përkatës, por pa kaluar në konceptin e vetë procesit të veprimit ose të rezultatit të veprimit, ngase për koncepte të tilla tani dalin të specializuar prejppjesorë të tjerë, siç janë emrat e prejardhur me prapashtesat e specializuara –IM dhe –JE si dhe prejppjesorë femërorë të paranyjzuar, prejppjesorë pandajshësorë, përkatësisht emrat prejmbiemërorë me paranyjzim, siç është tipi me -SI e të tjerë.

5. Në kreun V, jepen edhe disa konstatime të tjera plotësuese që identitetin e asnjaneve të paranyjzuar në kuadër të sistemit emëror të shqipes e bëjnë edhe më të qartë, siç është edhe ndërlidhja kuptimore e asnjaneve prejppjesor me paskajoren e mirëfilltë (me+pjesore), me singularia tantumet, me pluralia tantumet, me valencën, formalisht me emrat e përgjithshëm të emëruar nga mbiemrat e pjesoret e paranyjzuara që përdoren zakonisht si emra të përgjithshëm në emërtimin e njerëzve dhe së fundi u trajtua edhe raporti mbiemri prejppjesor ndaj asnjaneve prejppjesor si dhe në raportin mbiemër prejppjesor ndaj asnjaneve prejppjesor.

6. Në kreun VI u konstatua se anashkalimi i asnjaneve të paranyjzuar në burime të ndryshme, sidomos në vitet ‘50-‘90 të shekullit të kaluar, është shkaktuar më tepër subjektivisht, si pasojë e konstatimeve të nxituara, pa mbështetje të fortë të brendshme evolucionore të gjuhës, por siç supozohet për këtë më fort kanë ndikuar këta tre faktorë shtytës të jashtëm, si p.sh.:

E para, nga ndikimi i gjuhëve të huaja (neolatine e sllave), të cilat nuk e kanë asnjaneve analitik, siç e ka shqipja (nyje+mbiemër ose nyje+ pjesore), po e kanë atë në formën sintetike, zakonisht me prapashtesa speciale, siç janë edhe prejfoljorët e shqipes të gjinisë mashkullore me prapashtesën -im dhe ata të gjinisë femërore me prapashtesën -je.

E dyta, si shkak del njohja e pamjaftueshme e identitetit të asnjaneve të paranyjzuar, sidomos fakti që ka të bëjë me nënfushën semantike që mbulojnë, nënfushë kjo që ende nuk njihet sa duhet nga disa qarqe të studiuesve të caktuar,

E treta, si shkak del edhe sugjerimi përgjithësues, duke u mbështetur në fakte pjesërisht të drejta, se gjoja të gjithë treguesit e asnjansve edhe atyre të paranyjzuar si dhe asnjansit vetë janë konvertuar ose janë në konvertim i sipër në gjinitë aktive, sidomos në gjininë mashkullore.

Sidoqoftë, këto tri arsye sipas analizës që u bë dalin pjesërisht të drejta, por jo të mjaftueshme që asnjansit e paranyjzuar të konsiderohen pothuaj plotësisht të pasivizuar, andaj, së këndejmi del si rrjedhojë edhe paraqitja jo e denjë e asnjansve në burimet tona normative të letrarishtes së sotme në fazën e sapokaluar të diskutueshme prej nesh, prej viteve '70 të shekullit të kaluar deri në vitin 2002.

7. Në kreun VII, të parafundit, pasi përmenden disa raste të hapura lidhur me asnjansit sipas katër tipave (prejemërorë të paparnyjzuar, prejmbiemërore, prejppjesorë dhe si shprehje prejrrjedhore (ablativale) dhe jepen sugjerime rreth zgjidhjes së përkufizimeve dhe përdorimit të tyre dhe specifikimi i tyre sipas nënfushve semantike që mbulojnë.

8. Në kreun VIII, të fundit, pas konstatimeve përgjithësuese, në disa pika, veç e veç, sipas tipave të asnjansve, ilustruhet përdorimi i tyre sipas nënfushave përkatëse semantike me shembuj konkretë. Kështu

a) për asnjansit primitivë, si emra të mirëfilltë ceken 2 nënfusha semantike të profiluara,

b) për asnjansit prejmbiemërore 6,

c) për asnjansit prejppjesorë, 16 ose 18 nënfusha të profiluara semantike dhe.

ç) për asnjansit me shprehje prejrrjedhore, 5 profilime.

Në fund u shtrua kërkesa që vlen për të katër tipat në fjalë, por sidomos për dy tipat e asnjansit të paranyjzuar (prembiemërorë dhe prejppjesorë) që në burimet tona normative të shqipes standarde të jenë të përfaqësuar më denjësisht, sipas profilimit të nënfushave semantike që mbulojnë, përkatësisht sipas tipit të foljeve që përfaqësojnë.

Gjithsesi nga krejt ajo që është trajtuar në këtë punim mund të thuhet me bindje të plotë se koncepti rreth asnjansit në gjuhën shqipe do të dalë më i plotë dhe më i qartë në çdo burim tjetër, vështruar sidomos nga rrafshi sinkronik, veprim ky që do të kontribuojë në të mirë të konsolidimit të mëtejshëm të normës së sistemit emëror të shqipes së sotme në përgjithësi dhe të nesërme të standardit të rinuar në veçanti.



## REZYME

Duke analizuar mënyrën e formimit të emërtimeve të proceseve tekniko-teknologjike dhe përgjithsisht të dukurive përkatëse si në fushën e konkretizimit, po ashtu e sidomos edhe në atë të abstraksionit, veç emrave të gjinisë mashkullore dhe të asaj femërore na u imponuan edhe emrat e gjinisë asnjane. Këtu edhe fillon interesimi ynë për fushat semantike që mbulojnë emrat e tillë në gjuhën shqipe, sidomos në fushën e abstraksionit. Nga literatura modeste që konsultuam morëm sadopak edhe njohuri të para modeste, megjithatë kjo mjaftoi si bazë që të futemi edhe më thellë në trajtimin e emrave të kësaj gjinie, së këtejmi doli edhe punimi, ta quajmë, monografik: **Rreth identitetit të gjinisë asnjane në shqipen e sotme**, i mbarështruar në tetë krerë. Meqë, me sa jemi në dijeni, kjo temë nuk ishte krejt e patrajtuar, por më tepër kishte të bënte me boshtin historik se me atë sinkronik, ne, u orientuam dhe u thelluam kryesisht në identitetin e emrave e të kësaj gjinie në rrafshin sinkronik dhe arritëm në mjaft konstatime, të cilat paksa ishin të njohura për gjuhësinë tonë, por jo në nivel të kënaqshëm, madje kishte konstatime e sqarime kundërtëse që nuk i përgjigjeshin realitetit. të sotëm, andaj në pika të shkurta po i rikujtojmë në këtë rezyme disa nga vëzhgimet tona që mund të quhen sirisi ose edhe rezultate të këtij punimi:

Së pari, në asnjë burim të deritashëm të shqipen standarde nuk dalin të trajtuar as të emërtuar në mënyrë të plotë integrale të gjithë tipat e asnjanesit në gjuhën tonë, ndërkaq ne përmblodhëm dhe identifikuam katër tipa të emrave asnjane të shqipes, duke manipuluar kryesisht me këto emërtime:

- 1) **asnjanësit si emra të mirëfilltë të paparanyjzuar** (tipi: kryet, ujët),
- 2) **asnjanësit prejmbiemërorë të paranyjzuar** (tipi: të mbarët, të bukurit, të gjallët),
- 3) **asnjanësit prejpjesorë të paranyjzuar** (tipi: të prerët, të ftohurit, të shkruarit) dhe
- 4) **asnjanësit e paranyjzuar ablativalë, të rasës rrjedhore që i quajtmë edhe prejrrjedhorë** (tipi: së foluri, së mbari, së koti, së pari, së andejmi).

Së dyti, pothuajse të gjithë studiuesit, duke u mbështetur vetëm në emrat e tipit të parë, të cilët duke u konvertuar evolutivisht në shumicën e rasteve në gjininë mashkullore, kanë pësuar, paksim numri, *rrudhje*, madje edhe zhdukje(!), kanë dhënë konstatime të paqëndrueshme *en bloc*, edhe për tipat e tjerë, gjoja se asnjansi i shqipes si kategori është në zhdukje e sipër ose karakterizohet si gjini me karakter mbeturinor(!). Prandaj rreth këtij konstatim të paqëndrueshëm që gjoja ka të bëjë me pasivizimin *en bloc* të të gjithë tipave të asnjanesve ne shqipen e sotme ne kemi tërequr vërejtjen dhe gjatë tërë këtij punimi, jemi përpjekur me e paraqitë realitetin, i cili e demanton një konstatim të tillë.

Së treti, megjithatë disa nga studiuesit i identifikojnë mirë asnjanesit prejmbiemërorë dhe ata prejpjesorë, por konstatojnë pa të drejtë se edhe ata ndërkohë

janë zëvendësuar ose gjoja po zëvendësohen potencialisht nga emrat e prejardhur, zakonisht **prembiemërorët** me emrat e prejardhur me prapashtesën **-si** (disa versione me **-i** fundore) si tipi: *të mirët – mirësi, të bukurit – bukuri, të gjallët - gjallëri*, e kështu me radhë, ndërsa **prejppjesorët** nga emrat e prejardhur prejppjesorë me prapashtesën **-im** ose **-je**, tipi: *të punuarit – punim-i ose të qeshurit – qeshje-a*, konstatim ky rreth zëvendësimit potencial që, sipas vëzhgimeve tona realisht nuk qëndron, andaj lidhur me këtë në këtë punim, jo vetëm shprehet rezervë, por edhe kundërshtohet dhe vërtetohet me fakte se trajtat e tilla në shqipen e sotme bashkëjetojnë sinonimisht, pa rrezikuar ekzistencën e njëra-tjetrës, sepse mbulojnë nënfusha paksa të ndryshme të specifikuara semantike, zakonisht po në kuadër të fushës së gjerë të abstraksionit.

Së katërti, për të arritur më binshëm në qëndrueshmërinë e konstatimeve të caktuara që ne i quajtmë të diskutueshme ose të pasakta konsultuam burimet e caktuara normative leksikografike. Fillimisht konsultuam *Fjalorin i shqipes së sotme* (1984, rib. 2002) ku volën të gjithë asnjansit e regjistruar aty, numri total i tyre arrinte në 84 shembuj, prej tyre 6 asnjans si emra të mirëfilltë, 35 prejmbiemërorë dhe 43 asnjans prejppjesorë, ndërsa në atë burim manipulohet me afro 300 asnjans. Në të vërtetë, ne, të gjithë emrat e tillë të regjistruar (84 sish) i merenduan sipas tipave ose nënfushave semantike që mbulojnë. Së këtejmi arritëm në përfundim se asnjansit edhe pse në këtë burim nuk dalin të përfaqësuar denjësisht, sipas nëntipave, profileve apo të grupeve përkatëse, megjithatë ata nuk dalin me karakter mbeturinor, sidomos dy tipat e paranyjzuar, të cilët madje dalin potencialisht veprues e prodhimitarë.

Së pesti, për të treguar identitetin e asnjansve të paranyjzuar sidomos **prejmbiemërorë**, në fushën e abstraksionit ne u mbështetëm në temën e qartë fjalëformuese të tyre, kuptimi i së cilës bartet edhe tek koncepti që mbulon forma e asnjansit, kështu edhe asnjansit u grupuan sipas profileve semantike të nënfushave përkatëse, së pari asnjansit e regjistruar *me kuptimësi cilësie* dhe së dyti ata *me kuptimësi gjendjeje a të qeni*, ndërsa asnjansit e paranyjzuar **prejppjesorë** që nga burimi vijnë *me kuptimësi veprimi* u merenduan sipas tipit të foljeve.

Së gjashti, për të vërtetuar faktin se gjoja numri i asnjansve të paranyjzuar, sidomos i prejppjesorëve nuk kishte pësuar rrudhje as pakësim numri që nga periudha e Rilindjes e këndeje, konsultuam pothuajse të gjitha burimet përkatëse leksikografike, duke filluar nga Fjalori i K. Kristoforidhit deri edhe te Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (2011) dhe vëretuam se konstatimet e disa studiuesve të mëparshëm që përfillëshin si të sakta, sidomos brenda periudhës së viteve të '50-'90-a, lidhur me këtë, dilyn pothuajse, tërësisht të paqëndrueshme, sepse përkundër qëndrimeve jofavorizuese për emrat e tillë numri i tyre nuk shënon rënie, po rritje sasie e cilësie. Edhe pse ndikimi i konstatimeve të tilla të shqiptuara para viteve të '90-a vazhdon të mos demantohet ende, sidomos në burimet normative, e vërteta gjithnjë e më tepër po del sheshazi, kështu, b.f. ndërsa në FSHS 2002 (rib. i v. 1984) ndeshëm të regjistruar 84 shembuj në FGJSH 2006 të rihartuar, ndeshim pothuajse dyfishin e atij numri. Shembujt e tillë i afrohen 200-shit, sidomos shënon rritje tipi i asnjansve prejppjesorë.



Së shtati, për të vërtetuar edhe më binshëm se asnjësi, sidomos ai prepjesor që shpreh *koncepte veprimi* në kuadër të fushës së gjerë të abstraksionit, duke u pozicionuar në nënfushën më të lartë të asaj fushe, nuk rrezikohet fare nga prepjesorët e tjerë sinonimikë, siç qenë shprehur, pa të drejtë, disa studiues, dhe jolumnisht, konstatimet e tilla ende qëndrojnë të pademantuara në burimet tona normëzuese, në këtë punim është paraqitur skema e nënfushave përkatëse semantike prej 5 rubrikash, ku shihet qartë se nënfusha semantike që mbulojnë asnjësit *preppjesorë*, ashtu si edhe ata *prejmbimërorë* aspak nuk rrezikohet nga emrat sinonimikë, të cilët me konceptet e tyre dalin të specifikuar për nënfusha të tjera semantike, sepse asnjësit e tillë karakterizohen parësrisht me **konceptin e kuptimit të procesit të veprimit ose të cilësisë, të gjendjes a të të qenit**, në shkallën më të lartë të abstraksionit me një shtrirje të lehtë në tërë nocionin lidhur me atë proces dhe jo aq me emërtimin e vetë procesit ose me rezultatin e atij veprimi.

Së teti, për t’u kuptuar e vërteta, pse nuk rrezikohet qëndrueshmëria e asnjësve të paranyjzuar, mendojmë se është me interes të lexohet përkufizimi i mëposhtëm lidhur me këtë realitet:

*Ndonëse prejmbimërorët dhe preppjesorët i dallon tema e ndryshme, por e qartë motivuese fjalëformuese sipas prejardhjes, përkatësisht tema **mbimërore / pjesore**, këta dy tipa i bashkon nënfusha e njëjtë semantike që e mbulojnë, d.m.th. abstraksioni i veçantë që ka të bëjë pikërisht me konceptin në shkallën më të lartë të procesit në kuadër të fushës së shkallëzuar të abstraksionit.*

Pra, veç temës së qartë motivuese e kanë parësorisht pothuajse plotësisht të qartë edhe nënfushën semantike të përbashkët që e mbulojnë.

Së nënti, rreth identitetit të asnjësve të paranyjzuar u morën parasysh edhe fakte plotësuese, ku përveç identitetit formal gramatikor u morën në konsideratë edhe raporte të tjera ndërsinonimike. Në punim trajtohen 9 raste të tilla ndikuese e ndërndikuese. Ne këtu po e përmendim vetëm ndërldhjen a ndër këmbimin sinonimik në raportin **paskajore e mirëfilltë/ asnjësi prepjesor i paranyjzuar**. Krahaso ndër këmbimin:

*Veprimi (koncepti) i të shkruarit do të thotë me shkruet.*  
ose *Folja (veprimi) me shkruet nënkupton të shkruarit.*

Është e vëretë se në sistemin emëror shkallën më të lartë të fushës së abstraksionit e mbulon asnjësi i paranyjzuar, ndërsa në sistemin foljor atë funksion e kryen paskajorja e mirëfilltë me+pjesore. Mjerisht në normën e sotme të shqipes letrare asnjësi del jo i favorizuar, ndërsa paskajorja del krejtësisht e përjashtuar?!!

Së dhjeti, në punim në një krye të veçantë analizohet fakti pse në burimet tona normative gjatë periudhës së viteve të ‘50-‘90, me konstatime të nxituara (kuturu) u anashkaluan vlerat reale të asnjësit në shqipen e sotme, dhe si pasojë pati përfundime e veprime jo të drejta. Shtrohet pyetja pse ndodhi kështu? Si përgjigje jepet si supozim ose si fakt se u bënë veprime të nxituara (paushalle) nga individët e caktuar, zakonisht të ndikuar subjektivisht, qoftë nga gazetarë – përkthyesit e paformuar gjuhësisht, të cilët bashkë me përkthime sillnin edhe kalkëzime spontane të ndikuar nga gjuhët e huaja, qoftë nga mungesa e koncepteve përkatëse e së këtejmi ranë në atë ndikim edhe vetë studiuesit

vendës, të cilët, siç e pamë në fillim të këtij punimi emrat e kësaj gjinie i parashihnin jo me perspektivë për gjuhën letrare kombëtare, ngase i shihnin të zëvendësueshëm me emra përkatës të prejardhur jo të nyjzuar. Pra, në njërin anë ajo ishte arsyeja e konstatimeve të tilla jofavorizuese për emrat e gjinisë asnjane por në anën tjetër ndër shkaqet me më ndikim, për konstatimet për pasivizimit të asnjane në përgjithësi, për mendimin tonë, ka shërbyer ndryshimi i metodës së punës rreth hartimit të fjalorit përshkrues normativ të vitit 1980, i botuar në emër të AKSHSH. Kështu në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*(1980), në vend të asnjanesit që referohej (përdorej) në Fjalorin e gjuhës shqipe 1954, tani referohen (parapëlqehen) trajtat e foljes përkatëse. Këtë fakt këtu po e ilustruam vetëm me një shembull:

Në FGJSH (1954): gufim – të gufuarit,

Në FGJSSH (1980) –Veprimi sipas kuptimeve të foljeve *gufoj, gufohet*.

Kështu me një gjest të tillë me mija emra asnjane me të cilët manipulohesh në FGJSH 1954 nuk dalin të përfshirë fare në FGJSSH 1980. Pra ky fakt s’do koment.

Së njëmbëdhjeti, ndër çështje të hapura lidhur me asnjanesit në shqipen e sotme, përveç çështjes së përkufizimit terminologjik të tre tipave të asnjanesve të identifikuar të rasës emërore si rasë përfaqësuese (asnjanesve të mirëfilltë të paparanyjzuar dhe dy tipave të paranyjzuar, vend të veçantë në trajtim zë çështja e tipit të asnjanesit ablatival (prejrrjedhor) ose me prejardhje nga trajtat e rasës rrjedhore. Këtë tip emrash asnjanesish e karakterizon pjesëza ose nyja e përparme *së* dhe emri në trajtën e pashquar me fundoren *-i* të njëjësit të rasës rrjedhore. Këta emra karakterizohen edhe me prejardhje prejmbiemërore, prejpjesore, por edhe nga kategori të tjera leksiko-gramatikore si p.sh:

*së mbari, së punuari, së koti, së dyti, së fundi* etj.

Madje po sipas prejardhjes ndryshon edhe implementimi i tyre në praktikë. Kështu prejmbiemërorët e kategoritë e tjera të emëruara në këtë mënyrë përdoren vetëm si ndajfolje a si shprehje ndajfoljore, ndërsa prejpjesorët të emëruar në këtë trajtë implemetohen në kuadër të togfjalëshave të lirë foljorë si: *mbarova së foluri, u kënaqëm së shikuari* e kështu me radhë, ku edhe pse si togfjalësh të lirë, janë të pandarë kuptimisht nga foljet përkatëse që i parashoqërojnë.

Së dymbëdhjeti, edhe pse asnjanesit e tipit të katërt (prejrrjedhorët) nuk dalin të trajtuar, madje as të cekur si asnjane në asnjërin nga fjalorët normativë përshkrues që konsultuam, identiteti i tyre si asnjane nuk dyshohet, madje në Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe (2011) janë shënuar me siglën as (asnjane) në zera të veçantë gjashtë shembuj të tillë..Sidoqoftë identiteti i tyre asnjane del i shënuar (trajtuar) në gramatikën e Akademisë (morfologji e sintaksë) si dhe në studime përkatëse të autorëve të caktuar, ku sadokudo emërtohen ose identifikohen si tip i veçantë asnjanesish. Këto fakte ishin të mjaftueshme që në këtë punim asnjanesit e tillë të trajtohen dhe të vlerësohen si tip i veçantë.

Së trembëdhjeti, për të dy tipat e asnjanesve të paranyjzuar të rasës emërore (si trajtë përfaqësuese), mund të thuhet se janë aktivë e prodhimtarë në shqipen e sotme,

sepse asnjansit e paranyjzuar të rasës emërore mund të thuhet se janë të pozicionuar fort në standardin e shqipes së sotme për këto tri arsye:

e para, nga tema e qartë motivuese fjalëformuese, qoftë mbiemërore ose ajo pjesore (foljore) që si të themi tema e tillë reflektohet drejtpërdrejt te kuptimi i emrit, d.m.th. tek asnjansi përkatës i paranyjzuar;

e dyta, nënfusha e qartë e specifikuar semantike që e mbulojnë emrat në fjalë, e cila ka të bëjë kryesisht me majat e fushës së gjerë të abstraksionit dhe

e treta, duke e pasur temën e qartë motivuese dhe nënfushën e qartë semantike që e mbulojnë aktiviteti dhe produktiviteti i emrave të tillë, varësisht nga konteksti, jo vetëm është i gjallë, por del me mundësi të pakufizuar shumimi.

Së katërmbëdhjeti, në të vërtetë edhe asnjansi i rasës rrjedhore ka një motivim të tillë, por jo aq të qartë, si dy tipat e paranyjzuar të sipërpërmendur, por edhe te këta emra ka njëfarë specifike që kushtëzon dhe motivon, qoftë në kuadër të shprehjes ndajfoljore, qoftë në kuadër të togfjalëshit foljor dhe së këtejmi edhe prodhimtaria dhe veprimi i tyre varësisht nga konteksti nuk shënon pasivim ose nuk del i kufizuar në shqipen e sotme letrare.

Së pesëmbëdhjeti, kur është fjala tek asnjansit e paranyjzuar si emra të mirëfilltë në shqipen e sotme nuk ka rigjallërim, madje nuk dalin të përfaqësuar as në fjalorët përkatës normativë të shqipes së sotme, megjithatë ende disa prej tyre nuk kanë dalë nga përdorimi pasi përdoren në gjuhën popullore si nga veriorët ashtu dhe nga jugorët, por edhe nga shqipfolësit në diasporë (ngulitjet e hershme), madje edhe në letrarishtesën e sotme disa trajta të emrave të tillë përkatës janë aktivë, por aq më tepër në frazeologjizma, idioma etj., ku e kanë edhe bekimin e standardit. Sidoqoftë, asnjansit e tillë, marrë në përgjithësi, mund të quhen me karakter mbeturinor.

Së gjashtëmbëdhjeti, në punim pas trajtimit të profilimit të nënfushave semantike që mbulojnë asnjansit në shqipen e sotme rezultati del kështu:

*Ndërsa tek emrat asnjane të paranyjzuar ende gjejnë përdorim, sa me thënë në 3 nënfusha të profiluara, tek emrat asnjans prejmbimërore janë 6 nënfusha të tilla të nëpërdukshme të profiluara, tek emrat asnjans prejpjesorë dalin 16, ndërkaq tek emrat prejrrjedhorë 5 nënfusha të profiluara dhe kjo ilustron me shembuj konkretë, por edhe këtu mbesin gjëra të hapura ose të paqartësuara mjaftueshëm a si duhet.*

Edhe pse në këtë punim identiteti i asnjansit në shqipen e sotme del i trajtuar mjaft në thellësi dhe gjerësi kjo nuk do të thotë se nuk kanë mbetur ende shumë gjëra të hapura, madje edhe disa konstatime mund të jenë të diskutueshme, prandaj ky punim le të jetë jo si sfidë, por si bazë mbështetëse nxitëse për standardologët e sidomos për studiuesit e tashëm e të ardhshëm për të çuar më tej trajtimin edhe të kësaj teme.



## **Emrat e autorëve të cekur, faqe:**

Abdullah Zajmi, 61.  
Abdullah Zymberi , 13, 27, 27, 28, 67, 121, 122, 123.  
Aleksandër Xhuvani, 54, 89, 89, 90, 89, 90. 90. 90,99.,  
Ali Dhrimo, 64.  
Ali B. Berisha, 61.  
Androkli Kostallari, 54, 54, 54, 55, 55, 58, 77, 78, 92, 93, 93, 96, 97, 99  
Bahri Beci, 17.  
B.Hajrullai 123, 123  
Destan Bajraktarui, 97.  
Eqerem Qabej 17.  
Gani Luboteni, 61,  
Harvej Mayer, 17,  
Henrik Bariçi,57.  
Idriz Ajeti, 17, 77, 78, 80.  
Jani Thomai. 62.  
Kolec Topalli. 18, 22, 37, 101, 106, 113, 123, 123.  
K. Kristofolidhu, 55, 134.  
Latif Mulaku, 17, 61.  
Mehdi Bardhi, 60.  
Mehmet Çeliku, 122.  
Mehmet Elezi, 38, 61, 62, 80.  
Migena Balla, 38.  
Mikel Ndreca, 60.  
Naser Pajaziti, 17.  
Nikollë Gazulli, 56.  
Ragip Mulaku, 27.  
Rami Memushaj. 17, 64.  
Remzi Parnaska, 27.  
Rexhep Ismajli, 17, 80.  
Rozana Rusghiti, 99.  
Selman Riza, 80.  
Sitki Imami 61.  
Sulejman Drini, 61.  
Shaban Demiraj, 16, 18, 77, 78, 82, 99,1 101,04, 104, 113, 114, 115.  
Tahir Dizdari, 57, 58..



## Literatura kryesore

- Ali Berisha, Fjalor i fjalëve të reja, Klinë, 2006.
- Abdullah Zymberi, Prania e emërzimit të në disa të folme popullore  
Gjurimime albanologjike, seria e shkencave filologjike, Priashtinë,  
36/2006; Asnjanësit te Bardhi, F. Bardhi - 100 vjetori i lindjes,  
IAP, Prishtinë 2007. Rreth historisë së asnjanësve të shqipes,  
sipas akademik Ajetit “ Gjuha shqipe, 2/2007.
- Aleksandër Xhuvani, Vepra 1, Tiranë 1980.
- Bahri Beci, .Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë 1958.
- Eqerem Çabej, Studime gjuhësore VII, Prishtinë 1986.
- Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1976.
- Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (A. Xhiko –R. Memushaj), Tiranë 2011).
- Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954.
- Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 2006
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980
- Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë 1954, 2002.
- Fjalori i “Bashkimit” 1908, Prishjtinë, rib. 1978.
- Fjalor rusisht-shqip, Moskë, 1954.
- Fjalor serbokroatisht - shqip (grup autorësh, IAP; Prishtinë 1974, rib. 1986.
- Fjalor serbokroatisht - shqip (grup autorësh).Tiranë 1948.
- Fjalor shqip-serbokroatisht (grup autorësh), IAP, Prishtinë 1981.
- Fjalor terminologjik serbokroatisht-shqip (grup autorësh), Prishtinë 1961.
- Frang Bardhi - 400-vjetori i lindjes (përmbledhje kumtesash), IAP,  
Prishtinë, 2007.
- Gramatike gjuhës shqipe 1, 2 (grup autorësh ), ASHSH, Tiranë, 2002
- Gramatika praktike e gjuhës shqipe, (grup autorësh), Tiranë 1998.
- Gjuha letrare shqipe për të gjithë (grup autorësh), Tiranë 1976.
- Henrik Bariç, Fjalor i gjuhës serbishte ose kroatishte dje i shqipes, Zagreb  
1950..
- Idriz Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes III, Prishtinë 1985.
- Kolec Topalli, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë 2011.
- Kongresi i drejtshkrimit, Prishtinë 1973.
- Konstantin Krisoforidhi, Fjalor shqip- greqisht 1904, rib. Prishtinë 1977.
- Mehmet Elezi, Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë 2006.
- Mikel Ndreca, Fjalor shqip-serbokroatisht, Prishtinë 1976.
- Nikollë Gazulli, Fjalorth i ri 1941, rib. Prishtinë 1968.
- Nuhi Veselaj, Foljet më -O në gjuhën shqipe, Prishtinë 2002.
- Rami Memushaj, Shqipja standarde, Tiranë 2005.
- Rexhep Ismajli, “Në gjuhë” dhe “për gjuhën”, Dukagjini, Pejë 1998.
- Revista *Seminari*, 25/1 2006, 26/1 2007, Prishtinë
- Selman Riza, Vepra 1, ASHAK, Prishtinë,1996.

Sokol Dobroshti, Fjaluer serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1053.  
Studime mbi leksikun...I, II, Tiranë 1972, III, Tiranë 1989.  
Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988.  
Tahir Dizdari, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë 2004  
Valter Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë  
në gjuhën shqipe, Gjirokastër 1999.